



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORTI VJETOR 2017

Nr. 17

Prishtinë, 2018

Tabela e përmbajtjes

1.	Fjala e Avokatit të Popullit.....	9
1.1	Institucioni i Avokatit të Popullit	10
1.2	Mandati i Institucionit të Avokatit të Popullit	10
2.	Promovimi i të Drejtave të Njeriut	13
3.	Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit.....	18
4.	Gjendja e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës	19
4.1	Legjislacioni	19
4.2	Mbrojtja gjyqësore e të drejtave.....	25
5.	Roli i ekzekutivit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut	32
5.1	Qeveria e Republikës së Kosovës	32
5.2	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK)	34
5.3	Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).....	35
5.4	Çështja e Fabrikës së Tubave (IMK) në Ferizaj.....	35
5.5	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP).....	36
5.6	Shpronësimet e pronës së paluajtshme.....	37
5.7	Kushtëzimi i regjistrimit të automjeteve me pagesën e tatimit në pronë	38
5.8	Zyra e Rregullatorit të Energjisë	39
5.9	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit.....	41
5.10	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Kosovë.....	42
5.11	Përgjegjësia për mjedisin jetësor.....	44
5.12	E drejta e qasjes në dokumente publike	52
6.	Të drejtat e fëmijëve.....	55
6.1	Gjendja e të drejtave të fëmijëve.....	55
6.2	Korniza ligjore dhe të drejtat e fëmijëve	56
6.3	E drejta e fëmijëve në arsim	56
6.4	Fëmijët me aftësi të kufizuara.....	57
6.5	Dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkolla	59
6.6	Të drejtat e fëmijëve në procedurat pranë organeve gjyqësore dhe administrative	60
6.7	Mbrojtja sociale dhe shëndetësore.....	60
6.8	Drejtësia për të mitur	61
7.	Barazia para ligjit	62

7.1	Vështtrim i paketës së ligjeve për të drejtat e njeriut - parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi	62
7.2	Personat me aftësi të kufizuar	65
7.3	Diskriminimi në punë	70
7.4	Të drejtat që ndërlidhen me HIV/AIDS në Kosovë	76
7.5	Pensionet	77
7.6	Strehimi social	79
7.7	Komunitetet pakicë.....	80
7.8	Kthimi dhe siguria	82
7.9	Shtetësia dhe regjistri civil	85
7.10	Arsimimi i komuniteteve.....	89
7.11	Komuniteti rom, ashakli, egjiptian	91
7.12	Përdorimi i gjuhëve	97
7.13	Barazia gjinore	100
7.14	Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020 dhe aktet nënligjore.....	101
7.15	Komunitetet LGBT.....	106
7.1	Liritë fetare në Kosovë.....	108
8.	Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës	110
9.	Përmbledhja e raporteve me rekomandime	116
9.1	Raportet Ex Officio	116
9.2	Raport me rekomandime për rastin ex officio nr. 1/2017 lidhur me faturimin paushall të shpenzimeve të ujit nga kompanitë e ujësjellësit.....	117
9.3	Raport me rekomandime ex officio nr. 44/2017 lidhur me zvarritjet procedurale në trajtimin e lëndëve nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	118
9.4	Raport me rekomandime ex officio nr. 265/2017 lidhur me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës	119
9.5	Raport me rekomandime ex officio nr. 278/2017 lidhur me mostrajtimin e personave me çrregullime kronike psikiatrike konform procedurave ligjore	121
9.6	Raport me rekomandime ex officio nr. 575/2016 lidhur me të drejtën në arsim për personat e privuar nga liria - mosrespektimi i afatit ligjor për fillimin e procesit mësimor në Qendrën Korrektuese në Lipjan.....	123
9.7	Raport me rekomandime ex officio nr. 582/2017, lidhur me trajtimin e punëve të pambaruara nga legjislatura e kaluar, sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës .	

9.8	Raport me rekomandime ex officio nr. 594/2017, lidhur me mbrojtjen efektive në procedurë penale dhe garantimin e barazisë së palëve – caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike.....	125
9.9	Raport me rekomandime ex officio nr. 551/2017, lidhur me heqjen e kompetencave të caktuara të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, sipas Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	128
9.10	Raport me rekomandime ex officio nr. 707/2017 lidhur me lirinë e shprehjes (medieve) dhe sigurinë e gazetarëve.....	129
10.	Raportet e bazuara në ankesa	133
10.1	Raport me rekomandime nr. 12/2017, lidhur me trajtimin e pabarabartë në caktimin e koeficientit të pagës për zyrtarët e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prishtinë	134
10.2	Raport me rekomandime nr. 347;729;730;333/2015 lidhur me kushtëzimin e qytetarëve nga komunat për pagesën e tatimit në pronë me rastin e regjistrimit të automjeteve	135
10.3	Raport me rekomandime nr. 11/2017 lidhur me moszbatimin e kontratës së punës dhe vendimit përfundimtar në procedurë administrative nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime	136
10.4	Raport me rekomandime nr. 597/2014 lidhur me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë	137
10.5	Raport me rekomandime nr. 438/2015 lidhur me zvarritjet e procedurave gjyqësore në shqyrtimin e padisë të parashtruar në Gjykatën Themelore në Ferizaj	138
10.6	Raport me rekomandime nr. 765/2016 lidhur me të drejtën në jetë dhe detyrimet pozitive për hetime efektive.....	138
10.7	Raport me rekomandime nr. 592/2016 lidhur me mosllogaritjen e stazhit të punës për ish zyrtarët policor sipas mënyrës që rregullonte Ligji për Punë të Brendshme i vitit 1978	140
10.8	Raport me rekomandime nr. 71/ 2015 lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në vendosjen e lëndës në Gjykatën Themelore në Mitrovicë në lëndën C.nr. 82/ 2013.....	141
10.9	Raport me rekomandim nr. 500/2015 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 3141/2013	142
10.10	Raport me rekomandim nr. 929/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC 1553/2014.....	143
10.11	Raport me rekomandim nr. 503/2015 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.1926/14.....	144
10.12	Raport me rekomandim nr. 161/2015 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 1457/2014	144
10.13	Raport me rekomandim nr. 238/2015 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prizren në lëndën C.Nr.450/2009	145
10.14	Raport me rekomandim nr. 236/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 1717/2015	146

10.15	Raport me rekomandim nr. 306/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 3194/2015	147
10.16	Raport me rekomandim nr.262/2014 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr.3930/2016	148
10.17	Raport me rekomandim nr. 477/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 1168/14	150
10.18	Raport me rekomandim nr. 553/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.Nr 2823/16.....	151
10.19	Raport me rekomandim nr. 690/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan	152
10.20	Raport me rekomandime nr. 431/2017 në lidhje me kufizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike.....	153
11.	Raportet e Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës.....	155
11.1	Raport me rekomandime lidhur me monitorimin e Qendrës Korrektuese në Dubravë .	155
11.2	Raport me rekomandime lidhur përkitazi me monitorimin në Qendrën e Mbjajtjes për të Huajt në Vranidoll	156
11.3	Raport me rekomandime përkitazi me monitorimin në Qendrën për Azilkërkues.....	157
11.4	Raport me rekomandime përkitazi me monitorimin në Qendrën Rajonale të Mbjajtjes në Prishtinë.....	158
11.5	Raport përkitazi me monitorimin në pikat e kalimit të kufirit në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë, pikën kufitare “Hani i Elezit” dhe pikën kufitare “Vërmicë” ..	160
11.6	Raport me rekomandime lidhur me vizitën në Institutin Special në Shtime	162
11.7	Raport me rekomandime lidhur me vizitën në Qendrën për Integrim dhe Rehabilitim të sëmurve kronik psikiatrik në Shtime	164
11.8	Raport me rekomandime lidhur me vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë.....	166
11.9	Raport i Mekanizmit Kombëtar Për Parandalimin e Torturës lidhur me Vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren.....	167
11.10	Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës lidhur me vizitën në Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa përkujdesje familjare.....	170
11.11	Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës për Vizitat në Stacionet Policore.....	172
12.	Letër Rekomandimet	175
12.1	Letër rekomandim - Ankesa nr. 318/2016.....	175
12.2	Letër rekomandim - Ex officio nr. 700/2016.....	175
12.3	Letër rekomandim - Ex officio nr. 43/2017.....	176
12.4	Letër rekomandim - Ankesa nr. 549/2015.....	177

12.5	Letër rekomandim - Ankesa nr. 914/2016.....	178
12.6	Letër rekomandim - Ankesa nr.792/2016.....	179
12.7	Letër rekomandim - Ex officio nr. 87/2017.....	180
12.8	Letër rekomandim - Ankesa nr. 497/2016.....	181
12.9	Letër rekomandim - Ankesa nr. 24/2016	181
12.10	Letër-rekomandim - Ankesa nr. 312/2017	183
12.11	Letër rekomandim - Ankesa nr. 619/2017.....	184
12.12	Letër rekomandim - Ankesa nr. 742/2015.....	185
12.13	Letër rekomandim - Ankesa nr. 692/2017.....	186
12.14	Letër rekomandim - Ankesa nr. 315/2016.....	187
13.	Amicus Curiae.....	188
13.1	Mendim juridik i Avokatit të Popullit, në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) në lidhje me gjendjen e homofobisë dhe transfobisë	188
13.2	Mendim juridik i Avokatit të Popullit, në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) në lidhje me paditë ndaj Autoritetit të Likuidimit që janë duke u trajtuar në këtë Gjykatë të paraqitura nga ish-punëtorët e Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr Salloniti” nga Hani i Elezit... ..	190
13.3	Mendim juridik i Avokatit të Popullit, në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) në lidhje me padinë e Komunës së Ferizajt, kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,	193
14.	Kërkesat për masë të përkohëshme	195
14.1	Kërkesë për shfuqizimin e nenit 55, paragrafët 4–5, dhe neneve 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, si dhe për pezullimin e menjëhershëm të këtyre dispozitave deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate.....	195
14.2	Padi dhe kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit.....	198
14.3	Kërkesë për pezullimin e zbatimit të vendimit – Rasti Ex officio 551/2017.....	200
15.	Aktivitetet e Institucionit të Avokatit të Popullit në fushën e promovimit për vitin 2017	202
16.	Bashkëpunimi ndërkombëtar.....	203
16.1	Bashkëpunimi me homolog dhe organizata të tjera ndërkombëtare.....	207
16.2	Projektet me mbështetje të organizatave ndërkombëtare	208
16.3	Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare	211
16.4	Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtar	212
17.	Komunikimi me publikun dhe mediat.....	212
18.	Financimi.....	217
18.1	Buxheti i IAP-së.....	217

18.2	Financimi i IAP-së nga Buxheti i Republikës së Kosovës	217
19.	Statisitikat.....	221
19.1	Përmbledhja statistikore e ankesave dhe rasteve për vitin 2017	221

1. Fjala e Avokatit të Popullit

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut paraqesin fundamentin e rendit juridik në Republikën e Kosovës. Për të 17-tën herë me radhë, Kuvendit të Republikës së Kosovës, i ofrohen të dhënat e përmbledhura vjetore, përmbajtësore dhe statistikore, si pasqyrim i respektimit, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në vendin tonë.

Përmbushja e obligimit kushtetues për t'i paraqitur Raport vjetor Parlamentit të vendit, këtë vit po bëhet në një fazë intensifikimi të rolit të ligjvënësit kundrejt përgjegjësive që kanë autoritetet publike për t'iu përgjigjur rekomandimeve të Avokatit të Popullit, e së këndejmi rivendosi së të drejtave të cenuara.

Në kontekst të fokusimit për periudhën raportuese 1 janar – 31 dhjetor 2017, Raporti paraqet gjendjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës në fushën e legjislacionit - procesit të hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve; mbrojtjes gjyqësore të të drejtave, me theks në: zvarritjen e procedurave gjyqësore, parashkrimin e lëndëve, mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, përmbaruesit privat, përfaqësimin ligjor të qytetarëve, si dhe mangësinë e gjyqësorit kundrejt mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sipas standardeve ndërkombëtare, në veçanti të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ) dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Raporti vjetor 2017 koncentrohet edhe tek roli i ekzekutivit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut; në të drejtat e fëmijëve; barazinë para ligjit - parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe raportimin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Po ashtu, ky Raport vjetor i rezervon hapësirë të veçantë promovimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si obligim i dalë nga dokumentet dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe nga Ligji për Avokatin e Popullit.

Duke pasur vazhdimisht për bazë pavarësinë institucionale, që udhëhiqet nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit dhe profesionalizmit, Institucioni i Avokatit të Popullit, mbetet i përkushtuar dhe i pakompromis në përmbushjen e arsyes thelbësore të themelimit: sundimit të ligjit dhe epërsisë së të drejtave të njeriut - si garanci e funksionimit të një shteti të mirëfilltë demokratik dhe aspirues për zbatimin efektiv të standardeve më të larta të pranuara ndërkombëtarisht e të garantuara në vendin tonë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik.

Bashkë me besimin se konstatimet dhe rekomandimet që janë përmbledhur në këtë Raport vjetor do të kenë vëmendjen tuaj të merituar, theksoj se respektimi i përkufizimeve normative dhe bashkëpunimi ndër-institucional janë domosdoshmëri për të arritur synimet e përbashkëta si shtet demokratik.

1.1 Institucioni i Avokatit të Popullit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (nenet 132-135) ka përcaktuar Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) si kategori kushtetuese, përkatësisht si institucion të pavarur kushtetues.¹ Avokati i Popullit mbikëqyr, promovon dhe mbron të drejtat dhe liritë themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës (më tej: autoritetet publike) si dhe krijimin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT).² Po ashtu, Avokati i Popullit përfaqëson mekanizmin e barazisë i cili promovon, monitoron dhe mbështet trajtimin e barabartë pa diskriminim në bazat e përcaktuara me Ligjin për barazi gjinore dhe Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi.³ Sipas Kushtetutës, Avokati i Popullit ka një ose më shumë zëvendës,⁴ ndërsa Ligji për Avokatin e Popullit përcakton se IAP përbëhet nga: Avokati i Popullit, pesë (5) zëvendës të Avokatit të Popullit dhe personeli i IAP-së.⁵

1.2 Mandati i Institucionit të Avokatit të Popullit

Mandati i Avokatit të Popullit është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Avokatin e Popullit në bazë të të cilëve merr dhe heton ankesat nga çdo person, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës, i/e cili/a pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë nga autoritetet publike në Kosovë.

IAP është i pavarur në ushtrimin e detyrave dhe nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga autoritetet publike, të cilat janë të detyruara t'i përgjigjen kërkesave të IAP-së dhe t'i paraqesin të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.

Në punën e vet IAP udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit⁶ si dhe ka pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj.⁷

Në kuadër të kompetencave të tij kushtetuese⁸ dhe ligjore,⁹ Avokati i Popullit zhvillon hetime për ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe aktet tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, posaçërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ).

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 132-135.

² Po aty, neni 132 dhe Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 1, paragrafi 1.

³ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 1, paragrafi 2.

⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 133, paragrafi 2.

⁵ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 5.

⁶ Po aty, neni 3, paragrafi 1.

⁷ Po aty, neni 3, paragrafi 3.

⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132.

⁹ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16.

Avokati i Popullit mund të zhvillojë hetime edhe me iniciativën e vet (*ex officio*) nëse dëshmitë, faktet, konstatimet ose njohuritë e fituara ofrojnë bazë për shkeljen e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, Avokati i Popullit përdorë ndërmjetësimin dhe pajtimin, si dhe mund t'u ofrojë shërbime të mira edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës që ndodhen jashtë shtetit. Shërbimet e ofruara nga IAP janë falas.

Nëse Avokati i Popullit gjatë kryerjes së hetimeve vëren se ka elemente të veprës penale e informon organin kompetent për fillimin e hetimeve; po ashtu Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi. Avokati i Popullit nuk ndërhyjnë në rastet dhe në procedura tjera ligjore, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave, por Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Po ashtu, Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.¹⁰

Në kuadër të IAP-së funksionon edhe Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (MKPT).¹¹ Avokati i Popullit, në kuadër të përgjegjësi si MKPT, është i obliguar që t'i vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria (duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut), si dhe të krijojë mekanizëm të veçantë që do të kryej të gjitha funksionet e MKPT-së. Avokati i Popullit duhet të bashkëpunojë me mekanizmat ndërkombëtar dhe vendor në fushën e parandalimit të torturës si dhe formave të tjera të trajtimit apo ndëshkimit mizor, jonjerëzor dhe poshtëruës. Gjithashtu, Avokati i Popullit mund të jap sugjerime dhe rekomandime për personat dhe institucionet përgjegjëse ku mbahen personat e privuar nga liria pa marrë parasysh llojin apo objektin dhe rrethanat e mbajtjes së tyre, për përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të tyre.

Avokati i Popullit kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi, Ligjin për barazi gjinore dhe legjisllacionin tjetër në fuqi; mbledh të dhëna statistikore për çështjet e diskriminimit dhe barazisë të paraqitura në IAP, të cilat edhe i publikon; publikon raporte dhe jep rekomandime për politikën dhe praktikën për luftimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë; bashkëpunon me partnerët social dhe OJQ-të që merren me çështje të barazisë dhe kundër diskriminimit si dhe me trupa të ngjashëm ndërkombëtar me Avokatin e Popullit.¹²

Avokati i Popullit ka edhe përgjegjësitë e theksuara ligjore: jo vetëm t'i hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit por edhe të angazhohet për

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 113, paragrafi 2 dhe 135, paragrafi 4; Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 10; Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, neni 29.

¹¹ Po aty, neni 17.

¹² Ligji për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, neni 16, paragrafët 13-16.

eliminimin e tyre; të hartojë dhe miratojë procedura të veçanta për pranimin dhe trajtimin e ankesave për fëmijët, si dhe krijimin e ekipit të specializuar për të drejtat e fëmijëve dhe të programit të përhershëm për vetëdijesimin e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe rolin e IAP-së për mbrojtjen e tyre; t'i bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe t'i rekomandojë Qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve të tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit; t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve si dhe nxjerrjen apo ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës; të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës; të rekomandojë harmonizimin e legjislacionit vendor me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut, barazisë dhe diskriminimit, dhe të kryejë hulumtime për çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës; të bashkëpunojë, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, me të gjitha autoritetet vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut; të ruaj fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të dhënave që i merr, duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurisë së ankuesve, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale (obligim ky që vlen për Avokatin e Popullit, zëvendësit e tij dhe personelin e IAP-së, edhe pas përfundimit të mandatit ose marrëdhënies së punës).¹³

Ankesat kundër administratës publike, qytetarët mund t'i parashtrojnë sipas procedurës së thjeshtë dhe pa pagesë. Ankesat e drejtuara në IAP mund t'u referohen veprimeve, mosveprimeve ose vendimeve të administratës publike, që nga ankuesit mund të konsiderohen të padrejta ose të pafavorshme. Në shqyrtimet e ankesave të tilla, veprimet e juristëve të IAP-së kanë të bëjnë me ofrimin e këshillave juridike, me kërkim të të dhënave nga administrata publike, nga gjykatat dhe nga institucionet tjera të rëndësishme, lidhur me ankesat e paraqitura, si dhe me mbikëqyrjen e procedurave të caktuara administrative dhe gjyqësore.

Në rastet që kërkojnë veprime të menjëhershme, Avokati i Popullit paraqet kërkesa për masa të përkohshme. Nëse Avokati i Popullit konsideron se duhet të merren masa të menjëhershme nga autoritetet publike, ai mund të kërkojë ligjërisht që organi administrativ kompetent të ndërmarrë ose të suspendojë një veprim të veçantë, si masë e përkohshme për të parandaluar dëmtimin e papërmirësueshëm të ankuesve apo pasurisë së tyre.

Në qoftë se kërkesat për intervenim dhe përpjekjet për ndërmjetësim nuk janë të suksesshme, Avokati i Popullit mund të nxjerrë raport, duke siguruar analiza dhe paraqitje publike për shkelje të të drejtave të njeriut ose të ligjeve të aplikueshme, së bashku me rekomandime për institucionin publik, për të evituar shkeljet. Raportet janë

¹³ Po aty, neni 18.

metoda e fundit e institucionit për avokim. Raporti i drejtohet autoritetit që ka bërë shkelje, kurse kopja e raportit i dërgohet Kuvendit të Kosovës dhe organizatave të tjera përkatëse. Ndërsa, raportin vjetor për vitin paraprak, Avokati i Popullit ia paraqet Kuvendit të Kosovës deri më 31 mars të vitit vijues, i cili shqyrtohet në seancë plenare në Kuvend gjatë sesionit pranveror.¹⁴

Avokati i Popullit, në kuadër të obligimeve ligjore dhe me qëllim të përmbushjes sa më efektive të mandatit të përcaktuar me Kushtetutë dhe me Ligjin për Avokatin e Popullit,¹⁵ më 18 janar 2017, ka miratuar: *Rregulloren Nr. 01/2017 për përshkrimin e detyrave të punës dhe klasifikimin e vendeve të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit; Rregulloren Nr. 02/2017 për procedurën e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese të nëpunësve në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Rregulloren Nr. 03/2017 për avancim në karrierë dhe transferimin e nëpunësve të Institucionit të Avokatit të Popullit*, të cilat janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (GZRK) më 23 janar 2017, dhe kanë hyrë në fuqi po atë ditë.

Kompetencat e Avokatit të Popullit për të shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi në përgjithësi dhe diskriminimi gjinor në veçanti janë paraparë me dy ligjet tjera bazike për të drejtat e njeriut (Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligjin për Barazi Gjinore).

Kështu, sipas Ligjit për Barazi Gjinore,¹⁶ Avokati i Popullit është institucion i barazisë gjinore që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor, në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.

Ndërsa, sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,¹⁷ Avokati i Popullit është institucion i pavarur, i cili bënë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.

Përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, është Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM).¹⁸

2. Promovimi i të Drejtave të Njeriut

Avokati i Popullit, në vitin 2017, vëmendje të veçantë i kushtoi promovimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si obligim i dalë nga dokumentet dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe Ligji për Avokatin e Popullit.

Avokati i Popullit, konsideron që shteti duhet të vazhdojë të fuqizojë ndërmarrjen e masave të përshtatshme për të promovuar të kuptuarit e të drejtave civile, politike,

¹⁴ Po aty, neni 29.

¹⁵ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 37.

¹⁶ Ligji nr. 05/L-020 për barazi gjinore, neni 13.

¹⁷ Ligji nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi, neni 9.

¹⁸ Po aty, neni 10, paragrafi 1, pika 1.2.

ekonomike, sociale dhe kulturore, nga të gjithë qytetarët brenda juridiksionit të saj, përmes publikimeve, qasjes së plotë dhe të barabartë në të gjitha dokumentet vendore dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, përfshirë raportet periodike nga shteti tek organet e themeluara nga instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Po ashtu, mbetet që institucionet vendore të përforcojnë veprimet në drejtim të promovimit dhe edukimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në të gjitha nivelet e arsimit, si dhe të sigurojë që programet edukative dhe trajnimet të avancohen në drejtim të njohjes së të drejtave të njeriut .

Rol me rëndësi në promovimin e të drejtave të njeriut kanë edhe mediat. Avokati i Popullit, vëren që si TV-të, po ashtu radiot dhe shtypi ditor duhet të përfshijnë më tepër në skemat e tyre programore, emisione dhe programe që kanë për qëllim edukimin mbi të drejtat dhe liritë e njeriut dhe promovimin e tyre, për target grupe të ndryshme. Në veçanti, duhet të shtohen programet me temë për të drejtat e njeriut, si dhe respektimi i tyre, në programet për fëmijë.

Me qëllim të vetëdijësimit të publikut, përmes aktiviteteve të ndryshme si edukimi, trajnimi, informimi dhe hulumtimi, për të forcuar më tej tolerancën, paqen dhe marrëdhëniet miqësore mes kombeve dhe midis të gjitha grupeve racore, etnike dhe fetare, Avokati i Popullit, duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm dhe përgjegjësini që mbanë në ruajtjen e demokracisë, inkurajon individët, organizatat joqeveritare dhe institucionet përkatëse për t'i intensifikuar aktivitetet drejt promovimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Promovimi i të Drejtave të Njeriut nga Avokati i Popullit

Bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë e Institucionit të Avokatit të Popullit, me Kushtetutë, ligj dhe standarde ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për promovimin, ofrimin e informatave, trajnimeve, edukimit, raportimit dhe hulumtimit, bashkëpunimit me organizatat joqeveritare dhe shoqërië civile në përgjithësi, në lidhje me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, marrjen e iniciativave, dhënien e deklaratave, qëndrimeve dhe opinioneve për promovimin e të drejtave të njeriut të garantuara me akte dhe standarde ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kushtetutë dhe ligje, Avokati i Popullit, gjatë vitit raportues ka themeluar Departamentin për Bashkëpunim, Raportim dhe Promovim të të Drejtave të Njeriut.

Fushëveprimi dhe përgjegjësitë e departamentit përshijnë bashkëpunimin me instucionet vendore dhe ndërkombëtare, si dhe organizatat që merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, informimin e publikut për punën e institucionit nëpërmjet raporteve vjetore dhe të veçanta, organizimit të tryezave të përbashkëta, seminareve e konferencave; bërjen të njohur të të drejtave të njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijësimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe përmes trajnimeve, kontakteve të drejtpërdrejta me akterët e zbatimit të ligjit dhe përmes bashkëpunimit me media. Departamenti, ndër të tjera ka

kompetencë për të rekomanduar autoritetet kompetente në Republikën e Kosovës, në çështjet që kanë të bëjnë me promovimin, avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe të bashkëpunojë me partnerë socialë dhe organizatat joqeveritare që merren me çështjet e barazisë, mosdiskriminimit dhe të drejtat e njeriut.

Në këtë drejtim duke pasur parasysh që promovimi kualitativ dhe efektiv i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, është element thelbësor dhe forcë shtytëse për zbatim efektiv të të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit, si objektivi të parë strategjike në Strategjinë dhe Planin Zhvillimor të Institucionit të Avokatit të Popullit 2017-2019¹⁹, ka paraparë Promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Realizimi i objektivit të parë, *“Ngritja e besueshmërisë së qytetarëve në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”*, bazohet në një nga shtyllat e misionit kushtetues dhe ligjor të IAP, në drejtim të promovimit të të drejtave të njeriut, përmes vetëdijësimit dhe informimit të publikut përmes mediave dhe komunikimit të drejtpërdrejtë, si dhe transparencës së aktiviteteve dhe punës së IAP-së, si një nga format e llogaridhënies para qytetarëve, përmes së cilës rritet edhe besueshmëria e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës në Institucionin e Avokatit të Popullit, pa dallime, duke përfshirë edhe pakicat.

Prioritetet e Avokatit të Popullit, të përcaktuara në këtë strategji janë si në vijim:

1. Vetëdijësimi i publikut për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, promovimi i mandatit dhe edukimi për të drejtat e njeriut tek institucionet përgjegjëse për zbatimin e standardeve kushtetuese dhe ligjore në vend;
2. Fuqizimi i imazhit të Institucionit të Avokatit të Popullit, dhe maksimalizimi i ndikimit të tij;
3. Forcimi i rolit të IAP-së në promovimin e transparencës, llogaridhënies, integritetit dhe njohjen e tij si institucion që ushtron mandatin e tij në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale;
4. Rrjetëzimi dhe promovimi i aktiviteteve të Institucionit të Avokatit të Popullit përmes komunikimit institucional në nivel vendi;
5. Fuqizimi i bashkëpunimit me mediat dhe shoqërinë civile;
6. Sfidimi publik i diskriminimit dhe pabarazisë.

Me qëllim të ngritjes së vetëdijësimit dhe edukimit të publikut për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe promovimin e mandatit të institucionit, Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët e tij, gjatë vitit raportues kanë ndërmarrë një sërë aktiviteteve si:

¹⁹ Strategjia dhe Plani Zhvillimor i Institucionit të Avokatit të Popullit 2017-2019, është dokument bazë për planifikimin vjetor të punës dhe aktiviteteve të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe ky dokument poashtu ka për qëllim që të shërbejë si udhëzues përgjatë këtyre viteve për promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vizionin e Avokatit të Popullit

organizimi dhe pjesmarrja në tryeza, konferenca, media, organizimi i fushatave vetëdijësuese me grupe të ndryshme, duke filluar nga nxënësit e shkollave të niveleve të ndryshme, studentët, shërbyesit civil, punëtorët për të drejtat e njeriut, prokurorët dhe gjykatësit, Policinë e Kosovës, grupet dhe komunitetet e marginalizuara. Vlen të theksohet se veprimet dhe aktivitetet në fjalë kanë ndikuar drejtpërsëdrejti edhe në drejtim të fuqizimit të imazhit të Institucionit të Avokatit të Popullit, maksimalizim të ndikimit të tij.

Gjatë vitit 2017, janë transmetuar dy spote televizive, të cilat kanë të bëjnë me promovimin e mandatit ligjor të IAP-së dhe kompetencat e dala nga pakoja ligjore për të drejtat e njeriut, Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, dhe Ligji për Barazi Gjinore. Po ashtu, është transmetuar edhe spoti televiziv “Njih me të drejtat tua” që ka për qëllim promovimin e platformës “Know Your Rights” apo “Njih me të drejtat tua”²⁰

Gjatë vitit, rëndësi e veçantë i është kushtuar intesifikimit të veprimeve në rrjetizimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, përmes formave të ndryshme me institucione publike, shoqërinë civile si dhe organizata ndërkombëtare.

Ka vazhduar bashkëpunimi i institucionit me mekanizmat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, institucionet kombëtare të vendeve të tjera që janë kompetente në fushat e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut organizatat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që veprojnë në Kosovës.

Avokati i Popullit, në Konferencën Ndërkombëtare me temë ”Përmirësimi i të drejtave të njeriut në Evropë: Si të rritet hapësira demokratike”, e cila u mbajt më 11 dhe 12 maj 2017, në Zagreb, e realizuar nën përkrahjen e IOI, ENHRI dhe Equinet, e në të cilën u diskutuan tema si: luftimi i terrorizmit, integrimi dhe respektimi i dallimeve, luftimi i diskriminimit, ruajtja e demokracisë në Evropë etj, nënshkroi Deklaratën e Zagrebit, e cila ka për qëllim të përkujtoj rolin dhe përkushtimin e institucioneve të drejtave të njeriut në nivel kombëtar, për mbrojtje dhe promovim të të drejtave të njeriut dhe bashkëpunim.

Më 15 shtator 2017, Avokati i Popullit dhe homologët e tij nga Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia, Sllovenia dhe Serbia, në konferencën e mbajtur në Ljublanë të Sllovenisë, kanë nënshkruar Deklaratën për bashkëpunimin e Ombudsmanëve në fushën e mjedisit dhe të drejtave të njeriut. Duke pasur parasysh rolin e Ombudsmanëve për të pranuar dhe trajtuar kërkesa që kanë të bëjnë me çështje

²⁰ “Know Your Rights” (Njih të Drejtat Tua) është një platformë online, me të cilën Institucioni i Avokatit të Popullit ka për qëllim të promovojë të drejtat e të rinjve të moshës 16-29 vjeçare, sipas legjislatioit në fuqi në Kosovë. Platforma ofron udhëzime për disa nga të drejtat në fushët e arsimit, shëndetësisë, komuniteteve jo shumicë, punësimit, familjes, sistemit të drejtësisë, punës në komunitet, përfitimet sociale, dhe fuqizimit të rinisë. Përshkrimet e të drejtave janë të shoqëruara me një hartëzim të institucioneve që janë përgjegjëse për zbatimin e të drejtave, si dhe ato në të cilat të rinjtë mund të drejtojnë ankesat në rast të shkeljes së të drejtave të tyre. Platforma gjithashtu përmban informata të detajuara rreth procesit të dërgimit të ankesave në Institucioni e Avokatit të Popullit dhe ofron mundësi të raportimit të shkeljeve drejtpërdrejt përmes platformës “Know Your Rights”.

mjedisore, të cilat afektojnë jo vetëm shtetet përkatëse, por edhe shtetet në fqinjësi e më tej në kontekstin global, si dhe duke theksuar se pjesëmarrja e publikut për çështje mjedisore është nën nivelin e dëshirueshëm, nënshkruan themelimin e Rrjetit të Ombudsmanëve për Mjedis dhe të Drejta të Njeriut, i cili ka për qëllim bashkëpunimin e ngushtë, shkëmbimin e njohurive, praktikave dhe përvojave, zhvillimin e formave në të cilat Ombudsmanët do t'i përgjigjeshin sfidave mjedisore, në përmbushje të mandatit që kanë.

Avokati i Popullit si institucion kombëtar për të drejtat e njeriut, ka vazhduar të jap kontributin e tij lidhur me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, në raportet që i kërkohet t'i paraqes institucioneve ndërkombëtare dhe rajonale.

Avokati i Popullit, duke i konsideruar si partner serioz në përmbushjen e përbashkët të obligimit për promovimin dhe edukim të të drejtave të njeriut, si dhe inkurajimin për respektimin e të drejtave të njeriut gjatë vitit 2017, ka vazhduar bashkëpunimin me organizatat joqeveritare.

Me qëllim të bashkëpunimit me Organizata Joqeveritare, gjatë vitit 2017, Avokati i Popullit, ka nënshkruar marrëveshje të veçanta mirëkuptimi me organizatat në vijim: Civil Rights Program, Advanced Together, KIPRED, ARTPOLIS, QSJP, Shoqata e Mamive të Kosovës, UNHCR, Universiteti "ILIRIA", Ministria e Mirëqenies Sociale, Demand for Justice (NCSC), QKRMT, Terre des Hommes, Forumi i Aftësisë së Kufizuar.

Në mbështetjen e misionit të OSBE-së, Avokati i Popullit, së bashku me një grup të Organizatave Joqeveritare, të profileve të ndryshme të përfaqësuara nga komunitetet joshumicë, personat me aftësi të kufizuara, forumet rinore, komuniteti i grave dhe grupet e marginalizuara, në muajin nëntor ka mbajur një punëtori tri ditore, në të cilën përmes identifikimit të fushave më kritike të të drejtave të njeriut, problemeve më të mëdha dhe shkeljeve sistematike, në bashkëpunim është hartuar një plan i veprimit, si përgjigje e përbashkët ndaj diskriminimit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut. Plani përmban një numër prioritetesh dhe aktivitësh për vitin 2018, me synim të përmirësimit të qasjes në arsim, përmirsimin e kushteve të punës, të shërbimeve dhe qasjes së papenguar të personave me aftësi të kufizuara, respektimin e të drejtave të komuniteteve joshumicë dhe ngritjen e vetëdijesimit dhe edukimin për të drejtat e njeriut.

Gjatë vitit raportues, në kuadër të projekteve të zbatuara nga shoqëria civile në partneritet me Institucionin e Avokatit të Popullit janë realizuar një sërë aktivitësh që kishin për qëllim promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe njëkohësisht edhe promovimin e rolit dhe mandatit të IAP-së.

Si pjesë e projektit *“Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut në Kosovë përmes shoqërisë civile aktive”*, mbështetur nga BE-ja, dhe i zbatuar nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Artpolis, në periudhën tetor - dhjetor të vitit 2017, është shfaqur *Forum*

Teatri, "Stigma – Kërko të drejtën tënde". Forum teatri është shfaqur në shtatë (7) komuna të Kosovës dhe atë në: Qendrën Korrektuese në Lipjan, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Prizren, Gjakovë dhe Prishtinë.

Po ashtu, në kuadër të aktiviteteve të projektit „*OmbudsWatch – Promovimi i Rolit të Avokatit të Popullit në Kosovë*”, projekt ky i zbatuar nga BIRN Kosova dhe ACDC (Qendra e Avokimit për Kulturë Demokratike) në partneritet me IAP-në dhe i mbështetur nga Ambasada e Holandës në Kosovë është bërë ndarja e çmimeve për tri storiet më të mira gazetareske në çështjet e të drejtave të njeriut. Aktiviteti ka pasur për qëllim inkurajimin e komunitetit të gazetarëve që përmes storieve të tyre, të formave të ndryshme, të informojnë dhe të vetëdijesojnë publikun për gjendjen e të drejtave të njeriut në vend, si dhe respektimin dhe raportimin për të drejtat e njeriut.

Avokati i Popullit dhe Organizatat Joqeveritare të Republikës së Kosovës, nën moton “*Çohu për të drejtat e njeriut*”, në këtë iniciativë të përbashkët, në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, më 10 dhjetor 2017, në Prishtinë, në mënyrë unanime nënshkruan Deklaratën e përbashkët, qëllimi i të cilës është mbrojtja e të Drejtave dhe Lirive Themelore të të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.

Më këtë rast për nder të shënimit të Ditës Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, u organizua marshi i përbashkët, përmes të cilit u bë thirrje Institucioneve të Republikës së Kosovës për krijimin e masave efektive për ushtrimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, të përcaktuara nga Kushtetuta e Kosovës dhe instrumentet ndërkombëtare. Njëherit u ftuan të gjithë akterët e pushtetit shtetëror, që t’i fuqizojnë përpjekjet për promovimin dhe edukimin mbi të drejtat e njeriut dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Nga Qeveria e Republikës së Kosovës, u kërkua që t’i adresojë me prioritet çështjet e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe t’u ofrojë përkrahje më të fuqishme institucionale në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe organizatave joqeveritare.

3. Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit

IAP në zyrat e saj për çdo ditë pune (nga e hëna deri të premten) nga ora 8:00 - 16.00 pret qytetarët, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre. Ata priten nga këshilltarët ligjorë të IAP-së, të cilët i trajtojnë rastet me kujdes, konfidencialitet dhe profesionalizëm.

Për të lehtësuar qasjen e qytetarëve të Kosovës në IAP, përveç Zyrës Qendrore në Prishtinë, IAP ka edhe zyra rajonale në Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicën jugore dhe veriore, Pejë, Prizren dhe Graçanicë.

Zyrat e IAP-së përbëhen nga stafi profesional që u shërben qytetarëve dhe përgjigjet në kërkesat dhe ankesat e tyre, si dhe mbron të drejtat të cilat ata konsiderojnë se u janë shkelur.

Njëra nga format e qasjes më të lehtë të qytetarëve në IAP është organizimi i Ditëve të Hapura nga Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij. Ato organizohen në Prishtinë dhe në zyrat rajonale. Zyrat rajonale i njoftojnë qytetarët e komunave përkatëse për ditët e hapura përmes publikimit të datave nëpër këto komuna, në mediat lokale dhe ueb faqen zyrtare të IAP-së.

Format tjera të qasjes janë edhe me postë, telefon dhe me postë elektronike, që po përdoret gjithnjë e më shumë dhe e cila, në të shumtën e rasteve aktualisht po përdoret për parashtrimin e ankesave nga qytetarët që jetojnë jashtë Kosovës. Në Zyrën Qendrore të IAP-së në Prishtinë ekziston edhe linja telefonike falas për raste urgjente, por edhe për raste të tjera të zakonshme.

Zyrtarët e IAP-së bëjnë vizita të rregullta në të gjitha burgjet dhe në vendet ku mbahen personat me liri të kufizuar në Kosovë. Për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë me të burgosurit, në bashkëpunim me autoritetet e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe me autoritetet përgjegjëse të burgjeve në Kosovë, IAP që nga viti 2004, në të gjitha burgjet dhe në qendrat e paraburgimit në Republikën e Kosovës, në vende të dukshme, ka vendosur kutitë postare, të cilat hapen vetëm nga përfaqësuesit e IAP-së. Kjo praktikë ka dëshmuar se kutitë e vendosura nëpër burgje, përkatësisht në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, kanë ndihmuar shumë të burgosur ose të paraburgosur ta vënë kontaktin e parë me Avokatin e Popullit. Kutitë e tilla janë vendosur edhe në Entet dhe Qendrat e Shëndetit Mendor, gjë që lehtëson qasjen e pacientëve në IAP. Këto ente dhe qendra vizitohen rregullisht për çdo muaj nga përfaqësuesit e IAP-së.

4. Gjendja e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës

4.1 Legjislacioni

Sikurse në vitet e mëparshme, edhe gjatë vitit 2017, Avokati i Popullit ka përcjellë procesin e hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve. Specifike për këtë vit ishin Programet legjislative të qeverive të dy legjislaturave, për shkak të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare që u mbajtën më 11 qershor 2017.²¹

Nëse i përmbledhim Programet legjislative për vitin 2017, të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 30 dhjetor 2016²² dhe më 18 shtator 2017²³, vërehet se janë paraparë që gjatë vitit 2017, të shqyrtohen dhe të miratohen 105 projektligje (prej tyre 61 të reja dhe 44 me ndryshime dhe plotësime të ligjeve ekzistuese) si dhe Projekt-Kodi Civil i Kosovës.

Po qe se krahasojmë programet legjislative për tre vjetët e fundit (2015 - 2017) vërehet trendi i zvogëlimit të numrit të projektligjeve të propozuara me ndryshime dhe plotësime.

²¹ Në këtë vit janë mbajtur edhe zgjedhjet lokale (për kuvendet komunale dhe kryetarë të komunave) më 22 tetor 2017 dhe raundi i dytë për kryetarë të komunave më 19 nëntor 2017.

²² Mbledhja e 125-të e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimi nr. 01/125, datë 30 dhjetor 2016.

²³ Mbledhja e 3-të e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimi nr. 02/03, datë 18 shtator 2017, plotësuar me Vendimin nr. 02/12, datë 3 nëntor 2017.

Deri sa në vitin 2015, 65% të projektligjeve të propozuara kanë qenë me ndryshime dhe plotësime, në vitin 2016 numri i projektligjeve të tilla ka qenë më i vogël (50%), kurse gjatë vitit 2017 ka rënë në 42%.

Edhe pse vërehet se numri i projektligjeve me ndryshime dhe plotësime është në rënie e sipër, trendi i projektligjeve të tilla të propozuara është ende i madh. Ky fakt është tregues që dëshmon se ligjet e miratuara nuk po e përmbushin standardin e cilësisë së dëshiruar dhe se nuk janë hartuar në pajtim me zhvillimet në ato fusha të cilat kanë synuar t'i rregullojnë, dhe kjo nuk i kontribuon parimit të sigurisë juridike.

Avokati i Popullit ka analizuar me vëmendje Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës dhe ka konstatuar se është e nevojshme të bëhen ndryshime në dispozitën e cila rregullon punët e pambaruara (86). Sipas kësaj dispozite, në fund të mandatit të Kuvendit, ekziston detyrimi për të rinisur çdo punë nga e para. Një rregullim i tillë rrezikon të vonojë punët e Kuvendit, si dhe të pengojë mirëfunksionimin e institucioneve të tjera që janë në pritje të vendimeve të tij. Duke marrë parasysh këtë rrezik, detyrimi që Kuvendi t'i kthejë të gjitha punët në hapin e parë në fillim të legjislaturës së re, do të mund të justifikohet vetëm nëse ka arsye të forta për një detyrim të tillë. Lidhur me këtë, IAP ka përgatitur Raport me Rekomandime nëpërmjet të cilit kërkuar nga Kuvendi që në Rregulloren pasuese të Kuvendit të Republikës së Kosovës të përcaktohet mundësia që Kryesia e Kuvendit, në fillim të çdo legjislature, të gëzojë të drejtën për të vendosur, me kërkesë të komisioneve dhe institucioneve të ndryshme, t'i vazhdojë punët e pambaruara nga legjislatura e kaluar, në vend që t'i rifillojë këto punë nga hapi i parë.

Në raportet vjetore të viteve të kaluara IAP ka tërhequr vërejtjen për lëshimet evidente në procesin e hartimit të ligjeve dhe të projektligjeve të propozuara me ligjet ekzistuese, prandaj me qëllim të konsolidimit të legjislacionit, ka rekomanduar fuqizimin e Drejtorisë për standardizim, përafrim dhe harmonizim ligjor të Kuvendit të Kosovës. Në këtë drejtim vjet janë ndërmarrë disa masa për themelimin e Njësisë për analiza ligjore që do të funksiononte në kuadër të kësaj Drejtorie, e cila do të ndihmonte Komisionet parlamentare me ekspertizë ligjore gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit të projektligjeve dhe do të ndikonte në forcimin e kapaciteteve profesionale për analiza ligjore dhe përafrimin e legjislacionit të Kosovës me legjislacionin e Bashkimit Evropian për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA). Mirëpo, përkundër premtimeve se Njësia do të funksionalizohet brenda tremujorit të parë të vitit 2017, me punësimin e dhjetë (10) ekspertëve, me theks të posaçëm në të drejtën evropiane, gjatë vitit 2017, nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim dhe kjo Njësi nuk është funksionalizuar ende.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se është e nevojshme që Qeveria të hartojë Planin e Përafrimit Ligjor për një periudhë të caktuar, sipas të cilit Kuvendi i Kosovës do të monitoronte procesin e përafrimit të legjislacionit vendor me atë evropian. Rrjedhimisht, është e nevojshme që ky plan të aprovohet nga Kuvendi dhe në të, të përfshihen edhe pjesët e legjislacionit të miratuar nga Qeveria dhe të monitorohen nga Komisioni për Integritet Evropian. Me qëllim që ky plan të implementohet në mënyrë sa më efektive do të

jetë e nevojshme të krijohet dhe të funksionojë një mekanizëm efikas i bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë në fushën e përafrimit me legjislacionin evropian. Në këtë mënyrë Kuvendi do të mund ta implemetonte këtë plan në kohë të arsyeshme dhe do të mbulonte tërë legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Procesi i hartimit të ligjeve është përcjellë edhe me mungesën e konsistencës gjuhësore dhe terminologjike, si pasojë edhe e mungesës së terminologjisë unike juridike. Kjo dukuri ka shkaktuar vështirësi në zbatimin përkatës të ligjeve, por edhe në interpretim gjatë zbatimit të tyre. Përkitazi me këtë është e nevojshme që sa më shpejtë të bëhet standardizimi i terminologjisë juridike përmes hartimit të fjalorit terminologjik juridik, i cili do të ndihmonte sponsorizuesit e ligjeve, por edhe deputetët në procesin e hartimit dhe të miratimit të ligjeve.

Proces tjetër i rëndësishëm është edhe ai i kodifikimit të ligjeve, përkatësisht përmbledhjes së ligjeve të cilat rregullojnë fushën e njëjtë apo të përafërt. Ky proces do të siguronte që i gjithë legjislacioni i një fushe apo i një resori të jetë i përmbledhur në një dokument, gjë që do të lehtësonte qasjen në ligje që përbën kusht themelor për zbatimin e tyre, si dhe ndihmesë për zbatuesit e ligjeve për kontroll efektiv të fushave përkatëse të së drejtës. Viteve të kaluara IAP i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës, përmes opinioneve të saj, që ta fillojë me këtë proces. Në Projektin legjislativ për vitin 2017, është planifikuar hartimi dhe miratimi i Kodit Civil të Kosovës dhe në këtë drejtim, më 25 maj 2017, Ministria e Drejtësisë (MD) ka prezantuar fillimin e punës për hartimin e tij, për çka ka krijuar grupin punues përkatës. MD si referencë ka vendosur që Kodi Civil të ndjekë modelin gjerman. Ky projekt është i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian (BE). Lidhur me këtë, Avokati i Popullit e vlerëson të domosdoshëm nxjerrjen e Kodit Civil dhe e konsideron shumë të rëndësishëm ekzistencën e tij për sistemin juridik të Kosovës. Nxjerrja e Kodit Civil do të mundësojë përmbledhjen e ligjeve të fushës civile në një dokument me të cilin do të avancohet sistemi dhe rendi juridik në Republikën e Kosovës në fushën civile, me çka do të lehtësohet përdorimi i legjislacionit civil në praktikë. Ekzistenca e Kodit Civil do të bëjë të mundur identifikimin dhe zbatimin më të lehtë të ligjeve të fushës civile.

Në drejtim të miratimit të legjislacionit, është me rëndësi të theksohet se procesi i përafrimit të legjislacionit vendor me atë të BE, është i domosdoshëm për ngritjen e nivelit normues dhe arritjen e standardeve të pretenduara në Kosovë. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit konsideron se duhet të ketë një bashkëpunim më të madh ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë në procesin e hartimit të akteve normative e po ashtu edhe në monitorimin e tyre, me fokus në procesin e përafrimit të legjislacionit. Në këtë mënyrë do të ngritet efikasiteti i procesit të përafrimit të legjislacionit vendor me atë të BE, dhe do të shërbejë si mjet për ngritjen e standardit të legjislacionit të Kosovës.

Si hap pozitiv i Kuvendit të Kosovës në drejtim të arritjes së standardeve ndërkombëtare për transparencë parlamentare është funksionalizimi i Sistemit Elektronik për Përcjelljen e Legjislacionit (SEPL), i cili është promovuar më 9 nëntor 2017. Kjo platformë që është

vendosur në ueb faqen zyrtare të Kuvendit do t'ua lehtësojë dukshëm të gjithë të interesuarve (juristëve, studentëve, OJQ-ve, mediave dhe qytetarëve të tjerë) qasjen në të gjitha informatat dhe dokumentet që ndërlidhen me projektligjet që janë në shqyrtim në Kuvend, dhe atë gjatë çdo faze të procesit ligjvënës, duke ua mundësuar atyre të përcjellin ndryshimet dhe plotësimet e propozuara në projektligje dhe t'i adresojnë vërejtjet, sugjerimet, komentet dhe reagimet e tyre. Projekti është realizuar në bashkëpunim me Institutin Kombëtar Demokratik (NDI), me mbështetjen e Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Gjatë vitit 2017, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar vetëm 21 ligje. Ndërsa, në procedurë janë 25 projektligje, 14 prej të cilave kanë kaluar shqyrtimin (leximin) e parë në Kuvend, 3 projektligje u janë shpërndarë deputetëve, kurse 2 projektligje të tjera nuk u janë shpërndarë fare deputetëve.

Asnjë nga ligjet e miratuara në vitin 2017, nuk i përket legjislacionit me interes vital²⁴, ndërkohë që nuk janë miratuar disa projektligje të kësaj fushe që kanë qenë të parapara me Programin legjislativ për këtë vit.

Shqyrtimin e parë në Kuvendin e Kosovës e ka kaluar vetëm Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë, ndërkohë që deputetëve u është shpërndarë Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi, ndërsa projektligjet e tjera nuk janë proceduar fare.²⁵

Lidhur me procesin e miratimit të ligjeve gjatë vitit 2017, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se Kuvendi i Kosovës kishte efikasitet më të vogël në krahasim me dy vitet e kaluara. Gjatë vitit 2017, Kuvendi ka miratuar vetëm 21 ligje, për dallim nga viti 2015 në të cilin Kuvendi kishte miratuar 46 ligje, dhe viti 2016 kur Kuvendi kishte miratuar 52 ligje. Avokati i Popullit vlerëson se ky efikasitet i vogël i miratimit të ligjeve nga Kuvendi, është rezultat i ngjarjeve politike dhe vonesave në formimin e institucioneve pas certifikimit të rezultateve të dala nga zgjedhjet qendrore që kanë ndodhur në këtë vit. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se zvarritjet e tilla ndikojnë negativisht në funksionimin e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe përmbushjen e obligimeve të tyre kushtetuese dhe ligjore.

Me qëllim të lehtësimit të përdorimit të ligjeve në praktikë, Avokati i Popullit e konsideron të nevojshëm ndryshimin e teknikave për hartimin e legjislacionit, konkretisht rregullimin e procesit pas miratimit të ligjeve për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese. Në këtë drejtim do të jetë e nevojshme që me Ligjin për Aktet Juridike, në një kapitull të veçantë, të rregullohet procedura sipas të cilës pas miratimit të ligjit për

²⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 81 dhe Amendamentet 2 e 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, hyrë në fuqi më 7 shtator 2012.

²⁵ Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës dhe Projektligji për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

ndryshimin dhe plotësimin e ligjit ekzistues, ato ndryshime dhe plotësime të inkorporohen në ligjin bazik dhe të ekzistojë si një ligj i vetëm²⁶. Një rregullim i tillë do ta bënte me lehtë të qasshëm dhe me të përdorshëm legjislacionin që pëson ndryshime dhe plotësime.

IAP ka pranuar një sërë projektligjesh dhe draftesh të udhëzimeve administrative nga Qeveria dhe ministritë për dhënien e komenteve. Rregullorja e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 09/2011, përcakton obligimin e organit propozues që për projektligjet dhe aktet nënligjore, pos me ministritë përkatëse, të konsultohet edhe me IAP-në, për përputhshmërinë e tyre me “... *standardet e pranueshme ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut...*”²⁷. Avokati i Popullit ka dhënë komente dhe rekomandime për Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës dhe në Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Avokati i Popullit e vlerëson pozitivisht praktikën e dërgimit të projektligjeve si dhe të draft udhëzimeve administrative dhe të akteve tjera nënligjore nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës për konsultim me IAP.

Bazuar në ato që u theksuan më sipër, Avokati i Popullit konstaton se Kuvendi i Kosovës në këtë vit kishte efikasitet shumë më të vogël në krahasim me vitet e kaluara, duke miratuar një numër relativisht të vogël të ligjeve. Po ashtu, konsiderohet e nevojshme që të ngriten kapacitetet e Kuvendit, konkretisht Komisionit për Integrim Evropian në drejtim të monitorimit të përafrimit të legjislacionit vendor me atë të BE. Rjedhimisht, do të jetë e nevojshme që të bëhen ndryshimet e përmendura në Rregulloren e Punës së Kuvendit (neni 86), e po ashtu të bëhet rregullimi i teknikes së hartimit të akteve normative në drejtim të inkorporimit të ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve në ligjin bazik, me qëllim të lehtësimit të përdorimit të ligjeve në praktikë. Në kuadër të përgjegjësisë së tij, Avokati i Popullit ka dhënë rekomandime, sugjerime, vlerësime si dhe ka potencuar nevojat që të ndërmerren veprime konkrete nga institucionet përgjegjëse me qëllim të përmirësimit të standardit të legjislacionit, por edhe funksionimit më efikas të institucioneve që kanë kompetencë hartimin e akteve juridike.

Në kuadër të përgjegjësisë së Avokatit të Popullit, të përcaktuara me Ligjin për Avokatin e Popullit, është edhe: “*të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës*”²⁸.

Avokati i Popullit i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës ndryshimin dhe plotësimin e këtyre ligjeve dhe akteve nënligjore:

- Të sqarojë shprehimisht se neni 86 i Rregullores së Kuvendit e lë të pavendosur çështjen se si një Kuvend i sapo zgjedhur duhet t'i trajtojë punët e pambaruara nga

²⁶ Projektligji për Aktet Juridike, është në proces të shqyrtimit në Kuvend, dhe sugjerimi për rregullimin e teknikes së hartimit të akteve normative mund të jetë lehtë i realizueshëm.

²⁷ Rregullorja e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, neni 7, paragrafi 2.

²⁸ Neni 18, paragrafi 1, pika 1.7.

legjislatura e kaluar; dhe të plotësojë Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës për të përcaktuar se Kryesia e Kuvendit, në fillim të çdo legjislature, do të gëzojë të drejtën për të vendosur, me kërkesë të komisioneve dhe institucioneve të ndryshme, të vazhdojë punët e pambaruara nga legjislatura e kaluar, në vend që t'i rifillojë këto punë nga hapi i parë (shih: Raporti me rekomandime *ex officio* nr. 582/2017).

- Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) si në vijim:
 - o Neni 21, paragrafi 7 i Ligjit për AKKVP (“*Agjencia administron pronat dhe zbaton skemën e qirasë sipas këtij neni, më së largu deri tetëmbëdhjetë (18) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji*”), të hiqet në tërësi;
 - o Neni 19, paragrafi 7 i Ligjit për AKKVP (“*Për çdo ri uzurpim pasues [pas dy dëbimeve] të pronës së njëjtë, do të zbatohen rregullat e procedurave të përgjithshme të përbarimit bazuar në të njëjtin vendim/aktgjykim dhe urdhër dëbimi si dokumente përbaruese*”) të hiqet në tërësi; dhe
 - o Neni 19, paragrafi 6 i Ligji për AKKVP, të ndryshohet si në vijim: “*Për çdo ri uzurpim pas kohës së përbarimit të urdhëresës për dëbim, pas njoftimit nga parashtruesi i kërkesës për ri uzurpimin e kundërligjshëm të pronës Agjencia do ta ri përbaroj atë edhe një herë përmes ri dëbimit të uzurpuesit nga prona bazuar në urdhëresën e re të lëshuar, duke i respektuar procedurat e paragrafit 3-5 të këtij neni. Për ri dëbim, Agjencia do ta informojë paraqitësin e kërkesës për ditën e ri dëbimit dhe do ta ftojë të jetë i pranishëm gjatë ri dëbimit. Nëse parashtruesi i kërkesës apo i autorizuari i tij/saj dështon të merr pjesë në ri dëbim, Agjencia do ta përbarojë dëbimin dhe do të lëshojë vërtetim të ri posedimit*” (shih: Raporti me rekomandime *ex officio* nr. 551/2017).

Gjithashtu, Avokati i Popullit i ka rekomanduar:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës që, në bazë të rregullave dhe procedurave për nisma legjislative, të propozojë ndryshimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përkatësisht nenin 3.1 të Ligjit në mënyrë që të ofrohet qasje e drejtë dhe efektive për palët në procedurë në Dhomën e Posaçme (shih: Raporti me rekomandime *ex officio* nr. 44/2017).
- Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) që të nxjerr aktet nënligjore që përcaktohen me ligj për organizimin e procesit mësimor për personat e privuar nga liria, duke përfshirë edhe të miturit që qëndrojnë në Qendrën Korrektuese (QK) në Lipjan duke adresuar nevojat e tyre. Në këtë kuadër është e nevojshme të ndryshohet edhe paragrafi 1 i nenit 4 të *Udhëzimit Administrativ nr.16/2011*, i datës 30 dhjetor 2011, që të gjendet zgjidhje për kërkesat për ndërrimin e profileve arsimore për nxënësit në këtë QK edhe jashtë afateve që aktualisht janë përcaktuar në këtë udhëzim. Po ashtu, që me akte nënligjore duhet të adresohen qartësisht

përgjegjësitë që i takojnë MASHT-it dhe komunave, në këtë rast Komunës së Lipjanit, për mbarëvajtjen e mësimit në QK në Lipjan (shih: Raporti me rekomandime *ex officio* nr. 575/2016).

- Ministrisë së Financave (MF) që të ndryshojë *Udhëzimin Administrativ nr. 07/2011 për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë* duke e fshirë pikën 1.3 të paragrafit 1 të nenit 2; duke e fshirë paragrafin 2 të nenit 2; dhe duke e fshirë fjalinë e fundit nga paragrafi 1 i nenit 5 “*Komuna nuk duhet t'i kryej këto shërbime për derisa nuk është paguar tatimi në pronë*” (shih: Raporti me rekomandime për ankesat e qytetarëve A. nr. 333/2015, A. nr. 347/2015, A. nr. 729/2015 dhe A. nr. 730/2015).
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) që të iniciojë përpilimin e një instrumenti ligjor që do të përbënte mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, që siguron lehtësim në formën e parandalimit apo të kompensimit lidhur me ankesat për zvarritje të procedurës gjyqësore (shih: Raportet me rekomandime për rastet A. nr. 597/2014 dhe A. nr. 438/2015).

4.2 Mbrojtja gjyqësore e të drejtave

Gjyqësori i vendit në këtë vite raportues ka pasur ngritje pozitive në zbatimin e ligjit në raport me vitin paraprak por ende nuk ka arritur të sigurojë mbrojtje të drejtave të njeriut sipas standardeve ndërkombëtare, në veçanti të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ) dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Plani strategjik i gjyqësorit 2014-2019²⁹, përmban objektiva të cilat kanë të bëjnë me përshejtimin e zgjidhjes së lëndëve gjyqësore, menaxhimin përkatës dhe llogaridhënien, përforsimin e mekanizmave të vlerësimit dhe atyre disiplinore, përfshirjen e komuniteteve pakicë në sistemin gjyqësor si dhe arsimimin e shtuar dhe trajnimin gjyqtarëve dhe personelit të gjykatave, që duhet të përmbushën në mënyrë që sistemi gjyqësor të jetë sa më funksional dhe në shërbim të qytetarëve.

Gjyqësori nuk ka mbështetje të mjaftueshme financiare të ndarë sipas buxhetit vjetor për vitin 2017. Buxheti final i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ishte 21,793,948.18 €. Pjesëmarrja e buxhetit të KGJK-së në buxhetin e përgjithshëm të Kosovës gjatë vitit 2017 ka qenë rreth 1.20 %, andaj që të kemi një gjyqësor të pavarur dhe më efikas në punën e tij duhet të ngritet përqindja e pjesëmarrjes së tij në ndarjen e përgjegjshme të buxhetit të vendit.

Po ashtu gjyqësori i vendit ballafaqohet me numërtë pamjaftueshëm të gjyqtarëve, në vitin 2017 ishin 404 gjyqtar të emëruar, përkundër që kemi një rritje të konsiderueshme në raport me vitin paraprak, por shqetësuese për Avokatin e Popullit është numri i ulët i bashkëpunëtorëve profesional, prej 40 (katërdhjetë) që punojnë nëpër gjykata. Prandaj

²⁹ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Plani Strategjik i Gjyqësorit të Kosovës 2014-2019, faqe 14, 19, 22 dhe 26 www.kgjk-ks.org

shtimi i numrit të bashkëpunëtorëve profesional dhe personelit tjetër, do të ndihmonte gjyqtarët në procesin e shqyrtimit të lëndëve në afatet kohore dhe kjo do të reflektonte në zvogëlimin e numrit të lëndëve gjyqësore, që kanë kaluar kufijtë e arsyeshmërisë.

Avokati i Popullit e vlerëson si hap pozitiv në sistemin e drejtësisë themelimin e Akademisë së Drejtësisë sipas ligjit nr.05/L -095 për Akademinë e Drejtësisë. Pritshmëritë janë që do të ketë ngritje të cilësisë dhe efikasitetit të punës së gjyqësorit nëpërmjet organizimit të trajnimeve të vazhdueshme profesionale për gjyqtarë e prokurorë si dhe për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Sipas ligjit tani trajnimi fillestar për aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapo emëruar, do të zgjas dymbëdhjetë (12) muaj dhe përbëhet nga pjesa teorike dhe praktike, me mbështetjen e trajnuesve.

Gjyqësori i vendit në nëntorin e këtij viti ka arritur funksionalizimin e tij në pjesën veriore të Kosovës dhe integrimin e tij në sistemin e gjithmbarshëm gjyqësor, pas më tepër se dy vjet që kur Prishtina dhe Beogradi e kanë nënshkruar në Bruksel Marrëveshjen për integrimin e gjyqësorit në veri të Kosovës³⁰. Avokati i Popullit e konsideron si hap të rëndësishëm për drejtësinë kosovare, krijimin e një sistemi unitar të drejtësisë në tërë territorin e vendit, dhe që do t'u garantojë qytetarëve qasje të barabartë në institucionet e drejtësisë si dhe realizimin e të drejtave të tyre kushtetuese e ligjore³¹.

Në kuadër të Këshilli Gjyqësor të Kosovës vepron Njësia për Shqyrtim të Performancës së Gjyqësorit (NjShPGj), e cila sipas udhëzimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Komisionit të saj për Administrimin e Gjykatave, punon në zbatim të nenit 29 të Ligjit mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës. NjShPGj i ofron KGJK-së analiza, vlerësime, rekomandime, këshilla dhe informata në lidhje me aktivitetet e zhvilluara dhe të shqyrtuara në gjykata me anë të të cilave do të promovohet kontrolli efektiv me kualitete të larta profesionale të të punësuarve. Por Avokati i Popullit vëren se nuk është bërë një vlerësim i gjithmbarshëm për gjendjen e gjyqësorit ashtu që të bëhen prioritetet dhe planet për permisim gradual pozitiv të gjendjes së gjyqësorit.

Më 27 tetor 2017, Presidenti i Kosovës ka dekretuar 40 gjyqtarë dhe 13 prokurorë nga radhët e komunitetit serb të cilët do të punojnë në sistemin gjyqësor të vendit dhe do të zbatojnë ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës. Por, për Avokatin e Popullit mbetet shqetësimi i ngritur në raportin e vitit të kaluar për të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën për mjete efektive juridike, duke tërheq vëmendjen e institucioneve përkatëse për nevojën e ndërmarrjes së veprimeve në realizimin e kësaj të drejte, lidhur me parashkrimin e mbi 1500 lëndëve në çështjet penale të cilat nuk janë trajtuar fare, dhe mbi 2500 çështje civile në të cilat nuk është ndërmarrë asnjë veprim, me

³⁰ Ligji nr.04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

³¹ Këshilli Gjyqësor i Kosovës "Veriu integrohet në sistemin e drejtësisë së Kosovës 24/10/2017", <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/event/index/113>

çka kërcënohet seriozisht parimi i sigurisë juridike dhe qasjes në drejtësi në pjesën veriore të vendit³².

Gjyqësori i vendit vazhdon të mbështetet nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX) në Kosovë në fushën e sundimit të ligjit, në bazë të Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian³³.

Gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë ndihmojnë autoritetet gjyqësore drejt zhvillimit dhe forcimit të sistemit të pavarur të drejtësisë. Gjyqtarët veprojnë në panele të përziera gjyqësore me gjyqtarë vendorë në çështjet e krimeve të luftës, gjenocidit, terrorizmit, krimet të organizuar, korrupsionit, krimet ndëretnike, vrasjet e rënda, krimet ekonomike, por edhe për gjykimin e lëndëve civile sipas ligjit³⁴.

Avokati i Popullit vëren se në vendimet e gjykatave, gjyqtarët në raste të pakta i referohen praktikës së GJEDNJ dhe në ato raste kur kjo ndodh ato janë të përgjithësuara dhe jo konkrete në raport me rrethanat e rastit në praktikë. Vlen të ritheksohet që sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të drejtat e njeriut interpretohen në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së.

Sa i përket mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në lëmin e gjyqësorit, Avokati i Popullit ka mandat të limituar që është i përcaktuar me Ligjin për Avokatin e Popullit, sipas të cilit Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor, duke mos ndërhyrë në raste dhe në procedura ligjore që janë duke u zhvilluar në gjykata, përveç çështjeve që kanë të bëjnë me pretendimet për administrimin e drejtësisë, përkatësisht të zvarritjeve të procedurave gjyqësore dhe mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.³⁵

Edhe në këtë vit raportues, sipas statistikave të ankesave të paraqitura në IAP, mund të konstatohet se qytetarët vazhdojnë të mos kenë besim në sistemin gjyqësor të vendit. Ata vazhdojnë të përballen me zvarritje të procedurave për vendosjen e rasteve të tyre me vite të tëra, moszekutim të vendimeve gjyqësore të plotfuqishme, vendime joefektive, parashkrim të lëndëve gjyqësore, si dhe gabime në shënimet personale të tyre që ndikon në pamundësinë e realizimit të të drejtave të tyre. Te qytetarët këto kanë ndikim negative në perceptimin e drejtësisë dhe krijohet mosbesim në sistemin e gjyqësorit për mungesë të objektivitetit të gjyqtarëve gjatë vendosjes në rastet e tyre.

³²Raport me rekomandime Ex officio Nr. 415/2016, në lidhje me, mungesën e qasjes në ndërtesën e gjykatës në pjesën veriore të Mitrovicës, respektivisht mohimit të së drejtës për qasje në drejtësi, drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Gjykatës Themelore në Mitrovicë dhe Prokurorisë Themelore në Mitrovicë

³³Ligjin për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve EULEX-it në Kosovë, nr. 03L 053, neni 5. paragrafi 1.

³⁴Ligji, nr.04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

³⁵Ligji nr.05/L-019 Për Avokatin e Popullit, neni 16.8.

Zvarritja e procedurave gjyqësore

Po ashtu, edhe gjatë këtij viti raportues, Avokati i Popullit ka vazhduar të pranojë ankesa kundër gjykatave që kryesisht kanë të bëjnë me zvarritje të procedurave gjyqësore në vendosjen e rasteve të tyre.

Ankesat kryesisht kanë të bëjnë me zvarritje të procedurave lidhur me kontestet e natyrës, civile, si pronësore, detyrimeve, të punës dhe sociale³⁶. Kjo vjen si pasojë e numrit të madh të rasteve të vjetra të pazgjidhura dhe paraqitjes së rasteve të reja.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) në raportin statistikor të gjykatave për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, ka raportuar se numri i lëndëve të ngelura si të pazgjidhura është 358.138³⁷. Sipas këtij raporti gjykatat kanë pasur në punë gjithsej 527.780 lëndë gjyqësore, ndërsa kanë zgjidhur 169.605. Në këtë gjashtëmujor qytetarët kanë parashtruar 130.035 lëndë të reja gjyqësore.

Po ashtu, KGJK në raportin statistikor të gjykatave të gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, ka raportuar se numri i lëndëve të ngelura si të pazgjidhura është 417,733. Sipas këtij raporti gjykatat kanë pasur në punë gjithsej 664,465 lëndë gjyqësore, ndërsa kanë zgjidhur 246,700. Në këtë gjashtëmujor qytetarët kanë parashtruar 223.838 lëndë të reja gjyqësore.

Me gjithë numrin e lartë të lëndëve të pazgjidhura në gjashtëmujorin e vitit 2017, vërehet ulje prej 59.595 lëndë krahasuar me te njëjtën periudhë raportuese të vitit 2016. Pavarësisht kësaj, KGJK duhet të angazhohet në mbështetje të gjyqësorit për përmirësimin e situatës.

Avokati i Popullit vëren se kur bëhet fjalë për zvarritje procedurale, sidomos në lëndët që kalojnë nga një instancë në instancën tjetër, përgjatë procesit të shqyrtimit apo në situata kur rastet kthehen në rigjykim, gjykatat kanë tendencë që periudhën e vendosjes së rastit ta llogarisin prej ditës kur rasti i është kaluar asaj gjykate, ndërsa sipas praktikës së GJEDNJ-së periudha e llogaritjes për zgjidhjen e një rasti gjyqësor fillon prej ditës kur qytetarët kanë paraqitur padinë në gjykatën kompetente. Po ashtu, Avokati i Popullit vëren se gjykatat nuk trajtojnë me urgjencë kontestet nga marrëdhënia e punës³⁸, siç kërkohet me Ligjin për procedurën kontestimore³⁹.

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), në raportin e auditimit të gjykatave në vitin 2017, kishte konstatuar se procesi i menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore nuk

³⁶A.nr.44/2017, Raport me rekomandime për Dhomën Posaçme të Gjykatës Supreme, A.278/2017 Raport me rekomandime GJTH Ferizaj, A.597/2014, Raport me rekomandime, GJTH Prishtinë, A.nr.500/2015 Raport me rekomandime GJ Apelit, A.nr.690/2017 Raport me rekomandime, GJTH Prishtinë, A.553/2017, Raport me rekomandime ,GJ Apelit, A.nr.236/2017 Raport me rekomandime, GJ Apelit, A.262/2014 Raport me rekomandime, GJ Apelit, A.nr.549/2015 Raport me rekomandime, GJTH Prishtinë.

³⁷Këshilli Gjyqësor i Kosovës Raporti i 6 mujorit të parë 2017, Statistikat e gjykatave të rregullta, www.kgjk-ks.org, faqe 3.

³⁸ A. nr. 553/2017 Raport me rekomandime, GJ. Apelit, A.nr.238/2017 Raport me rekomandime, GJTH Prizren, A.nr.447/2017 Raport me rekomandime, GJ. Apelit.

³⁹ Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, neni 475.

është efikas dhe ka zvarritje në vendosjen e lëndëve.

Gjykatat vazhdojnë të ballafaqohen me numër të konsiderueshëm të lëndëve të vjetra që vazhdojnë të mbesin ende të pazgjidhura, dhe numri i përgjithshëm i lëndëve civile nuk është reduktuar, por është vazhdimisht në rritje. Si rezultat i numrit të madh të lëndëve civile nëpër gjykata themelore, qytetarët detyrohen të presin periudha të gjata kohore për t'iu shqyrtuar e finalizuar lënda. Njëkohësisht, është shqetësues fakti se trendi i lëndëve që mbeten të pazgjidhura nga viti në vit është vazhdimisht në rritje, dhe nëse nuk ndërmerren masa për ta përmirësuar këtë gjendje atëherë gjyqësori mund të shkojë drejt kolapsit⁴⁰.

Situatës së rëndë lidhur me procedurat e stërzgjatura nëpër gjykata i kontribuon edhe mungesa e një mekanizmi të brendshëm ligjor, nëpërmes të cilit qytetarët të cilëve u është shkelur e drejta në një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, do të mund të kërkonin kompensim për shkak të shkeljes së kësaj të drejte.

Parashkrimi i lëndëve

Avokati i Popullit vëren se edhe më tej ka ankesa të qytetarëve lidhur me parashkrimin në gjykata dhe prokurori, gjë që dëmton seriozisht besimin e qytetarëve në drejtësi dhe shkelë të drejtat e njeriut.⁴¹ Gjykatat nuk ofrojnë të dhëna statistikore për lëndët e parashkuara, gjë që cenon sigurinë juridike.

Po ashtu, një shqetësim tjetër lidhur me gjendjen e mijërave lëndëve të pashqyrtuara dhe mundësinë e parashkrimit të tyre në regjionin e Mitrovicës e ka paraqitur vet Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës në konferencën e tij në mjetet e informimit publik⁴².

Parashkrimi i lëndëve mund të jetë rezultat i ngarkimit të gjykatave me lëndë gjyqësore dhe pamundësisë së vendosjes brenda afateve kohore, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve. Mirëpo, ka raste kur parashkrimi vjen si pasojë e neglizhencës apo e keqpërdorimeve. Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD) në të gjitha rastet e parashkrimit të lëndëve gjyqësore duhet të hetojë në hollësi shkaqet e parashkrimit të lëndëve për çdo rast, pa asnjë përjashtim, dhe të iniciojë procedura përkatëse ndaj përgjegjësve që kanë lejuar parashkrimin e lëndëve gjyqësore.

Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore

Avokati i Popullit, gjatë këtij viti ka pranuar numër të konsiderueshëm të ankesave lidhur me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

⁴⁰ Zyra e Kombëtare e Auditimit të Kosovës, Raporti i Auditimit, -Efikasiteti i menaxhimit të lëndëve civile në gjykata themelore, Dokumenti nr: 24.18x.9-2015/16-08, publikuar nëntor 2017, <http://www.zka-rks.org/publications/>

⁴¹ A.nr.132/2017, kundër Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

⁴² Deklarata e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë z. Shyqyri Sylja "Zëri" 3 dhjetor 2017.

Pas hetimit të ankesave, në disa raste është vërejtur se si pengesë në ekzekutimin e vendimeve ka qenë gjendja ekonomike-financiare e debitorit⁴³, përkundër veprimeve të ndërmarra nga gjykata. Në një rast të hetuar është vërejtur neglizhenca e organeve të administratës në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe vetëm pas veprimit të Avokatit të Popullit rasti është proceduar.⁴⁴

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në nivel të vendit mbetet ende i ulët, gjë që për Avokatin e Popullit mbetet shqetësuese. Raporti gjashtëmuor i vitit 2017 i KGJK-së,⁴⁵ sa i përket lëndëve civile, tregon se gjykatat kanë pasur në punë 4068 lëndë, prej të cilave i kanë ekzekutuar 1576, ndërsa 2492 kanë mbetur pa u ekzekutuar.

Avokati i Popullit shpreh shqetësimin se ende kemi numër të lartë të vendimeve të plotfuqishme gjyqësore që kanë mbetur të pa ekzekutuara.

Me këtë rast Avokati i Popullit tërheqë vëmendjen e autoriteteve përkatëse, se sipas KEDNJ-së dhe praktikës së GJEDNJ-së, ekzekutimi i vendimeve të plotfuqishme është pjesë e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e që obligon ato për ndërmarrjen e masave të domosdoshme për realizimin e kësaj të drejte.

Përmbauesit privat

Vërehet se përmbauesit privat e kanë përmirësuar nivelin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe qytetarëve u është ofruar mundësi më efikase dhe efektive në realizimin e të drejtave të tyre. Por, në disa raste përmbauesit privat kanë tejkaluar normat ligjore të cilat përcaktojnë kufizimet lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore⁴⁶, duke lëshuar urdhra përmbauesit për ekzekutimin e vendimeve në bankat komerciale, me ç'rast kanë bllokuar llogaritë bankare të ankuesve.

Avokati i Popullit, gjatë hetimit ka vërejtur se ankuesit kanë qenë shfrytëzues të ndihmave sociale, pensioneve të pleqërisë dhe këto të hyra janë bllokuar në procesin e ekzekutimit, në kundërshtim me ligjin, i cili përcakton kufizimet ligjore për shumat të cilat nuk mund të jenë objekt i ekzekutimit⁴⁷. Pas veprimit të Avokatit të Popullit është arritur zgjidhja e çështjeve të ankuesve që llogaritë bankare të tyre të zhblokohen dhe ndalesat të behën në pajtim me ligjin.

Në disa raste, në ankesat ndaj përmbauesve privat palët ankohen për zvarritje të ekzekutimit, por nga hetimi është konstatuar se kundër vendimeve në procedurën e përmbauesit palët e kundërta kanë ushtruar ankesa në gjykata dhe lëndet janë zvarritur

⁴³ A. nr. 240/2017, kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.252/2017, kundër Gjykatës Themelore në Gjiilan., A.nr.601/2017, kundër Gjykatës Themelore në Prizeren,A.nr.666/2017,kundër Gjykatës TH. Prishtinë.

⁴⁴ A. Nr. 611/2017, kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenës Sociale, A.569/2017, kundër Komunës së Pejës.

⁴⁵ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti i 6 muhorit të parë 2016 , Statistikat e gjykatave të rregullta, www.kgjk-ks.org , faqe 37

⁴⁶ Ligji nr.04/L-139 për Procedurën Përmbauesit, neni 112.

⁴⁷ A. nr. 704/2017 Hoxha, kundër Përmbauesit Privat në Prishtinë,A.139/2017 Voci kundër Përmbauesit Privat në Pejë.

per ekzekutim deri në përfundimin e procedurave gjyqësore.⁴⁸ Po ashtu, në disa raste të ankesave është vërejtur se disa vendime gjyqësore nuk kanë mundur të ekzekutohen nga përmbauesit privat për shkak se debitorët nuk kanë pasur mjete financiare.⁴⁹

Por, në të gjitha rastet e hetuara kur është konstatuar se nga përmbauesit privat ka pasur shkelje të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaimore, (neni 112), lidhur me kufizimet e përmbaimit, Avokati i Popullit u ka rekomanduar përmbauesve që të ndryshojnë urdhrat përmbaimit në përputhje me ligjin, e të cilat janë zbatuar nga ana e tyre.

Përfaqësimi ligjor i qytetarëve

Avokati i Popullit, po ashtu ka pranuar numër të konsiderueshëm të ankesave që ka të bëjë me mos përfaqësimin adekuat të palëve nga avokatët mbrojtës në çështje të ndryshme gjyqësore. Kjo e pengon realizimin e plotë të së drejtës për mbrojtje të drejtave të njeriut në procedurat gjyqësore. Në disa raste, ankuesit kanë paraqitur edhe kërkesa për t'u këshilluar lidhur me adresimin e shqetësimeve të tyre në raport me avokatët e tyre mbrojtës, përkritazi me pretendimet për mos përfaqësim dinjitoz, mashtrim dhe bashkëpunim me palën e paditur⁵⁰. Në të gjitha këto raste, ankuesit janë njoftuar me të drejtën e tyre për ndërrimin e avokatëve, duke tërhequr autorizimin për përfaqësim si dhe për mundësinë e paraqitjes së ankesave në Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK).

Në një rast të hetuar nga Avokati i Popullit lidhur me mungesën e informacioneve nga avokati mbrojtës për trajtimin e lëndës në procedurat gjyqësore, kompensim dëmi, është konstatuar, se lënda e ankuesit ka përfunduar në gjykatë në vitin 2012 dhe se është paguar zhdëmtimi material në llogarinë e avokatit mbrojtës, por ai nuk e ka njoftuar palën për këtë. Vetëm pas hetimit të rastit nga Avokati i Popullit, pala ankuese ka arritur ta kuptoj të vërtetën dhe i janë dhënë të gjitha dokumentet administrative dhe gjyqësore të rastit⁵¹.

Për shkak të mos bashkëpunimit të avokatit mbrojtës me palën për ta njoftuar me vendimin gjyqësor, ka rezultuar me humbjen e afatit ligjor për parashtrimin të mjeteve juridike ankimore. Avokati i Popullit me këtë rast ka hapur rastin për të monitoruar procedurën ankimore të paraqitur nga pala në Zyrën e Prokurorit Disiplinor të OAK-së, se si po procedohet procesi i ankimit të palës ndaj avokatit mbrojtës⁵².

OAK ka një kornizë normative lidhur me standardet e punës dhe Kodin e Etikës për sjelljet e avokatëve, por ajo nuk ka arritur që të vendosë një sistem i cili në mënyrë

⁴⁸ A. nr. 678/2017 Rexhaj, kundër Përmbauesit Privat në Prishtinë, A. nr.576/2017 Krasniqi kundër Përmbauesit Privat në Prishtinë.

⁴⁹ A. nr. 443/2017 Neziri kundër Përmbauesit Privat në Prizren, A. nr.349/2017 Velu kundër Përmbauesit Privat në Mitrovicë.

⁵⁰ Ankesa Gjeta kundër avokatit mbrojtës ,Oda Avokatëve të Kosovës; Ankesa Gjorllaku kundër avokatit mbrojtës, Oda Avokatëve të Kosovës; Ankesa Greku kundër avokatit mbrojtës, Oda Avokatëve të Kosovës; Ankesa Asllani kundër avokatit mbrojtës, Oda Avokatëve të Kosovës; AnkesaJonuzaj dhe të tjerët kundër avokatit mbrojtës ,Oda Avokatëve të Kosovës.

⁵¹ A.nr. 65/2017 Morina kundër avokatit mbrojtës ,Oda Avokatëve të Kosovës.

⁵² A. nr. 892/2017 Kosumi kundër avokatit mbrojtës ,Oda Avokatëve të Kosovës.

efikase do të mbikëqyrë dhe përcjell respektimin e këtyre standardeve.

Ndihma juridike falas është kategori kushtetuese⁵³ që u mundësohet qytetarëve që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, dhe nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasje efektive në drejtësi. Por, si sfidë për ofrimin e ndihmës juridike falas në raport me kërkesat e qytetarëve mbetet mungesa e mjeteve buxhetore, gjë që pamundëson ofrimin e ndihmës juridike për qytetarët në tërë territorin e Republikës së Kosovës në pajtim me ligjin për ndihmë juridike falas.

Në shumë raste qytetarët kanë kërkuar nga Avokati i Popullit hartimin e parashtresave të ndryshme si në çështjet administrative, gjyqësore por edhe për përfaqësim në gjykatë, por për shkak të kufizimeve ligjore të mandatit të përcaktuar, në të gjitha rastet palët janë udhëzuar të paraqiten të Agjencia për ndihmë juridike falas për marrjen e shërbimeve.

Zvarritjet e procedurave në vendosjen e lëndëve gjyqësore, mungesa e mjeteve efektive juridike, shkalla e ulët e ekzekutimit të vendimeve janë çështje që kërkojnë vëmendje dhe adresim adekuat nga autoritetet përkatëse.

Prandaj, Avokati i Popullit, përveç tjerash, rithekson nevojën e krijimit të një mekanizmi ligjor të brendshëm, në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, i cili qytetarëve do t'u garantonte të drejtën në mjete efektive juridike në rastet e shkeljes së të drejtës në zgjidhjen e rasteve të tyre brenda afatit të arsyeshëm kohor dhe mosekzekutimin e vendimeve të plotfuqishme gjyqësore, të drejta këto të përcaktuara me nenin 6 të KEDNJ-së dhe të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

5. Roli i ekzekutivit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut

5.1 Qeveria e Republikës së Kosovës

Sipas Ligjit për Administratën Shtetërore, administrata shtetërore kryen punët e administratës në suaza të të drejtave, përgjegjësi dhe detyrave të Republikës së Kosovës. Administrata shtetërore funksionin e saj e ushtron dhe punët i kryen në bazë të kushtetutës, ligjit, dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme. Punët e administratës shtetërore ngërthejnë zbatimin e drejtpërdrejt të ligjit, nxjerrjen e dispozitave për aplikimin e tyre, ushtrimin e mbikëqyrjes administrative dhe kryerjen e punëve të tjera administrative dhe profesionale. Po sipas këtij ligji, Autoritetet e larta të administratës shtetërore janë Qeveria si tërësi, Kryeministri, Zëvendës Kryeministrit dhe ministrit, ndërsa Zyra e Kryeministrit dhe Ministritë janë organet e larta të administratës shtetërore përmes të cilave Autoritetet e Larta të Administratës Shtetërore ushtrojnë kompetencat e tyre qeveritare dhe administrative.⁵⁴

Koncepti i shtetit ligjor (Rechtsstaat) apo i sundimit të ligjit (Rule of Law) paraqet një vlerë të madhe të civilizimit evropian dhe botëror.⁵⁵ Në lidhje me administratën

⁵³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 31, paragrafi 6.

⁵⁴ Ligji Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore në Republikën e Kosovës

⁵⁵ Lord Lloyd of Hampsted, M.D.A. Freedman, Lloyd's Introduction to Jurisprudence, London, 1985

shtetërore, rëndësia e veçantë e sundimit të ligjit qëndron në ligjshmërinë e vendimeve administrative. Këto vlera janë mishëruar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.⁵⁶

Asnjë sistem bashkëkohor i administratës shtetërore nuk është i paramendueshëm pa sundimin e ligjit.⁵⁷

Lidhur me këtë, Avokati i Popullit dëshiron të vë në pah disa vendime të Qeverisë të cilat kanë ngritur debat në opinionin publik.

Vendimi i Qeverisë Nr. 13/06, i datës 3 tetor 2017, për faljen e borxheve për ambalazhuesit e ujit është vendim në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe po ashtu me Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës. Një vendim i tillë nuk do të duhej të merrej pa aprovimin paraprak të Kuvendit të Kosovës dhe në këtë rast do të duhej të veprohej ngjashëm sikurse me faljen e borxheve publike, për çfarë Kuvendi i Kosovës kishte miratuar Ligjin Nr. 05/1-043 për Faljen e Borxheve Publike.

Vendimi i Qeverisë Nr. 13/06, në mes tjerash, mbështetët në nenin 93, paragrafin 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit Qeveria ka kompetencë, *“që të merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve.”* Ndërsa në rastin konkret nuk është e qartë se cilin ligj ka pasur qëllim ta zbatojë Qeveria me nxjerrjen e këtij vendimi.

Pastaj, Vendimi Nr.04/20, i datës 20 dhjetor 2017, për caktimin e pagës mujore të Kryeministrit, Ministrave, zëvendëskryeministrave, Shefit të Stafit, Shefit të Kabinetit, etj., po ashtu duket se është në kundërshtim me Kushtetutën dhe duket se nuk ka mbështetje në ligj. Një vendim i tillë është në kundërshtim me Kushtetutën, për shumë arsye. Së pari, sipas Kushtetutës, Qeveria nxjerrë vendime që janë të nevojshme për zbatimin e ligjeve. Projektligji për Pagat nga Buxheti i Republikës së Kosovës deri më tani nuk është proceduar në Kuvend nga Qeveria. Së dyti, Avokati i Popullit konsideron se rritja deri në dyfishim të pagave të kategorive të caktuara, të cekura në Vendimin e Qeverisë është në kundërshtim me vlerat kushtetuese të cilat në mes tjerash bazohen në sundimin e ligjit, mos-diskriminimit dhe drejtësisë sociale.⁵⁸ Kosova është një ndër vendet më të varfra të Evropës, me një numër relativisht të madh të popullatës që jeton në minimumin ekzistencial.

Një vendim tjetër, mjaft diskutabil është edhe vendimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) për anulimin e procedurave të rekrutimit në konkursin për Inspektor/Hetues në Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK). Avokati i Popullit tërheqë vëmendjen për raste të ndërhyrjes politike në çështjet dhe procedurat e rekrutimit në institucionet e Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim Avokati i Popullit ka vërejtur se

⁵⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 7 [Vlerat]

⁵⁷ Upravno Pravo, Savremena Administracija

⁵⁸ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. KO 119/10, dt 8 dhjetor 2011, Parashtruesi Avokati i Popullit, Vlerësimi i kushtetueshmërisë së nenit 14, paragrafit 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27, të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Nr.03/L-111, të 4 qershorit 2010, pika 78.

në konkursin për Inspektor/Hetues në IPK, ministri i MPB-së ka ndërhyrë në procedurat e rekrutimit duke marrë vendim për pezullimin e nënshkrimit të kontratave me kandidatët e përzgjedhur sipas konkursit, edhe pse për këtë çështje nuk ka pasur kompetencë ligjore. Më tej, ministri ka kërkuar anulimin e konkursit, gjë që ka ndodhur më 29 dhjetor 2017. Avokati i Popullit konstaton se në rastin konkret ministri ka ndërhyrë në kompetencat e Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së duke mos respektuar Ligjin Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, që është ligj bazik, i cili përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e IPK-së, e po ashtu duke mos respektuar Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2017 për procedurat lidhur me kushtet e punësimit dhe të punës për punëtorët e IPK-së. Avokati i Popullit shpreh shqetësimin e tij se ndërhyrje të tilla krijojnë pasiguri juridike të normave që përcaktojnë kompetencat e subjekteve bartëse të institucioneve e po ashtu krijon pasiguri në normat që rregullojnë çështjet dhe procedurat e rekrutimit për punonjësit në institucionet e Republikës së Kosovës.

5.2 Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK)

Avokati i Popullit gjatë viteve të kaluara ka publikuar një numër raportesh me rekomandime, lidhur me zvarritjet e procedurave gjyqësore në DHPGJSK, por si duket këto rekomandime nuk kanë prodhuar ndonjë efekt, pasi që situata ka mbetur e pandryshuar. Avokati i Popullit, gjatë hetimit të ankesave të drejtuara kundër DHPGJSK-së për zvarritje të procedurave gjyqësore dhe komunikimit me kryetarin e DHPGJSK-së ka identifikuar një problem sistematik. Avokati i Popullit ka vlerësuar se problemet kryesore të cilat shkaktojnë zvarritje janë dispozitat e Ligjit për Dhomën e Posaçme, përkatësisht neni 3.1 i ligjit, i cili përcakton numrin dhe përbërjen e gjyqtarëve.

Prandaj, Avokati i Popullit ka përcjellë tek autoritetet përgjegjëse Raportin *ex officio* me rekomandime lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut të shkaktuara nga zvarritjet procedurale në trajtimin e lëndëve nga DHPGJSK, duke u bazuar në 49 ankesa të ndara të paraqitura në IAP. Në këtë numër ankesash nuk janë llogaritur edhe ankesat e paraqitura kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), e që lidhen me çështjet që kanë të bëjnë me DHPGJSK dhe që për nga natyra janë të njëjta me ankesat kundër DHPGJSK-së. Raporti ka marrë parasysh edhe faktin se rastet e ankuesve kanë kaluar paraprakisht edhe nëpër një procedurë në AKP, gjë që ndikon akoma më shumë në zvarritjen zgjidhjes së këtyre ankesave.

Në Raport konstatohet se grumbullimi i lëndëve për DHPGJSK është rezultat i numrit të kufizuar me ligj të gjyqtarëve, zëvendësimit të shpeshtë të gjyqtarëve, në veçanti të gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe mungesës së këshilltarëve ligjor dhe përkthyesve.

Avokati i Popullit ka kërkuar ndërmarrje të masave nga autoritetet përkatëse të Republikës së Kosovës, konkretisht ndryshimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme, përkatësisht të dispozitës ligjore që kufizon numrin e gjyqtarëve në DHPGJSK, si masë urgjente në rritjen e efikasitetit të DHPGJSK-së.

Po ashtu, Avokati i Popullit ka rekomanduar që Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) t'i ofrojë mbështetje DHPGJSK-së në aspektin organizativ dhe operativ, në pajtim me kërkesat dhe nevojat e funksionimit adekuat të DHPGJSK-së, si dhe i ka rekomanduar DHPGJSK-së të hartojë një strategji për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara duke vendosur jo vetëm shpërndarje të barabartë të rasteve për secilin gjyqtar, por edhe norma dhe afate brenda të cilave duhet të zgjidhet numri i caktuar i lëndëve nga secili gjyqtar.

Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga DHPGJSK dhe KGJK të cilat janë pajtuar me konstatimet e Avokatit të Popullit dhe janë zotuar në ndërmarrjen e masave të rekomanduara nga Avokati i Popullit, përderisa nuk ka pranuar përgjigje nga Qeveria e Kosovës por që është njoftuar në mënyrë joformale për nismën e Ministrisë së Drejtësisë për ndryshimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme.

5.3 Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Avokati i Popullit ka vazhduar të pranojë ankesa kundër AKP-së, megjithëse në numër më të vogël se viteve më parë, që kryesisht kanë të bëjnë me kompensimin e ish-punonjësve të ndërmarrjeve shoqërore në privatizim/likuidim. Është vërejtur gjatë viteve të kaluara se në situatat kur AKP me vendim i njeh të drejtën për kompensim ish punonjësve të ndërmarrjeve shoqërore në procesin e privatizimit apo likuidimit, këto vendime nuk zbatohen shpejt për shkak se i nënshtrohen procesit gjyqësor në DHPGJSK. Ky proces gjyqësor mund të mos jetë drejtpërdrejtë në lidhje me vendimet individuale për kompensim, por çfarëdo ankese që ka të bëjë me privatizimin apo likuidimin e ndërmarrjes shoqërore të caktuar, drejtuar DHPGJSK-së pezullon zbatimin e vendimeve për kompensim të lëshuara nga AKP. Prandaj, procesi i shpërndarjes së mjeteve mbetet peng i përfundimit të proceseve që janë në shqyrtim në DHPGJSK. Kuptohet se kjo është një procedure e përcaktuar me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, por për këtë procedurë ish punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore, të cilëve u është njohur kompensimi, nuk njoftohen në mënyrë të duhur, prandaj në mungesë të informatave dhe pasigurisë që krijohet rreth faktit se kur do të zbatohen vendimet për kompensim ata shumë shpesh i drejtohen IAP-së me ankesa për moszbatimin e vendimeve të AKP-së. AKP do të duhej që me rastin e lëshimit të vendimeve për njohje të së drejtës në kompensim, të njoftojë personat të cilëve u është njohur kjo e drejtë, se shpërndarja e mjeteve do të bëhet pasi që i gjithë procesi i privatizimit apo likuidimit të ndërmarrjes shoqërore të përfundojë me vendime përfundimtare të lëshuara nga DHPGJSK.

5.4 Çështja e Fabrikës së Tubave (IMK) në Ferizaj

Rasti i Fabrikës së Tubave në Ferizaj është rast i njohur për publikun, lidhur me të cilin punëtorët e fabrikës kishin paraqitur ankesë edhe te Avokati i Popullit, i cili e ka trajtuar këtë rast në të kaluarën dhe i ka mbajtur në fokus zhvillimet rreth kompensimit të ish-punëtorëve të fabrikës. Avokati i Popullit është takuar disa herë me ankuesit dhe ka dëgjuar shqetësimet e tyre. Së fundi, ankuesit kanë paraqitur në IAP Qëndrimin e Bordit të AKP-së për çështjen e ish-punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj, të datës 21 qershor 2016. Më sa kuptohet nga Qëndrimi i Bordit të AKP-së pagesa për ish punëtorët

e Fabrikës së Tubave nuk mund të realizohet për shkak të procedurave gjyqësore të shqyrtimit të ankesave në DHPGJSK për Fabrikën e Tubave. Bordi i AKP-së ka udhëzuar që të kërkohet nga Dhoma e Posaçme që të trajtojë me prioritet ankesat e parashtruara në procedurën e likuidimit të Fabrikës së Tubave. Avokati i Popullit duke marrë parasysh faktin se Gjykata Kushtetuese tanimë ka konstatuar se ka pasur shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm për shkak të mosekzekutimit të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Ferizaj, i është drejtuar DHPGJSK-së duke kërkuar informata se në çfarë faze ndodhet trajtimi i ankesave në procedurën e likuidimit të N.SH. Fabrikës së Tubave. Avokati i Popullit me këtë rast ka kërkuar nga DHPGJSK që t'i kushtojë prioritet ankesave që kanë të bëjnë me procedurën e likuidimit të Fabrikës së Tubave, në mënyrë që ish-punëtorët e fabrikës të jenë në gjendje t'i realizojnë të drejtat e tyre.

DHPGJSK i është përgjigjur Avokatit të Popullit duke njoftuar se janë 49 lëndë në pritje në DHPGJSK për t'u proceduar që ndërlidhen me paditë - ankesat e punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj, të paraqitura ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit, duke bashkëngjitur edhe listën e lëndëve që janë në trajtim. Kryetari i DHPGJSK-së me këtë rast ka bashkëngjitur edhe një shkresë drejtuar gjyqtarëve të rastit duke përcjellë rekomandimin e Avokatit të Popullit që rastet që kanë të bëjnë me Fabrikën e Tubave të trajtohen me prioritet.

5.5 Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP)

Duke marrë parasysh bartjen e disa përgjegjësive nga Agjencisë Kosovare të Pronës tek AKKVP, Avokati i Popullit në raportin e vitit 2016 kishte kërkuar përkrahje maksimale për AKKVP. Gjatë vitit 2017, Avokati i Popullit ka vërejtur se disa dispozita të Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës nuk janë në pajtim me *Parimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Rikthim të Banimit dhe Pronave për Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur* të njohura si *Parimet e Pinherios* si dhe që këto dispozita cenojnë të drejtat pronësore të personave të zhvendosur. Avokati i Popullit ka vërejtur se Ligji për AKKVP parashikon heqjen e dy kompetencave të rëndësishme të kësaj Agjencie. Së pari, Ligji përcakton se pas 18 muajve nga hyrja në fuqi e Ligjit, Agjencia nuk do të vazhdojë administrimin e pronave nën kujdesin e saj. Së dyti, për çdo rast kur AKKVP kryen dy dëbime të uzurpuesve të një prone të njëjtë, Ligji për AKKVP parashikon se përgjegjësia për çdo dëbim tjetër lidhur me atë pronë, do të kalohet tek vetë pronari, brenda sistemit të rregullt të përmbarimit privat.

Ligji po ashtu përcakton se Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e Agjencisë, nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Qeveria ka dështuar që të nxjerr aktet nënligjore brenda afatit të përcaktuar me ligj, duke e shkurtuar kështu afatin 18 mujor për zbatimin e dispozitave të ligjit që kanë të bëjnë me shuarjen e skemës së administrimit të pronave nga agjencia për 8 muaj. Ligji për AKKVP ka hyrë në fuqi më 3 nëntor të vitit 2016, ndërsa Qeveria ka nxjerrë Vendimin Nr. 06/149

të datës 17 korrik 2017, me të cilin është miratuar Udhëzimi Administrativ nr. 07/2017 për procedurat, kushtet dhe kriteret rreth përfundimit të administrimit të pronave nën administrim dhe atyre të përfshira në skemën e qirasë të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Prandaj, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me Rekomandime Nr.551/2017, me të cilin ka kërkuar ndryshimin e dispozitave të Ligjit për AKKVP, të cilat sipas Avokatit të Popullit nuk janë në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe të cilat cenojnë të drejtat pronësore të personave të zhvendosur.

Aktualisht, Zyra e Kryeministrit së bashku me akterët përkatës është në përpilim të konceptit për ndryshimin e Ligjit për AKKVP, duke filluar kështu zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

5.6 Shpronësimet e pronës së paluajtshme

Avokati i Popullit ka pranuar ankesë nga banorët e fshatrave Shipitullë dhe Hade, Komuna e Obiliqit lidhur me procesin e zhvendosjes së banorëve që sipas tyre bëhet për interesa të KEK-ut me pretendimet se ka shkelje të të drejtave të njeriut dhe të drejtës pronësore.

Gjatë hetimit të këtyre ankesave Avokati i Popullit ka vërejtur se banorët e këtyre fshatrave e kundërshtojnë të ashtuquajturën Draft Matricën e të Drejtave e cila ishte përgatitur nga një kompani ndërkombëtare e kontraktuar nga KEK-u për vlerësimin e pronave të pronarëve.

Avokati i Popullit rikujton me këtë rast, se sipas Kushtetutës e drejta e pronës është e garantuar. Por, autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj dhe se është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.⁵⁹

Sipas kësaj, e drejta e pronës është e garantuar por ajo mund të kufizohet më ligj nëse kjo është e nevojshme për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik. Ndërsa, Ligji Nr.03/L-2015 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe Ligji Nr. Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, në mes tjerash, përcakton në mënyrë të qartë rregullat dhe kushtet sipas të cilave mund të bëhet shpronësimi i të drejtave pronësore ose të drejtave tjera në pronën e paluajtshme të një personi.

Së këndejmi, qëndrimi i Avokatit të Popullit lidhur me ankesën e banorëve ndaj zhvendosjes është se kufizimi i të drejtës pronësore mund të bëhet ekskluzivisht me Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe se përpjekjet tjera, si në rastin konkret marrëveshja për zhvendosje, nuk janë në pajtim me Kushtetutë dhe me ligj.

⁵⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

IAP ka qenë në kontakt me banorët e fshatrave të cilët kanë paraqitur ankesa dhe shqetësime në IAP lidhur me mënyrën dhe shumën e kompensimit, të garantuar me Ligjin për Shpronësimin e Pronave të Paluajtshme dhe se Plani i Veprimit për Zhvendosje (PVZH) i Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor nuk garanton shpronësim adekuat në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin. Sidoqoftë, Avokati i Popullit gjatë komunikimit me banorët ka arritur të kuptojë se një numër i konsiderueshëm pronarësh të pronave në këto zona tanimë kanë hyrë në negociata me KEK-un për zhvendosje sipas PVZH, gjë që paraqet devijim nga Kushtetuta dhe ligji kur bëhet fjalë për kufizimin e të drejtës pronësore për interes publik.

Avokati i Popullit është në hetim të një rasti për të cilin dyshohet për shkelje të procedurave të shpronësimit.⁶⁰ Në bazë të pohimeve të ankuesit kuptohet se ndërtimi i rrugës lokale Botushë-Koshare, në gjatësi prej 8.3 km, kalon nëpër pronat e ankuesit dhe të disa pronarëve tjerë, me ç'rast ata pretendojnë se janë privuar pa të drejtë nga shfrytëzimi i qetë dhe i lirë i pronës, sepse u është marrë prona në kundërshtim me ligjin dhe ata nuk janë kompensuar për pronën e marrë.

Lidhur me këtë Avokati i Popullit i ka drejtuar letër ministres së MPMH me të cilën ka kërkuar informata lidhur me rastin. Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje nga MPMH, as pas dërgimit të letrës përsëritëse të Avokatit të Popullit për këtë çështje.

Avokati i Popullit deri në hartimin e këtij raporti nuk ka pranuar ndonjë përgjigje, por gjithsesi do të vazhdojë hetimet për këtë rast.

5.7 Kushtëzimi i regjistrimit të automjeteve me pagesën e tatimit në pronë

Avokati i Popullit ka pranuar një numër ankesash me pretendim për shkelje të të drejtave pronësore për shkak të kushtëzimit me rastin regjistrimit të automjeteve me pagesën e tatimit në pronë nga komunat. Për më shumë, ankuesit kane pohuar se ata janë detyruar nga komuna, në këtë rast Komuna e Prishtinës, të paguajnë tatimin në pronë për pronën e prindërve të tyre edhe përkundër faktit që ata nuk janë shfrytëzues apo pronarë të atyre pronave.

Gjatë hetimit të ankesave është hasur në Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Financave (MF) nr.07/2011 për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë, i cili ka vënë kushtëzim procedural për qytetarët, nëpër të gjitha komunat, për kryerjen e obligimeve të tatimit në pronë si kusht për t'u pajisur me urdhëresë komunale për ta regjistruar automjetin. Në anën tjetër, është hasur edhe në Udhëzimin Administrativ nr.16/2016 i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) sipas të cilit çdo qytetar është i obliguar që të sjellë në Qendrën Komunale të Regjistrimit të Automjeteve dëshminë e pagesës së taksës komunale në mënyrë që të vazhdojë regjistrimin e automjetit.

Avokati i Popullit, duke u bazuar në qëndrimin e GJEDNJ-së, vlerëson se kompetenca

⁶⁰ Rasti 413/2017 - Rama ./ MPMH

për të vënë pagesën e taksave është një ndër atributet e sovranitetit shtetëror. Me këtë rast, Avokati i Popullit vlerëson se vendosja e taksave dhe obligimi për të paguar tatimin në pronë, si i tillë, nuk cenon të drejtat dhe liritë themelore.

Mirëpo, Avokati i Popullit e konsideron se kushtëzimi nga komunat i vendosur me Udhëzimin Administrativ nr.07/2011 të MF-së, me të cilin qytetarët detyrohen ta paguajnë tatimin në pronë në mënyrë që atyre t'u lëshohet dëshmia për pagesën e taksës komunale të nevojshme për regjistrimin e automjetit, sipas Udhëzimit Administrativ nr.16/2016 të MPB-së, nuk është metodë e ligjshme për vjelje të tatimit në pronë. Avokati i Popullit e ka parasysh, se vjelja e tatimit në pronë është jetike për funksionimin e komunave, mirëpo ai e konsideron se kjo duhet të bëhet në pajtim me ligjin. Konsiderojmë se këto dy udhëzime administrative anashkalojnë procedurat për pagesën e tatimit në pronë të përcaktuar me Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme Nr.03/L-204.

Lidhur me këtë Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me Rekomandime⁶¹ me të cilin ka kërkuar nga ministritë e lartpërmendura shfuqizimin e dispozitave të caktuara të këtyre dy udhëzimeve administrative. Po ashtu, ka kërkuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) të ndryshojë qëndrimin e saj zyrtar të shprehur në Shkresën shpjeguese të datës 20 qershor 2012, drejtuar Kryetarëve të Komunave të Republikës së Kosovës dhe Kryesuesve të Kuvendeve Komunale dhe të nxjerrë një qëndrim të ri me konstatimin se kushtëzimet për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve nga komunat me pagesën e tatimit në pronë nuk kanë bazë ligjore dhe janë në kundërshtim me të drejtat e njeriut dhe si të tilla nuk mund të aplikohen.

Fatkeqësisht, deri më tani rekomandimet e Avokatit të Popullit kanë mbetur të pazbatuara nga autoritetet përgjegjëse.

5.8 Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Një çështje tjetër që e ka karakterizuar punën e IAP-së në periudhën raportuese është çështja e faturimit të rrymës së shpenzuar në veri. Avokati i Popullit ka iniciuar hetime *ex officio*, duke u bazuar në shkrimin e gazetës “Zëri”, të datës 7 prill 2017, me titull: “KEDS-i na faturon 8 milionë euro në vit për rrymën e serbëve të veriut.” Në letrën drejtuar Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), më 28 prill 2017, në mes tjerash janë kërkuar informata nëse vlera e energjisë që shpenzohet në veri të Kosovës është 8 milionë euro në vit dhe se kjo vlerë u shpërndahet nëpër fatura të qytetarëve në të gjithë Kosovën, ashtu siç është raportuar në shkrimin e gazetës “Zëri”. Më 18 maj 2017, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga ZRRE me konfirmimin se rryma që shpenzohet në veri u faturohet qytetarëve në pjesët tjera të vendit, me pretendimet se kjo është në pajtim nenin 48 [Miratimi i tarifave], paragrafi 3, pika 3.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë

⁶¹ Raport me rekomandime për rastet A.nr. 347/2015;A.nr. 729/2015;A.nr. 730/2015 dhe A.nr. 333/2015, i publikuar më 20 mars 2017.

Nr.05/L-084 dhe nenin 28 [Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes], paragrafi 1, pikat prej 1.21 deri 1.25 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085. Sipas ZRRE-së, neni 48, paragrafi 3, pika 3.3 përcakton se ZRRE gjatë miratimit apo caktimit të tarifave, do të sigurojë që të licencuarve t'u mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme, duke përfshirë, përveç tjerash, edhe kostot e niveleve të humbjeve të energjisë në sistemet e transmetimit dhe të shpërndarjes. ZRRE më tej ka theksuar se furnizimi me energji elektrike i të gjithë konsumatorëve është obligim ligjor, prandaj gjatë miratimit të tarifave ZRRE merr në konsideratë një nivel të arsyeshëm të humbjeve, të cilat i trajton në mënyrë të barabartë në tërë territorin e Kosovës. ZRRE për më shumë ka theksuar se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) e ka të pamundur qasjen në veri të vendit dhe se humbjet që shkaktohen atje nga OSSH konsiderohen si "humbje politike" që janë jashtë kontrollit të OSSH dhe se OSSH nuk mund të kryejë funksionet e veta për shkak të kostos së lartë të këtyre humbjeve, gjë që do të rrezikonte furnizimin e rregullt me energji elektrike në të gjithë vendin. Po ashtu, ZRRE ka konfirmuar se ekziston një vendim i datës 6 shkurt 2012, nr. V_399_2012 me të cilin përcaktohet niveli i reduktimit të humbjeve në shpërndarje. Sipas ZRRE-së, ky vendim për reduktim të humbjeve përcakton nivelin e reduktimit të të gjitha humbjeve në sistemin elektroenergjetik duke përfshirë edhe humbjet në veri të Kosovës.

Avokati i Popullit pas komunikimit me ZRRE, ka zhvilluar komunikime edhe me Ministrinë për Zhvillim Ekonomik (MZHE) dhe Ministrinë për Tregti dhe Industri (MTI).

Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit ka publikuar Raport me gjetjet se asnjë nga ligjet që e rregullon sektorin e energjisë elektrike nuk i jep ZRRE-së të drejtë për të faturuar rrymën e shpenzuar në veri qytetarëve në pjesë të tjera të vendit. Është gjetur se bëhet fjalë për një praktikë të ZRRE-së, të pabazuar në ligj, e cila përbën shkelje të shumëfishtë, sepse është në kundërshtim me vet ligjet për energjinë elektrike, shkel të drejtën e qytetarëve për t'u mos u diskriminuar, të drejtën e pronës dhe të drejtën e konsumatorit. Prandaj, është rekomanduar që ZRRE-ja urgjentisht të ndalë praktikën e kundërligjshme të faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në veri të Republikës së Kosovës tek konsumatorët në pjesën tjetër të vendit; që Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me ZRRE-në dhe KEDS-in, të gjejë një mënyrë alternative për t'iu shmangur humbjeve në veri të vendit, duke trajtuar të gjithë konsumatorët në mënyrë të barabartë sipas normave kushtetuese dhe ligjore kundër diskriminimit dhe që ZRRE-ja, në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, të nxjerrë një vendim, me të cilin do të miratohej zbritja e tarifave deri në atë masë që do të mundësonte kompensimin e konsumatorëve të cilët, padrejtësisht janë faturuar dhe vazhdojnë të faturohen, për energjinë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore. Më 12 korrik 2017, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga ZRRE lidhur me Raportin me Rekomandime me të cilën ZRRE njofton Avokatin e Popullit për vështirësitë në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Duke marrë parasysh faktin se rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk janë përfillur nga ZRRE dhe duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me një vendim administrativ të ZRRE-së, Avokati i Popullit më 15 gusht 2017 ka

paraqitur padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës - Departamenti për Çështje Administrative, me ç’ rast ka kërkuar anulimin e Vendimit të ZRRE-së V_399_2012, të datës 6 shkurt 2012 dhe kompensimin e konsumatorëve të cilët faturohen për shpenzimin e energjisë elektrike në katër komunat veriore. Bashkë me padinë është kërkuar shtyrja e ekzekutimit të Vendimit të ZRRE-së V_399_2012. Gjykata Themelore në Prishtinë më 11 shtator 2017. ka aprovuar kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit deri në marrjen e aktgjykimit sipas kërkesëpadisë. ZRRE, më 29 shtator 2017 ka ushtruar ankesë ndaj vendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në Gjykatën e Apelit, e cila e ka refuzuar ankesën e ZRRE-së si të pabazuar dhe ka vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës. Më 30 nëntor 2017, Avokati i Popullit është njoftuar nga ZRRE për zbatimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë. ZRRE ka theksuar se kjo është një zgjidhje e përkohshme dhe se nuk pasqyron vendimin e Bordit të ZRRE-së. Sidoqoftë, tanimë çështja kryesore është duke u trajtuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe deri në hartimin e këtij raporti akoma nuk është marr ndonjë vendim.

5.9 Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

Në fillim të vitit raportues është ngritur shqetësimi për faturimin paushall të shpenzimeve të ujit nga kompanitë e ujësjellësit. Lidhur me këtë Avokati i Popullit ka rekomanduar që faturimi i ujit të bëhet në bazë të konsumit real në njehsorin e konsumatorit dhe shpenzimeve reale, ashtu sikur që parashihet me Ligjin Nr.04/L-121 për mbrojtje të konsumatorëve si dhe ka kërkuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) monitorimin e rregullt të Ofruesve të Shërbimeve. Nga përgjigja që Avokati i Popullit ka pranuar nga ARRU vërehet se çështja e faturimit dhe çështja e monitorimit të operatorëve të licencuar është mirë e normuar nga ARRU me Rregulloren për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë. Po ashtu, nga një raport që Avokati i Popullit ka pranuar nga ARRU raportohet se ARRU zhvillon inspektime të rregullta edhe në teren si dhe ndërmerr masa në rastet e mungesës së përmbushjes së standardeve minimale për shërbimet e ujit.

Sidoqoftë, situata mbetet problematike në pjesën veriore të vendit ku operon ndërmarrja e pa licencuar “Vodovod Ibar” e cila e distribuon ujin deri te konsumatori final. ARRU ka njoftuar se ka dënuar këtë kompani me 20,000 EUR, e cila nuk i është përgjigjur ARRU-së, prandaj rasti është ngritur në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe se akoma nuk ka ndonjë vendim lidhur me padinë e ngritur nga ARRU kundër ndërmarrjes “Vodovod Ibar”. Përderisa rasti i furnizimit me ujë të pjesës veriore të Mitrovicës dallon nga rasti i furnizimit dhe faturimit të rrymës së shpenzuar në atë pjesë, sepse sipas përgjigjes së ARRU ujësjellësi rajonal KRU “Mitrovica” furnizon pjesën veriore të qytetit me ujë, me çmim e ujit të shitjes me shumicë dhe se qytetarët e pjesës tjetër të qytetit nuk paguajnë për pjesën veriore, është Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) e cila kohë pas kohe, sipas mundësive buxhetore, e subvencionin KRU “Mitrovica” për të mbuluar shpenzimet dhe për të bërë të mundur operimin e ndërmarrjes. Prej asaj çfarë ka mundur të kuptohet nga komunikimi i Avokatit të Popullit

me ARRU dhe me MZHE-në është se edhe për shpenzimet e ujit në pjesën veriore të vendit mungon inkasimi i rregullt nga operatori i licencuar për shpërndarje të ujit. Po ashtu, kuptohet se Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Ligjit të Buxhetit ka mbështetur pjesërisht KRU “Mitrovica” që nga viti 2009 deri në vitin 2017 në vlerë prej 5,291,078.⁰⁰ EUR në emër të kategorive të veçanta sociale që janë liruar nga pagesat dhe mungesën e inkasimit në pjesën e komunave veriore.

Kuptohet se çështja e furnizimit me ujë është një çështje jetike fundamentale, por megjithatë faturimi për pjesën e veriut, subvencionimi nga Qeveria dhe kriteret për subvencionim duhet të definohen në mënyrë të qartë. Po ashtu, është e nevojshme që të zgjidhet edhe çështja e licencimit të ndërmarrjeve të cilat e bëjnë distribuimin e ujit në pjesën veriore të qytetit, sepse megjithatë buxheti i shtetit paraqet të hollat e qytetarëve taksapagues të Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit ka zhvilluar një takim me menaxhmentin e ARRU me të cilët janë dakorduar që të organizohet një takim i përbashkët me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrinë e Financave, Bordin e Drejtorëve dhe menaxhmentin e KRU “Mitrovica” për të gjetur një zgjidhje të pranueshme për faturimin e ujit në pjesën veriore të Mitrovicës.

5.10 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Kosovë

Gjatë kësaj periudhe raportuese, IAP është ballafaquar me tendencat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Kosovë (KPMK) për ndërhyrje në pavarësinë e IAP-së apo paaftësinë e KPMK-së për të kuptuar pavarësinë e institucioneve të pavarura, të garantuara sipas Kapitullit XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

IAP gjatë vitit 2017, ka zhvilluar ri-organizimin e strukturës së brendshme, në pajtim me Rregulloren Nr.01/2016 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institucionin e Avokatit të Popullit. Procedura e rekrutimit të stafit të ri dhe avancimit të stafit ekzistues është zhvilluar nëpërmjet një procesi të hapur dhe transparent, duke u bazuar në kriteret profesionale.

Avokati i Popullit dëshiron të vë në pah se KPMK nuk e ka kuptuar qartë pavarësinë e IAP-së, të konfirmuar edhe me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës KO73/16, të datës 8 dhjetor 2016, prandaj edhe ka marrë vendime për të anuluar të gjitha procedurat ku KPMK në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi ka qenë i përfshirë. Kundër dy vendimeve për anulimin e procedurave të rekrutimit, Avokati i Popullit ka paraqitur padi për konflikt administrativ dhe është në pritje të vendimeve. Sidoqoftë, çështja e cila është ngritur nga KPMK është autorizimi i Avokatit të Popullit për të nxjerrë rregullore të brendshme, gjë që vërehet në secilin vendim të KPMK-së.

Avokati i Popullit me këtë rast dëshiron t’ia rikujtojë edhe Kuvendit se nxjerrja e rregulloreve të brendshme nga Avokati i Popullit del si obligim nga Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, të miratuar nga ky Kuvend.

Për më shumë, me hyrjen në fuqi të pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut, në korrik të vitit 2015, (Ligji për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020 dhe Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi Nr. 05/L-21), IAP-së si institucion i vetëm kombëtar për drejtat e njeriut i janë shtuar kompetenca të veçanta me qëllim të zbatimit të tyre. IAP me qëllim të kryerjes së përgjegjësive ligjore, me ligjin bazik për Avokatin e Popullit i është dhënë e drejta e nxjerrjes së rregulloreve të veçanta në kuptim të reformimit, ristrukturimit dhe funksionalizimit të tij. Nga teksti i Ligjit aktual për Avokatin e Popullit, dëshmohej qëllimi i ligjdhënësit për të liruar Avokatin e Popullit prej rregullave të shërbimit civil, të paktën për sa i përket procedurës së organizimit të brendshëm dhe rekrutimit. Dallimi ndërmjet Ligjit aktual për Avokatin e Popullit dhe Ligjit të mëparshëm (tashmë të shfuqizuar), e bën të qartë këtë qëllim legjislativ. Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit (tashmë i shfuqizuar) ka përcaktuar se: “Personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit përzgjidhet nga radhët e qytetarëve të Republikës së Kosovës në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës” (neni 30). Ndërsa, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (në fuqi), përcakton se: “Personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit zgjidhet në mesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, në një proces të hapur dhe transparent, bazuar në kriteret profesionale” (neni 32, par. 1).

Ky ndryshim sugjeron se i vetmi obligim i Avokatit të Popullit në zhvillimin e procedurës së rekrutimit është që të ndjekë *“një proces të hapur dhe transparent, bazuar në kriteret profesionale”* por jo edhe të veprojë *“në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës”*.

IAP me qëllim të kryerjes së përgjegjësive ligjore, me ligjin në fuqi për Avokatin e Popullit, i është zgjeruar e drejta e nxjerrjes së rregulloreve të veçanta në kuptim të reformimit, ristrukturimit dhe funksionalizimit të tij. Dallimi ndërmjet ligjit aktual për Avokatin e Popullit dhe ligjit të mëparshëm (tashmë të shfuqizuar), qëndron në zgjerimin e autorizimeve të Avokatit të Popullit për të nxjerrë rregullore të veçanta. Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit (tashmë i shfuqizuar) ka përcaktuar se: “Brenda tre (3) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Institucioni i Avokatit të Popullit nxjerrë Rregulloren e punës.” (neni 37). Përderisa, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (në fuqi) përcakton se: “Avokati i Popullit nxjerrë Rregulloren e punës, Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin.” (neni 37.1)

Me këtë rast, Avokati i Popullit dëshiron ta bëjë të qartë se në asnjë rrethanë nuk i shmanget përgjegjësisë për llogaridhënie për çështjet të cilat nuk e prekin pavarësinë e IAP-së, madje është shumë i vullnetshëm që një organ si KPMK të vazhdojë të mbikëqyrë proceset e rekrutimit të IAP, por që kjo mbikëqyrje të bëhet në pajtim me rregulloret e brendshme të IAP-së, të miratuara nga Avokati i Popullit në pajtim me ligjin dhe të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

5.11 Përgjegjësia për mjedisin jetësor

Gjatë vitit 2017, IAP ka vazhduar të pranojë ankesa që kanë të bëjnë me probleme mjedisore dhe ndikimin e tyre në të drejtat e njeriut. Përkundër problemeve të vazhdueshme mjedisore me të cilat janë ballafaquar qytetarët në vitet e kaluara, edhe gjatë vitit 2017 nuk është marr ndonjë veprim i cili ka ndikuar dukshëm në përmirësimin e cilësisë së mjedisit jetësor në vend.

Viti 2017, nuk ka shënuar ndonjë përmirësim të gjendjes së ajrit, ujërave dhe tokës, e as ndërmarritjen e masave për pengimin e shkarkimeve në to. Ka vazhduar degradimi i tokës bujqësore dhe shkatërrimi i sipërfaqeve pyjore. Proceset vendimmarrëse mjedisore janë zhvilluar në dritë të zbehtë të transparence, qasja në informata mjedisore nuk ka shënuar ndonjë përmirësim, e po ashtu nuk ka ndonjë përmirësim në drejtim të përshpejtimit të proceseve gjyqësore lidhur me lëndët që kanë të bëjnë me probleme mjedisore, si ato të natyrës penale, ashtu edhe ato të natyrës kundërvajtëse.

Edhe pse zurma vite me radhë ka cenuar privatësinë e qytetarëve, nuk është arritur të miratohet ligji i ri. Ndërsa, çështja e menaxhimit të mbeturinave dhe e deponive mbetet sfidë në vete. Edhe përkundër problemeve me të cilat janë ballafaquar qytetarët vite me radhë nga mosrespektimi i normave bazë të planifikimit hapësinor, nuk është shënuar ndonjë ndryshim.

Përkundër orientimeve dhe nismave globale për mbrojtje të mjedisit, mjedisi dhe mbrojtja e mjedisit në vend nuk është vendosur në prioritetet e qeverisë, edhe pse vendi është duke u ballafaquar me gjendje të rëndë mjedisore. Buxheti i MMPH-së vazhdon të mbetet tejet i ulët, ndërsa edhe pse e përcaktuar me ligj⁶², taksa ekologjike vazhdon të mos shfrytëzohet për qëllime të mbrojtjes së mjedisit, ashtu si është paraparë me Ligjin për Taksën Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve⁶³.

Përkrahë të gjithë parregullsive, gjatë vitit raportues nuk është vërejtur ndonjë aktivitet me përkushtim i organeve shtetërore, sidomos i MMPH-së, për promovimin e së drejtës së qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Bashkëpunimi ndërinstucional për zgjidhjen efektive të problemeve mjedisore në çështjet që kanë të bëjnë me ligje të ndryshme, nuk ka shënuar përmirësim. Ka vazhduar mungesa e bashkërendimit të aktiviteteve të institucioneve dhe organeve kompetente për mbrojtje të mjedisit.

Edhe pse shumë i rëndësishëm zëri i OJQ-ve, përkatësisht i shoqërisë civile nuk ka qenë i fuqishëm në drejtim të promovimit të kësaj të drejte, përkundër problemeve serioze

⁶² Ligji Nr. 04/L-117 për Taksën Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve, Neni , paragrafi 2. Me këtë ligj gjithashtu rregullohet edhe vendosja e taksës ekologjike për automjetet regjistruara në Kosovë dhe për automjetet e huaja. Taksa ekologjike ka për qëllim ngritjen e cilësisë së mbrojtjes së ambientit.

⁶³ Përgjigje e pranuar nga Ministria e Financave, lidhur me rastin Ex Officio nr 218/2016, “Në vështirësi të nenit2 të Ligjit Nr. 03/L-048 për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të hyrat nga taksat konsiderohen para publike dhe të gjitha paratë publike depozitohen në Fondin e Kosovës. Të gjitha të hyrat, duke përfshirë taksën ekologjike grumbullohen në buxhetin e Kosovës dhe destinohen sipas prioritetëve vjetore të përcaktuar me Ligjin Vjetor të buxhetit.

mjedisore, me të cilat është duke u ballafaquar Kosova. Madje, nuk është vërejtur ndonjë iniciativë për rrjetëzimin e organizatave të kësaj natyre.

Të zbehta ngelin veprimet e institucioneve dhe mediave në drejtim të vetëdijësimit dhe edukimit të qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit.

Institucionet shtetërore ende nuk kanë filluar të ndërmarrin veprime të qëndrueshme për t'iu bashkangjitur iniciativës globale lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.⁶⁴ Duke mos pasur ndonjë informatë të qëndrueshme përkundër interesimit të Avokatit të Popullit, Kosovës i mbetet që me hapa të përshpejtuar të ndërmarr masa në drejtim të përmbushjes së objektivave që kanë të bëjnë me mjedisin si: qasja në ujë të pastër dhe kanalizim⁶⁵, sigurimi i qasjes në energji të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë⁶⁶, të bërit e qyteteve dhe vendbanimeve të jetuara nga njerëzit, gjithëpërfshirëse, të përshtatshme dhe të qëndrueshme⁶⁷, marrjen e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e saj⁶⁸, mbrojtjen e ujërave, mbrojtjen, rivendosjen, dhe promovimin e qëndrueshëm të ekosistemit tokësor, menaxhimin në mënyrë të qëndrueshme të pyjeve, luftimin e shkretëtirëzimit, ndalimin e degradimit të tokës dhe ndalimin e humbjes së biodiversitetit⁶⁹.

Më 15 shtator 2017, në konferencën e katërt Ndërkombëtare për Mjedisin dhe të Drejtat e Njeriut, “Pjesëmarrja e publikut në çështjet mjedisore”, e mbajtur në Lubjanë (Slloveni), u nënshkrua deklarata për bashkëpunim më të ngushtë për mjedisin, dhe u krijua Rrjeti i Ombudsmanëve për Mjedisin dhe të Drejtat e Njeriut nga Avokati i Popullit i Kosovës dhe Ombudsmanët nga Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe Sllovenia. Me këtë rast u theksua se e drejta për një mjedis të shëndetshëm jetësor është e drejtë themelore e njeriut (të drejtat e gjeneratës së tretë) dhe që të gjitha shtetet duhet të përpiqen të miratojnë masa sistematike për t'i ushtruar ato. Po ashtu u theksua se çështjet e mjedisit të sigurt, të shëndetshëm janë të lidhura ngushtë me situatën në shtetet fqinje, sikurse në kontekstin ndërkufitar dhe global.

Ajri

Asnjë përmirësim në krahasim me vitin paraprak nuk është shënuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Në cilësinë e ajrit vazhdojnë të ndikojnë emisionet e liruara nga industria energjetike⁷⁰, përdorimi i mjeteve të vjetra të transportit, karburanteve të cilësisë së ulët dhe pa kontrollë efektive, pluhuri i liruuar nga ndërtimi i rrugëve dhe objekteve, ushtrimi i veprimtarive të gurthyesve dhe guroreve, djegia e hamulloreve dhe

⁶⁴ <http://www.undp.org/content/undp/en/home/sustainable-development-goals.html>

⁶⁵ <http://www.undp.org/content/undp/en/home/sustainable-development-goals/goal-6-clean-water-and-sanitation.html>

⁶⁶ <http://www.undp.org/content/undp/en/home/sustainable-development-goals/goal-7-affordable-and-clean-energy.html>

⁶⁷ <http://www.undp.org/content/undp/en/home/sustainable-development-goals/goal-11-sustainable-cities-and-communities.html>

⁶⁸ <http://www.undp.org/content/undp/en/home/sustainable-development-goals/goal-13-climate-action.html>

⁶⁹ <http://www.undp.org/content/undp/en/home/sustainable-development-goals/goal-15-life-on-land.html>

⁷⁰ Agjencioni për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës, Raport Gjendja e Mjedisit 2015

pyjeve, mos menaxhimi përkatës i deponive dhe mbeturinave urbane dhe industriale, djegia e materialeve piroteknike etj. Zonat e rrezikuara vazhdojnë të mbeten zona e KEK-ut, Ferronikeli, dhe Sharr Cem⁷¹ E drejta e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm ka vazhduar të kufizohet nga tejkalimet mbi normat e lejuara me ndotësit PM10, PM2.5⁷², me vlerën maksimale të lejuar (VML), e po ashtu tejkalimet e NO2, SO2⁷³ etj.

Sipas matjeve të realizuara nga stacionet e rrjetit për monitorimin e ajrit qytetarët kanë vazhduar të ballafaqohen me cilësi të pashëndetshme të ajrit. Dallojnë stacionet e monitorimit në Obiliq, me 90 ditë tejkalime të VML brenda vitit, Gjilani me 75, Prishtina-IHMK, me 75, Prishtina- Rilindja 66, Drenasi me 61, Hani i Elezit me 45, në raport me 35 ditë të tejkalimeve, të lejuara me Udhëzimin Administrativ 02/2011 për normat e cilësisë së ajrit.⁷⁴ Vetëm në janar qytetarët e Prishtinës janë ballafaquar me 15 ditë tejkalime.⁷⁵

Gjendja e rëndë e ndotjes së ajrit në komunën e Prishtinës me rrethinë filluar në periudhën tetor-dhjetor 2016, vazhdoi me parametra alarmant në muajt e parë të vitit 2017⁷⁶. Edhe pse në periudhën nëntor-dhjetor, i pritur tejkalimi i pragut të alarmit, nga tejkalimi i vlerave të lejuara në ajër, organet kompetente nuk arritën t'i përmbushin obligimet e tyre pozitive të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-160 Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja⁷⁷, të cilat do t'i garantonin qytetarëve të drejtën për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, dhe të do të siguronin mbrojtjen e shëndetit të tyre.

Përkundër problemeve të mëdha me tejkalimet e shkarkimeve në ajër, nuk janë ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e gjendjes. Masat e paralajmëruara nga MMPH⁷⁸, të quajtura *“Plani i aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë së ajrit vjeshtë-dimër 2017-2018”*, i cili parasheh arritjen e tri objektivave: përmirësimin e cilësisë së ajrit, rritjen e nivelit të zbatimit të legjislacionit dhe përgjegjësiive institucionale, si dhe ngritjen e nivelit të edukimit dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, Avokati i Popullit, e vlerëson si plan intervenimi⁷⁹ të vonuar dhe jo proporcional në krahasim me gjendjen e krijuar dhe dëmin e mundshëm të shkaktuar.

Po ashtu, vendimi i MMPH-së për zëvendësimin e thëngjillit me dru, nuk mund të konsiderohet masë racionale e as proporcionale, duke pasur parasysh gjendjen e pyjeve

⁷¹ Po aty, fq.40

⁷² <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs313/en/>

⁷³ <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs313/en/>

<http://www.icopal-noxite.co.uk/nox-problem/nox-pollution.asp>

⁷⁴ Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit I Kosovës, Raport Vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë, fq.8.

⁷⁵ Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit I Kosovës, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, Raporti Për Cilësinë e Ajrit për periudhën Nëntor –Dhjetor 2016 dhe Janar 2017.

⁷⁶ 484 ppm: http://www.gazetaexpress.com/lajme/alarmue-ndotja-e-ajrit-ne-prishtine-arrin-nivel-rekord-306596/?archive=1?utm_source=referral&utm_medium=web&utm_campaign=copyright

⁷⁷ Neni 1 dhe neni 24.

⁷⁸ <http://www.mmph-rks.org/sq/Lajmet/MASAT-PER-PERMIRESIMIN-E-CILESISE-SE-AJRIT-PRIORITET-I-MMPH-SE-DHE-QEVERISE-SE-KOSOVES-2055>

⁷⁹ Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 35

dhe ndikimin e djegies së drurit në mjedis. Edhe pse mund të përshëndetet vendimi për ndalimin e shfrytëzimit të thëngjillit për ngrohje, shteti paraprakisht ka dështuar të ndër marrë masa alternative që do t'i mundësonin individit zgjidhje të duhur.

Përkundër problemeve të vazhdueshme, nuk është vërejtur ndonjë përpjekje minimale për zgjerimin e rrjetit të kogjenerimit, i cili do të ndikonte në përmirësimin e cilësisë së ajrit në Prishtinë dhe rrethinë. Nuk është vërejtur ndonjë përmirësim, por as ndërmarrje e ndonjë mase efektive për zvogëlimin e transportit rrugor, në veçanti në komunën e Prishtinës. Ndërsa, vendosja e masave për efikasitet dhe kursim të energjisë, ka mbetur vetëm në vullnet të individit, pa asnjë kontrollë institucionale.

Edhe pse gjatë vitit raportues u evidentuan tejkalime të vlerave të lejuara, nuk është realizuar ndonjë fushatë informuese e veçantë dhe serioze nga MMPH, institucionet qendrore, komunat apo organizatat e autorizuar,⁸⁰ e cila do të përmbante informata për ndotjen, ndikimin në shëndet si dhe masat parandaluese. Informimi zyrtar i paraparë në ligj⁸¹ ka munguar. Qytetarët kanë vazhduar të informohen prej burimeve tjera jo zyrtare.

Avokati Popullit vëren se përkundër informacioneve⁸² të ndryshme për ngritjen e numrit të të prekurve nga sëmundjet e organeve respiratore, kardiovaskulare dhe malinje, sëmundjeve të lëkurës në territorin në fjalë⁸³, Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik⁸⁴ nuk ka ndër marrë asnjë veprim për të siguruar statistika dhe për të bërë hulumtime të veçanta, të cilat do të paraqitnin numrin real të kategorive në fjalë, si dhe do të ishin indikatorë për ndërmarrjen e veprimeve konkrete për edukimin dhe parandalimin e ndikimit të ndotjes në shëndetin e popullatës. Hulumtimi i bërë nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, pas ndotjes alarmante në fundin e vitit 2016⁸⁵, i bazuar vetëm në të dhënat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) për numrin e të sëmurëve nga organet respiratore, mund të konsiderohet si dokument me të dhëna jo të plota, duke pasur parasysh që qytetarët i drejtohen edhe institucioneve të tjera shëndetësore publike dhe private.

80 Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 54.

81 Ligjin Nr. 03/L-160 Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Neni 25 Informimi i publikut 1. Ministria, siguron që informatat e përditësuara për përqendrimin e materieve ndotëse në ajër të jenë në dispozicion të publikut dhe organizatave të interesuara.

82 Ndërtimi i së ardhmes më të mirë për qytetarët e Fushë Kosovës dhe Obiliqit: Pjesëmarrja, Mbrojtja dhe Partneritetet Shumetnike për Arsim, Shëndetësi më të mirë dhe Amvisëri më të Qëndrueshme, Zyra Rajonale e OBSHsë për Europë ka realizuar një mision në Kosovë, tetor të vitit 2012.

83 http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/204585/1/9789241565196_eng.pdf?ua=1 "In 2012, this present study estimates, 12.6 million deaths globally, representing 23% (95% CI: 13–34%) of all deaths, were attributable to the environment".

84 Ligji Nr. 02/L-78 Ligji Për Shëndetësi Publike, neni 4, "Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHP) është institucion publik i cili ushtron veprimtari referente në lëmin e shëndetësisë publike si në vijim:.."

l) Analizimit dhe vlerësimit të aerondotjes;"

t) Grumbullimit, përpunimit dhe analizimit të të dhënave nga Sistemi i Informimit shëndetësor (SISH) dhe propozimit të masave për avancimin dhe menaxhimin e SISH-it;

85 Informatë e pranuar nga përfaqësuesja e IKSHP, në tryezën me temë "Cilësia e ajrit në Kosovë, sfidat dhe veprimet", Prishtinë 10 nëntorë 2017

Uji

Nuk është ndërmarrë asnjë masë për të përmirësuar dhe të siguruar zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social - ekonomik⁸⁶ të vendit. Dëmtimi dhe degradimi i shtretërve të lumenjve, si formë e degradimit të resurseve ujore ka vazhduar, po thuaj në masë të njëjtë. Mbrojtja, ruajtja dhe monitorimi i cilësisë së ujërave mbetet njëra prej sfidave më të mëdha para shoqërisë sonë⁸⁷.

Përmirësimin e infrastrukturës ujore, rehabilitimi i shtretërve të lumenjëve, ngritja e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura dhe adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike në sektorin e ujërave, mbetet e pandryshuar. Mbledhja e pagesave për shfrytëzimin dhe shkarkimin e ujërave kanë vazhduar të jenë sfidë. Mbishfrytëzimi i pa kriter i inerteve ka shkaktuar tejkalimin e kapaciteteve të shtretërve, duke shkaktuar dëme jo vetëm në ekosistemin e lumenjve, por duke ndikuar edhe në vërshime dhe përmytje. Lumenjtë më të degraduar dhe që ende vazhdojnë të degradohen janë: Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Pejës, Ereniku, Lumi Desivojcë, Lumi Krivarekë dhe Ibrë.

Edhe pse e drejtë e njeriut, 0.7% e popullatës, nuk ka qasje në shërbimin e ujësjellësit⁸⁸. Vetëm 53% e popullsisë e bënë shkarkimin e ujërave të zeza nëpërmjet kanalizimit të lidhur me sistem publik, 16% e bëjnë shkarkimin e ujërave të zeza nëpërmjet kanalizimit që nuk menaxhohet nga kompanitë publike, kurse 27% e popullsisë përdorin forma tjera të shkarkimit (kanal, gropë septike etj.), ndërsa 4% nuk ka sistem të kanalizimit⁸⁹.

Ujërat e ndotura nuk trajtohen. Shkarkimi i tyre vazhdon të bëhet direkt në lumenj. Impianti për trajtimin e ujërave urbane në Llaushë të Skënderajt vazhdon të mbetet i vetmi impiant për trajtimin e ujërave të ndotura i cili funksionon me pengesa.

Industritë vazhdojnë të jenë gjeneruesit e një pjesë të konsiderueshme të ujërave të ndotura me potencial kontaminues në vend. Ato lirojnë elemente të komponimeve organike komplekse me përmbajtje acidike dhe me metale të rënda, të cilat mund të kenë ndikime të dëmshme në shëndetin e njeriut dhe mjedis. Shkarkuesit më të mëdhenj industrial në Kosovë janë Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Ferronikeli, Sharrçemi, Silçapori, Minierat Trepça, Kishnica, Artana, etj⁹⁰.

Më 29 maj 2017, Avokati i Popullit, vizitoi pikat e derdhjeve hidraulike nga Termocentralet Kosova A dhe Kosova B në lumin Sitnicë, në fshatin Dardhishtë të Komunës së Obiliqit. Nga mostrat e marra nga shkarkimi ujërave industriale, u pa se tejkalimet e vlerave të lejuara të shkarkimeve në ujë ishin alarmantë. Vlera e pH-së 12.78, në pikën e derdhjes hidraulike të Termocentralit Kosova A, dhe e pH-së 12.98, arrinte në grykëderdhjen hidraulike të Termocentralit B, janë tregues të tejkalimeve

⁸⁶ Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës

⁸⁷ Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit I Kosovës, Raport Vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë, fq.15.

⁸⁸ [http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_ujrave_i_2015_shqip_\(2\).pdf](http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_ujrave_i_2015_shqip_(2).pdf), fq.38

⁸⁹ [http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_ujrave_i_2015_shqip_\(2\).pdf](http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_ujrave_i_2015_shqip_(2).pdf), fq. 87

⁹⁰ MMPH, AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Republikën e Kosovës, fq.89.

ekstreme nga standardet e pranueshme të derdhjeve industriale të cilat dëmtojnë vlerat natyrore të ujit, dhe shkaktojnë pasoja afatgjata për njeriun dhe ekosistemin në përgjithësi. Avokati i Popullit u bëri thirrje autoriteteve përgjegjëse që të veprojnë në mënyrë urgjente në pajtim me ligjet përkatëse për mbrojtjen e ambientit dhe standardet e pranueshme për cilësinë së ujit, tokës dhe ajrit. Përkundër tejkalimit alarmant, Avokati i Popullit deri në kohën e përpilimit të këtij raporti nuk ka pranuar përgjigje nga MMPH, lidhur me çështjen dhe masat e ndërmarra.

Toka

E drejta e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, privatësia, e drejta e pronës dhe e gëzimit të shtëpisë, edhe më tutje kufizohet nga ndotja dhe degradimi i sipërfaqeve tokësore nga ndërhyrjet arbitrare. Nuk është vërejtur përmirësim i planifikimit të përdorimit të tokës në harmoni me konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm. Keqmenaxhimi i mbeturinave, deponitë e egra me mbeturina, shkarkimi i ujërave të zeza nga deponitë, shkarkimi i ujërave të patrajuara nga industrinë, gërmimi, hapja e rrugëve dhe eksploatimi i lumenjve, erozioni i tokës, ngjeshja e tokës, ndotja nga veprimtaritë ekonomike dhe industriale (ndotja kimike) mbeten problematike⁹¹ edhe gjatë këtij viti raportues. Edhe pse në masë më të vogël, edhe më tej ka vazhduar parcializimi i tokës bujqësore dhe ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në ndërtimore. Ndërsa, çështje në vete janë rrëshqitjet e dheut dhe dëmet e shkaktuara nga aktivitetet minerare. Mbetet evidente mungesa e sistemit për monitorimin e tokës (dheut) në Kosovë⁹², monitorimit të hotspotëve, të parametrave të cilësisë së tokës, të pjellorisë së tokës, si dhe parametrave për cilësinë e ushqimit.

Prerja e pakontrolluar e pyjeve ka vazhduar, duke rrezikuar menaxhimin e qëndrueshëm të tyre si dhe erozionin e tokave. Konsiderohet shqetësuese masa e ndërmarrë e MMPH-së për zëvendësimin e thëngjillit për djegie me masë drunore.

Mbeturinat

Ende nuk ka menaxhim të duhur të mbeturinave sipas standardeve, ndërkohë që ka vazhduar keqmenaxhimi i deponive dhe ndikimi i tyre në mjedis. Kompaktimi, mbulimi dhe rrjedhja e ujërave të zeza dhe depërtimi në prona private nuk është përmirësuar. Sasia më e madhe e mbeturinave është deponuar në deponinë sanitare në Mirash⁹³. Po ashtu në tërë territorin e vendit janë evidentuar deponi të egra, numri më i madh i të cilave është në Drenas (137), Pejë (123) dhe Lipjan (105). Parregullsitë në menaxhimin e deponive kanë ndikuar në frekuentimin e shumë qenve endacak, brejtësve dhe shpezëve, si bartës të sëmundjeve në zinxhirin e sistemit ekologjik, si dhe që gjysma e saj të jetë e mbushur çdo herë me ujë dhe të kundërmojë.⁹⁴ Nuk është vepruar në drejtim të krijimit të infrastrukturës së përshtatshme për ruajtjen ose trajtimin e mbeturinave të rrezikshme, të

⁹¹ Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit i Kosovës, Raport Vjetor për gjendjen e mjedisit ne Kosove, fq.20.

⁹² Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit i Kosovës, Raport Vjetor për gjendjen e mjedisit ne Kosove, fq 21.

⁹³ Po aty, fq. 29.

⁹⁴ Informatë e pranuar në përgjigjen e MMPH -së, në kërkesën e Avokatit të Popullit, datë 3 tetor 2016

cilat shpeshherë janë të përziera me mbeturina shtëpiake. Ndërsa, asgjë nuk është ndërmarrë për trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave. Fare pak është vepruar në drejtim të eliminimit dhe rehabilitimit të hotspotëve.⁹⁵ Edhe këtë vit shteti ka dështuar ta vë nën kontroll zhurmën dhe mbrojtjen e qytetarëve nga zhurma. As gjatë vitit 2017 nuk u miratua Ligji i ri për mbrojtje nga zhurma. Organet kompetente, duke u bazuar në ligjin aktual nuk arritën ta vënë nën kontroll zhurmën dhe të mbrojnë qytetarët nga ndërhyrjet e zhurmshme në privatësinë e tyre dhe gëzimin e shtëpisë. Po ashtu, është vërejtur mungesa e vullnetit të organeve kompetente për pajisje me aparate për matjen e zhurmës dhe për bashkëpunim në gjetjen e zgjidhjeve alternative. Ndërsa, çështje në vete është mos vendosja e paneleve për mbrojtje nga zhurma pranë vendbanimeve në autostrada.

Nuk është shënuar ndonjë përmirësim as në promovimin e cilësisë së lartë të jetesës dhe sistemeve të qëndrueshme për zhvillimin e vendbanimeve në planifikimin hapësinor, e cila do të krijonte parakushte për zhvillim social dhe ekonomik të baraspeshuar, trajtim të barabartë, lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për të gjithë qytetarët në tërë Kosovën. Ende nuk është mbuluar i tërë territori i Kosovës me plane zhvillimore,⁹⁶ e po ashtu, nuk është kompletuar baza ligjore me akte nënligjore.

Baza ligjore e pakompletuar ka ndikuar në kufizimin e të drejtës së privatësisë, dhe e gëzimit të shtëpisë dhe vazhdon të kufizohet për arsye të mos arritjes së përmbushjes së kërkesave minimale për sigurinë për jetën dhe shëndetin publik të banorëve, të parapara me legjislacionin e ndërtimit si dhe akteve nënligjore që e plotësojnë atë. Që nga viti 2012, nuk është arritur të përpilohet Kodi Unik i Ndërtimit i Republikës së Kosovës,⁹⁷ i cili do të garantonte vendosjen e kërkesave minimale për mbrojtjen e shëndetit publik, sigurisë dhe mirëqenies së përgjithshme përmes rezistencës së nevojshme të strukturës së hapësirave të emergjencës, ekuilibrit dhe stabilitetit, sanitarisë, menaxhimit të mbeturinave ndërtimore, ndriçimit adekuat dhe ventilimit, masave për efikasitet dhe kursim të energjisë, dhe sigurisë së jetës dhe pronës nga zjarri dhe rreziqeve tjera që i atribuohen mjedisit ndërtimor si dhe t'i krijoj siguri zjarrfikësve dhe përgjegjësve tjerë në raste të emergjencave..

Organet kompetente, inspektoratet e nivelit qendror dhe lokal, nuk kanë arritur të vënë nën kontroll çështjen e ndriçimit adekuat dhe ventilimit, qasjes sipas parametrave arkitektonike, qasjes së personave me aftësi të kufizuara, çështjes së efikasitetit të energjisë, shkallëve emergjente etj. Për më tepër shumë pak objekte janë të përcjella me hapësirat e gjelbra, garazhe dhe parkingje, si hapësira përcjellëse të objekteve. Aq më tepër shteti ka dështuar në përmbushjen e obligimit pozitiv për kontroll teknik të objekteve të banimit.

⁹⁵ Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit i Kosovës, Raport Vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë, fq.47, Sipas të dhënave, në Kosovë janë të evidentuara 28 hotspote.

⁹⁶http://www.mmph-rks.org/repository/docs/Indikatorret_per_planifikim_hapesinor_06173_577095.pdf, fq14.

⁹⁷ Ligji Nr. 04/L – 110 Për Ndërtim, Neni 6 Kodi Unik i Ndërtimit i Republikës së Kosovës.

Nuk janë shënuar përmirësime as sa i përket gjendjes së trotuareve, ato kanë vazhduar të ngelin me gjerësinë e pamjaftueshme në krahasim me numrin e qytetarëve, dhe shpeshherë të përcjella me lartësi larg normave të parapara, me mungesë të elementeve për qasje, rampave të cilat do të krijonin lidhjen pa ndërprerje në mes të niveleve të ndryshme të trotuarit me sipërfaqet publike pa pengesë si dhe qasjen në rrugët e qarkullimit kryesor.

Qytetarët janë duke u ballafaquar me shtigje të këmbësorëve të përcjella me gropa dhe puseta të dëmtuara, hapësira të zëna me vetura, tryeza nga shërbimet hoteliere dhe mallra, material ndërtimor dhe pa asnjë masë mbrojtëse, apo shenjë paralajmërimi.

Shqetësuese është mosndërmarrja e masave për përmirësimin e infrastrukturës pranë shkollave dhe kopshteve të fëmijëve, e cila do të garantonte të drejtën e jetës, shëndetit dhe sigurisë së fëmijëve. Mungesa e rrethojave adekuate, madje edhe asaj të gjelbër, si pjesë përcjellëse e shtigjeve/trotuareve të këmbësorëve pranë çerdheve, kopshteve dhe shkollave, si dhe e nënkalimeve dhe mbikalimeve në rrugët magjistrale e rajonale mbeten çështje imediate që kërkon ndërmarrje të masave të menjëhershme dhe koordinim në mes të komunave, Ministrisë së Infrastrukturës (MI) dhe Policisë së Kosovës. Kësaj gjendjeje i ka kontribuar, edhe mospërfshirja e qytetarëve në vendimmarrje në proceset para të ndërtimit të rrugëve, të cilët pa dyshim me interferimin e interesave dhe ideve të tyre, do të ndikonin në zgjidhje efektive dhe racionale.

Zinxhirit të parregullësive me ndikim në mjedis i shtohet edhe qarkullimi i pakontrolluar i mjeteve të rënda motorike/mjeteve të punës të angazhuara në ndërtimin e rrugëve dhe qasja e tyre nga vendpunishtet në rrugë publike, pa asnjë përpjekje për të larguar baltën dhe mbeturinat. Bartja e baltës në rrugë publike jo vetëm që ndikon drejtpërdrejtë në ndotje të mjedisit por edhe rrezikonë sigurinë publike të pjemarrësve në komunikacion, duke pasur parasysh ndikimin e mbledhjes së baltës apo papastërtisë së rrugës dhe në reduktimin e kushteve të fërkimit, meqë duke shkaktuar humbje progresive të kontaktit në mes të rrotës/ave dhe asfaltit, me ndikim në rritjen e kohës së frenimi.

Pas ndërhyrjes dhe kërkesës së Avokatit të Popullit, komuna e Prishtinës, duke u bazuar në rekomandimet e Policisë së Kosovës, bëri zgjidhje efektive të çështjes së lëvizjes/kalimit të sigurtë për nxënës, studentë dhe qytetarë tjerë, në hapësirat pranë shkollave dhe Fakultetit të Bujqësisë, në rrugën Prishtinë - Fushë Kosovë, pranë kazermës “Adem Jashari”.⁹⁸

Edhe pse, sa i përket çështjes së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje mjedisore, Kushtetuta, ligjet mjedisore dhe ato që e rregullojnë fushën e planifikimit hapësinor e kanë të paraparë qartë këtë parim procedural, respektimi i procedurës nga institucionet është i brishtë. Institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal, përgjegjëse për të organizuar procesin e dëgjimit publik, përipiqen ta respektojnë procesin dhe procedurat, por jo me transparencë të duhur. Hapi i parë, informimi lidhur me çështjen, kohën dhe

⁹⁸ Ex officio nr. 577/2015.

vendin e mbajtjes së dëgjimit, bëhet përmes mjeteve jo shumë të qasshme për publikun, gazetave të tirazhit të ulët, apo ndonjëherë edhe përmes ueb faqes, së vet organit. Proceset e dëgjimit publik ndiqen nga numër i vogël i qytetarëve, si për arsyen e mos informimit, ashtu edhe të mos interesimit të vet qytetarëve për pjesëmarrje, për shkak të mungesës së besimit në institucionet publike. Vërejtjet e qytetarëve shpeshherë hasin në vesh të shurdhër.⁹⁹

Po ashtu, qasja në informata mjedisore ka mbetur pothuajse në shkallë të njëjtë. Edhe pse qasja në informata mjedisore është e garantuar me legjislacionin mjedisor, institucionet mbajtëse të dokumenteve më shpesh orientohen ta zbatojnë Ligjin për qasje në dokumente publike, e cila dokumentet mjedisore i ka renditur në listën e informatave të kufizuara. Ministria, institucionet qendrore, komunat, organizatat e autorizuara dhe të tjera, nuk arritën t'i përmbushin detyrat që rregullisht, dhe me kohë, në mënyrë të plotë dhe objektive ta informojnë publikun për gjendjen e mjedisit, si dhe për masat paralajmëruese ose të shtrirjes së ndotjes që mund të paraqesin rrezik për mjedisin, shëndetin dhe jetën e tyre.

Avokati i Popullit, vëren se zbatimi i dispozitave ndëshkimore nga Inspektoratet Mjedisore nuk është në pajtueshmëri me frymën e ligjeve mjedisore, të cilat përmes dispozitave ndëshkuese japin të drejtën e shqiptimit të masave ndëshkimore të gjobës në të holla, ndotësve të mjedisit. Zgjedhja e praktikës së inicimit të procedurave kundërvajtëse në gjykata themelore, mund të vlerësohet si devijim i qëllimshëm i inspektorateve për zbatim konsekuent dhe efektiv të ligjeve.¹⁰⁰

Sipas informatave të pranuar nga inspektorati qendror, ato lokale dhe Policia e Kosovës, të lëndët e karakterit kundërvajtës, dhe ato penale që kanë të bëjnë me mjedisin, të iniciuara në gjykata, zvarriten ose parashkruhen. Nuk ka statistika të sakta gjyqësore të cilat do të ishin tregues real i numrit të lëndëve të parashkruara, të shqyrtuara dhe kohës mesatare të vendosjes së lëndës.

5.12 E drejta e qasjes në dokumente publike

E drejta e qasjes në dokumente publike, është e drejtë e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ)¹⁰¹, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)¹⁰², Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹⁰³ dhe Ligjin për qasje në

⁹⁹ Pjesë nga prezantimi i Avokatit të Popullit, në Konferencën e IV-të Ndërkombëtare "Mjedisi dhe të Drejtat e Njeriut", 15 shtator 2017, Slloveni.

¹⁰⁰ Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Neni 92, Dispozitat Ndëshkimore; Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Neni 38, Dispozitat Ndëshkimore; Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma, Neni 25, Dispozitat Ndëshkimore; Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, Neni 70, Dispozitat Ndëshkimore; etj.

¹⁰¹ DUDNJ, neni 19: "Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjete, pa marrë parasysh kufijtë".

¹⁰² Lirinë për të marrë dhe dhënë informacion e parasheh edhe neni 10, paragrafi 1, i KEDNJ: "Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...".

dokumente publike (LQDP). Megjithatë, respektimi i kësaj të drejte, si dhe zbatimi i ligjit vazhdon të mbetet sfidues për shkak të paqartësive të ligjit, të mungesës së kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës në trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, por edhe të mungesës së vullnetit të institucioneve për zbatimin e ligjit.

Ndonëse në përgjithësi vërehet ngritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për këtë të drejtë, institucionet shtetërore duhet të punojnë më shumë për promovimin dhe veprimet konform Kushtetutës dhe ligjit në raport me këtë të drejtë, por edhe në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies.

LQDP, në nenin 4, paragrafi 1, përcakton që *“Çdo kërkuar i dokumentit, ka të drejtë në qasje të dokumenteve të institucioneve publike”*, por në të njëjtën kohë i parasheh kushtet dhe përgjegjësitë e kërkuarëve të dokumenteve, duke kërkuar që kërkuarët duhet *“përmbajtur parimeve, kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara me ligj”*. Mirëpo, ligjvënësi, përkundër që i ka paraparë në ligj arsyet e kufizimit, megjithatë nuk i ka sqaruar qartë se cilat janë parimet dhe kushtet të cilave duhet t’i përmbahet kërkuarët i dokumenteve.

Një ndër problematikat e evidentuara është edhe zbrazëtira në ligj, duke mos përcaktuar në mënyrë të qartë se kush është zyrtari kompetent për të vendosur për kërkesat për qasje në dokumente publike. Edhe pse neni 5, paragrafi 3 i LQDP, specifikon që *“njësia apo zyrtari për komunikim me qytetarë pas marrjes dhe shqyrtimit fillestar të kërkesës për qasje në dokumente zyrtare duhet të vlerësojnë se cila është njësia përkatëse brenda institucionit publik që duhet ta ketë dokumentin e kërkuar. Pas marrjes së dokumentit nga njësia përkatëse brenda institucionit publik, këtë dokument, në pajtim me legjislacionin në fuqi ia dërgojnë kërkuarët të dokumentit”*.

Po ashtu, LQDP nuk specifikon se kush mund të konsiderohet *“palë e tretë”* në procedurën e realizimit të drejtës për qasje në dokumente publike, gjë që krijon paqartësi në zbatimin e nenit 6, paragrafi 4 të LQDP, sipas të cilit *“Kërkuarët i ndonjë dokumenti ka të drejtë për të mbetur anonim ndaj palëve të treta”*.

LQDP e rregullon situatën kur institucioni publik nuk posedon, nuk disponon ose nuk e mbikëqyrë informatën, por ka njohuri për organin gjegjës, resorin e tij ose institucionin tjetër, duke krijuar detyrim që kërkesa t’i përcillet organit gjegjës ose sektorit brenda institucionit i cili e posedon, disponon ose e mbikëqyrë informatën. Megjithatë, Avokati i Popullit ka vërejtur mungesën e disponimit të zyrtarëve brenda institucioneve për të përcjellë kërkesën tek organi, apo resori gjegjës, madje edhe kur ato gjenden brenda institucionit përkatës.

Ndonëse, në të shumtën e rasteve, përgjigjet e institucioneve për pranimin e kërkesës janë të shpejta dhe brenda afateve ligjore, megjithatë, koha e vendosjes së lejimit apo të

¹⁰³Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 41, paragrafi 1, parasheh të drejtën për qasje në dokumente publike: *“Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike”*.

refuzimit të kërkesës, përkundër rëndësisë së dhënies me kohë të informacioneve, shpeshherë i tejkalon afatet e parapara me ligj.

Në përgjigjet e institucioneve në kërkesat për qasje në dokumente publike, në të cilat aprovohet kërkesa për qasje nuk vërehet referenca në nenin 4, paragrafi 4 të LQDP, i cili përcakton që *“Dokumentet publike të pranuar nga kërkuesi nuk mund të përdoren për qëllime denigrimi, propagandistike dhe komerciale”*, ndonjëherë përdoruesit e informatave, i tejkalojnë kufijtë e lirisë së shprehjes. Prandaj, referimi në këtë nen në përgjigjet e institucioneve do të ndihmonte në ndërgjegjësimin e shfrytëzuesve të së drejtës për qasje në dokumente publike që përkrah të drejtës, në raste të caktuara, ka edhe kufizime.

Ligji në nenin 12, paragrafi 2, precizon që: *“Qasja në informata të përmbajtura në një dokument mund të refuzohet nëse zbulimi i tyre dëmton apo ka mundësi të dëmtojë, cilindo nga interesat e përmendura në paragrafin 1. ..., përveç nëse nuk ekziston ndonjë interes publik më i lartë për të bërë zbulimin”*. Mirëpo, vërehet se përgjegjësit në institucionet publike nuk janë të gatshëm, për të përmbushur obligimin e tyre kushtetues, që të drejtën në qasje në dokumente publike ta kufizojnë vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme për një shoqëri të hapur dhe demokratike, në mënyrë që të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi, si dhe t’i kushtohet kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet.

Një problematikë mjaft e shprehur është e lidhur me mungesën e klasifikimit apo klasifikimit me kohë të dokumenteve. Si e drejtë kushtetuese, e drejta për qasje në dokumente publike megjithatë nuk është e drejtë absolute. Ajo duhet të jetë e mbrojtur në mënyrë proporcionale dhe e balancuar me të drejtat tjera.

Gjatë hetimit dhe shqyrtimit të rasteve, përkitazi me kufizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike, Avokati i Popullit ka vërejtur që institucionet shtetërore, mbajtëse, hartuese apo pranuese të informacioneve, në shumicën e rasteve nuk i kanë klasifikuar me kohë dokumentet, ose nuk i kanë klasifikuar fare, ashtu sikurse e parasheh Ligji Nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë dhe Ligji Nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale. Avokati i Popullit ua rikujton autoriteteve që klasifikimin e dokumenteve ta bëjnë që në momentin kur prodhohet informacioni, sepse kështu do të lehtësohej procesi i ofrimit të qasjes apo refuzimit të kërkesës për qasje.

Përkundër këtyre problemeve, përpjekjet për ndryshimin dhe plotësimin e LQDP-së, për t’i tejkaluar sfidat e deritashme, kanë dështuar, megjithatë Projektligji për ndryshimet dhe plotësimet e LQDP-së është në programin legjislativ për vitin 2018.

Gjatë vitit 2017, IAP ka hetuar 24 ankesa lidhur me kufizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike.

Avokati i Popullit, më 20 dhjetor 2017, ka publikuar Raportin me rekomandime për kufizimin e qasjes në dokumente publike. Qëllimi i këtij raporti ishte tërheqja e

vëmendjes Komunës së Ferizajt për ankesën e OJQ “Iniciativa për Progres – INPO” përkitazi me kufizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike. Lidhur me rastin në fjalë, Avokati i Popullit, duke pasur parasysh se “*Vetëm ligji ka autoritetin për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për personat juridik dhe fizik*”, si dhe duke u bazuar në faktet e ofruara, ka konstatuar se mospërgjigja e Komunës së Ferizajt, përkitazi me kërkesën e OJQ “Iniciativa për Progres – INPO”, bie në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-215 për qasje në dokumente publike. Avokati i Popullit, pas analizimit të rrethanave të rastit dhe legjislacionit në fuqi, i ka rekomanduar Komunës së Ferizajt që të ndërmarrë hapa për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve publik lidhur me zbatimin Ligjit për qasje në dokumente publike.

6. Të drejtat e fëmijëve

6.1 Gjendja e të drejtave të fëmijëve

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve në Kosovë vazhdon të mos bëhet në mënyrë adekuate. Përkundër faktit se janë ndërmarrë shumë hapa në krijimin e politikave dhe kornizës ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, megjithatë realizimi në praktikë i të drejtave të fëmijëve, mbrojtja dhe respektimi i tyre mbetet sfidë për institucionet e Kosovës. Zbatimi i legjislacionit dhe sigurimi i burimeve financiare në fuqizimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë mbetet problem. Në veçanti, është shqetësuese mos sigurimi i qëndrueshmërisë së qendrave të kujdesit ditor për trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mungesa e gjithë përfshirjes së tyre në sistemin arsimor përfshirë këtu edhe mungesën e asistentëve dhe mësuesve mbështetës. Po ashtu, çështjet lidhur me fëmijët në situatë rruge, që jetojnë në kushte të rënda sociale, nuk shkojnë në shkollë dhe shpesh herë janë subjekt i formave të ndryshme të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit ende nuk janë adresuar. Nuk janë adresuar as çështjet lidhur me krijimin dhe ofrimin e shërbimeve përkatëse për fëmijët viktimë të abuzimit me substanca narkotike dhe familjeve të tyre, përveç tjerash.

Është gjithashtu shqetësuese se numri i përdoruesve të substancave narkotike po vjen duke u rritur, ndërsa është shtuar numri i përdoruesve të moshës më të re (16.06 vjeç)¹⁰⁴. Për adresimin adekuat të çështjes, institucionet shtetërore duhet të sigurojnë programe parandaluese dhe të ofrojnë shërbime përkatëse për mbrojtjen dhe ndihmën e fëmijëve përdorues të substancave narkotike në rehabilitimin dhe ri integrimin e tyre.

Mbetet ende shumë për të bërë në adresimin e këtyre problemeve me të cilat përballen fëmijët. Institucionet kosovare kanë për obligim të bashkërendisin dhe shtojnë punën dhe veprimet për të siguruar që të drejtat e fëmijëve respektohen, mbrohen dhe zbatohen.

¹⁰⁴Informatat janë siguruar nga OJQ Labyrinth për vitin 2017, dhe përfshijnë të dhënat për shërbimet e kryera sipas të cilave 1205 persona janë të regjistruar si përdorues, 85 prej tyre kanë vdekur si pasojë e ndërlidhjes me drogat, 4 prej tyre kanë qenë të moshës 20 vjeçare. Sipas të dhënave moshë mesatare e fillimit të përdorimit të drogës ka qenë 16.06 vjeç. Ndërsa ka pasur raste kur moshë e fillimit të përdorimit të drogës së parë ka qenë 12 vjeç. Sipas të dhënave të OJQ Labyrinth, Krahasuar me vitet e kaluara, kjo moshë ka rënë dukshëm referuar vitit 2007, kur moshë e fillimit të përdorimit të drogës së parë ka qenë 21.4 vjeç.

6.2 Korniza ligjore dhe të drejtat e fëmijëve

Korniza ligjore e Republikës së Kosovës në fushën e të drejtave të fëmijëve në masë të madhe është në pajtim me standardet ndërkombëtare, me theks të veçantë në Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF).¹⁰⁵ Legjislacioni përkatës është i shpërndarë nëpër disa ligje, akte nën-ligjore dhe politika të ndryshme pasi që Kosova ende nuk ka një ligj të veçantë për të drejtat e fëmijës. Ky fragmentim i ligjeve që rregullojnë çështje që ndikojnë në jetën dhe mirëqenien e fëmijëve është parë si mangësi ligjore pasi që mungesa e një ligji gjithëpërfshirës dhe të plotë i lë fëmijët në një situatë të ndjeshme dhe pasiguri juridike. Për të adresuar këtë problem, në vitin 2013 ka filluar hartimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Projektligji ka kaluar përmes konsultimeve të hollësishme me institucionet vendore, atyre ndërkombëtare dhe shoqërisë civile. Vitin e kaluar IAP së bashku me KOMF, UNICEF, si dhe Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë (Grupi) i kanë dërguar sugjerime/rekomandime Komisionit parlamentar për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, për persona të pagjetur dhe peticione. Rekomandimet kishin për qëllim rritjen e zbatueshmërisë së ligjit duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijës. Rekomandimet inkurajonin që Projektligji të krijojë mekanizma të fuqishëm për mbrojtjen e fëmijëve, rritjen e llogaridhënies së institucioneve dhe përfshirjen e masave ndëshkimore për moszbatimin e ligjit. IAP së bashku me akterët kyç të lartpërmendur kanë vazhduar punën dhe përpjekjet për përfshirjen e rekomandimeve në Projektligj. Edhe gjatë këtij viti ky Projektligj nuk arriti të miratohet në Kuvend. Ndryshimet dhe situata e krijuar politike në vend, çuan në zvarritjen e procedurave dhe kthimin e projektligjit për rishikim në organet përkatëse qeveritare me të cilat grupi ka bashkëpunuar me qëllim të përfshirjes së rekomandimeve. Kuvendi i Kosovës do të duhej që ta trajtojë këtë projektligj me prioritet dhe seriozitet të shtuar duke ndërmarrë veprimet e nevojshme që projektligji të shqyrtohet pa vonesa të mëtejme.

6.3 E drejta e fëmijëve në arsim

Rastet të cilat i ka pranuar dhe hetuar IAP, përfshirë rastet e iniciuara sipas detyrës zyrtare, lidhur me të drejtën për arsimim kanë trajtuar: mungesën e kushteve elementare për mësim në shkolla, vështirësitë dhe pengesat për përfshirje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim, detyrimin për nxënës të cilët i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore për të kryer pagesën e nevojshme për vazhdim të mësimin, braktisja e shkollimit dhe përdorimi i dhunës ndaj fëmijëve, si dhe ushtrimin e veprimtarisë së tridhjetë çerdheve pa licensë në Prizren.¹⁰⁶

Katër nga rastet e pranuar kishin të bëjnë me mungesën e kushteve elementare për mësim, që çon në vështirësi të realizimit të procesit mësimor. Në dy nga këto katër raste të hetuara, pas dërgimit të rekomandimeve me shkrim autoriteteve komunale në Prishtinë

¹⁰⁵ Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), është instrumenti më i rëndësishëm i së drejtës ndërkombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve, i cili zbatohet drejtpërdrejt nga institucionet e Kosovës sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

¹⁰⁶ IAP, rastet: ex.of., 855/2017,412/2017, 735/2017, 688/2017, A.nr.53/2017.

dhe pas ndërmjetësimit të IAP-së me autoritetet komunale arsimore të Fushë Kosovës, u bë përmirësimi i kushteve për mësim dhe vijim të procesit mësimor për fëmijët në shkollat përkatëse.¹⁰⁷

Po ashtu, dy raste të cilat IAP i kishte pranuar vitin e kaluar, në fillim të këtij viti përfunduan me sukses. Këto raste kishin të bënin me detyrimin e braktisjes së mësimin nga fëmijët nëse nuk do t'iu sigurohej transporti për të vijuar mësimet në shkollë, përkatësisht nuk do të mbuloheshin shpenzimet e transportit. Pas ndërmjetësimit të IAP-së tek autoritetet përkatëse komunale, rastet u zgjodhën në të mirë të fëmijëve.

Duke u nisur nga informatat e siguruar nga portali “BLIC”, me shkrimin me titull: “*Nxënësit detyrohen t'i paguajnë vetë prishjet në shkollat e Prishtinës*”, Avokati i Popullit ka filluar hetimet *ex officio*. Sipas shkrimit, shkollat e mesme në kryeqytet, madje edhe në tërë territorin e Kosovës, përveç problemeve me hapësirat dhe numrin e madh të nxënësve, përballen edhe me faktin se nxënësit detyrohen të japin para në administratat shkollore për rregullimin e prishjeve që ndodhen në ambientet shkollore. Avokati i Popullit në këtë fazë të raportimit ka kërkuar nga Komuna e Prishtinës informata në lidhje me veprimet që janë ndërmarrë apo pritet të ndërmerren, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisive të tyre ligjore, për rastin në fjalë. Po ashtu IAP ka kërkuar edhe mbi bazën e cilës rregullativë ligjore, nxënësve u kërkohet t'i paguajnë vet prishjet eventuale në shkolla. MASHT, komunat, institucionet arsimore dhe të gjitha organet të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar me ligj, përveç tjerash, duhet të planifikojnë dhe hartojnë politika përkatëse për ndërtimin dhe renovimin e objekteve të financuara nga buxheti i Kosovës dhe donatorët, menaxhimin e mirëfilltë të tyre dhe mirëmbajtjen e hapësirës shkollore, në pajtim me legjislacioni përkatës në fuqi.¹⁰⁸

MASHT, komunat, institucionet arsimore dhe të gjitha organet të tjera të planifikojnë dhe hartojnë politika përkatëse për ndërtimin dhe renovimin e objekteve të financuara nga buxheti i Kosovës dhe donatorët, menaxhimin e mirëfilltë të tyre dhe mirëmbajtjen e hapësirës shkollore, në pajtim me legjislacioni përkatës në fuqi.

6.4 Fëmijët me aftësi të kufizuara

Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë vazhdojnë të përballen me vështirësi të shumta në të gjitha fushat e jetës. Këtë vit, pas ndërmjetësimit të IAP tek autoritetet komunale të Gjakovës, ishte arritur që një fëmijë me aftësi të kufizuara t'i realizohet pagesa e shpenzimeve të transportit nga komuna dhe ai të vazhdojë mësimin në shkollën përkatëse në Prizren. Një ankesë tjetër është pranuar nga nëna e një fëmijë me aftësi të kufizuara. Ankesa ishte e drejtuar kundër MASHT, për mospagimin e asistentit personal për mësimnxënie në shkollë për fëmijën e saj në mënyrë që vajza të mund të marrë ndihmën

¹⁰⁷ IAP, rastet: A.nr. 700/2016, A.nr. 53/2017.

¹⁰⁸ Ligji nr. 04/L-032, për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës.

e nevojshme.¹⁰⁹ Nga informatat e siguruar nga prindër, arsimtarë¹¹⁰ por edhe përfaqësues të OJQ-ve që punojnë me fëmijë me aftësi të kufizuara del se familjet me gjendje më të mirë ekonomike në shumë raste angazhojnë dhe paguajnë vetë profesionistë/asistentë për të ndihmuar fëmijët e tyre për mësimnxënie, edhe pse kjo ndikon në gjendjen e tyre ekonomike. Mirëpo, jo të gjitha familjet e kanë këtë mundësi, prandaj edhe shumë fëmijë mbesin pa ndihmën e nevojshme për mësim gjë që zvogëlon mundësitë për mësim adekuat. Natyrisht një gjë e tillë ndikon dhe vështirëson mësimnxënien edhe për nxënësit e tjerë dhe mësimdhënësit. Kjo është shqetësuese dhe kërkon adresim dhe prioritizim nga institucionet shtetërore. Fëmijët me aftësi të kufizuara përballen edhe me infrastrukturë joadekuate shkollore, mungesë të mësuesve mbështetës e shumë herë edhe të planeve individuale arsimore. Kjo u mohon vajzave dhe djemve me aftësi të kufizuara gëzimin e plotë të së drejtës për arsim cilësor, gjithëpërfshirës, siç e përcakton ligji.

Vështirësi hasen edhe në fushën e shëndetësisë sa i përket realizimit të së drejtës për shërbime shëndetësore cilësore dhe pa pagesë. Jo gjithëherë, institucionet shëndetësore sigurojnë barnat falas dhe pajisje të tjera që do u mundësonin përmirësimin e shëndetit, lëvizjen e lirë dhe jetë me dinjitet fëmijëve. Përfshirja dhe sigurimi i shërbimeve sociale në komunitet, për fëmijët me aftësi të kufizuara gjithashtu mbetet i mangët. IAP në fillim të këtij viti, sipas detyrës zyrtare ka vazhduar hetimet lidhur me pamundësinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara që të marrin shërbime sociale dhe familjare në disa nga qendrat e kujdesit ditor, për shkak të mbylljes së tyre për mungesë të mjeteve financiare.¹¹¹ Duke marrë parasysh seriozitetin dhe peshën e kësaj çështje, Avokati i Popullit përveç tjerash, i është drejtuar MPMS me letër me rekomandime nga e cila ka kërkuar ndërmarrjen e masave të nevojshme që qendrave të kujdesit ditor t'u ofrohet mbështetja e nevojshme. Kjo mbështetje duhet të përfshijë edhe mbështetjen financiare që qendrat e kujdesit ditor të vazhdojnë punën dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara t'u ofrohet ndihma dhe shërbimet përkatëse sociale. IAP nuk ka pranuar përgjigje lidhur me letrat. Në vitin e ardhshëm IAP do të vazhdojë ndërmarrjen e masave të nevojshme drejtuar MPMS për adresimin e problemit, në pajtim me ligjin. Autoritetet shtetërore duhet të ndërmarrin veprimet përkatëse përfshirë edhe mbështetjen materiale, ndarjen e buxhetit adekuat për të përmirësuar gjendjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke siguruar qëndrueshmëri të qendrave të kujdesit ditor për trajtimin, rehabilitimin, dhe riintegrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe gjithëpërfshirja e tyre në procesin arsimor.

Është e nevojshme të ndahet buxhet adekuat për të siguruar qëndrueshmëri të qendrave të kujdesit ditor për trajtimin, rehabilitimin, dhe riintegrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe gjithëpërfshirja e tyre në procesin arsimor, si dhe të garantohen shërbime

¹⁰⁹ IAP, rasti A.nr.888/2017.

¹¹⁰ Informatat e siguruar gjatë takimeve me fëmijë, arsimtarë dhe disa prindër gjatë nëntorit të këtij viti në kuadër të fushatës “Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit”

¹¹¹ IAP, rasti ex officio nr.43/2017

cilësore shëndetësore për fëmijët me aftësi të kufizuara nëpërmjet sigurimit të rregullt të barnave, materialeve shpenzuese dhe pajisjeve të domosdoshme për këta fëmijë.

6.5 Dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkolla

Gjatë kësaj periudhe raportuese IAP ka zhvilluar hetime për 4 raste, nga të cilat një është hapur sipas detyrës zyrtare.¹¹² Rasti i hetuar sipas detyrës zyrtare kishte të bënte me dyshimin për kryerje të ngacmimit seksual nga mësuesi ndaj një nxënëseje. Pas hetimeve, IAP konstatoi se institucionet përkatëse kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe procedura gjyqësore është duke u zhvilluar para organeve të drejtësisë. Në një rast tjetër lidhur me pretendimet për ushtrim të dhunës nga arsimtari, IAP ndërmori veprimet e duhura në raport me autoritetet përkatëse komunale dhe prindi i fëmijës u udhëzua për veprimet që mund t'i ndërmarrë mëtutjje në pajtim me ligjin. Rasti tjetër kishte të bënte me pretendimet e një nxënësi për trajtimin fyes dhe poshtërues të nxënësve nga një mësimsdhënës dhe për mospërgjigje në ankesat e tyre nga Drejtoria Komunale e Arsimit si dhe Inspektorati i Arsimit. IAP është në proces të takimit me përfaqësuesit e tyre për të hetuar dhe për t'u informuar me veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga këto institucione. IAP gjithashtu përkritazi me pohimet për përdorim të dhunës ndaj fëmijëve pa përkujdesje prindërore nga punonjës të një organizate që ofron shërbime për fëmijë, është në pritje të përgjigjes nga drejtuesit e organizatës, nga të cilët ka kërkuar që çështja të hetohet dhe të informohet për rezultatin e hetimeve.

Në vitin 2016, IAP në bashkëpunim me Save the Children publikoi studimin sipas të cilit 75.6 përqind e fëmijëve të moshës 12-16 vjeç kanë parë dikë duke u grushtuar ose goditur gjatë vitit 2015. Ndërkohë, 32.9 përqind janë ndjerë të ngacmuar gjatë 12 muajve të mëparshëm, dhe 9.3 përqind e djemëve dhe 6.2 përqind e vajzave rrallë ose asnjëherë nuk ndjehen të sigurt në rrugën e tyre për në shkollë.¹¹³ Përdorimi i dhunës ndaj fëmijëve, si dhe shtimi i shpërfaqjes së rasteve të dhunës së ushtruar nga edukatorë e mësues, që janë të thirrur të zbatojnë norma pedagogjike dhe sjellje të kujdesshme me fëmijët, e ka shtyrë Avokatin e Popullit që vitin e kaluar të trajtojë ndikimin e dhunës në shëndetin dhe jetën sociale të fëmijëve në formën e një opinioni. Ky opinion u është drejtuar institucioneve përgjegjëse me qëllim të tërheqjes së vëmendjes në ndikimin negativ të dhunës ndaj fëmijëve, si dhe rëndësinë e parandalimit të saj, duke e identifikuar, referuar dhe trajtuar me kohë.¹¹⁴ Të gjeturat nga studimi i lartcekur dhe rekomandimet e opinionit kanë shërbyer për informim edhe në kuadër të fushatës informuese "Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit".¹¹⁵ Fushata është mbajtur gjatë muajit nëntor dhe përfaqësuesit e IAP janë takuar me fëmijë dhe me mësimsdhënës të shkollave me qëllim të vetëdijesimit për domosdoshmërinë e parandalimit të ndëshkimit trupor nëpër shkolla. Institucionet

¹¹² IAP, rastet: ex officio nr.397/2017.

¹¹³ Save the Children, Zëri ynë 2016 në:

https://resourcecentre.savethechildren.net/node/10218/pdf/young_voices_report_alb.pdf

¹¹⁴ IAP, rasti:A.nr.668/2016

¹¹⁵ Lidhur me fushatën shihni pjesën për aktivitetet e DMDF

përkatëse të ndërmarrin veprimet e duhura në rritjen e ndërgjegjësimit në parandalimin e dhunës nëpër shkolla.

Duhet të rritet ndërgjegjësimi në parandalimin e dhunës nëpër shkolla nëpërmjet politikave dhe fushatave vetëdijësuese.

6.6 Të drejtat e fëmijëve në procedurat pranë organeve gjyqësore dhe administrative

IAP edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit, ka hetuar një numër të ankesave kundër gjykatave, të parashtruar nga prindër të fëmijëve. Këto ankesa kishin të bëjnë me zvarritje të procedurës gjyqësore për të vendosur lidhur me besimin e fëmijëve në ruajtje dhe edukim si dhe me monitorimin e seancave gjyqësore përkitazi me vendosjen për kërkesat për urdhër mbrojtës për dhunë në familje.¹¹⁶ Lidhur me mosrealizimin e kontakteve apo pamundësinë e realizimit të kontakteve të rregullta me fëmijë, IAP ka pranuar ankesa edhe kundër qendrave për punë sociale, Policisë së Kosovës dhe Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.¹¹⁷ Në këto raste, IAP u është drejtuar institucioneve në fjalë për ndërmarrje të veprimeve përkatëse si dhe ka ndërmjetësuar lidhur me to, në mënyrë që fëmijët të mund t'i realizojnë të drejtat e tyre, të garantuara edhe me KDF. Gjykatat, përkatësisht të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime për familje do të duhej të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që rastet që kanë të bëjnë me fëmijë apo prekin të drejtat e fëmijëve të vendosen pa vonesa, brenda afateve të përcaktuara ligjore, në mënyrë që të mos dëmtohet apo rrezikohet shëndeti i fëmijëve, mirëqenia apo edhe jeta e tyre. Ato gjithashtu do të duhej të ndërmarrin të gjitha veprimet që interesi më i mirë i fëmijëve të jetë parësor gjatë punës së tyre lidhur me fëmijët përfshirë këtu edhe respektimin e të drejtës së fëmijëve për t'u dëgjuar.

6.7 Mbrojtja sociale dhe shëndetësore

IAP gjatë kësaj periudhe raportuese nga fusha e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore ka filluar dhe hetuar edhe 14 raste të reja, përfshirë edhe ato sipas detyrës zyrtare, të cilat i referohen të drejtave të fëmijëve. Rastet kishin të bëjnë ndër të tjerash me: mosdhënje të ndihmës sociale; gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale; mospërkrahje financiare për trajtimin shëndetësor; pamundësinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara që të marrin shërbime sociale dhe familjare në disa nga qendrat e kujdesit ditor për shkak të mbylljes së tyre; moskompensim material shëndetësor etj. Një numër i tyre janë zgjedhur në të mirë të ankuesve përfshirë këtu edhe 4 raste të pranuar në vitin 2016. Siç është rasti i dy familjeve me fëmijë, në gjendje të rëndë ekonomike, të cilat pas ndërmjetësimit të IAP-së me autoritetet komunale të Pejës dhe Prizrenit përfituan ndihmën sociale. Një rast tjetër kishte të bënte me një familje me 4 fëmijë, të cilët jetonin në një shtëpi në kushte të vështira dhe në rrezik për shëndetin dhe jetën. Me ndërmjetësimin e Avokatit të Popullit dhe me përkushtimin e autoriteteve komunale të Dragashit, e cila u kishte gjetur një

¹¹⁶ IAP, rasti A.nr.28/2017, A.nr.244/2017

¹¹⁷ IAP, rastet: A.nr. 570/2017, A.nr. 187/2017, A.nr.366/2017, A.nr. 545/2017

donator, familjes në fjalë u është ndërtuar shtëpi e përshtatshme për jetesë. Lidhur me këtë, shteti do duhej të krijojë politika të qëndrueshëm financiare për të siguruar përkrahjen financiare dhe sociale, emergjente dhe të përhershme, për qytetarët me nevojë sociale, veçmas në rastet kur është në pyetje mirëqenia e fëmijëve.

Është e nevojshme që të sigurohet financim i qëndrueshëm dhe adekuat për shërbimet sociale në Kosovë përmes ndryshimit të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe krijimin e një Granti Specifik për Shërbime Sociale.

6.8 Drejtësia për të mitur

Edhe fëmijët që janë subjekt i sistemit të drejtësisë, përkatësisht të miturit të cilët kanë rënë ndesh me ligjin, duhet të kenë qasje dhe shërbime të duhura të kujdesit arsimor. Arsimimi i të miturve që janë të dënuar dhe qëndrojnë në institucionet korrektuese është një nga detyrimet kryesore të institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës që buron nga Kushtetuta, ligjet në fuqi, dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare. Si i tillë, ky detyrim i institucioneve për të realizuar një nga të drejtat themelore të njeriut, siç është ofrimi i mundësisë për arsim për të rinjtë nuk mund të shmanget as për të miturit që qëndrojnë në qendrat korrektuese. IAP, duke u nisur nga informatat e siguruar nga gazeta e përditshme “Koha Ditore”, në shkrimin me titull: *“Dështon sërish fillimi i mësimin në Qendrën Korrektuese në Lipjan”*, të datës 29 shtator 2016 kishte filluar hetimet sipas detyrës zyrtare.¹¹⁸ Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimeve konstatoi se procesi mësimor në Qendrën Korrektuese në Lipjan kishte filluar me vonesë, se disa prej të miturve që ishin liruar u ishte mohuar e drejta e vijimit të mësimin në shkollat jashtë qendrës. Avokati i Popullit, gjithashtu konstatoi se atyre u ishte mohuar edhe mundësia e nënshtrimit në provimin shtetëror të maturës, për faktin e moslëshimit të certifikatave dhe diplomave pas lirimit nga Qendra Korrektuese në Lipjan. Lidhur me rastin, me datën 5 shtator 2017, Avokati i Popullit u dërgoi raport me rekomandime MASHT dhe Komunës së Lipjanit.¹¹⁹ MASHT dhe institucionet e tjera përgjegjëse duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme me kohë, në pajtim me obligimet ligjore dhe kushtetuese, që këto praktika të mos përsëriten në të ardhmen, të garantohet e drejta në arsim për personat e mitur në Qendrën Korrektuese në Lipjan dhe në institucionet e tjera ku mbahen personat e privuar nga liria.

Dokumenti kryesor i cili rregullon këtë fushë Kodi i Drejtësisë për të Mitur, ka qenë në proces të ndryshimeve ligjore në mënyrë që harmonizimi me standardet ndërkombëtare të jetë sa më i plotë. Përfaqësuesi i IAP-së ishte pjesë e takimeve konsultative gjatë draftimeve. Projekt Kodi i Drejtësisë për të Mitur është avancuar dukshëm nga Kodi ekzistues duke adresuar në masë të madhe mangësitë e legjislacionit për të drejtat e fëmijëve në Kosovë dhe vështirësitë të cilat janë hasur në zbatimin në praktikë. Projekt Kodi është në procedurat e Kuvendit dhe do të duhej që pas shqytrimit të hollësishëm dhe

¹¹⁸ Ex officio 575/2016.

¹¹⁹ Raport me rekomandime ex officio 575/2016.

serioz të miratohet pa vonesa në frymën e praktikave dhe standardeve me të mira ndërkombëtare.

IAP gjatë këtij viti raportues ka pranuar 61 ankesa të parashtruara kryesisht nga prindër të fëmijëve. Nga ky numër, 36 janë pranuar për t'u hetuar, ndërsa të tjerat janë shpallur të papranueshme. Ankesat janë shpallur të papranueshme sepse çështjet me të cilat kanë pasur të bëjnë ato kanë qenë jashtë juridiksionit të IAP-së, nuk ka pasur shkelje të drejtave të njeriut, apo ankuesit kanë pasur mundësi t'i shfrytëzojnë ose kanë qenë në shfrytëzim të mjeteve juridike. Duke marr parasysh natyrën e trajtimit të ankesave dhe autorizimeve ligjore, IAP në bashkëpunim me Terre des hommes është duke bërë vlerësimin e mekanizmit të ankimit në IAP, veçmas në hartimin e procedurave të veçanta për pranimin dhe trajtimin e ankesave nga fëmijët.

7. Barazia para ligjit

7.1 Vështrim i paketës së ligjeve për të drejtat e njeriut - parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

Mos diskriminimi është një e drejtë e njeriut, por edhe elementi më i rëndësishëm i të gjitha të drejtave të njeriut. Diskriminimi është i ndaluar me vetë Kushtetutën e Kosovës dhe për shkak të rëndësisë së luftimit të diskriminimit dhe arritjes së barazisë, Kosova ka ndërtuar një kornizë ligjore për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, duke i respektuar standardet ndërkombëtare dhe duke u mbështetur në përvojën e të drejtën krahasuese.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD) në kuptimin normativ e paraqet bazën e rregullave ligjore të legjislacionit për mbrojtje nga diskriminimi në Kosovë. Me këtë, në të drejtën pozitive të Kosovës është përfshirë një pjesë e trashëgimisë ligjore të Bashkimit Evropian, sepse bazën për hartimin e tij në një masë të konsiderueshme e paraqesin disa direktiva të Këshillit të Bashkimit Evropian.¹²⁰

Me LMD, viktimave të diskriminimit u është siguruar një mbrojtje adekuate dhe është krijuar një kornizë e përgjithshme për parandalimin dhe luftën kundër diskriminimit. Ky ligj i shpjegon bazat për mbrojtjen nga diskriminimi dhe fushëveprimin e zbatimit, llojet e diskriminimit, i përcakton përgjegjësitë e institucionit dhe strukturën dhe kompetencat e autoriteteve administrative që kanë të bëjnë me diskriminimin dhe i definojnë masat e duhura për të rritur ndërgjegjësimin e publikut.

Ky ligj, i përcakton llojet e trajtimit të pabarabartë, që e përbën diskriminim, si dhe rolin dhe zbatimin e veprimeve afirmative. Risia më e rëndësishme në këtë ligj ka të bëjë me kompetencën e organeve administrative në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi. LMD e forcon pozitën e IAP në shtrirjen e kompetencave në kuptim të mbrojtjes nga shkeljet e të drejtës në bazë të diskriminimit.

Shikuar në përgjithësi, Avokati i Popullit merret me çështjet e diskriminimit në përputhje

¹²⁰ Shih Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi neni 1, paragrafi 2

me kompetencat e parashikuara në Ligjin për Avokatin e Popullit¹²¹ dhe Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.¹²²

Përveç pranimit dhe hetimit të ankesave dhe mbrojtjes së personave në rastet konkrete të diskriminimit, Avokati i Popullit gjithashtu është i autorizuar që: të hetojë dhe veprojë me vetiniciativë ex-officio, kur ekziston dyshimi i bazuar se është bërë diskriminimi nga subjektet e sektorit publik; t'i drejtohet autoriteteve hetuese dhe ndjekëse me kërkesë për fillimin e hetimeve për kundërvajtje dhe vepra penale dhe të kërkojë fillimin e procedurave të zbatueshme disiplinore; Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës “*amicus curiae*” në procedurat gjyqësore që kanë të bëjnë me barazinë dhe mbrojtjen nga diskriminimi, që praqet risi në raport me kompetencat e zakonshme të Avokatit të Popullit.,

Sipas LMD, Avokati i Popullit ka rol të gjerë në promovimin e luftës kundër diskriminimit.. Në këtë kuptim, Avokati i Popullit është kompetent ta monitorojë zbatimin e LMD dhe të iniciojë ndryshime në dispozitat për zbatimin dhe promovimin e mbrojtjes kundër diskriminimit, e informon publikun për rastet e diskriminimit dhe ndërmerr masa për promovimin e barazisë, jep këshilla, udhëzime për sektorin publik dhe privat mbi praktikën më të mira në promovimin e barazisë dhe jep rekomandime për marrjen e masave për parandalimin dhe eliminimin e diskriminimit në çfarëdo baze, bashkëpunon me partnerët social, organizatat joqeveritare dhe mekanizmat relevantë të vendeve të tjera, të cilat merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe institucionet dhe komunitetet fetare të regjistruara në Kosovë, mund të zhvillojë një kod të praktikës së mirë në luftën kundër diskriminimit që mund të përdoret si pikë referimi në rastet e diskriminimit, etj.¹²³

Sipas LMD, është paraparë dispozita (neni 23, paragrafi 4) me të cilën përcaktohet shqiptimi i gjobës për kundërvajtje në çështjet që kanë të bëjnë me diskriminim, ndaj çdo personi i cili fsheh faktet apo informatat e kërkuara nga organi administrativ apo gjykata kompetente. Kjo dispozitë paraqitet si risi në LMD dhe i kontribuon efektshmërisë në mbrojtjen nga diskriminimi.

Përveç kësaj, Avokati i Popullit ka një rol të veçantë edhe në fushën e ofrimit të ndihmës juridike në kontekstin e mbrojtjes nga diskriminimi, ndaj personave fizik dhe personave juridik, të cilët kanë parashtruar ankesë për diskriminim. U jep atyre informacione të nevojshme për të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe për mundësitë e mbrojtjes gjyqësore. Në këtë mënyrë, Ligji i orienton individët te Avokati i Popullit, si instancë e parë në kërkimin e mbrojtjes nga diskriminimi. Paraqitja e ankesës te Avokati i Popullit nuk është kusht për fillimin e padisë para gjykatës dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar

¹²¹ Shih Ligjin për Avokatin e Popullit, neni 16, me të cilin janë precizuar kompetencat e Avokatit të Popullit.

¹²² Shih Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi, neni 9, me të cilin janë precizuar kompetencat e Avokatit të Popullit në mbrojtje nga diskriminimi.

¹²³ Ibid.

që t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale.¹²⁴

LMD gjithashtu e specifikon rolin edhe të një organi tjetër institucional, gjegjësisht Zyrës së qeverisjes së mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, në promovimin dhe zbatimin e LMD dhe si organ që e monitoron zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit.¹²⁵

Ka mbetur ende e paqartë, se cilit organ administrativ saktësisht duhet t'u drejtohen qytetarët për të kërkuar ndihmë dhe cilat procedura administrative do të duhej t'i ndiqnin. Por, në mënyrë të qartë janë emëruar dy organe në nivel qendror, të cilat e kanë detyrim t'i mbulojnë të gjitha ankesat e natyrës diskriminuese: Avokati i Popullit, si një institucion jo gjyqësor dhe gjykatat kompetente.

Përveç LMD, Ligji i veçantë për Barazinë Gjinore e garanton, mbron dhe promovon barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin e një shoqërie demokratike dhe i definon masat e përgjithshme dhe të veçanta për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të barabarta të grave dhe burrave dhe përcakton institucione përgjegjëse dhe kompetencat e tyre. Ky ligj shprehimisht e precizon ndalimin, qoftë të diskriminimit të tërthortë, qoftë diskriminimit të drejtpërdrejtë në bazë të gjinisë, kurse dhunën në bazë gjinore, e definon si një formë e veçantë të diskriminimit. Përveç mekanizmave të tjerë institucional, me këtë ligj, gjithashtu i është dhënë një rol i rëndësishëm Avokatit të Popullit, i cili është i autorizuar t'i trajtojë rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin gjinor.¹²⁶

Me këtë paketë të të drejtave të njeriut është vendosur një sistem integral i mbrojtjes nga diskriminimi në rendin tonë ligjor, mirëpo themelimi i një sistemi ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi nuk nënkupton realizimin e qëllimit dhe fundin e përpjekjeve për realizimin e barazisë në të drejta.

Që nga fillimi i zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, ka kaluar një periudhë kohore prej gati tri vitesh, por tashmë është e dukshme se praktika gjyqësore kundër diskriminuese nuk është as përafërsisht e pasur, sa është "i pasur" realiteti ynë shoqëror me shembuj të diskriminimit. Jemi dëshmitarë të faktit se realitetin shoqëror në Kosovë e shënojnë bashkëjetesa, bashkëpunimi dhe toleranca, por edhe stereotipet etnike dhe të tjera dhe paragjykimet, si dhe niveli i lartë i distancës shoqërore në raport me pakicat etnike, fetare dhe të tjera, si dhe grupet e ndjeshme gjinore, gjë që në mënyrë të konsiderueshme e kufizon arritjen e standardeve të barazisë në jetën e përditshme. Prandaj, për realizimin e mbrojtjes nga diskriminimi, të gjitha pjesët e shoqërisë, të cilave ligji u përcakton detyra konkrete, duhet të përfshihen në kapacitet të plotë. Është evidente se në realizimin e kësaj detyre, gjykatat kompetente dhe Avokati i Popullit kanë një nga rolet më të rëndësishme dhe atë jo vetëm se në procedurat përkatëse me efikasitet do të ofrojnë mbrojtje ligjore nga diskriminimi, por edhe se pushtetit legjislativ do ta propozojë me kohë ndryshimin dhe plotësimin e zgjidhjeve eventuale jo adekuate ligjore.

¹²⁴ Shih Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi, neni 12

¹²⁵ Shih nenin 10, Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi

¹²⁶ Shih Ligjin për Barazinë Gjinore, nenin 13.

Nga periudha prej 1 janar 2017 deri më 19 dhjetor 2017, Avokati i Poullit ka pranuar 177 ankesa me bazë diskriminimi, prej të cilave për hetim janë hapur 115 ankesa, ndërsa 62 ankesa janë refuzuara si të papranueshme. Nga rastet e hetuara, 84 raste janë përfunduar hetimet dhe rastet janë mbyllur.

Përveç ankesave të paraqitura nga qytetarët, Avokati i Popullit ka hapur 9 raste për hetim sipas detyrës zyrtare (*ex-officio*).

Lidhur me çështjet e hetuara janë publikuar 4 raporte me rekomandime dhe janë paraqitur 2 *amicus curie* drejtuar sistemit gjyqësor.

7.2 Personat me aftësi të kufizuar

Ashtu si edhe në vitet paraprake Avokati i Popullit, vazhdon të përcjell situatën e personave me aftësi të kufizuara. Përveç ankesave individuale të pranuar nga ankuesit, Avokati i Popullit vazhdon të pranojë dhe të hetojë edhe ankesa nga takimet e rregullta të realizuara me përfaqësues të Organizatave Joqeveritare, të cilat i mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuar. Avokati i Popullit gjatë kohës raportuese në bazë të mandatit ligjor, ka realizuar takime me institucione të cilat janë drejtpërdrejtë përgjegjës në shkeljet e pohuara të ankuesve në ankesat e tyre.

Personat me aftësi të kufizuara si pjesë e shoqërisë sonë, vazhdojnë të ballafaqohen me probleme të njëjta në të gjitha sferat e jetës ashtu siç është raportuar edhe në vitet paraprake. Problemet e tyre fillojnë nga qasja e lirë nëpër hapësira publike, objekte të institucioneve publike, objekte banesore kolektive duke përfshirë edhe ato të ndërtuara për raste sociale, nëpër shkolla publike, shëndetësi, arsimim, punësim, gjendje ekonomiko sociale.

Në Kosovë ka infrastrukturë të gjerë ligjore e cila garanton të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.¹²⁷ Nga analiza e ligjeve, del se ligjvënësi, shumicën çështje të dala nga këto ligje i ka lënë të rregullohen në mënyrë të detajuar me akte nënligjore. Mungesa e nxjerrjes së akteve nënligjore bën që këto ligje të mos gjejnë zbatim të plotë, në këtë mënyrë personat me aftësi të kufizuar nuk arrijnë të kenë përkrahjen e garantuar ligjore për t'i realizuar të drejtat e tyre.

¹²⁷ Ligji nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, Ligji Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër, Ligji Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 05/L-078, Ligji Nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, Ligji Nr. 03/L-022 për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme, Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (dispozitat përkatëse për personat me aftësi të kufizuara), Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.04/L-081, Ligji Nr. 02/L-52 mbi edukimin parashkollor, Ligji Nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 05/L-018 për provimin e maturës shtetërore (dispozitat përkatëse për personat me aftësi të kufizuara), Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Ligji Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor (dispozitat përkatëse për personat me aftësi të kufizuara), Ligji Nr. 04/L – 110 për ndërtim / Udhëzimi Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara

Ligji Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër i cili zbatohet nga 1 janari i vitit 2013, ka për qëllim të rregullojë statusin ligjor të personave të verbër në Republikën e Kosovës, ndërsa fushëveprimi i tij është rregullimi i të drejtave dhe përfitimeve si dhe përcaktimi i kriterëve për kategorizimin e personave të verbër. Nga ky ligj zbatohet vetëm dispozita e kompensimeve për personat e verbër dhe për shoqëruesit e tyre, ndërsa deri më tani kanë mbetur pa u nxjerrë aktet nënligjore të cilat rregullojnë çështjet e sigurimit shëndetësor dhe kujdesit shëndetësor, edukimit dhe arsimit, rehabilitimit, udhëtimit, energjia elektrike, telefonja etj pra, këto dispozita të ligjit që rregullojnë beneficionet e përcaktuara me ligj për personat e verbër, kanë mbetur pa u zbatuar deri më tani. Avokati i Popullit e konsideron se është obligim i organeve përgjegjëse që sa më parë të nxjerrin aktet nënligjore përkatëse, të cilat do të mundësonin zbatimin e plotë të këtij ligji.

Në bazë të ankesave të cilat Avokati i Popullit i ka pranuar nga personat me aftësi të kufizuar, kuptohet se nuk ka ndonjë politikë për sistemimin e personave me aftësi të kufizuar në sektorin e punësimit, aty ku ka mundësi për kryerjen e punëve sipas kualifikimit dhe aftësive të tyre.

Ligji nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 05/L -078, në mesin e ligjeve që rregullojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, mund të konsiderohet si ligji më i pazbatuar në fushën e personave me aftësi të kufizuara. Neni 12 i këtij ligji i cili ka caktuar se organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare obligohen që me kushtet e përshtatshme të punës të punësojnë një persona me aftësi të kufizuar në çdo pesëdhjetë (50) të punësuar, vazhdon të mbetet i pa zbatuar.

Gjithashtu, Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 5 gusht 2016, ka miratuar Ligjin Nr. 05/L -078 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019. për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, por edhe sot nuk ka asnjë përmirësim të zbatimit të tij dhe as përmirësim të punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Avokati i Popullit disa herë i është drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), për të mësuar për planet e ministrisë që kanë të bëjnë me politikat apo strategjitë e punësimit të personave me aftësi të kufizuar. Avokati i Popullit veçanërisht ka qenë i interesuar të njoftohet me planin e MPMS-së në zbatimin e ligjeve për aftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar si dhe për veprimet apo planet MPMS-së në zbatimin e Ligjit të Punës, nr. 03/L-212 dhe nr. 03/L-019, të ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019, që parashih një sërë masash dhe zgjidhjesh për këtë kategori. Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje. Avokati i Popullit i rekomandon MPMS të veprojë në përputhje me obligimin kushtetues dhe ligjor për bashkëpunim.

Me Ligjin për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara nr.03/L-022, rregullohet e drejta për përkrahje materiale familjeve të cilët ruajnë dhe përkujdesen

për fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme dhe mënyra e realizimit të kësaj përkrahje materiale. Ky ligj parasheh që fëmijët nën moshën 18 vjeçare të kenë përkrahje materiale në vlerë prej 100 euro në muaj. Pensionet e personave me aftësi të kufizuara pas moshës 18 vjeçare rregullohen me Ligjin Nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti. Sipas këtij ligji, përkatësisht nenit 9 ky pension përkufizohet si pension i paaftësisë të përhershme, si pension i rregullt mujor, bazuar në vendimin e organit përkatës të Ministrisë, për personat që i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj. Ky ligj, përveç pensionit nuk rregullon ndonjë të drejtë tjetër për personat me aftësi të kufizuara. Është shqetësuese fakti se shuma mujore e pensionit është 75 Euro, dhe e caktuar në mënyrë lineare për të gjithë, pa u bazuar në nevojat dhe në llojin apo shkallën e aftësisë së kufizuar. Këtë shqetësim Avokati i Popullit e ka ngritur edhe në raportet paraprake vjetore.¹²⁸ Avokati i Popullit rekomandon edhe më tej që të rishikohet baza ligjore për kompensim të personave me aftësi të kufizuar, kompensimi të vlerësohet mbi bazën e shkallshmërisë së aftësisë së kufizuar duke pas parasysh faktin se edhe më tej nuk ka të përcaktuar shkallë objektive të aftësisë së kufizuar dhe se shuma e mbështetjes financiare vazhdon të mbetet e njëjtë 75 euro për të gjithë.

Personat me aftësi të kufizuar vazhdojnë të kenë dyshim mbi korrektësinë e punës së komisionit mjekësor, sepse sipas tyre komisioni mjekësor nuk i vlerëson aplikuesit sipas diagnozave të mjekëve profesionist, por sipas dukjes së tyre me rastin e paraqitjes së tyre në komision mjekësor.

Ashtu siç është cekur edhe në raportet paraprake vjetore të Avokatit të Popullit, sipas këshillës juridike të vendimeve të Ministrisë Punës dhe Mirëqenies Sociale për ndërprerjen e pensioneve të personave me aftësi të kufizuar pas rishikimit, ankuesit kanë të drejtë të ushtrojnë padi në Gjykatë Themelore të Prishtinës, Departamentin për Çështje Administrative.

Kjo edhe më tepër e vështirëson mundësinë e personave me aftësi të kufizuar për të qenë shfrytëzues të pensioneve të personave me aftësi të kufizuar sepse gjykata nuk vendos në çështje meritore të rastit, por vetëm në çështje procedurale dhe me vendim të gjykatës rasti kthehet për rishqyrtim në komisionin mjekësor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Kjo bën që Personat me Aftësi të Kufizuar në njohjen dhe realizmin e të drejtës së tyre për pensionin e aftësisë së kufizuar presin me vite. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit ka raportuar edhe në raportin vjetor paraprak dhe njëherë ka publikuar një raport me rekomandime, në të cilin ka gjetur se me procedurat e vazhdueshme që janë të detyruar të ndjekin personat me aftësi të kufizuar për të realizuar të drejtën e pretenduar për pension, pa një vendim meritore dhe pa një shqyrtim të përshtatshëm gjyqësor është shkelje e të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara.¹²⁹ Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje në rekomandimet e tij, prandaj tërheq

¹²⁸ Shih raporti i 16 vjetor i Avokatit të Popullit, Aftësia e Kufizuar

¹²⁹ Raporti Ex-Officio nr. 425/2015, http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/425-2015_Raport_ne_lidhje_me_mungesen_e_mjeteve_efektive_juridike_982052.pdf

vëmendjen se mos bashkëpunimi i institucioneve përgjegjëse me Avokatin e Popullit përbën shkelje kushtetuese dhe ligjore.

Këtë vit raportues Avokati i Popullit, e sheh si hap pozitiv fillimin e zbatimit të Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Ky ligj ka për qëllim të rregullojë statusin dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme.

Gjatë këtij viti janë nxjerr aktet e para nënligjore, të parapara për zbatimin e këtij ligji. Më 30 janar 2017, është nxjerr udhëzimi administrativ i cili e rregullon formën dhe përbërjen e librezës zyrtare identifikuese si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, ndërsa më 26 maj 2017, është miratuar në Qeveri akti tjetër nënligjor, për përbërjen, funksionimin, përgjegjësitë e komisionit vlerësues dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit dhe të drejtave të personave paraplegjik dhe tetraplegjik. MPMS në fund të dhjetorit 2017, ka filluar ndarjen e vendimeve, përfituesve të benifiteve nga ky ligj.

Shkollimi i personave me aftësi të kufizuara është e drejtë themelore e njeriut e garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe me konventat ndërkombëtare. Çështja e gjithëpërfshirjes në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuar edhe përkundër legjislacionit në fuqi, vazhdon të mbetet sfidë për ta edhe më tej. Gjendja e qasjes fizike të fëmijëve me aftësi të kufizuar nëpër objektet shkollore publike vazhdon të mbetet e njëjtë.¹³⁰

Mungesa e asistentëve të angazhuar nga institucionet shtetërore nëpër shkolla vazhdon të shfaq elemente diskriminimi në mes të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Edhe më tej vetëm fëmijët me kushte më të mira ekonomiko sociale, po kanë mundësi të kenë asistent në procesin mësimor, sepse ata i angazhojnë vet prindërit me pagesat e tyre. Me këtë rast fëmijët me aftësi të kufizuar, prindërit e të cilëve nuk kanë mundësi të paguajnë për asistent, ballafaqohen me diskriminim të shumëfishtë. Kjo për shkak se institucionet shtetërore nuk angazhojnë asistent ndërsa sipas Kushtetutës secili gëzon shkollim themelor pa pagesë, përfshirë këtu edhe fëmijet me aftësi të kufizuar. Mungesa e angazhimit të asistentëve nga institucionet, si dhe pamundësia e prindërve për të angazhuar asistent me pagesë ndikon që trajtimi i fëmijëve me aftësi të kufizuar në procesin mësimor të mos jetë i barabartë në mësim nxënie.¹³¹ Mungesa e personelit profesionalndihmës bie në kundërshtim edhe me Ligjin për Arsimin Parauniversitar i cili garanton gjithëpërfshirjen, shërbimet efektive të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor dhe social.

¹³⁰Shih raporti i 16 vjetor i Avokatit të Popullit, Aftësia e Kufizuar

¹³¹ Rasti A.888/2017

Avokati i Popullit është në hetim të ankesës të parashtruar nga një prind i fëmijut me aftësi të kufizuara i cili ankohet në lidhje me mungesë të asistentëve për mësim-nxënje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla publike. Gjithashtu kjo ankesë përfshin edhe mungesën e transportit si dhe sfidat e prindërve për t'i dërguar fëmijët me aftësi të kufizuara deri në shkollë. Për më tepër Avokati i Popullit konsideron se mungesa e vullnetit institucional në mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin mësimor gjithëpërfshirës bëhet edhe më e qartë me faktin se në Ligjin për Buxhetin e Kosovës për vitin 2018, nuk janë miratuar propozime për buxhet shtesë me qëllim të arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar.

Prandaj, në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara të trajtohen në mënyrë të barabartë në procesin mësimor si dhe në funksion të zbatimit të legjislacionit që garanton shkollim gjithëpërfshirës, Avokati i Popullit, rekomandon që Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë duhet të trajtojë me prioritet çështjen e angazhimit të stafit jo mësimdhënës/ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara nëpër shkolla.

Për më tepër fëmijët nëpër shkolla fillore dhe të mesme mësojnë nga literatura shkollore e cila përgatitet nga Ministria e Arsimit. Avancimi i të nxënësve në mësim bëhet përmes mësimdhënies cilësore, duke zbatuar kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe duke shfrytëzuar resurse mësimore të cilësisë së lartë. Megjithatë, tekste shkollore të cilat u ndahen nxënësve për mësimnxënje përmbajnë gjuhë diskriminuese dhe fyese për personat me aftësi të kufizuara. Përdorimi i gjuhës diskriminuese dhe fyese e përdorur në tekste shkollore tek Institucioni i Avokatit të Popullit është ngritur si shqetësim nga Shoqata Down Sindrom Kosova. Terminologjia e përdorur në librin e biologjisë së klasës së 10-të dhe 11-të, ku Sindroma Down cilësohet si “Idiotia Mongoloide” dhe personat me sindromën Down, në këto tekste karakterizohen se “jetojnë më së shumti 10-15 vjet”, nuk përkon me realitet dhe është e pa bazuar shkencërisht.

Lidhur me këtë Avokati i Popullit është prononcuar publikisht duke theksuar se përdorimi i termave dhe koncepteve në literaturën shkollore, që nuk janë në pajtim me dinamikën e avancimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, për Avokatin e Popullit paraqet jo vetëm shqetësim, por edhe nevojë urgjente për korrigjime. Gjithashtu, Avokati i Popullit përmes prononcimit u ka tërhequr vëmendjen autoriteteve përgjegjëse se literatura shkollore ka nevojë të rishikohet me vëmendje dhe të riformulohet në pajtim me garancitë kushtetuese dhe ligjore në Republikën e Kosovës, për trajtim të barabartë dhe pa diskriminim¹³².

Personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen edhe me problemet shëndetësore. Medikamentet si dhe materialet higjienike për këtë kategori të shoqërisë sonë nuk përfshihen në lista esenciale prandaj, siguri i tyre mbetet në barrën e familjeve të tyre. Kjo situatë edhe më tepër i rëndon kushtet ekonomiko sociale të familjeve të cilët kanë anëtarë me aftësi të kufizuara.

¹³² <http://www.ombudspersonkosovo.org/sq/lajme/Avokati-i-Popullit-shpreh-shqetesimin-lidhur-me-perdorimin-e-terminologjise-dhe-koncepteve-diskriminuese-ne-literaturen-shkollore-1544>

Avokati i Popullit rekomandon që Ministria e Shëndetësisë duhet t'i përditësoj listat ku përfshihen barnat esenciale, t'i plotësoj ato edhe në përputhje me medikamentet e nevojshme si dhe materialet tjera përfshirë edhe ato higjienike, të cilat janë jetike për personat me aftësi të kufizuar.

Përfundimisht, Avokati i Popullit e sheh si shqetësim mos zbatimin e ligjeve. Moszbatimi i ligjeve konsiderohet si dështim i shtetit në ligj bërje. . Avokati i Popullit rekomandon organet përgjegjëse të jenë më vigjilente në kontrollin e zbatimit të ligjeve si dhe me prioritet të merren me nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse, të cilat do të mundësonin zbatimin e plotë të ligjeve. Avokati i Popullit, konstaton se institucionet përgjegjëse në Kosovë kanë dështuar të veprojnë në zbatim e ligjeve të cilat i garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat e tyre prandaj, rekomandon që të nxirën aktet nënligjore si dhe të zbatohen sanksione e parapara ndaj shkelësve të ligjeve të cilat garantojnë të drejtat dhe privilegjet e personave me aftësi të kufizuar.

7.3 Diskriminimi në punë

Parimi i barazisë në mundësitë dhe veprimet është pjesë përbërëse e të drejtës për të punuar në kuptimin më të gjerë. Diskriminimi në punë dhe lidhur me punën ndodh shumë shpesh , sepse prapa tij qëndron interesi i kapitalit dhe fitimit të përfitimeve ekonomike.

Duke u nisur nga koncepti i barazisë dhe trajtimit të barabartë, shteti e ka për detyrë që çdo punëtori t'ia sigurojë të njëjtat të drejta dhe të njëjtat kushte në ushtrimin e të drejtave të punës. Këto parime përcaktohen me Kushtetutë¹³³ dhe legjislacionin e vlefshën në Kosovë.¹³⁴

Me dispozitat ligjore në mënyrë eksplicite ndalohet shkelja e parimit të trajtimit të barabartë, në punësim dhe profesion, në lidhje me procesin e rekrutimit, aftësimin profesional, promovimit, kushteve të punësimit ose çështjeve të tjera në fushën e punës, të rregulluara me ligjet në fuqi në cilëndo veprimtari dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale. Dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë të zbatueshme drejtpërsëdrejti, kur bëhet fjalë për marrëdhëniet e punës ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit.

Me dispozitat ligjore gjithashtu në mënyrë specifike ndalohet diskriminimi në bazë të gjinisë dhe i referohet qasjes në punësim, vetëpunësim dhe zgjedhjes së karrierës.

Në çështjet e trajtimit të barabartë në të drejtat e punës, është i rëndësishëm edhe bashkëpunimi me sindikatat dhe institucionet e sistemit që merren me këto çështje, në mënyrë që me veprimtarinë e përbashkët të shfrytëzohen sa më mirë mekanizmat ekzistues për mbrojtjen e punëtorëve nga të gjitha format e diskriminimit në vendin e punës.

¹³³ Shih Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 24, Barazia para ligjit dhe neni 49, E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit

¹³⁴ Ligji i punës nr. 03/L-212 dhe Ligji i Shërbimit Civil të Kosovës nr.03/L-149. Ligji nr.2004/3 për mbrojtjen nga diskriminimi, Ligi për barazinë gjinore nr. 05/L-020.

Avokati i Popullit gjatë periudhës raportuese e ka monitoruar zbatimin e të drejtave të punës, ai mori informacione nga institucionet relevante,¹³⁵ nga terreni dhe përmes ankesave të pranura lidhur me diskriminimin në fushën e punës dhe zhvilloi hetime ex-officio.

Diskriminimi në punë, kryesisht ndodh në sektorin privat dhe problemi kryesor në sferën e ushtrimit të marrëdhënieve të punës është puna në të zezë, pra, puna pa një kontratë pune, puna e cila pas vetes tërheq punën jashtë orarit të rregullt të të paraparë me ligj, dhënia jo e rregullt e pagave, pamundësia për ta përdorur pushimin vjetor, mbrojtja joadekuate në punë etj.

Mungesa e kontraës së punës pamundëson realizimin e të drejtave të tij në bazë të punës, me çka shkelet parimi i mundësive të barabarta për krijimin e marrëdhënies së punës dhe gëzimin në kushte të barabarta të të gjitha të drejtave në fushën e punësimit. E gjithë kjo ndikon në sigurinë dhe të drejtat e punëtorëve, kurse punëdhënësit që veprojnë kështu janë konkurrencë jolojale për ata që ligjërisht bëjnë biznes, ndërsa shteti për shkak të kontributeve të papaguara pëson humbje..

Për shkak të shkallës së lartë të papunësisë në Kosovë, punëtorët në sektorin privat janë të gatshëm të pranojnë me vetëdije kompromise të ndryshme në mënyrë që të fitojnë dhe ta mbajnë një vend pune, i cili shpesh është burimi i vetëm i ekzistencës së tyre, duke shpresuar se një ditë do ta marrin kontratën dhe do të punësohen për një periudhë të pacaktuar.

Diskriminimi i punëtorëve në sektorin privat më së shumti është i shprehur në sektorin e ndërtimit, tregtisë, hotelierisë dhe industrisë, ku punëtorët shpesh punojnë pa kontratë të punës, pa pushime ditore, javore dhe vjetore dhe nuk kanë të drejtë në pushime mjekësore, kurse për lëndimet në vendin e punës vështirë se mund të marrin kompensim. Ata shpesh janë të detyruar të punojnë më gjatë se orari i parashikuar i punës, por edhe të dielave dhe gjatë festave, kurse ajo punë e kryer nuk evidentohet, kështu që as nuk mund të dëshmohet sa ka zgjatur koha e punës, kurse puna e bërë as nuk mund të paguhet në mënyrë adekuate. Themelimi i një sistemi të tillë të punës domosdoshmërisht çon deri te përkeqësimi i shëndetit të njerëzve dhe humbja e aftësisë për punë, në këtë mënyrë, punëtorët që punojnë ilegalisht hyjnë në zonën e varfërisë dhe pasigurisë së plotë sociale në pleqëri.¹³⁶

Gjithashtu, një element shumë të rëndësishëm të punës dinjitoze e paraqet sistemi i mbrotjes së shëndetit dhe sigurisë në punë. Megjithëse, legjislacioni i punës¹³⁷ i parashikon standardet e mbrotjes së shëndetit dhe sigurisë në një vend të punës, që është

¹³⁵ Informatat e mblidhura në lidhje me shkeljen e të drejtës në punë, nga takimet e mbajtura gjatë periudhës raportuese, me inspektorin e Inspektoratit të Kosovës dhe kryetarin e Unionit të pavarur të sindikatave të Kosovës.

¹³⁶ Po aty.

¹³⁷ Ligji i punës dhe Ligji për Mbrojtjen Shëndetësore të Punonjësve dhe Mjedisin e Punës nr.203/19

pjesë përbërëse e organizimit të procesit të punës dhe i udhëheq të gjitha aktivitetet në vend dhe i përcakton përgjegjësitë dhe detyrimet e punëdhënësit në atë drejtim, situata lidhur me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe sigurimit të dinjitetit të tyre elementar në punë, nuk mund të konsiderohet e kënaqshme. Ne jemi dëshmitarë të një numri në rritje të aksidenteve në vendet e punës. Ky problem më së shumti është i theksuar në sektorin e ndërtimit, ku për shkak të mbrojtjes joadekuate të punëtorëve dhe mosrespektimit të standardeve të sigurisë po ndodh numri më i madh i lëndimeve të rënda në punë dhe lëndimeve që rezultojnë me humbje jetësh.

Legjislacionin përkatës, është gjithëpërfshirës dhe dispozitat e tij ofrojnë mekanizma adekuat për mbrojtjen e barabartë të punëtorëve në sektorin publik dhe privat.

Megjithatë, Inspektorati i punës si një mekanizëm që është organ ekzekutiv i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fushën e punës, duke përfshirë marrëdhëniet e punës, sigurinë në punë, kujdesin shëndetësor të të punësuarve dhe mbrojtjen e mjedisit.¹³⁸ Në shërbimin e vet ka 50 inspektorë që e kontrollojnë zbatimin e legjislacionit në fushën e punës dhe funksionin e vet e kryen në 30 komuna në Kosovë, përmes shtatë zyrave rajonale. Në raport me kompleksitetin e punës, territorin që mbulohet, pjesën e sektorit publik dhe numrin e madh të bizneseve private të regjistruara në Kosovë, Inspektorati i Punës nuk ka burime dhe kapacitet të mjaftueshëm, që në mënyrë cilësore dhe të dobishme t'i përmbushë detyrimet e veta dhe të bëjë inspektimin e një numri aq të madh të bizneseve. Në këtë drejtim, është e nevojshme që Qeveria të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e rregullores në fushën e inspektimit të punës dhe lartësisë së sanksioneve, në drejtim të funksionimit më efikas dhe efektiv të mbikëqyrjes inspekuese, që do të mund t'i monitoronte punëdhënësit dhe të kishte një ndikim të matshëm në problemet në fushën e punës dhe të vepronte në mënyrë parandaluese ndaj problemit të diskriminimi në fushën e punës dhe lidhur me punën. Rezultatet e deritanishme të inspektimeve nuk e tregojnë efektivitetin në dekurajimin dhe parandalimin e shkeljeve të mëtejshme të ligjeve dhe diskriminimit në fushën e punës.¹³⁹

Sa i përket Kontratës kolektive, Avokati i Popullit vëren që kontrata i rregullon të drejtat dhe obligimet e punëdhënësve dhe punëmarrësve, duke përfshirë dispozitat për orarin e punës, punën në turnin e natës, pushimin vjetor, pushimin e lehonisë, sigurinë në vendin e punës dhe përfitimet shëndetësore të të punësuarve. Kontrata gjithashtu përmban të gjithë mekanizmat mbrojtës nga ligji i punës dhe ka të bëjë me të gjithë të punësuarit qoftë në sektorin publik, qoftë në atë privat, prandaj Qeveria duhet që sa më parë të krijojë kushte për zbatimin e saj të plotë.

¹³⁸ Ligji për Inspektoratin e punës nr. 03/L-017

¹³⁹ Më 05.06.2017 përfaqësueset e IAP mbajtën një takim me Inspektorin kryesor të Inspektoratit të punës me të cilin biseduan për problemet në lidhje me diskriminimin në vendin e punës dhe obligimet e Inspektoratit në ushtrimin e funksioneve të veta. Të dhënat e marra në takimin e mbajtur me Inspektorin kryesor të Inspektoratit të punës flasin se ekzistojnë mbi 50,000 biznese janë regjistruar në Kosovë, ata e kanë theksuar se ka edhe biznese të paregjistruara në terren.

Për shkak të shkallës së lartë të papunësisë, rastet e diskriminimit në vendin e punës raportohen shumë rrallë, sepse të punësuarit kanë frikë nga hakmarrjet e punëdhënësve të tyre. Shumë shpesh, të punësuarit i kanë zgjidhur çështjet e tyre të punës brenda dhe në mënyrë joformale me punëdhënësit e tyre.

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit i inicioi disa raste ex officio lidhur me diskriminimin në vendin e punës në sektorin privat. Hetimet në këto raste janë në zhvillim e sipër dhe raportet me rekomandime të Avokatit të Popullit priten në periudhën e ardhshme.

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit i ka trajtuar edhe rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin në vendin e punës në sektorin publik, për të cilat në pajtim me kompetencat e veta dhe bazuar në dyshimin se ekziston diskriminim nga ana e sektorit publik,¹⁴⁰ janë inicuar hetimet ex-officio.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Avokati i Popullit sipas detyrës zyrtare e hapi çështjen nr. 127/2017,¹⁴¹ lidhur me punësimin e kuadrit mësimdhënës nga ana e Drejtorisë për Arsim të Komunës së Ferizajt. Kjo çështje lidhet me çështjen, të cilën Avokati i Popullit e ka shqyrtuar dhe publikuar në raportin me rekomandime ex officio Nr. 499/2016, për kriteret e publikuara në konkurset e shpallura nga drejtoritë komunale për arsim në 19 komunitat e Republikës së Kosovës dhe shkeljet e procedurave ligjore gjatë procesit të rekrutimit të personelit.

Për këtë qëllim, duke shfrytëzuar kompetencat e veta ligjore,¹⁴² Avokati i Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) ia paraqiti Gjykatës Themelore në Prishtinë një mendim ligjor me qëllim që ta informojë atë për gjetjet dhe konkluzionet e tij lidhur me çështjen në shqyrtim.

Ky mendim ligjor i referohet sqarimit të procedurës ligjore lidhur me rekrutimin e stafit mësimdhënës, në përputhje me vendet e lira të shpallura nga Drejtoritë Komunale të Arsimit në Republikën e Kosovës (DKA), në të cilat Avokati i Popullit, pas hetimit, i determinoi kriteret që janë diskriminuese dhe të cilat e shkelin të drejtën për trajtim të

¹⁴⁰ Neni 16, i Ligjit për Avokatin e Popullit në paragrafin 4 parasheh; “Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.”

Në paragrafin 9, të nenit 16 i cili e autorizon: “Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimit.”

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, neni 9, paragrafi 2.3 “Avokati i Popullit ka autorizim të hetoj ose të veproj mbi ndonjë ankesë të parashtruar ose me vetë-iniciativë (ex-officio) kur ka bazë për të dyshuar se ka ndodhur diskriminimi nga subjektet e sektorit publik.”

¹⁴¹ Shih mendimin juridik të Avokatit të Popullit të drejtuar në cilësinë e amicus curiae Gjykatës Themelore në Prishtinë, në rastin Ex officio nr. 127/ 2017, lidhur me padinë e komunës së ferizajt kundër Ministrisë së punës dhe mirëqenies socialje , të publikuar më 23. maj 2017.

¹⁴² Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, neni 9, paragrafi 2.13 “Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimit;”

barabartë, me rastin e punësimit dhe në një mënyrë të caktuar i favorizojnë kandidatët dhe krijojnë pabarazi midis konkurrentëve. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit theksoi se veprimet e tilla të autoriteteve publike në komunat konkrete e shkelin barazinë para ligjit dhe janë në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Lidhur me këtë çështje Avokati i Popullit është i mendimit se është fakt i padiskutueshëm që shumica e DKA-ve në Republikën e Kosovës, sipas konkurseve të shpallura për pozitat e mësimdhënësve, po e zbatojnë Ligjin e Punës, përzgjedhja e kandidatëve në disa komuna është bërë në përputhje me disa dispozita të veçanta ligjore, kurse në disa në pajtim me dispozitat e Ligjit të Punës, ose në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 14/2011 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënieve të punës në sektorin publik, prandaj institucionet publike, të cilat i zbatojnë ligjet duhet t'i zbatojnë ato në mënyrë të barabartë për të gjithë dhe t'i sigurojnë secilit mbrojtje të njëjtë. Pa dyshim, një shembull i tillë kontribuon në mungesën e besimit të qytetarëve në drejtësi. Zbatimi i dispozitave të ndryshme nga ana e disa komunave sjell deri te situatat, të cilat janë në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit dhe barazisë para ligjit.

Lidhur me çështjen në fjalë, Avokati i Popullit e saktësoi se është e domosdoshme që përzgjedhja e stafit mësimdhënës për të gjitha lëndët mësimore të bëhet në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 05/2015, normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional dhe Udhëzimin administrativ nr. 06/2015, për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm. Dispozitat e sipërpërmendura parashikojnë zgjidhje për çështje të caktuara që dalin në rastet e punësimit në institucionet arsimore dhe krijojnë bazë të mjaftueshme ligjore, e cila kërkohet pikërisht me nenin 2.2 të Ligjit të Punës. Rekrutimi i personelit mësimdhënës në institucionet arsimore duhet të bëhet në përputhje me udhëzimet, procedurat dhe standardet, të cilat i publikon Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit ka hapur hetimet ex officio¹⁴³ lidhur me diskriminimin në sektorin publik dhe lidhur me kushtin diskriminues në konkurset për vendet e lira të punës në Universitetin e Prishtinës, të shpallura në vitin 2016 dhe 2017. Hetimi në këtë çështje ka përfunduar dhe publikimi i raporteve me rekomandime i Avokatit të Popullit pritet në periudhën e ardhshme.

Në vitin 2017, Avokati i Popullit e shqyrtoi një ankesë në emër të sindikatave të ish-policëve të Kosovës, për shkak të mos llogaritjes së përvojës së punës për ish-oficerët e policisë, sipas mënyrës të përcaktuar me Ligjin për punë të brendshme, të vitit 1978.

Ish-zyrtarët e policisë e konsiderojnë se janë të diskriminuar, meqë përvoja e punës për punëtorët arsimor dhe shëndetësor nga periudha 1989-1999 u njihet sipas nenit 8 të Ligjit mbi skemat e pensioneve të financuara nga shteti, ndërsa një gjë e tillë nuk u njihet ish zyrtarëve policor, të cilët me dhunë ishin dëbuar nga punët e tyre të punës.

Pas shqyrtimit të fakteve të rastit në kontekstin e legjislacionit përkatës dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Avokati i Popullit konkludoi se në pajtim me

¹⁴³ Ex officio nr.853/2016

Ligjin për punët e brendshme, të vitit 1978 dhe Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 26/83) ish oficerët e policisë kishin pritje legjitime që ata ta gëzojnë njohjen përvojës së punës, në mënyrë që të njëjtit të realizonin përfitimin nga skemat e pensioneve. Kjo e drejtë nuk mund të zhbëhet duke miratuar një ligj të ri, sepse do të ishte në kundërshtim me të drejtat themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe parimin e mos-fuqisë prapavepruese të ligjit. Ligjet bëhen për të vepruar në të ardhmen, pas hyrjes së tyre në fuqi.

Veprimi i pakthyeshem ose jo-retroaktiviteti i ligjit është një parim i përgjithshëm dhe ekziston që nga e drejta romake: *Leges et constitutiones futuris certum est dare formam negotiis, non ad facta praeterit revocari, nisi nominatim etiam de praetorito tempore adhuc pendentibus negotiis cautum sit*. Kushtetuta dhe ligjet e përcaktojnë formën e veprimit juridik në të ardhmen dhe nuk mund të vlejnjë edhe për aktet që kanë ndodhur më parë, në qoftë se nuk është paraparë shprehimisht që të njëjtat vlejnjë edhe për kohën e mëparshme dhe atë vetëm për veprimet ligjore që ende nuk janë përfunduar. Avokati i Popullit vëren se, gjatë kësaj kohe përvoja e punës duhej të llogaritej në përputhje me dispozitat e nenit 117 të Ligjit për punë të brendshme të vitit 1978 dhe për çdo periudhë të punës prej një viti, saktësisht 12 muajsh, ish-zyrtarëve të policisë duhej t'u llogaritej si t'i kishin 16 muaj përvojë pune. Në të kundërtën, kjo paraqet shkelje serioze të interesave të të punësuarve në polici, për shkak se atyre u pamundësohet realizimi i drejtës për pension, çështje e cila është e rregulluar me Ligjin për punë të brendshme të vitit 1978, gjatë kohës kur ata (policët) kanë qenë në marrëdhënie pune. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e çështjes, Avokati i Popullit thekson se autoritetet kompetente duhet të gjejnë një zgjidhje, e cila do ta mundësojë njohjen përvojës së punës të beneficuar për periudhën, në të cilën ata kanë punuar, ose të analizojnë mundësi të tjera, siç është ndryshimi i ligjit, ku do të precizohet cilat kategori mund të jenë të përfshira në "të tjerëve" (si në paragrafin 6 të nenit 8) të Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Bazuar në atë që u tha më sipër, Avokati i Popullit konkludoi se ndaj ish-zyrtarëve të policisë së Kosovës, të cilët u larguan me forcë nga puna gjatë periudhës 1989-90, autoritetet shtetërore vepruan në mënyrë diskriminuese, sepse statusi i tyre ligjor ka mbetur i paqartë dhe nuk e gëzojnë të drejtën e pensionit sipas përvojës së punës të beneficuar, e cila më parë ka qenë e rregulluar me Ligjin për punë të brendshme të vitit 1978 dhe po ashtu nuk u është njohur përvoja e punës sipas Ligjit 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti. Me qëllim të mbrojtjes nga diskriminimi në lidhje me çështjen e lartpërmendur, Avokati i Popullit i ka dërguar rekomandimet e duhura Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe pret një përgjigje.

Diskriminimi në punë dhe lidhur me punën është një nga format më ekstreme të cenimit të dinjitetit njerëzor dhe kufizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, për ç'shkak nga

shteti dhe institucionet kombëtare kërkohet që vazhdimisht t'i përmbushin detyrimet e veta për t'i mbrojtur qytetarët.

7.4 Të drejtat që ndërlidhen me HIV/AIDS në Kosovë

Përgjigja e Kosovës ndaj HIV/AIDS duhet të ndërtohet mbi bazat themelore të të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët e Kosovës, duke përfshirë lirinë nga diskriminimi për shkak të racës, seksit dhe gjinisë; të drejtën në shëndet; të drejtën për pjesëmarrje dhe të drejtën për informim. Mbrojtja e këtyre të drejtave të njeriut është veçanërisht e rëndësishme në kontekst të HIV/AIDS, i cili në mënyrë disproporcionale prek grupet e marginalizuara të popullsisë si personat që jetojnë me HIV, të cilët shpesh përballen me stigmën, diskriminimin, përjashtimin social dhe mohimin e të drejtave të tyre. Në këtë kontekst, një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut thekson detyrimet ligjore të shtetit në realizimin e të drejtave të qytetarëve të saj, duke përfshirë të drejtën për shëndet, si dhe rëndësinë e fuqizimit dhe përfshirjen aktive të komuniteteve dhe individëve të infektuar ose të prekur nga HIV/AIDS.

Në Kosovë ekziston mbrojtje e pabarabartë ligjore dhe shkelje e të drejtave të njeriut për personat që jetojnë me HIV dhe grupeve të cenueshme. Sipas raporteve të Programit të Fondit Global për parandalim të HIV në Kosovë, moszbatimi i ligjit për mbrojtje nga diskriminimi ndikon në jetën e përditshme të atyre që jetojnë me HIV dhe grupeve të cenueshme duke krijuar barriera për qasje në kujdesin shëndetësor, parandalimin dhe trajtimin të HIV, si dhe mundësitë për punësim dhe arsimim. Sipas këtyre raporteve, personat që jetojnë me HIV, pavarësisht se përfshihen abuzime të të drejtave të tyre, nuk përpiqen të kërkojnë mbrojtje të të drejtave të tyre nëpërmjet rrugëve ligjore për shkak të mungesës së njohurive për të drejtat e tyre dhe nga frika e zbulimit të statusit të tyre me HIV pozitiv. Rrjedhimisht, nuk ka të dhëna të konfirmuara lidhur me rastet e raportitmit të diskriminimit apo shkeljeve të të drejtave të personave që jetojnë me HIV dhe grupeve tjera të cenueshme.

Megjithatë, stigma dhe diskriminimi i personave me HIV/AIDS është evident në të gjitha sferat e jetës, në veçanti në qasjen në shërbimet shëndetësore. Sipas organizatave joqeveritare që punojnë në këtë fushë, disa prej rasteve më të shpeshta të raportuara kanë të bëjnë me: refuzimin e trajtimit shëndetësor të personave që jetojnë me HIV nga zyrtarët shëndetësor nga frika e infektimit; institucionet shëndetësore publike nuk kanë terapi dhe personel shëndetësor adekuat për të trajtuar fëmijët të cilët jetojnë me HIV duke i obliguar ata që të kërkojnë trajtim jashtë vendit. Këtyre grupeve u vështirsohet qasja në shërbime të parandalimit të HIV/AIDS por edhe në shërbime të tjera shëndetësore si dhe në skemat sociale apo lehtësira të tjera sociale.

7.5 Pensionet

Lidhur me shkeljen e dinjitetit dhe të drejtës së pensionistëve për daljen në pension, Avokati i Popullit në raportin vjetor për vitin 2016 ka raportuar për përfundimin e hetimit në rastin ex officio dhe ka dal me rekomandime.¹⁴⁴

Qëllimi i këtij raporti ka qenë që të tërheqë vëmendjen Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) për domosdoshmërinë e mbrojtjes së dinjitetit njerëzor të pensionistëve si rezultat i procedurës së raportimit çdo gjashtë muaj, që rrjedh nga Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti (Ligji Nr. 04 / L-131) dhe Udhëzimit Administrativ (MPMS Nr. 05/2015). Megjithatë, rekomandimet e Avokatit të Popullit kanë mbetur të paimplementuara.

Pamundësia për të përmbushur kriterin 15 vjeçar për realizimin e pensionit kontribut - pagues

Nuk ka ndonjë zhvillim pozitiv lidhur me pensionet kontribut-paguese për qytetarët të cilët nuk kanë arritur ta përmbushin njërin nga kriteret për njohje të pensionit kontribut-pagues, përkatësisht stazhin pensional kontribut-pagues, që është minimum 15 vjet.

Federata Sindikale e Administratës Publike në Kosovë (SPAK) ka vazhduar të paraqesë ankesa në IAP lidhur me këtë çështje.

Avokati i Popullit vazhdon të jetë i mendimit se çështja e kësaj kategorie duhet të trajtohet nga Qeveria e Kosovës dhe për këtë kërkohet dialog në mes të palëve për të arritur zgjidhje të pranueshme në favor të këtyre qytetarëve. Kjo për faktin se këta qytetarë janë dëbuar nga puna në baza diskriminuese dhe pa vullnetin e tyre dhe se me mos trajtimin e këtij problemi këta qytetarë vazhdojnë të jenë të diskriminuar. Sidoqoftë, Avokati i Popullit është në përfundim të një hulumtimi dhe analize për këtë çështje dhe së shpejti pritet të publikojë qëndrimet dhe rekomandimet e tij për Qeverinë.

Rasti Grudic

Avokati i Popullit, më 15 shkurt 2016, kishte publikuar Opinionin drejtuar Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, nëpërmes Shoqatës së Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, për mos ekzekutimin e aktgjykimit të GJEDNJ-së për rastin Grudic kundër Serbisë, numër 31925/08 (2012). Opinioni, shprehë shqetësimin për mos përmbushjen e obligimeve të Republikës së Serbisë ndaj pensionistëve të Kosovës, sipas aktgjykimit të GJEDNJ-së, në vitin 2012, për rastin Grudic kundër Serbisë. Aktgjykimi i GJEDNJ-së në rastin Grudic kundër Serbisë është aktgjykim parimor, me të cilin Serbia ishte obliguar t'i kompensojë në mënyrë të njëjtë, sipas aktgjykimit të lartpërmendur, pensionet kontributpaguese, pensionet invalidore të punës dhe pensionet familjare, për qytetarët e Kosovës, të cilët i kanë gëzuar këto pensione deri në vitin 1999, kur edhe janë ndërprerë nga Serbia në mënyrë arbitrare.

¹⁴⁴ Raporti me rekomandime Ex officio nr. 382/2016 od 25.11.2017, drejtuar Ministrisë së punës dhe mirëqenies sociale.

Gjatë vitit 2017, Avokati i Popullit ka përcjellë zhvillimet në Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës. Raporti vjetor i vitit 2016 i Këshillit të Ministrave, i publikuar në muajin mars të vitit 2017, evidenton në mënyrë të qartë dërgimin e Opinionit si një zhvillim të ri, i cili sipas Këshillit të Ministrave në mënyrë të veçantë ka theksuar nevojën e rivlerësimit të aplikacioneve të qytetarëve të Kosovës për rifillimin e pagesës së pensioneve.¹⁴⁵

Përveç kësaj, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, nëpërmes Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë, i cili pastaj nëpërmes Ministrisë së Punëve të Jashtme, Misionit të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Evropës, kishte kontaktuar Departamentin e Ekzekutimit e Vendimeve të GJEDNJ-së duke kërkuar informacion lidhur me procesin e ekzekutimit të vendimit në çështjen Grudic kundër Serbisë. Përgjigja dhe qëndrimi i Sekretariatit për këto çështje, në mes tjerash, njofton se Sekretariati ka vendosur të presë vendimin e GJEDNJ-së në rastin *Skënderi k. Serbisë*, ku pritej që GJEDNJ të shprehet edhe për disa ankues të tjerë, në mesin e tyre edhe një ankues që jeton në Kosovë dhe që kjo do të merret si referencë nga Komiteti i Ministrave, i cili do të mbikëqyrë ekzekutimin e këtij vendimi nga Serbia. Rrjedhimisht, në varësi të vendimit të GJEDNJ-së, do të varet edhe trajtimi i kërkesave për rinisje të pensioneve nga shtetasit e Republikës së Kosovës. Më 27 korrik 2017, GJEDNJ ka publikuar vendimin në rastin *Skënderi k. Serbisë*¹⁴⁶ duke shpallur kërkesat të papranueshme për shkak të mos shterimit të mjeteve juridike brenda Serbisë, përkatësisht, mos dërgimit të rastit tek Gjykata Kushtetuese e Serbisë. Prandaj, qëndrimi i GJEDNJ-se mbi substancën e argumentit kryesor të Opinionit të Avokatit të Popullit mbetet pikëpyetje, edhe pas vendimit në rastin *Skënderi*. Në paragrafin 79 të këtij vendimi, përmendet se Gjykata Kushtetuese e Serbisë ka nxjerre tri vendime, të cilat konstatojnë se është përgjegjësia e vetë Fondit Pensional të Republikës së Serbisë dhe jo e aplikuesit, për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e aplikimit. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse në Opinionin e Avokatit të Popullit është theksuar që Serbia ka refuzuar një shumicë të madhe të aplikimeve të qytetarëve të Kosovës për shkak të mungesës së dokumentacionit.

Fatkeqësisht, Këshilli i Ministrave, më 7 dhjetor 2017, ka mbyllur rastin Grudic, sepse është shprehur i kënaqur që autoritetet e Serbisë kanë marrë hapat e duhur për ekzekutimin e këtij vendimi. Mbyllja e rastit është bërë në bazë të një Raporti të nxjerrë nga vetë Serbia.¹⁴⁷ Ky Raport nuk i kthen përgjigje drejtpërdrejt Opinionit të Avokatit të Popullit. Mirëpo, Raporti pretendon, , që GJEDNJ, duke refuzuar ankesën e parashtruesit të dytë në rastin *Skënderi*, ka miratuar mospagimin e pensioneve për qytetarët e

¹⁴⁵<https://rm.coe.int/prems-021117-gbr-2001-10e-rapport-annuel-2016-web-16x24/168072800bhttps://rm.coe.int/prems-021117-gbr-2001-10e-rapport-annuel-2016-web-16x24/168072800b> (shih faqe 249)

¹⁴⁶http://www.zastupnik.gov.rs/uploads/cr/odluke/komentari/odluke-u-predmetu-skenderi-i-4-drugih-protiv-srbije-od-27.-jula-2017.-godine/SKENDERI_o_15090_08_eng.pdf

¹⁴⁷Shih https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=090000168076d502 dhe https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=0900001680758af2

Kosovës.¹⁴⁸ Ky qëndrim është krejt i gabuar, sepse vendimi i GJEDNJ-së në rastin *Skënderi* nuk e ka prekur substancën e këtij debati.

Në aspektin juridik praktika që duhet ndjekur nga rasti *Skënderi* është që pretendimet e qytetarëve të Kosovës fillimisht duhet të shqyrtohen nga Fondi Pensional i Serbisë, pastaj nga gjykatat e Serbisë, deri në Gjykatën Kushtetuese të Serbisë dhe në rast të përgjigjes negative nga Gjykata Kushtetuese e Serbisë, atëherë rastet mund të dërgohen në GJEDNJ.

Avokati i Popullit vlerëson se autoritetet shtetërore të Republikës së Kosovës kanë dështuar në mbështetjen e pensionistëve të Kosovës, e cila ka mundur të bëhet nëpërmes dërgimit të opinioneve dhe shkresave, sikur që ka vepruar Avokati i Popullit që nga viti 2004, gjë që përmendet edhe në vet Vendimin e GJEDNJ-së në rastin Grudic kundër Serbisë, por edhe sikur që ka vepruar Republika e Serbisë gjatë gjithë kohës. Autoritet e Kosovës kanë dështuar të llobojnë për të qenë së paku pjesëmarrës në mbledhjet e Komitetit të Ministrave, si vëzhgues, duke marrë parasysht se Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës është organ politik ku vendimet jo rrallë herë janë politike, sikur ky në rastin e zbatimit të vendimit Grudic kundër Serbisë.

7.6 Strehimi social

E drejta në banim është një çështje mjaft e rëndësishme për stabilitetin social, shëndetin dhe zhvillimin kualitativ të mirëqenies sociale. Në shumicën e vendeve të zhvilluara banimi është e drejtë sociale e qytetarëve. E drejta e banimit ka efekte të gjëra, si sociale, kulturore, financiare, etj. Andaj projektet e banimit social janë mjaft të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve të pastrehë.

Legjislacion në Kosovë është një tregues i qartë për obligimin e institucioneve qeverisëse për të realizuar të drejtën për banim adekuat. Duke filluar nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, standardet ndërkombëtare që janë të zbatueshme në Kosovë, komunat dhe MMPH janë institucionet kryesore për zhvillimin dhe implementimin e programeve të veçanta të banimit.

Qeveria e Kosovës kishte marrë vendim të ndryshojë politikat e banimit sepse kishte vlerësuar se ligji në fuqi për banim nuk ofron zgjidhje adekuate për këtë problem. Po ashtu mungesa e buxhetit, mungesa e strukturës së mirëfilltë administrative kanë ndikuar që të ketë rezultate të kufizuara.

Strehimi social edhe më tej vazhdon të mbetet sfida për organet e vetëqeverisjes lokale sikur dhe për qytetarët në nevojë. Kërkesat për strehim social vazhdojnë të janë të mëdha, ndërsa mundësitë për të ofruar strehime sociale janë të vogla. Gjatë kësaj periudhe raportuese, IAP ka pranuar disa raste që kanë të bëjnë me këtë çështje.

¹⁴⁸ Shih Raportin, par. 17 ("The authorities . . . assume from the Court's case-law developed in *Skenderi* and *Others* that these rejections are in compliance with the Convention requirements and the Court's indications").

Komuna e Prishtinës në vitin 2017 ka ndarë 50 banesa sociale. Sipas të dhënave 331 familje që kishin aplikuar për strehim social 287 i kanë plotësuar kriteret për këtë banim, por përveç 50 përfituesve të strehës sociale familjet tjera kanë mbetur pa strehim.

Përparim në këtë drejtim vërehet edhe tek komuna e Graçanicës, e cila është në përfundim të realizimit të projektit për banim social të rreth 16 banesave të tilla.

Duke pasur parasysh analizimin e situatës për gjendjen e banimit social të paraqitur nga vet Qeveria, ndryshimi i politikave për banim social duhet të merret me shumë seriozitet dhe të punohet në drejtim të realizimit të kësaj të drejte për qytetarët e Republikës së Kosovës.

7.7 Komunitetet pakicë

Komunitetet pakicë sigurisht që në masë të konsiderueshme ngjyrosin imazhin e një shoqërie, pa marrë parasysh sa janë të vogla për nga numri, sepse edhe komuniteti më i vogël në një shoqëri ndryshon karakterin e kësaj shoqërie dhe i kushtëzon normat dhe rregullat e caktuara në vetë shoqërinë. Shoqëritë të cilat komunitetet pakicë i konsiderojnë si domosdoshmëri shprehin qartë mosgatishmërinë e tyre që të ndryshojnë karakterin e tyre, si dhe çështjen se sinqeriteti dhe toleranca nuk janë vlera në shoqëri të tillë. Shoqëritë në të cilat toleranca nuk është vlerë, por dobësi, është shoqëri e cila në dallime sheh rrezikun dhe dënon dallimet. Është shumë e rëndësishme të kuptojmë që, kur bëhet fjalë për dallimet dhe qëndrimin e shoqërisë, por edhe shtetit, që prej atij qëndrimi të shumicës ndaj pakicave varet se çfarë shoqërie ndërtojmë dhe çfarë shteti krijojmë. Duhet kuptuar se dallimet, gjegjësisht diversiteti në pikëpamje teknike, është pasuri. Diversiteti na ndihmon që të kuptojmë që të gjithë së bashku, sikurse komunitetet shumicë ashtu edhe ato pakicë, mund të bëhemi shumicë e cila në dallime do t'i shohi vlerat të cilat, sipas diversitetit, do të zhvillojnë qëndrim pozitiv.

Edhe pse në disa vitet e fundit, në Kosovë është krijuar një kornizë e kënaqshme ligjore për mbrojtjen e drejtave të komuniteteve pakicë, ende ekzistojnë vështirësi në realizimin jo vetëm të drejtave të caktuara të cilat i janë garantuar komuniteteve pakicë, por edhe kryesisht në zbatimin jo-konsistent të ligjeve të caktuara dhe akteve nënligjore nga ana e institucioneve shtetërore apo zyrtarëve të tyre.

Avokati i Popullit ende mbetet konsistent në paraqitjen e tij ndaj autoriteteve shtetërore për problemet serioze me të cilat janë ballafaquar në periudhën e kaluar komunitetet pakicë me shpresën se këto probleme do të trajtohen në mënyrë ekspeditive dhe me kujdesin më të lartë të nga ana e institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës.

Në përgjithësi, gjetjet pozitive janë se, sikurse edhe në periudhën e mëhershme raportuese, është përmirësuar liria e lëvizjes, është përmirësuar besimi në Policinë e Kosovës në vendet e të rikthyerve, qasja në drejtësi, media, ka më shumë aktivitete në promovimin e drejtave të komuniteteve pakicë nga ana e Komitetit Këshillimorë për komunitete, kurse janë zvogëluar incidentet ndëretnike.

Në përmbajtje mund të keni një pasqyrë në problemet më të shpeshta të cilat i paraqesin komunitetet pakicë, të cilat në tekstin në vijim do të përpunohen individualisht.

Komuniteti serb shqetësimin e vet e shprehë kur bëhet fjalë për zgjidhjen e çështjes së personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës, problem të madh vazhdon të paraqesë uzurpimi i pasurisë, shkatërrimi i pasurisë dhe pamundësia e disponimit me pasurinë, rregullimi i drejtave në nënshtetësi, në infrastrukturë arsimore, si dhe kohëzgjatjen e procedurave pranë gjykatave, dhe posaçërisht kur bëhet fjalë për lëndët të cilat kanë të bëjnë me uzurpimin e pasurisë në të gjitha instancat gjyqësore, si dhe në veprimet e prokurorisë mbi çështjet e njëjta.

Komuniteti i Malazezëve ende shprehë mospajtimin dhe shqetësimin për mosnjohjen e këtij komuniteti në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sikurse është konstatuar edhe në periudhën paraprake raportuese.¹⁴⁹ Përveç kësaj, ky komunitet thekson edhe problemin i cili ka të bëjë me kthimin e të zhvendosurve, uzurpimin e pasurisë dhe rregullimin e dokumentacionit personal.

Kur bëhet fjalë për *Komunitetin shqiptarë në veri të Kosovës*, ekzistojnë zhvillime pozitive në lidhje me periudhën paraprake raportuese. Për shkak të zhvillimeve inkurajuese të cilët kanë të bëjnë me integrimin në veri të vendit në sistemin shtetërorë të Kosovës, është përmirësuar përfshirja dhe përfaqësimi më i madh i përfaqësuesve të komunitetit shqiptarë në nivel komunal në veri të Kosovës, si dhe pjesëmarrja e tyre politike. Edhe pse ekzistojnë shembuj pozitiv, ende duhet të punohet në përmirësimin e qasjes në sistemin shëndetësorë, marrjen e informatave në gjuhën shqipe, qasjen më të mirë në shërbimet publike, etj., të cilat ende nuk janë në nivel të kënaqshëm.

Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë ende komunitetet më të rrezikuara dhe më të marginalizuara në Kosovë. Problemet shumë të rënda ekzistenciale dhe varfëria ndikojnë në atë që fëmijët në vend që të dërgohen në shkollë, ata dërgohen të grumbullojnë lëndë sekondare, që të kërkojnë lëmoshë apo në ndonjë mënyrë tjetër të kontribuojnë në përmirësimin e ekzistencës themelore jetësore të familjeve të tyre. Qasja në kujdesin shëndetësorë primarë dhe sekondarë nuk paraqet problem, sa paraqet mungesa e parave për blerjen e medikamenteve dhe trajtim adekuat, dhe përveç kësaj, është shumë e ulët përqindja e vaksinimit të fëmijëve në mesin e pjesëtarëve të këtyre tri komuniteteve. Diskriminimi, regjistri civil, dokumentacioni personal, objektet joadekuate banesore, numri i vogël i fëmijëve që vijojnë shkollën, paraqesin vetëm një gamë të problemeve me të cilat pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian ballafaqohen çdo ditë.

Komuniteti i boshnjakëve shprehë shqetësimin e vetë në zbatimin jo konsistent të ligjit mbi përdorimin e gjuhëve, në përkthimin e dobët dhe cilësinë e teksteve shkollore për arsimin fillorë dhe të mesëm, papunësinë, si dhe mundësinë e pjesëtarëve të komunitetit boshnjak që arsimin universitarë ta vazhdojnë në universitetin shtetërorë të Prishtinës, jo

¹⁴⁹Raporti ditor IAP për vitin 2016, pjesa 2.3. Komunitetet e pakicave

vetëm për ndjekjen e ligjëratave në gjuhën shqipe, por edhe për shkak të dhënies së provimit pranues në Universitetin shtetërorë në Prishtinë vetëm në gjuhën shqipe.

Komuniteti turk, sikurse edhe komuniteti boshnjak, më së shumti theksojnë problemin e përdorimit të gjuhës turke, përkthim dhe cilësi të dobët të teksteve në shkollat shtetërore.

Komuniteti goran shqetësimin e vetë e thekson në qasjen në institucionet arsimore dhe infrastrukturë, pranimin e nënshtetësisë për personat të cilat kanë vendbanimin jashtë Kosovës, vjedhjet e shpeshta të bagëtive, përdorimin e gjuhës, papunësinë, përfaqësim joadekuat në organet e vetëqeverisjes lokale dhe në Kuvendin Komunal të Dragashit.

7.8 Kthimi dhe siguria

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me mandatin e tij, edhe në këtë periudhë raportuese ka përcjellë dinamikën e kthimit dhe situatën e cila ka të bëjë me kthimin dhe sigurinë e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë. Nga numri i përgjithshëm i personave të zhvendosur dhe refugjatëve të cilët Kosovën e kanë lëshuar në mesin e vitit 1999 dhe në mars të vitit 2004, numri më i madh është i pjesëtarëve të komunitetit të serbëve të Kosovës, pastaj romëve, boshnjakëve, malazezëve dhe komuniteteve tjera pakicë në mesin e të cilëve është edhe një numër i komunitetit të shqiptarëve nga veriu i Kosovës.

Në bazë të të dhënave të Komisionit të Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara (UNHCR), në Kosovë, për 17 vitet fundit janë kthyer gjithsej 27.714 persona (që është rreth 12% nga numri i përgjithshëm i personave të zhvendosur në vendet e regjionit të regjistruar nga ana e UNHCR), dhe nga ky numër rrjedh se 26.478 pjesëtarë të komuniteteve pakicë janë kthyer pas stabilizimit të situatës në Kosovë.¹⁵⁰ Gjatë vitit 2017 janë kthyer 417 persona, që është pak më i lartë sesa vitin 2016 kur janë kthyer 356 persona.¹⁵¹ Përkundër apelit të Komisionarit të lartë për të drejtat e njeriut të Këshillit të Evropës, i cili në fillim të vitit 2017 ka vizituar Kosovën, që në afat sa më të shkurtër të mbyllën qendrat kolektive dhe të gjendet zgjidhje afatgjatë për përdoruesit e këtyre qendrave, kjo nuk ka ndodhur. Gjegjësisht, vetëm qendra kolektive në komunën e Obiliqit është mbyllur dhe është zgjidhur çështja e banimit për 4 personat e mbetur nga kjo qendër. Sipas të dhënave të IAP-së të grumbulluara në terren dhe raportit të UNHCR-së, në qendrat kolektive anembanë Kosovës (Mitrovicë edhe pjesa veriore edhe jugore, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Shtërpçë dhe Graçanicë) janë vendosur 464 persona.¹⁵² Edhe më tej parashtrohet pyetja, përse autoritetet lokale së bashku me Ministrinë për komunitete dhe kthim (MKK) deri më tani nuk kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme për këta persona dhe të mbyllin qendrat kolektive në komunat e theksuara. Edhe më tej numri më i madh i personave gjendet në qendrat kolektive në komunën e Shtërpçës (247

¹⁵⁰Sipas të dhënave statistikore të UNHCR-së nga dhjetori i vitit 2017 theksohet se nga viti 2000 deri në fund të nëntorit të vitit 2017 janë kthyer: 11.806 serbë, 7.427 ashkali dhe egjiptian, 1865 boshnjakë, 3 kroat, 1.459 goranë, 17 malazez, 3.882 romë dhe 19 turq.

¹⁵¹Sipas të dhënave statistikore të UNHCR-së, nga janari deri në fund të nëntorit të vitit 2017 janë kthyer 142 serbë, 105 ashkali /egjiptianë, 2 boshnjakë, 1 goranë, 161 romë dhe 6 turq.

¹⁵²Personat e zhvendosur në qendrat kolektive në Kosovë: Mitrovicë e veriut 23, Mitrovicë e jugut 13, Leposaviq 90, Zubin Potok 39, Zveçan 31, Shtërpçë 247 dhe Graçanicë 21.

persona), të cilët për më shumë se 18 vite presin në zgjidhjen e qëndrueshme të situatës së tyre. Në lidhje me këtë, IAP në fund të dhjetorit të vitit 2017 ka marrë informata pozitive nga MKK, dhe se kjo Ministri ka filluar me ndërtimin ndërtesave banesore në bashkëpunim me Këshillin Danez për Refugjatë (DRC) për personat e vendosur në qendrat kolektive në komunën e Shtërpçës, si dhe që vendosja e tyre pritet në pjesën e parë të vitit 2018. Si pozitive mundet të vlerësohet edhe nxjerrja e Rregullores së Qeverisë së Kosovës e cila ka të bëjë me kthimin dhe personat e zhvendosur,¹⁵³ e cila personave të zhvendosur do t'i lehtësojë qasjen në institucionet me qëllim të zvogëlimit të burokracisë dhe realizimit më të lehtë të drejtave të tyre. Rregullorja përcakton përgjegjësinë e autoriteteve kompetente dhe vendimet, procedurat dhe kriteret për ofrimin e ndihmës për personat e zhvendosur dhe të kthyer.

Kur bëhet fjalë për sigurinë e komuniteteve pakicë, numri i përgjithshëm i incidenteve zvogëlohet gradualisht nga viti në vit. Numri më i madh i incidenteve vazhdon të ndodhë në pjesën perëndimore të Kosovës, në vendet e të kthyerve në komunat Pejë, Klinë, Istog dhe Deçan. Nga janari deri në fund të nëntorit të vitit 2017 janë shënuar 61 incidente në të cilat palë të dëmtuara ishin të kthyerit dhe pasuria e tyre. Një prej sulmeve më serioze ishte edhe sulmi me pajisje shpërthyes në shtëpinë e të kthyerit i cili atë ditë kishte marrë çelësat e shtëpisë së tij në fshatin Dragoljevc, komuna e Istogut.¹⁵⁴ Ky incident është gjykuar publikisht nga presidenti i Kosovës dhe Ministri për komunitete dhe kthim. Kur flitet për llojet e incidenteve, ka pasur shprehje të urrejtjes me grafitë, ri-uzurpim të pasurisë, vjedhje të bagëtive, si dhe vjedhje në objektet e Kishës Ortodokse Serbe (KOS).¹⁵⁵

Të gjitha incidentet të cilat prekin pjesëtarët e komuniteteve pakicë, të cilat më së shpeshti kanë ndodhur ndaj pjesëtarëve të komunitetit serb njësoj ndikojnë në personat e zhvendosur dhe vendimet e tyre që të kthehen apo jo. Është pozitive që gjykime dhe reagime publike ekzistojnë, por ende nevojitet pjesëmarrje aktive e të gjitha palëve në punën e mëtejme në krijimin e klimës pozitive për kthim dhe pajtim të qëndrueshëm ndërmjet komuniteteve. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit mirëpret iniciativën e presidentit të Kosovës për formimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin. Pas disa muajsh konsultimesh, më 13 dhjetor të vitit 2017, është themeluar Ekipi përgatitor si organ teknik i cili do të ketë rol që të përgatisë gjithçka që është e nevojshme për themelimin dhe punën e këtij komisioni. Ekipi përgatitorë i Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin do të përbëhet prej 9 anëtarëve – dy prej Zyrës së presidentit të Kosovës, nga një përfaqësues prej Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës dhe 5 anëtarë nga shoqëria civile. Këshilltar i ekipit të përmendur përgatitorë është përzgjedhur Avokati i parë i popullit në Kosovë z. Marek Antoni Novicki.

¹⁵³Rregullorja është miratuar në seancën e Qeverisë së Republikës së Kosovës më 4. janar të vitit 2018.

¹⁵⁴Burimi MKK, kurse informacioni është konfirmuar edhe nga ana e OSCE-së në takimin e mbajtur midis përfaqësuesve të OSCE-së dhe IAP në Graçanicë më 19. dhjetor të vitit 2017.

¹⁵⁵Ibid

Sikurse edhe në çdo raport vjetorë, edhe në këtë raport, IAP i është referuar punës dhe aktiviteteve të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK). IAP vëren se MKK gjatë vitit 2017, i ka ndihmuar të kthyerve dhe ka ndërtuar 24 shtëpi për të kthyerit dhe ka siguruar ndihmë për 62 familje.¹⁵⁶ Gjithashtu, i është ofruar ndihmë sociale familjeve të rrezikuara nga radhët e komuniteteve pakicë, si dhe ndihmë me qëllim të riintegritit dhe stabilizimit të komuniteteve anembanë Kosovës. Edhe pse është bërë mjaft nga ana e MKK-së gjatë vitit 2017, të kthyerit të cilët janë kthyer me vetë iniciativë në fshatin Lubizhdë, komuna e Istogut, ende presin në ndërtimin dhe rinovimin e shtëpive të tyre. Ministri i MKK-së disa herë ka deklaruar publikisht se shtëpitë do të ndërtohen deri në fund të vitit 2017, por deri në fund të periudhës raportuese kjo nuk ka ndodhur.¹⁵⁷

Avokati i Popullit është i mendimit se, duke marrë parasysh mandatin e MKK-së, ende mundet të avancohet puna e tyre në pikëpamje të zhvillimit të një plani dhe programi të qëndrueshmërisë së kthimit dhe krijimit të pavarësisë ekonomike të të kthyerve nga sistemi shtetërorë i ndihmave pas një periudhe të caktuar të fuqizimit të tyre ekonomik. Në këtë drejtim, MKK mund të paraqesë edhe miratimin e vazhdimin të projektit “Kthimi dhe riintegrimi i personave të zhvendosur”. IAP vlerëson edhe pranimin e rekomandimit të AP, nga raporti i vitit të kaluar, për nxjerrjen e Ligjit për personat e zhvendosur dhe refugjatët, i cili do të duhej të miratohet deri në fund të vitit 2018.

Tema të cilës duhet kushtuar vëmendje të posaçme është Iniciativa ndërinstitucionale për persona të zhvendosur nga Kosova, e njohur si “Iniciativa e Shkupit”.¹⁵⁸ Meqenëse është filluar me bashkëpunim më të mirë ndërinstitucional midis të gjitha vendeve në regjion në të cilat qëndrojnë personat e zhvendosur nga Kosova, MKK ka formuar grupet punuese për zbatimin e planeve dhe masave të planifikuara, të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me: të drejtat pronësore, dokumentet personale, sigurinë, dialogun dhe integritimin.¹⁵⁹ Megjithatë, informatat të cilat kanë të bëjnë me dokumentet përfundimtare të “Iniciativës së Shkupit” ende mungojnë në ueb faqen zyrtare të MKK-së, kurse përveç në rubrikën e lajmeve, informata tjera nuk ekzistojnë. Gjithashtu, nuk ekzistojnë konkluzione konkrete mbi iniciativën e përmendur, gjë që duhet të përmirësohet në të ardhmen, të gjitha këto me qëllim të informimit më të mirë të personave të zhvendosur

¹⁵⁶ Informata të marra nga sekretari i përhershëm i MKK-së përmes e-mailit, të datës 22.12.2017.

¹⁵⁷ Në fund të marsit të vitit 2017, 13 familje të zhvendosura të serbëve të Kosovës me vetiniciativë janë kthyer në fshatin Lubizhdë, komuna e Istog. Deri sa t’i ndërtohen shtëpitë, ata janë të gjithë së bashku të vendosur në një objekt.

¹⁵⁸ Gjatë vitit 2014, misionet e OSBE-së në Kosovë dhe UNHCR-së kanë filluar procesin regional të dedikuar gjetjes së zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova. Iniciativa përfshinë: të drejtën në kthim në vendin e prejardhjes, si dhe të drejtën në integritim në vendin e zhvendosjes. Qëllimi i procesit është që institucionet relevante të Kosovës, Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi të takohen rregullisht me qëllim të gjetjes dhe zbatimit të zgjidhjeve për personat e zhvendosur nga Kosova. Gjatë vitit 2015 dhe 2016 është vendosur një kornizë veprimi ku si masa dhe fusha me prioritet janë përcaktuar: të drejtat pronësore, dokumentacioni personal, siguria, dialogu dhe riintegrimi dhe zgjidhjet e planifikuara.

¹⁵⁹ Formimi i grupeve punuese dhe funksionaliteti i tyre, si dhe aktivitetet më të mëdha në vetë “Iniciativën e Shkupit” nga ana e institucioneve në Kosovë është vërtetuar edhe në takimin e IA-së me OSCE-në, i cili është mbajtur në Graçanicë më 19.12.2017.

dhe vetë publikut në Kosovë, që në mënyrë sa më të mirë dhe transparente të ndiqet i tërë procesi.

Sa i përket komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas lidhur me gjendjen e sigurisë tek këto komunitete IAP nuk ka pranuar ndonjë ankesë as të natyrës individuale, as kolektive (ankesa në lagjet e banuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian). IAP ka zhvilluar kontakte të rregullta me zyrtarët e Policisë së Kosovës dhe IAP vlerëson se përkushtimi i Policisë së Kosovës në këtë aspekt duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen.

7.9 Shtetësia dhe regjistri civil

Njohja juridike e çdo personi është e drejtë themelore njerëzore. Regjistrimi i qytetarëve është proces në të cilin personi identifikohet dhe pranohet si pjesë përbërëse e shoqërisë në të cilën jeton. Personat e paregjistruar nuk mund të marrin dokumente zyrtare dhe në këtë mënyrë janë të kufizuar që të realizojnë të drejtat e tyre. Pjesëtarët komuniteteve pakicë në Kosovë ende hasin në vështirësi me rastin e regjistrimit, dhe për këtë arsye në shumicën e rasteve mbesin pa dokumentacion personal, kurse gjithashtu problem të posaçëm paraqet edhe praktika e paligjshme e kushtëzimit të lëshimit të dokumenteve personale duke paguar tatimin në pronë, i cili zbatohet në shumicën e komunave.

IAP në raportin e mëhershëm raportues ka raportuar për ankesat të cilat i ka pranuar nga ana e komuniteteve pakicë në lidhje me çështjen e statusit të tyre civil dhe marrjen e dokumenteve personale. Në këtë periudhë raportuese, IAP ka pranuar një numër të madh të ankesave të cilat kanë të bëjnë me çështjen e shtetësisë dhe regjistrin civil, kurse numri më i madh i ankesave është pranuar në Prishtinë, në zyrën regjionale të IAP-së në pjesën veriore të Mitrovicës dhe zyrën regjionale në Graçanicë.¹⁶⁰ Edhe pse shtetësia e Republikës së Kosovës është rregulluar me Ligjin mbi shtetësinë,¹⁶¹ si dhe Udhëzimin Administrativ të MPB-së të Kosovës mbi kriteret të cilët përmbajnë argumente të ish RSFJ-së më datë 01.01.1998. UA nr. 05/2014, i cili ishte në fuqi deri në mes të korrikut të vitit 2017 kur është miratuar UA i ri, nr.07/2017 MPB.¹⁶² Udhëzimi i ri Administrativ i MPB-së kishte për qëllim të lehtësojë regjistrin civil dhe regjistrin në librat e shtetasve të kategorive të caktuara në të cilat bëjnë pjesë para së gjithash personat e zhvendosur,

¹⁶⁰ Numri i lëndëve të regjistruara në lidhje me njohjen e shtetësisë dhe regjistrimin në regjistrin e qytetarëve të R. Kosovës pran IAP është 25, kurse numri i qytetarëve të përfshirë në këto lëndë është 65 persona, nga të cilët edhe një ankesë grupore e cila përfshinë 39 persona pjesëtarë të komunitetit rom, ashkali, dhe egjiptian.

¹⁶¹ Ligji për shtetësinë e Kosovës nr.04/L-215 (neni 32, paragrafi 1,3 dhe 4).

¹⁶² UA nr.05/2017 mbi kriteret të cilët përmbajnë dëshmi për shtetësinë e ish RSFJ-së më datë 01.01.1998. posaçërisht nenet 3, 4, 5 dhe 6, si dhe aneksi i UA-së në të cilin gjendet lista e dokumenteve dhe udhëzimi. Përveç kushteve për pranimin e shtetësisë së personave të cilat kanë qëndruar në Kosovë deri më 01.01.1998, të cilët ishin përshkruar në UA 05/2014 e kaluar, me UA-në e re është lehtësuar pranimi i shtetësisë dhe vetë procedurës, sepse tani zyrat e regjistrin civil janë të autorizuar të vendosin për regjistrimin në librin e shtetasve për qytetarët të cilët paraqiten me kërkesë dhe që përmbushin kushtet e përshkruara. Gjithashtu, një prej risive pozitive është se regjistri në librin e shtetasve është mundësuar edhe në bazë të deklaratës së noterizuar të dy dëshmitarëve, gjë që do të lehtësojë shumë regjistrin posaçërisht personave të zhvendosur dhe refugjatëve, si dhe pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian për arsye se një numër i tyre i madh nuk ka rregulluar statusin e tyre civil, as statusin e fëmijëve të tyre, që një numër të madh të pjesëtarëve të theksuar e klasifikon në kategorinë e personave ligjërisht të padukshëm.

qytetarët në veri të Kosovës dhe komunitetet e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve. Megjithatë, për shkak të mospërputhjes së aplikimit dhe interpretimit individual të vetë UA-së, në zyrat e caktuar të statusit civil dhe regjistrimit, procedura ka komplikuar edhe më shumë situatën e cila edhe ashtu të komplikuar.

Nga ankesat të cilat IAP i ka regjistruar si të pranueshme prijnë ankesat në punën e zyrave për statusin civil dhe regjistrim në Mitrovicë jugore, Prizren, Ferizaj, Zubin Potok (në fshatin Çabër), Gjilan dhe Pejë. Të gjithë qytetarët të cilët kanë lindur në Kosovë para 01.01.1998 dhe të cilët atë ditë ishin shtetas të RSFJ/RFJ me vendbanim në Kosovë automatikisht konsiderohen shtetas të Kosovës. Të gjithë këta qytetarë, sipas Ligjit mbi nënshtetësinë e Kosovës dhe UA-së nr. 05/2017 e MPB-së së Kosovës nuk duhen të regjistrojnë lindjen apo të paraqesin kërkesë për pranim të shtetësisë si të huaj, por duhet të paraqesin kërkesë në zyrën për statusin civil në vendin e lindjes. Gjithashtu, procedura e njëjtë vlen edhe për të gjithë qytetarët të cilët nuk kanë lindur në Kosovë, por në Kosovë kanë pasur vendbanim para datës së lartpërmendur dhe të cilët mund të dëshmojnë vendbanimin e theksuar për së paku 5 vjet. Në ligjin për shtetësinë, si dhe gjithashtu në UA 05/2017 kjo është theksuar qartë. Megjithatë, zyrtarët e zyrave të gjendjes civile dhe regjistrimit në komunat e lartpërmendura nga ankuesit kanë kërkuar që së bashku me kërkesën të paraqesin gjithë dokumentacionin i cili theksohet edhe në Ligj edhe në UA, edhe pse në Ligj është përcaktuar që si dëshmi e lindjes në Kosovë të dorëzohet vetëm një dokument, kurse si dëshmi mbi vendbanimin gjithashtu një ose eventualisht dy dokumente me të cilat do të dëshmohet vendbanimi para datës 01.01.1998, në periudhë prej 5 viteve.

Përveç kësaj, zyrtarët e disa zyrave për gjendje civile dhe regjistrim, edhe pas hyrjes në fuqi të UA-së së re dhe caktimit të juridiksionit këtyre zyrave në lidhje me shqyrtimin e kërkesave për personat të cilat kanë jetuar në Kosovë para vitit 1999,¹⁶³ ankuesve i kanë refuzuar pranimin e kërkesave për pranimin e shtetësisë dhe i kanë udhëzuar që kërkesat t'i paraqesin në MPB, departamentit për shtetësi, azil dhe migrim në Prishtinë, sipas procedurës së rregullt për të huaj.¹⁶⁴ Gjithashtu, një numër i madh i ankesave ka të bëjë edhe me refuzimin e zyrtarëve të zyrave që të japin përgjigje me shkrim mbi refuzimin e pranimin të dokumentacionit me arsyetimin se nuk janë të obliguar që të japin arsyetim me shkrim për refuzim¹⁶⁵ gjë që është në kundërshtim edhe me Ligjin për procedurën administrative¹⁶⁶ edhe me UA 05/2017.

¹⁶³Ibid

¹⁶⁴IAP këtë rast e ka regjistruar në vitin 2016. A.nr.683/2016 M.P dhe M.P kundër zyrës për gjendje civile dhe regjistrim në komunën e Ferizajit, lënda ende nuk është zgjidhur.

¹⁶⁵UA nr.05/2017 mbi kriteret të cilët përmbajnë dëshmi mbi shtetësinë e ish RSFJ-së më datë 01.01.1998. posaçërisht neni 9, paragrafët 1,2 i 3

¹⁶⁶Ligji për procedurën administrative br.2005/02-L28

Situatë dhe problem i veçantë paraqitet tek regjistrimi i qytetarëve në regjistrin civil në katër komunat në veri (Mitrovica veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq)¹⁶⁷ prej të cilave IAP ka pranuar një numër të caktuar të ankesave lidhur me këtë temë.

Është shqetësues fakti që, pavarësisht interesimit shumë të madh të qytetarëve nga veriu i Kosovës për marrjen e dokumenteve personale të Republikës së Kosovës, numri i qytetarëve të cilët posedojnë të njëjtat është ende shumë i vogël. Sipas informatave të cilat IAP i ka grumbulluar në terren, arsyeja është mungesa e informatave si dhe komplikimi i vetë procedurës nga ana e zyrtarëve kompetent edhe pse procedurat e theksuara dhe procedura e tërësishme janë thjeshtuar me AU e lartpërmendur nr.05/2017. Sipas gjetjeve të IAP-së, konstatohet se konfuzioni dhe ndërlikimi më i madh i tërë situatës ndodhë shkaku i interpretimit të gabuar të UA-së së re, si dhe Aneks tabelës me UA-në në të cilën janë numëruar dokumentet të cilat munde të merren parasysh me rastin e argumentimit të vendbanimit në Kosovë para 01.01.1998. Përveç gjithë kësaj, qytetarët kanë njoftuar IAP-në se edhe me rastin e regjistrimit të fëmijëve në komunën e Mitrovicës veriore zyrtarët e caktuar nuk i pranojnë fletë-lëshimet e spitaleve të lindjes në Mitrovicën veriore, për arsye se ky spital punon në kuadër të sistemit të Republikës së Serbisë. Probleme të tilla nuk janë regjistruar në regjionet tjera ku jeton numër i madh i pjesëtarëve të komunitetit serb, sikurse është regjioni i Gjilanit, Graçanicës dhe Shtërpçës në të cilat gjithashtu funksionojnë spitalet dhe maternitetet të cilat punojnë në kuadër të sistemit të Republikës së Serbisë, mirëpo fëmijët janë regjistruar pa kurrfarë vështirësi me fletë-lëshime të këtyre materniteteve.

Avokati i Popullit vlerëson në mënyrë pozitive dhe afirmative rregullat ligjore dhe avancimin e të njëjtës me UA të ri tek rregullimi i statusit civil të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe të zhvendosur, për nga aspekti i lehtësimit të marrjes së dokumentacionit personal. Megjithatë, shqetëson fakti për lëshimet e disa zyrove kompetente dhe interpretimeve të ndryshme sikurse të vetë ligjit, ashtu edhe akteve nënligjore të cilët kanë të bëjnë me këtë fushë nga ana e zyrtarëve të këtyre zyrove. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit konsideron se është e nevojshme që Agjencia për regjistrin civil (ARC) së bashku me MPB-në të bëjë trajnime shtesë të zyrtarëve të zyrove të gjendjes civile dhe regjistrimin në të gjitha komunat, posaçërisht në Ferizaj, Prizren, Mitrovicë jugore, Gjilan, fshatin Çabër dhe Pejë, në mënyrë që vazhdimisht të zbatohen rregullat ligjore të cilat kanë të bëjnë me çështjen e shtetësisë dhe lëshimit të dokumenteve personale, personave të cilët deri më tani nuk e kanë rregulluar statusin e tyre civil në kuadër të sistemit të Republikës së Kosovës.

Sa i përket komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në këtë vit raportues është vërejtur progres për sa i përket regjistrimit civil në disa komuna të Kosovës. Avokati i Popullit ka pranuar një numër ankesash lidhur me regjistrimin civil të këtyre komuniteteve në

¹⁶⁷Në të vërtetë, të gjithë qytetarët e katër komunave në veri të cilët kanë lindur para majit të vitit 2012, kërkesat për ekstrakte nga regjistri i gjendjes civile munden t'i paraqesin në komunë në Mitrovicën jugore për Mitrovicë veriore, në fshatin Çabër për komunën Zubin Potok, në fshatin Lipa në Zveçan dhe në fshatin Bistrica për komunën e Leposaviqit.

Komunën e Graçanicës dhe Obiliqit. AP ka njoftuar ankuesit lidhur me procedurat ligjore të regjistrimit civil dhe është në kontakt me komunën si edhe me disa OJQ që merren me aktivitete në fushën e regjistrimit civil në mbështetjen e komuniteteve.

Të drejtat pronësore

Uzurpimi i paligjshëm i pronës private është ende shqetësues dhe kërkon reagim të vendosur nga ana e autoriteteve të cilat duhet të garantojnë mbrojtjen e plotë të drejtave pronësore si drejta themelore të njeriut të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Edhe më tutje është e nevojshme që Policia e Kosovës, prokuroria dhe gjykatat kompetente të zbatojnë Kodin penal të Kosovës (KPK) në mënyrë të vazhdueshme dhe pa përjashtime, që të avancojnë bashkëpunimin e tyre në zbatimin e vendimeve gjyqësore mbi dëbimin e uzurpatorëve, prokuroria duhet të kualifikojë dhe të parashtrijë akuzat e duhura kundër uzurpatorëve dhe është e nevojshme që në mënyrë të duhur të ndëshkohen kryesit e kësaj veprë penale dhe të kërkohet që pronarët të kompensohen nga ana e uzurpatorëve për tërë kohën në të cilën nuk kanë mundur të disponojnë lirshëm me pasurinë e tyre. Përveç kësaj, gjithashtu është e nevojshme që autoritetet kompetente gjyqësore, të cilat veprojnë sikur në lëndët penale ashtu edhe në kontestet të cilat kanë të bëjnë me uzurpimin e pasurisë, në kohën e duhur të fillojnë dhe përfundojnë me procedimin e lëndëve të tilla. Procedimi në kohë të duhur i lëndëve nga ana e organeve gjyqësore duhet të bëhet prioritet dhe praktikë pozitive, sepse deri më tani një numër i madh i lëndëve i cili ka të bëjë me uzurpimin e pasurisë zgjatë mesatarisht tri vite (edhe atë vetëm të fillohet me procedimin në procedurën e gjyqësore të shkallës së parë) kurse deri në plotfuqishmërinë e vendimeve dhe dëbimin e uzurpatorëve ose kompensimin, pronarët presin mesatarisht prej 6 deri 10 vite.¹⁶⁸

Posaçërisht shqetësuese është praktika se në lëndët penale të cilat kanë të bëjnë me uzurpimin dhe ri-uzurpimin e pasurisë së paluajtshme në asnjë rast nuk është paraparë paraburgimi për uzurpuesin, kurse gjoha më e lartë ishte gjoha prej 600 EURO.¹⁶⁹ Prokuroria rrallë herë kërkon nga gjykata që të dëbohen uzurpuesit, dhe në aktgjykim pala e dëmtuar (pronari i patundshmërisë) drejtohet vetëm në kontest në rast se dëshiron të mbrojë dhe realizojë të drejtën e vetë në disponim të lirë me pasurinë dhe posedimin e të njëjtës. Në këtë mënyrë nuk zgjidhet asgjë, por zgjidhja e problemit prolongohet edhe në disa vite sepse uzurpatori edhe përkundër gjykimit të dënimit penal ende përdorë pasurinë e paluajtshme si më parë. Policia rrallë herë reagon pas dënimit penal në rast se në aktgjykim nuk shkruan në mënyrë eksplicite se urdhërohet dëbimi i uzurpatorit, edhe pse pronari ka aktgjykimin në dobi të tij, si dhe tërë dokumentacionin me të cilin

¹⁶⁸Këto vlerësime janë marrë në bazë të lëndëve të cilat janë regjistruar në IAP, kurse kanë të bëjnë me gjetësinë e veprimit të Gjykatave themelore dhe Gjykatës së apelit në lëndët të cilat kanë të bëjnë me uzurpimin e pasurisë sikur në lëndët penale, ashtu edhe në konteste, si dhe në reagimin jo adekuat të policisë tek uzurpimi i përsëritur i pasurisë. Shembuj për këtë janë disa lëndë në IAP, sikurse janë: A. nr.262/14, A. nr.81/15, A. nr.450/15, A. nr.684/16, A. nr.609/17, A. nr.357/17, A. nr.357/17, A. nr.93/17, dhe shumë të tjera (numri i përgjithshëm i rasteve prenë IAP-së është je 50)

¹⁶⁹Kodi Penal i R. së Kosovës nr.04/L-082, neni 332

dëshmohej e drejta në pronë. Me këtë rast, Avokati i Popullit thekson se me vetë aktgjykimin pronari i pasurisë së paluajtshme nuk mund të realizojë të drejtën në pasurinë e paluajtshme, dhe se kjo do të jetë e mundur vetëm në atë moment kur në mënyrë të lirë mund të disponojë me pasurinë e vetë dhe të njëjtën ta kthejë dhe ta ketë në posedim, pa frikën se do të përsëritet situata e njëjtë sepse këtu janë Kushtetuta, Ligjet, organet e drejtësisë dhe policia të cilët garantojnë sundimin e ligjit dhe disponimin e lirë të pronës private.

Në raportin e mëparshëm vjetor është bërë fjalë edhe për rregullimin e grumbullimit të tatimit në pronën e paluajtshme personave pasuria e të cilëve është uzurpuar apo ka qenë e uzurpuar nga ana e personave të tretë, dhe është kthyer në posedim të pronarëve. Iniciativa e misionit të OSCE-së në Kosovë dhe përkrahja e tyre në zgjidhjen e kësaj çështje ka rezultuar që Qeveria e Kosovës më 4 maj 2017, ka miratuar draftin e Ligjit mbi plotësimin dhe ndryshimin e ligjit mbi tatimin në pronën e paluajtshme, i cili e rregullon këtë çështje, mirëpo për fat të keq i tërë procesi nuk është rrumbullakuar me votimin e këtij Ligji nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit mbi tatimin në pronën e paluajtshme, deri në raportimin e këtij raporti, nuk ka hyrë ende në procedurë të votimit në Kuvend dhe është e paqartë se kur do të vendoset në rend të ditës.¹⁷⁰

7.10 Arsimimi i komuniteteve

Sa i përket arsimimit të komuniteteve pakicë, ende është i pranishëm polarizimi në dy sisteme të arsimimit, në sistem i cili funksionon sipas planit dhe programit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe ai i cili funksionon sipas planit dhe programit arsimor të Ministrisë së arsimit, shkencës dhe zhvillimit teknologjik të Republikës së Serbisë. Prandaj, nuk është ndryshuar as situata në fushën e arsimimit në krahasim me raportin e mëparshëm vjetor të IAP-së.¹⁷¹ Shkollat shtetërore dhe universitetet nuk parashohin mësimdhënien në gjuhët e komuniteteve pakicë, përveç në regjionet e caktuara ku përfaqësohen komunitetet e boshnjakëve dhe turqve, edhe atë vetëm shkollat e profilit të lartë në Prizren dhe Pejë.

Edhe pse në vitin 2016, MASHT nxjerri Udhëzimin Administrativ 09/2016 mbi zbatimin e masave afirmative dhe numrin e mbrojtur të vendeve për regjistrimin e studentëve pjesëtarë të komuniteteve pakicë në institucionet publike të arsimit të lartë, ai aplikohet vetëm pjesërisht. Pjesëtarët e komuniteteve pakicë, të cilët studiojnë në universitetin shtetërorë në Prishtinë, vërejtje të posaçme kanë bërë në mosekzistimin e testeve për provimet përgatitore për regjistrimin në fakultete në gjuhët e pakicave edhe pse është paraparë me Udhëzimin Administrativ 09/2016 të lartpërmendur.¹⁷² Përveç kësaj, shpalljet

¹⁷⁰ IAP mori këtë informata në takimin me OSCE-në, i cili është mbajtur në zyrën regjionale në Graçanicë më datë 19.12.2017.

¹⁷¹ Raporti vjetor i IAP-së për viti 2016, pjesa 2.3. Komunitetet pakicë, 2.5 Arsimimi, faqe 69.

¹⁷² UA 09/2016 për zbatimin e masave afirmative dhe numrit të mbrojtur të vendeve për regjistrimin e studentëve të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në institucionet publike të arsimit të lartë, neni 3, paragrafi 2. dhe 3.

publike mbi vendet në konviktet studentore fillimisht nuk kanë përfshirë informatën se 12% e vendeve janë të rezervuara për studentët që i përkasin komuniteteve pakicë. Vlerësimi pozitiv, kur bëhet fjalë për arsimin, i referohet dhënies së akreditimit për arsimin universitar në gjuhën boshnjake dhe turke në Prizren, gjë që deri atëherë ishte problem për shkak të barazimit të kriterëve të akreditimit për Universitete/Fakultete në të cilat mësimi realizohet vetëm në gjuhën shqipe dhe në ato në të cilat mësimi realizohet në gjuhët e pakicave, gjë që nuk ka pasqyruar realitetin e barazimit të këtyre kushteve në lidhje me përqindjen e studentëve të regjistruar të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në regjionin e caktuar ku do të mundësohej studimi në gjuhët e pakicave, në rastin konkret në gjuhën boshnjake dhe turke.¹⁷³ Avokati i Popullit edhe me këtë rast do të shqyrtojë problemin i cili ekziston disa vite, që i referohet cilësisë së dobët të teksteve mësimore në gjuhën boshnjake dhe turke. Tekstet janë përkthyer dobët dhe nuk është bërë lektura e duhur në këto dy gjuhë, mungon një numër i madh i teksteve për klasat e larta (nga klasa e 9 e tutje) kështu që mësuesit janë të detyruar që tekstet t'i porosisin nga Bosnja dhe Hercegovina apo për lëndë të caktuara të përdorin tekstet të cilat janë përdorur para 20 e më shumë viteve.¹⁷⁴ Pjesëtarët e komunitetit turk vazhdojnë të paraqesin mungesën e teksteve. Tekstet në gjuhën turke për klasat e ulëta janë ende të dobëta, dhe për nga aspekti pedagogjik janë joadekuat. Për arsimin e mesëm të lartë ekziston deficit i teksteve të cilat sipas nevojës merren nga Turqia.

Pjesëtarët e komunitetit goran, të cilët kryesisht janë banojnë në komunën e Dragashit, shqetësimin e tyre ende e theksojnë se fëmijët nga radhët e këtij komuniteti ndjekin mësimin në kushte shumë të vështira dhe joadekuate. Një numër i fëmijëve nga komuniteti goran ndjek mësimin në gjuhë boshnjake sipas planit dhe programit të MASHT-it, kurse pjesa tjetër e ndjek mësimin në gjuhë serbe sipas planit dhe programit të Republikës së Serbisë. Në një numër të madh të fshatrave të komunës së Dragashit, mësimi zhvillohet në objektet e njëjta shkollore sipas të dyja planeve dhe programeve, vetëm në dy ndërrime dhe varësisht sipas cilit sistem punojnë. Vetëm herë pas here ekziston problemi për shkak të mospërputhjes së kalendarëve shkollorë, por problemet e tilla zgjidhen në bashkëpunim midis drejtorëve të shkollave. Problemi rreth përdorimit të ndërtesës ende ekziston vetëm në fshatin Krushevë, për të cilin IAP ka raportuar edhe në periudhën e mëparshme raportuese,¹⁷⁵ në të cilën drejtori i shkollës ende nuk lejon që fëmijët të cilët mësojnë në gjuhën serbe të ndjekin mësimin dhe përdorin objektin e shkollës. Në fshatin Rapçë ekzistojnë dy objekte të shkollës fillore, një që është rinovuar nga komuna e Dragashit e në të cilin fëmijët mësojnë në gjuhë boshnjake, dhe tjetri i cili është në gjendje shumë të keqe (pikon çatia dhe prej kohësh nuk është për përdorim) në të cilin fëmijët ndjekin mësimin në gjuhë serbe. Avokati i Popullit me këtë rast i bën thirrje komunës së Dragashit, drejtorisë për arsim, si dhe përfaqësuesve të komunitetit goran që

¹⁷³Informacioni i marrë në takimin midis IAP dhe OSCE në Prishtinë më 21.12.2017.

¹⁷⁴IAP i ka grumbulluar informatat gjatë vizitave në terren dhe shkollave të caktuara në gjuhën boshnjake në komunën e Prizrenit (shkolla „Meto Bajraktari“ në fshatin Reçan, 29.11.2017.)

¹⁷⁵Raporti vjetor i IAP-së për vitin 2016, pjesa 2.3. Komunitetet pakicë, 2.5 Arsimi, faqe 69.

edhe për këto dy probleme të tregojnë vullnet të mirë dhe të gjejnë zgjidhje adekuate për nxënësit.

Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, IAP ka përcjellë procesin e verifikimit të diplomave të fituara në Universitetin e Mitrovicës veriore i cili funksionon sipas sistemit të arsimimit të Republikës së Serbisë¹⁷⁶ dhe i cili është vazhduar me shumë sukses edhe gjatë vitit 2017. Çështja e cila nuk është rregulluar me këtë proces, për të cilën do të duhet të gjendet zgjidhje adekuate, është çështje e verifikimit të diplomave të shkollave të profileve të larta të studimeve profesionale të cilat janë fituar në Universitetin e Mitrovicës veriore. Gjithashtu, ende ekziston pengesa për verifikimin e diplomave të fituara në periudhën 1999 dhe 2000 në këtë Universitet, sepse marrëveshja e cila rregullon çështjen e verifikimit nuk ka përfshirë periudhën e caktuar në kuadër të këtij procesi, gjë që vë në pozitë të palakmueshme të gjithë ata të cilët i kanë fituar diplomat në atë periudhë.

7.11 Komuniteti rom, ashkali, egjiptian

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe gjatë këtij viti raportues ka vazhduar t'i kushtojë vëmendje të veçantë situatës lidhur me komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane dhe gjatë vitit 2017 u mbledhën informacione mbi temat e mëposhtme.

IAP vazhdoi edhe gjatë këtij viti të bashkëpunojë me përfaqësuesit e OJQ-ve aktive rome, ashkali dhe egjiptiane si: Voice of Roma, Ashkali and Egyptians (VoRAE), Roma and Ashkali Documentation Center, Përparimi i Komuniteteve - Avancimi i Komuniteteve, Rrjeti i Organizatave Rome - Një rrjet organizatash që i bashkon romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët në Kosovë etj. Gjatë periudhës raportuese, IAP me ndihmën OJQ-së VoRAE dhe OJQ-së Përparimi Rinor i Ashkalive të Mitrovicës (PRAM) ka mbajtur takime me qytetarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunat e Graçanicës, Obiliqit, Mitrovicës dhe Podujevës lidhur me të drejtat dhe liritë e njeriut, lidhur me parashtrimin e ankesave në IAP dhe lidhur me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Gjatë takimit me pjesëtarët e komuniteteve në fjalë në komunat e lartpërmendura, janë identifikuar probleme të caktuara dhe sfida, me të cilat ballafaqohen këta qytetarë e që kanë të bëjnë me: ndërprerjen e ndihmës sociale, mungesën e bashkëpunimit adekuat me përfaqësuesit e Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në disa komuna, mungesa e kushteve elementare të jetesës (strehimi i përkohshëm) në disa komuna, përfshirë edhe komunën e Graçanicës dhe Podujevës, problemin e regjistrimit civil në disa komuna, nivelin shumë të lartë të papunësisë në shërbimin civil dhe institucionet gjyqësore, shkyçja nga rrjeti elektrik, kohëzgjatjen e procedurave para organeve gjyqësore në lidhje me lëndët që kanë të bëjnë me kontestet pronësore, uzurpimin e pronës dhe pengim posedimin, ndotjen e mjedisit në fshatin Plementin të komunës së Obiliqit (afër ndërtesave që janë dedikuar për banim social), kërkimin e lëmshës nëpër

¹⁷⁶Gjatë vitit 2015, Zyra për çështje të pakicave pranë kabinetit të kryeministrit të Kosovës ka iniciuar çështjen e verifikimit të diplomave të arritura në Universitetin e Mitrovicës veriore e cila me dinamikë të caktuar realizohet me sukses radhazi 2 vite për të gjithë të cilët kanë fituar diplomat nga viti 2001.

rrugë nga fëmijët pjesëtarë të këtyre komuniteteve në fjalë, kujdesin joadekuat shëndetësor (mos vaksinimi i fëmijëve, sëmundjet e shpeshta infektive, etj.) por është shumë e shpeshtë edhe dukuria e braktisjes së shkollimit, veçanërisht të fëmijëve të gjinisë femërore.

IAP ka vepruar sipas ankesave që kanë të bëjnë me shumicën e çështjeve, me të cilat ballafaqohen komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Një numër i madh i ankesave të paraqitura në IAP janë dërguar nëpërmjet përfaqësuesve të shoqërisë civile, përfshirë OJQ-të, aktivistët dhe përfaqësuesit e këtyre komuniteteve në tërë Kosovën. Në bazë të këtij bashkëpunimi, më 15 mars 2017, Avokati i Popullit e nënshkroi një marrëveshje për bashkëpunim me OJQ-në "Advancing Together", e cila i referohet bashkëpunimit me rastin e realizimit të projekteve të karakterit informativ dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve pakicë.

Krijimi i një politike lidhur me procesin e kthimit, duke përfshirë edhe komunitetin rom, është një nga çështjet që i janë besuar MKK-së. Përveç kësaj, numri i personave që janë kthyer, kryesisht nga Serbia dhe Mali i Zi, në numër shumë të vogël¹⁷⁷ kanë marrë pako humanitare. Gjithashtu, bashkëpunimi i MKK-së me përfaqësuesit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është jo adekuat dhe i pamjaftueshëm dhe si pasojë e kësaj, të kthyerit që janë pjesëtarë të këtyre komuniteteve për shkak të ndihmës së pamjaftueshme me rastin e kthimit dhe asaj që atyre si të kthyer u takonte nga shteti, përkatësisht nga MKK-ja janë të detyruar të kthehen përsëri në Serbi ose Mal të Zi. Ndihma që marrin këto familje janë kryesisht pako ushqimore, të cilat i plotësojnë nevojat e tyre vetëm për një periudhë të caktuar kohore.

Ashtu si komunitetet e tjera të pakicave, edhe pjesëtarët e këtyre tri komuniteteve ballafaqohen me problemin e uzurpimit të pronave të tyre dhe pengim posedimit. Në organet gjyqësore në Kosovë ende mbetet i pazgjidhur një numër i madh i padive të paraqitura nga pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, mirëpo, për shkak të numrit të madh të rasteve, në të cilat veprojnë gjykatat, është e pamundur që të njëjta t'i procedojnë brenda një kohe të arsyeshme. Shumica e pronave të uzurpuara, për të cilat bëhet fjalë, ndodhen në qytetet më të mëdha të Kosovës dhe ka shumë vështirësi që të njëjta të lirohen nga uzurpatorët, madje edhe pas vendimeve të plotfuqishme gjyqësore. Duhet të theksohet gjithashtu se IAP disa lëndë të caktuara të kësaj natyre i përcjell dhe monitoron gjatë procedurave gjyqësore në mbarë Kosovën dhe po ashtu bashkëpunon ngusht me Agjencinë e ndihmës ligjore falas, si dhe me OJQ-në "Clard", e cila ofron ndihmë ligjore falas për ankuesit në rastet e uzurpimit të pronës private.

Pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë gjatë viteve paraprake kanë shënuar një përparim të rëndësishëm në marrjen e dokumenteve personale, por gjatë vitit 2017 i gjithë ai proces stagnoi, sepse këta njerëz janë ballafaquar me probleme të njëjta,

¹⁷⁷Informacionet e cekura më sipër IAP i ka marrë në terren, si dhe nga OJQ-të "Përparimi i Komuniteteve" nga Suhareka, "Përparimi Rinor i Ashkalive" nga Mitrovica Jugore dhe "Rrezet e Arta të Ashkalinjëve nga Fushë Kosova.

ose të ngjashme me rastin e parashtrimit të kërkesave, si edhe personat e zhvendosur. Lidhur me këtë duhet theksuar se ngecja ka ndodhur, kryesisht për shkak të mungesës së provave të lindjes, posedimit të çfarëdo dokumentacioni, ose lidhjes vetëm të martesave tradicionale, të cilat ka qenë e pamundur të dëshmohej me rastin e regjistrimit në regjistrin e qytetarëve të Kosovës. IAP në periudhën paraprake ka pranuar ankesa të shumta të qytetarëve nga radhët e këtyre komuniteteve minoritare që kanë të bëjnë me pamundësinë e regjistrimit në regjistrin e të lindurve dhe qytetarëve të Kosovës, pjesërisht për shkak të pamundësisë për të siguruar çfarëdo dëshmie për rregullimin e statutit personal civil, kurse pjesërisht për shkak të mungesës së fondeve për pagesën e taksave me rastin e rregullimit të statusit civil, ndërsa më vonë me rastin e marrjes së dokumenteve personale.¹⁷⁸ Avokati i Popullit konsideron se lidhur me çështjen e padukshmërisë ligjore të qytetarëve nga radhët e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, duhet të veprohet urgjentisht, me qëllim që këtyre komuniteteve t'u ofrohen mundësi, që në mënyrë të barabartë dhe pa përjashtime t'i realizojnë të drejtat e tyre qytetare. Gjithashtu, Avokati i Popullit është i mendimit se është e nevojshme që edhe më tutje të vazhdohet me praktikën pozitive të lirimit të komuniteteve të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve nga pagesa e tarifave për regjistrim me rastin e vonesave në regjistrimin, siç ishte deri më tani.

Sa i përket arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, aktivitetet e MASHT-it në lidhje me përmirësimin e arsimit për pjesëtarët e këtyre komuniteteve vazhduan edhe gjatë vitit 2017. Në bashkëpunim me një OJQ vendore dhe ndërkombëtare, MASHT-i ka ndarë 500 bursa për nxënësit e shkollave të mesme për t'i inkurajuar këta nxënës që të vazhdojnë shkollimin. Me këtë rast duhet të përmendet miratimi i Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr. 12/2017 për Themelimin dhe Funkcionimin e Qendrave të Mësimin, me iniciativën e OJQ-së, të cilës i është bashkuar edhe IAP. Me Udhëzimin Administrativ (UA) të lartpërmendur përcaktohen kriteret dhe procedurat për krijimin e qendrave të mësimin, të cilat ofrojnë mbështetje shtesë arsimore, si dhe aktivitete të tjera arsimore për nxënësit e këtyre komuniteteve. Meqenëse zbatimi i këtij UA po vonohet, IAP kërkon nga MASHT-i që procedurat për licencimin e tyre të bëhet në një kohë të arsyeshme dhe që komunat në kuadër të buxheteve të tyre ta parashohin edhe financimin e qendrave të planifikuara.

IAP mori informata¹⁷⁹ nga disa komuna për braktisjen e shkollimit obligues të fëmijëve të këtyre komuniteteve, veçanërisht të fëmijëve të gjinisë femërore. Në komunën e Fushë Kosovës, IAP mori pjesë aktive në ndërmjetësimin ndërmjet prindërve dhe përfaqësuesve të shkollave fillore për kthimin e fëmijëve të gjinisë femërore në mësimin e rregullt. IAP edhe në periudhën e ardhshme do të angazhohet gjithashtu në monitorimin e situatës dhe do të punojë për ta parandaluar atë. Në përputhje me këtë, Avokati i Popullit konsideron se është një përgjegjësi e madhe e MASHT-it që të fokusojë më shumë vëmendjen në

¹⁷⁸ IAP lidhur me këtë problem ka regjistruar një ankesë grupore me të cilën janë përfshirë 39 persona nga Graçanica, pjesëtarë të komunitetit rom dhe ashkali.

¹⁷⁹ Komuna e Pejës dhe Fushë Kosovës.

zbatimin e UA, që ka të bëjë me krijimin e ekipeve për të parandaluar braktisjen e shkollimit të detyrueshëm dhe jo siç ka qenë rasti deri tani që ekipeve të mos u kushtohet rëndësi, prandaj ato kanë qenë jofunksionale.

Kur bëhet fjalë për aktivitetet jashtëshkollore në lidhje me mësimin e gjuhës dhe kulturës rome, aktivitete të tilla ende po realizohen në komunën e Prizrenit, ndërsa në komunat e tjera kjo nuk ndodh për shkak të mungesës së burimeve financiare. Në Obiliq, ka qenë e planifikuar që gjuha rome të përfshihet në aktivitetet mësimore dhe në planprogramin e shkollës fillore, ku e vijojnë mësimin fëmijët romë, por për fat të keq kjo nuk është realizuar. Në shkollat e tjera të Kosovës, nuk ka burime financiare të parashikuara, që do të përdreshin për të paguar të ardhurat personale për mësuesit e gjuhës rome, prandaj kjo lëndë as nuk është përfshirë në planprogramin për fëmijët që i përkasin komunitetit rom.

Ankesat më të shpeshta të parashtruara në IAP nga pjesëtarë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian kanë të bëjnë me çështjen e përfitimeve sociale. Kriteret e ashpra që janë përcaktuar me ligjin në fuqi për skemat sociale edhe më tutje vazhdojnë të paraqesin problem madhor për përfituesit e ndihmës sociale. Sipas ligjit të lartpërmendur, ndihma financiare sociale u jepet fëmijëve që përmbushin kriteret të caktuara deri në moshën 5 vjeçare, por kur një fëmijë bëhet 6 vjeç, kjo ndihmë automatikisht ndërpritet. Një situatë e tillë pasqyrohet në zgjerimin e mundshëm të familjes së përfituesve të ndihmës sociale, gjë që ndikon negativisht, qoftë në planifikimin familjar, qoftë në gjithë sistemin shoqëror në vend, i cili me këtë rregull bëhet i pakuptimtë.

Përveç kësaj, problem i madh i këtyre komuniteteve është shkalla e lartë e papunësisë, si dhe zbatimi jo konsekuent i Ligjit për Shërbimin Civil, në pjesën që ka të bëjë me përfaqësimin e komuniteteve pakicë në institucionet shtetërore, ku ndër të tjera theksohet se së paku 10% e komuniteteve pakicë duhet të përfaqësohen në shërbimin civil në nivel qendror. IAP në mënyrë të përsëritur vuri në dukje në raportet e veta që Qeveria e Republikës së Kosovës, përfshirë Ministrinë e Administratës Publike (MAP), duhet të zhvillojë politika, të cilat do të zbatoheshin për zbatimin e plotë të detyrimit ligjor të lartpërmendur. Sipas të dhënave të MAP-it, përqindja e përfaqësimit të përfaqësuesve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shërbimin civil në nivelin qendror dhe lokal, është jashtëzakonisht e ulët krahasuar me komunitetet e tjera minoritare, të cilat kanë një përqindje më të lartë të përfaqësimit.

Gjatë vitit 2017, IAP pranoi ankesa që kishin të bënin me kushtet e vështira të jetesës dhe akomodimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në disa komuna,¹⁸⁰ siç janë komunat: Graçanicë, Istog dhe Podujevë. Sa i përket strehimit në përgjithësi, ka një përkeqësim të ndjeshëm të situatës së strehimit, si dhe një rritje në numrin e ankesave në IAP lidhur me këtë problem. Gjithashtu, IAP ka iniciuar dy raste ex-officio lidhur me strehimin joadekuat. Në fund të vitit 2016, IAP e hapi një lëndë lidhur me kushtet e joadekuate të jetesës dhe banimit për familjen rome me 14 anëtarë që jetonin në kushte të

¹⁸⁰ IAP i ka regjistruar 5 raste të rënda, të cilat kanë nevojë për sigurimin e strehimit në komunën e Graçanicës, Podujevës; Klinës dhe Istogut.

rënda në Graçanicë. Pas intervenimit të IAP, komuna e Graçanicës e ndihmoi këtë familje duke furnizuar të njëjtën me ushqime bazë për jetesë dhe pako higjienike, por vetë komuna ka deklaruar se për shkak të mungesës së fondeve buxhetore nuk mund të sigurojë strehim për këtë familje. E njëjta situatë është edhe me familjen e ashkalinjëve në Podujevë, ku komuna e Podujevës gjithashtu deklaroi se nuk mund të sigurojë strehim për këtë familje për shkak të mungesës së fondeve buxhetore për këtë qëllim.

Një nga rastet më të rënda të strehimit joadekuat ka të bëjë me disa familje, raste të rënda sociale, nga radhët e komuniteteve egjiptiane dhe shqiptare, të cilat jetojnë në ndërtesën e ish burgut në Gjurakovc, Komuna e Istogut. IAP në mënyrë të përsëritur dërgoi letra me rekomandime në Komunën e Istogut lidhur me gjendjen e rëndë të këtyre familjeve, por deri më sot, Avokati i Popullit nuk ka marrë ndonjë përgjigje nga kjo komunë.

Misioni i OSBE-së në Kosovë, në bashkëpunim me Zyrën për qeverisje të mirë, të drejta të njeriut, mundësi të barabarta dhe luftën kundër diskriminimit, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, më 15 nëntor 2016, paraqiti draftin përfundimtar të një strategjie gjithëpërfshirëse për integrimin e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve, për periudhën 2017 -2021. Kjo strategji përfshin katër fusha kryesore: arsimin, punësimin, shëndetësinë, çështjet sociale dhe strehimin, me qëllim të përmirësimit të gjendjes socio-ekonomike të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve. Në bazë të informatave që ka marrë IAP nga përfaqësuesit e Zyrës për qeverisje të mirë, e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, në zhvillim e sipër është vlerësimi i zbatimit të Strategjisë për vitin 2017 dhe aktualisht është duke u punuar në këtë. Ajo që është shqetësuese në lidhje me Strategjinë është iniciativa e disa përfaqësuesve të komunitetit egjiptianë, që ky komunitet të përjashtohet nga Strategjia, për shkak se ata nuk ishin të kënaqur me zbatimin e Strategjisë paraprake për integrimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, sidomos në aspektin e gjendjes socio-ekonomike dhe mos zgjidhjen e situatës strehimit për komunitetin egjiptian, për çka është bërë fjalë edhe në raportin vjetor paraprak të IAP.¹⁸¹

Në këtë kuptim, Avokati i Popullit përsëri e shpreh shqetësimin e tij për përjashtimin e komunitetit egjiptian nga Strategjia, sepse një vendim i tillë do ta sjellë këtë komunitet në një situatë të palakmueshme në raport me romët dhe ashkalinjtë dhe do ta përkeqësojë edhe më shumë pozicionin e tyre edhe ashtu të rëndë në shoqëri. Avokati i Popullit në mënyrë të përsëritur ka kërkuar që të gjitha strategjitë që kanë të bëjnë me të drejta e njeriut në Kosovë të integrohen në një dokument të vetëm që do të përmbante informacione konkrete, qëllime, afate kohore reale, parashikime buxhetore etj., por deri më sot një dokument i tillë nuk është hartuar. Përkundrazi, në vend të një dokumenti gjithëpërfshirës, ekzistojnë 13 strategji të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, të cilat përveçse nuk janë të dobishme, po ashtu janë edhe të komplikuar dhe ndikojnë negativisht në arritjen e qëllimeve, për të cilat janë hartuar.

¹⁸¹ Shih Raportin vjetor të IAP për vitin 2016, Strategjia për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian. Faqe 71 dhe 72

Procesi i riadhesimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë

Në bazë të informatave me të cilat disponon IAP, çështja e riadhesimit në përgjithësi, posaçërisht kur bëhet fjalë për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë, vazhdon sikurse viteve të kaluara, të jetë temë shqetësuese. Për shkak të kushteve të vështira socio-ekonomike, një numër i madh i qytetarëve nga radhët e këtyre komuniteteve vendosin të emigrojnë në vendet e Bashkimit Evropian. Përkundër të gjitha përpjekjeve të institucioneve kompetente në Kosovë, në favor të personave të riadhesuar, këta njerëz ende ballafaqohen me shumë sfida dhe probleme. Programet apo projektet të cilat kanë të bëjnë me personat e riadhesuar nuk kanë qëndrueshmëri dhe zgjasin shumë shkurtë, kështu shtrohet pyetja si të integrohen personat e tilla në kuadër të shoqërisë. Hap pozitiv në përmirësimin e qasjes institucionale të personave të riadhesuar është bërë në procesin e decentralizimit të riadhesimit nga niveli qendror në nivel lokal, megjithatë përsëri, nëse flitet për ndihmën e natyrës emergjente e cila kërkohet nga ana e personave të riadhesuar, ekzistojnë vonesa. Edhe një problem me të cilin ballafaqohen personat e riadhesuar është uzurpimi i pasurisë së paluajtshme private nga ana e personave të tretë, kurse kur rastet e lidhura me këtë çështje arrijnë pran organeve kompetente gjyqësore, proceset gjyqësore zgjasin jashtëzakonisht shumë, kurse gjykimet nuk bëhen brenda një kohe të arsyeshme.

Në Kosovë, momentalisht është në fuqi Rregullorja nr. 13/2017 në lidhje me riintegrimin e personave të riadhesuar (për personat të cilat janë kthyer nga vendet e BE-së), në të cilën janë përcaktuar përgjegjësitë institucionale, kriteret dhe procedurat e programeve riintegruese. Rregullorja në fjalë parasheh afate më të shkurtra të parashtrimit të kërkesave nga ana e personave të riadhesuar për përfitimet nga programi i ndihmës së shpejtë dhe sistemi i integritit të qëndrueshëm në raport me Rregulloren nr.04/2016 e cila është zbatuar në periudhën e kaluar. Me rregulloren br.13/2017 afatet për parashtrimin e kërkesave për përfitime nga skema e qëndrueshme e riintegritit janë zvogëluar në mënyrë drastike¹⁸² përderisa kriteret tjera kanë mbetur të njëjtë. Përfitimet tjera për personat e riadhesuar përfshijnë kujdesin e strehimit të përkohshëm deri në 7 ditë, banimin me qira s 6 + 6 muaj, ku pastaj komuna me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale dhe ligjin mbi financimin e programeve të posaçme, është e obliguar që të sigurojë banimin e qëndrueshëm për personat e riadhesuara, megjithatë, kjo e fundit rrallë herë zbatohet në praktikë. Përfitimi tjetër është ndihma sociale, e cila i sigurohet personave, në kohëzgjatje prej tre muajve, (në përputhje me Rregulloren e mëparshme, kjo periudhë zgjati 6+6 muaj), ndërsa personat në fjalë të mos hyjnë në skemë në përputhje me ligjin në fuqi. Përfitimet tjera të cilat janë paraparë për këto persona janë: një paketë ndihmë dimërore, ndihmë e njehershme financiare në shumë prej 200 EURO, pastaj ofrimi i ndihmës mjekësore me kontrolle parandaluese, pajisje e hapësirës banuese me mobile elementare, subvencionet që kanë të bëjnë me punësimin dhe të cilat duhet t'i sigurojë

¹⁸²Uredba br.13/2017 o integraciji repatriranih lica i upravljanje programima reintegracije, član 4 u kojem se predviđa da je roka za podnošenje zahteva 3 meseca , dok je prethodnom Uredbom br.04/2016 taj rok bio 6 meseci.

Ministria e punës dhe mbrojtjes sociale përmes thirrjeve publike, aftësimin profesional, ndihmës tek marrja e dokumenteve dhe regjistrimi civil, etj.

Megjithatë, në bazë të pretendimeve të parashtruesve të ankesave dhe situatës në terren, IAP vlerëson se shumica e personave të riatdhesuar nuk janë shfrytëzues të përfitimeve të përmendura, dhe shikuar në përgjithësi, marrin vetëm një pjesë të caktuar të këtyre kompensimeve.

7.12 Përdorimi i gjuhëve

Të drejtat për përdorimin e gjuhëve në Kosovë janë pjesë e mbrojtjes kushtetuese,¹⁸³ qëllimi i së cilës është mbrojtja dhe ruajtja e identitetit të komuniteteve jo shumicë, gjë që është e rregulluar më tej me një sërë ligjesh dhe rregulloresh, në bazë të të cilave pjesëtarëve të këtyre komuniteteve nuk mund t'u mohohet e drejta që të ushtrojnë cilëndo nga të drejtat e njohura, për shkak se nuk u është mundësuar që në gjuhët dhe shkrimet e tyre t'u drejtohen institucioneve dhe organeve publike në Kosovë dhe të marrin përgjigje prej tyre.

Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, nga viti në vit, e monitoron situatën në ushtrimin e të drejtave gjuhësore të të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe për këtë raporton rregullisht në raportet e veta vjetore. Gjatë monitorimit të përdorimit zyrtar të gjuhëve në Republikën e Kosovës dhe duke e respektuar kornizën legjislativë në fushën e përdorimit të gjuhës, është evidente se ushtrimi i të drejtës për përdorim të barabartë zyrtar të gjuhës shqipe dhe serbe,¹⁸⁴ si dhe përdorimi i gjuhëve të tjera zyrtare të komuniteteve joshumicë në nivel lokal nuk mund të konsiderohen të kënaqshme. Duke e monitoruar zbatimin e të drejtës gjuhësore dhe duke i analizuar të dhënat dhe praktikën e mbledhura në nivel qendror dhe lokal¹⁸⁵ gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit konstaton se, pavarësisht lëvizjeve të vogla, situata në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare nuk ka ndryshuar ndjeshëm krahasuar me periudhat e mëparshme raportuese.¹⁸⁶ Shumica e problemeve ende vazhdojnë të ekzistojnë.

Prandaj, Avokati i Popullit edhe kësaj radhe e përsërit dhe i thekson disa probleme kyçe, siç janë: autoritetet shtetërore nuk e nxisin në masë të duhur, zbatimin e të drejtës për përdorim zyrtar të gjuhës në nivelin qendror dhe lokal; problemet e përdorimit të gjuhëve

¹⁸³ Kushtetura e Republikës së Kosovës, nenet: 5, 57, 58 dhe 59.

¹⁸⁴ Neni 5 paragrafi 1 I Kushtetutës së Republikës së Kosovës

1. "Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe."

Neni 2 i Ligji për përdorimin e gjuhëve

2.1". Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës "

¹⁸⁵ Të dhëna të mbledhura gjatë takimit në vitin 2017 me Komisionerin për gjuhë, Misionin e OSBE në Kosovë, OJQ ECMI Kosovë, CSD, gjatë monitorimit të raporteve dhe hulumtimit të tyre lidhur me zbatimin e të drejtave gjuhësore në Kosovë; gjatë takimeve të përfaqësuesit të IAP me qytetarët, në bazë të ankesave individuale të paraqitura në IAP lidhur me shkeljen e të drejtave gjuhësore, gjatë leximit të ligjit dhe akteve nënligjore dhe dokumenteve të tjera të organeve shtetërore; përmes mediave etj.

¹⁸⁶ Shih raportet vjetore të Avokatit të Popullit për vitin 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, në pjesën „Përdorimi i gjuhëve“.

zyrtare në procesin e hartimit të legjislacionit e bëjnë të vështirë përfshirjen e komuniteteve në procesin legjislativ në të dy nivelet e qeverisjes; mungesa e nëpunësve civilë në autoritetet publike që i njohin mirë gjuhët zyrtare dhe mund të komunikojnë me palët; në të dy nivelet e qeverisjes problem paraqet numri i pamjaftueshëm i përkthyesve, kualifikimi i tyre, trajnimi i pamjaftueshëm i tyre dhe certifikimi, që rezulton me nivele të ulëta të cilësisë së teksteve të përkthyer dhe mospërputhjeve të njëjtave midis versioneve të ndryshme gjuhësore; shkelja e së drejtës për përdorim të barabartë të gjuhës serbe në një procedurë administrative të filluar para autoriteteve kompetente në nivel qendror dhe lokal; mosrespektimi i gjuhëve zyrtare në faqet zyrtare të disa institucioneve në të dy nivelet e qeverisjes etj.

Ende në fokus gjendet njëra nga problemet kyçe lidhur me procesin dhe cilësinë e përkthimit të ligjeve në gjuhët zyrtare, gjë të cilën Avokati i Popullit në mënyrë të përsëritur e ka theksuar në raportet e veta vjetore vite me rradhë. As gjatë gjatë kësaj periudhe raportuese nuk është bërë asgjë në rishikimin gjuhësor të teksteve të ligjeve në gjuhën serbe.¹⁸⁷ Avokati i Popullit ende e sheh si shqetësuese situatën në komunat në veri të Kosovës, të cilat janë të banuara me komunitetin shumicë serbë, ku shqiptarët e Kosovës ende kanë probleme në përmbushjen e të drejtave gjuhësore, përveç në komunën e Mitrovicës veriore ku situatat në fjalë kanë lëvizje të vogla pozitive.

Avokati i Popullit nuk e mohon ekzistencën e vullnetit të mirë të Qeverisë që respektimi i të drejtave gjuhësore, në përputhje me kornizën legjislative, në masë të plotë të rregullohet në sferën publike dhe të zbatohet në mënyrë adekuate pa diskriminim në bazë të gjuhës, por është gjithashtu e domosdoshme që Qeveria, pa vonesa të mëtejshme, të veprojë me përkushtimin e vet të plotë në atë drejtim. Jemi dëshmitarë të një gjendjeje, në të cilën nga viti në vit problemet po përsëriten dhe po grumbullohen.¹⁸⁸ Procesi i realizimit të barazisë së gjuhëve zyrtare në nivel qendror, si dhe gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve në përdorim zyrtar në nivel lokal,¹⁸⁹ po ecën ngadalë. Avokati i Popullit e përsërit se koncepti i shumëgjuhësisë në legjislacionin e Kosovës është jashtëzakonisht kërkuar dhe ambicioz dhe është i shqetësuar që shteti ende nuk i është qasur zgjidhjes së këtij problemi, me seriozitetin e kërkuar dhe angazhimin e të gjitha strukturave shtetërore dhe sociale në tërësi, me qëllim që të gjejë zgjidhje efikase dhe të qëndrueshme sistematike.

Në monitorimin e ushtrimit të të drejtave gjuhësore, Avokati i Popullit vëren se Zyra e Komisionerit për gjuhë (ZKGJ), si mekanizëm qendror për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave gjuhësore, me aktivitetet e veta bën përpjekje dhe angazhohet që problemet që kanë të bëjnë me të drejtat gjuhësore të zgjidhen në nivel sistematik. Në vitin 2015 ZKGJ

¹⁸⁷ Informatë e marrë në takimin e përfaqësueses së Avokatit të Popullit me Komisionerin për gjuhë, më 5.12.2017.

¹⁸⁸ Për të gjitha problemet rreth përdorimit të gjuhës, Avokati i popullit raportoi në detaje në të gjitha raportet e tij të mëparshme vjetore nga viti 2012 deri në vitin 2016. Që të mos përsëriten ato që janë thënë më parë, lidhur me këtë çështje më hollësisht mund të informoheni në raportet vjetore të lartpërmendura.

¹⁸⁹ Shih nenin 1 dhe 2 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve

e ka hartuar një Strategji Afatmesme (2016-2020) për zbatimin sistematik të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Propozimi për dorëzimin e strategjisë u miratua në takimin e Grupit Ndërmintor për Komunitete, në qershor të vitit 2016. Përkundër faktit që vendimet e këtij komisioni duhet të jenë të detyrueshme për Qeverinë, miratimi përfundimtar i kësaj strategjie ende nuk ka ndodhur. Komisioneri për Gjuhë shpjegoi se arsyeja e vonësës është mungesa e fondeve, sepse për realizimin e kësaj strategjie nevojiten mjete të shumta financiare, të cilat do t'u ndaheshin ministrive të ndryshme që janë përgjegjëse për zbatimin e qëllimeve të strategjisë.¹⁹⁰ Avokati i Popullit është informuar nga ZKGJ se Qeveria ka marrë vendim për formimin e një grupi punues që do ta hartojë një dokument koncept për formimin e një shërbimi qendror të përkthimit në Qeverinë e Kosovës dhe se ekziston një plan i qartë qeveritar për formimin e këtij grupi deri në fund të vitit 2018.¹⁹¹

Në përputhje me kompetencat e veta, kur rekomandimet ZKGJ në lidhje me mjetin juridik ose dëmshpërblimin, ose kompensimin nuk repsektohen nga ana e institucioneve përkatëse, ZKGJ ka kompetencë ta shqiptojë dhe ta imponojë cilindo sanksion, siç përshkruhet në Udhëzimin Administrativ në fuqi për Përcaktimin e Sanksioneve Administrative për Shkeljen e Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve; dhe në rast se personi dështon ose refuzon të pajtohet me kërkesat e Zyrës, ose pengon, ose e pamundëson Zyrën në kryerjen e detyrave të veta, ose në rastet kur ka shkelje të natyrës së tillë, Zyra mund të nisë procedurë ligjore ose disiplinore përmes autoriteteve përkatëse kundër personit apo organizatës që është përgjegjëse për shkelje.¹⁹² Avokati i Popullit vëren se, pavarësisht situatës së pakënaqshme në respektimin e të drejtave gjuhësore dhe shkeljes së parimit të barazisë para ligjit, ZKGJ që nga fillimi i themelimit të vet deri më sot nuk e ka shqiptuar asnjë nga sanksionet dhe masat e mundshme, nga fusha e kompetencave dhe autorizimeve të veta, për shkak të mosrespektimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, pavarësisht faktit që për këtë ka pasur hapësirë dhe duke marrë parasysh që disa nga rekomandimet e ZKGJ drejtuar institucioneve përgjegjëse nuk janë respektuar gjithmonë.¹⁹³

Avokati i Popullit gjithashtu vëren se në faqen e internetit të ZKGJ, deri më sot nuk është publikuar asnjë rekomandim i Komisionerit që i është drejtuar institucioneve, të cilat nuk e zbatojnë plotësisht Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Avokati i Popullit e konsideron që është obligim i ZKGJ-së, që për punën e vet ta informojë publikun në mënyrë plotësisht transparente dhe në faqen e vet të internetit të fillojë të ofrojë më shumë informata për ankesat e qytetarëve dhe t'i publikojë rekomandimet e tij drejtuar institucioneve me rastin e shkeljes së të drejtës për përdorimin e gjuhës, në mënyrë që ato informacione të jenë

¹⁹⁰ Informatë e marrë në takimin e përfaqësueses së Avokatit të Popullit me Komisionerin për gjuhë, më 5.12.2017.

¹⁹¹ Po aty.

¹⁹² Udhëzim administrativ nr 07/2012 për Zyrën e Komisionerit për gjuhë, neni 17 Kompetencat dhe autorizimet e Zyrës, paragrafi 2.5 dhe 2.6.

¹⁹³ Informatë të marra në takimin e përfaqësueses së Avokatit të Popullit me Komisionerin për gjuhë, më 5.12.2017.

qartë të dukshme, gjë që edhe punën e zyrës do ta ngriste në një nivel më të lartë. Avokati i Popullit e konsideron se ZKGJ-së si mekanizëm qendror në monitorimin e zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve i duhet më shumë mbështetje nga Qeveria në përpjekjet e veta për ta përmirësuar zbatimin e ligjit në fjalë. ZKGJ-së duhet t'i sigurohet një buxhet më i lartë dhe t'i lejohet rritje e numrit të stafit profesional, me qëllim të rritjes së efikasitetit në punën e ZKGJ-së.

Gjatë kësaj periudhe, Avokati i Popullit pranoi disa ankesa, të cilat përveç që kanë të bëjnë me shkeljen e disa të drejtave të tjera, kanë të bëjnë edhe me shkeljen e të drejtave gjuhësore. Ankuesit janë këshilluar që paraprakisht t'i shfrytëzojnë mjetet ekzistuese juridike që janë të disponueshme dhe t'i drejtohen ZKGJ si mekanizëm qendror për mbrojtjen e të drejtave gjuhësore. Avokati i Popullit është i mendimit se një numër kaq i vogël i ankesave, përmes të cilave, gjatë periudhës raportuese është kërkuar nga IAP mbrojtja e të drejtës për përdorim zyrtar të gjuhës, nuk e pasqyron treguesin real të problemit dhe shkallës së shkeljes së të drejtave gjuhësore të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë. Duke marrë parasysh që autoritetet publike në Kosovë nuk kanë bërë përpjekje të dukshme në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të cilat janë dhënë në raportet vjetore të mëparshme e që kanë të bëjnë me ushtrimin e të drejtave gjuhësore, Avokati i Popullit e konsideron se shteti këtë çështje duhet ta trajtojë më me seriozitet, sepse ka detyrë dhe përgjegjësi që të krijojë dhe sigurojë kushte adekuate për gëzimin e plotë dhe efektiv të të drejtave gjuhësore të të gjithë qytetarëve, pa diskriminim.

Konkluzioni i cili imponohet në fund të kësaj teme është se të drejtat e pakicave dhe masat afirmative të cilat kanë të bëjnë me ata janë pjesë e kornizës së përgjithshme ligjore të drejtave të njeriut dhe si i tillë duhet të respektohet dhe mbrohet nga autoritetet shtetërore, sikur me legjislacion ashtu edhe me zbatimin praktik dhe të vazhdueshëm të ligjit. Të drejtat e komuniteteve pakicë janë të bazuara në njohjen se pakicat gjenden në situatë vështirë në krahasim me popullsinë shumicë. Gjithashtu, kanë për qëllim që t'i mbrojnë nga diskriminimi, asimilimi ose dhuna si pasojë e statusit të tyre të pakicave. Prandaj, është e domosdoshme që t'u tregohet se integrimi i tyre është i mirëseardhur, e dëshirueshme dhe e pritshme, dhe jo e bujshme dhe e habitshme. Respektimi i të drejtave të komuniteteve pakicë i kontribuon zhvillimit të stabilitetit politik dhe shoqërorë, dhe në asnjë mënyrë zvogëlimit dhe degradimit. Në fund, është e nevojshme të theksohet se pjesëtarët e komuniteteve pakicë, gjithashtu, duhet të respektojnë të drejtat e shumicës dhe institucionet dhe ligjet e shtetit, në mënyrë që t'i tregojnë përkatësinë e tyre shoqërisë dhe shtetit në të cilin jetojnë.

7.13 Barazia gjinore

Barazia gjinore është një nga çështjet kyçe të zhvillimit të një shoqërie dhe parakusht themelor i demokracisë për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të bazuar në gjini. Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2015, e përcakton Avokatin e Popullit si institucion i barazisë që trajton

rastet që lidhen me diskriminimin gjinor në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit¹⁹⁴.

Për shkak të mandatit të tij Avokati i Popullit ka funksion të dyfishtë në këtë aspekt: të përpiqet ta luftoj diskriminimin gjinor me anë të hetimit të ankesave dhe ta parandalojë atë duke kërkuar zbatimin e duhur të ligjit dhe duke u angazhuar në promovimin e të drejtave të njeriut, ku përfshihet e drejta e secilit individ për të qenë i lirë nga çdo formë e diskriminimit, duke përfshirë edhe diskriminimin gjinor.

7.14 Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020 dhe aktet nënligjore

Gjatë periudhës raportuese ndryshimet në aktet nënligjore të Ligjit për Barazi Gjinore janë bërë me propozimin e Agjencisë për Barazi Gjinore. Më 5 prill 2017, është ndryshuar Udhëzimi Administrativ Nr.03/2017 për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve dhe është zëvendësuar me Udhëzimin Administrativ Nr.04/2017, sipas të cilit është zgjatë periudha kohore e zbatimit të këtij udhëzimi, prej periudhës një vjeçare në periudhën dy vjeçare. Qeveria e Kosovës ka bërë një hap pozitiv me këtë masë afirmative për të nxitur bashkëshortët që të regjistrojnë pasurinë e përbashkët në regjistrin kadastral.

Gjithashtu, si një hap pozitiv i Qeverisë konsiderohet edhe miratimi i Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Planit të Veprimit 2016 –2020. Kjo strategji është konceptuar si një udhërrëfyes drejt një shoqërie pa dhunë dhe pritet që zbatimi i saj do të jetë transparent dhe efektiv.

Gjatë kësaj periudhës raportuese Avokati i Popullit ka kërkuar zbatimin e Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore nga partivtë politike gjatë zgjedhjeve, në mënyrë që në listat e kandidatëve të cilat i dorëzohen Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), të ofrohen mundësi të barabarta për të dy gjinitë. Më 17 maj 2017, në Deklaratën e tij Avokati i Popullit theksoi se Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, e definoi qartë se “*Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse (Neni 6, paragrafi 8)*”.¹⁹⁵

E drejta në punë e grave

Diskriminimi gjinor në punë ndodhë kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë të pabarabartë në kontekstin e punës për shkak të përkatësisë gjinore. Trajtimi i pabarabartë mund të prekë nivelin e pagesës, si p.sh. kur një grua paguhet me pak për një punë të njëjtë me një burrë. Diskriminimi gjinor mund të ndodhë gjithashtu edhe sipas mënyrës së trajtimit të grave në punë. Diskriminim në fushën e punës paraqesin edhe

¹⁹⁴ Neni 13 të Ligjit për Barazi Gjinore nr.05/L-020

¹⁹⁵ Deklarata e Avokatit të Popullit : <http://www.ombudspersonkosovo.org/sq/lajme/DEKARATE-E-AVOKATIT-TE-POPULLIT-LIDHUR-ME-PERFAQESIMIN-E-BARABARTE-GJINOR-NE-LISTAT-E-KANDIDATEVE-NGA-SUBJEKTET-POLITIKE-1511>

largimet jo ligjore nga puna, mosdhënia e mundësive për aftësim profesional dhe avancimi në punësim. Ligji për Barazi Gjinore parashikon ndalimin e diskriminimit në punë, ndalimin e ngacmimit seksual, shëndetin dhe sigurimin në vendin e punës.

Gjatë vitit raportues Avokati i Popullit ka pranuar ankesa nga qytetarët lidhur me diskriminimin në marrëdhëniet e punës. Natyra e ankesave ka të bëjë me shkelje të të drejtës për kthim në vendin e mëparshëm të punës,¹⁹⁶ pastaj me ngacmim seksual në vendin e punës dhe mosndërmarrjen e masave nga eprori me gjithë njoftimin për ngacmimin seksual, për të cilat Avokati i Popullit është duke zhvilluar hetim.¹⁹⁷

E drejta në pronë

Ligjet në fuqi i japin grave dhe burrave të drejta të barabarta në pronë, me gjithë faktin se shumica dërrmuese e pronave është e regjistruar në emër të burrave. Pengesa më e madhe për një jetë të pavarur të grave është edhe fakti që gratë në shumicën e rasteve nuk posedojnë ndonjë pronë private. Ligjet të cilat mundësojnë zbatimin e barazisë gjinore dhe mundësojnë qasjen e barabartë të grave në pronë janë: Ligji për pronën, Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për trashëgimi, Ligji mbi familjen dhe Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ligji për Barazi Gjinore u mundëson pjesëmarrje të barabartë në të gjitha fushat jetësore të të dy gjinive në Kosovë, po ashtu edhe në të drejtën pronësore. Por, posaçërisht në zonat rurale, ekziston përparësia e anëtarëve meshkuj të familjes për të trashëguar pronën familjare si pasojë e së drejtës zakonore, e cila në një masë të madhe vazhdon të ketë ndikim në shoqërinë kosovare.

Sa i përket çështjes së pronës dhe trashëgimisë edhe në vitin 2017, në shoqërinë tonë është diskutuar shumë herë çështja e heqjes dorë nga trashëgimtaret të gjinisë femërore në favor të trashëgimtarit të gjinisë mashkullore, një situatë e tillë është prezentë në të gjitha komunitete në Kosovë pa përjashtim.

Me qëllim të përmirësimit të situatës në fushën e pronës dhe barazisë gjinore, gjatë vitit 2017, çështja e pronës së grave në Kosovë ka qenë subjekt i vëmendjes së veçantë nga Qeveria e Kosovës, por edhe OJQ-ve lokale si dhe organizatave ndërkombëtare. Qeveria e Kosovës, e cila në fillim të vitit 2016, ka bërë një hap pozitiv dhe ka miratuar Udhëzimin Administrativ 03/2016, si një masë afirmative për regjistrimin e pronës së përbashkët të paluajtshme në emër të dy bashkëshortëve, në vitin 2017, ajo ka bërë ndryshimin e këtij udhëzimit (Udhëzimi 04/2017), sipas të cilit është zgjatë periudha kohore e zbatimit të këtij udhëzimit. Qëllimi i kësaj mase afirmative ishte që të rrisë qasjen në pronë nga gratë, si dhe regjistrimi i pronës në emër të tyre si dhe të përshpejtojë arrijtjen e barazisë në mes të burrave dhe grave në aspektin e të drejtave pronësore. Beneficionet që kanë dalë nga ky Udhëzim janë: lirimi nga tarifa për shërbimin e

¹⁹⁶ A.nr.788/2017

¹⁹⁷ A.nr.788/2017

regjistrimit, lirimi nga tatimi mbi pronën për periudhën një vjeçare dhe lirim nga tarifa për shpenzimin e noterit.

Problemet të cilat janë paraqitur në lidhje me regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve ishin situata kur nga bashkëshortet është kërkuar që dy herë të realizojnë pagesë për të njëjtën pronë. Rastet të tilla janë raportuar vetëm në Komunën e Prishtinës. Pas një hetimi të kryer nga Institucioni i Avokatit të Popullit është konstatuar që situata është përmirësuar dhe kjo praktikë nuk vazhdon të shfaqet me tutje.

Me qëllim të arritjes së barazisë gjinore në aspektin e të drejtave pronësore Avokati i Popullit, ka konsideruar të nevojshme mbajtjen e një tryeze, e cila është mbajtur më 7 dhjetor 2017, me titull “*Barazia Gjinore dhe drejta në regjistrim të pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve*”. Në këtë tryezë, përfaqësuesit e IAP prezantuan të gjeturat nga hulumtimi në komunën e Prishtinës, Ferizajt dhe Graçanicës dhe theksuan se në këto tri komuna janë parashtruar 302 kërkesa: 66 në komunën e Prishtinës, 201 në Komunën e Ferizajit dhe vetëm 35 në Komunën e Graçanicës,¹⁹⁸ më pas u ofrua mundësia e diskutimit të përbashkët dhe shkëmbim i përvojave përkritazi me këtë temë edhe nga institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal dhe OJQ-të të cilat drejtpërdrejtë merren me çështjen e barazisë gjinore, e që ishin pjesë e kësaj tryeze.

Avokati i Popullit në këtë rast theksoi se masat afirmative janë standarde që ligjvënësi i përdorë për raste të caktuara deri në arritjen e qëllimit, të cilat në këtë rast nuk janë zbatuar. Pjesëmarrësit u dakorduan që për të funksionuar mekanizmat institucional për pronë të përbashkët dhe barazi gjinore qytetarët duhet që të informohen më shumë për të drejtat e tyre. Gjithashtu, ata theksuan se ligjet trajtojnë këtë tematikë dhe se aktet nënligjore që nxjerrën pastaj, duhet të jenë më të zbatueshëm në praktikë.

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka pranuar ankesa që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtës në pronë bazuar në gjini. Njëri nga rastet ka të bëjë me shkeljen e të drejtës pronësore nga familja e bashkëshortit. Rasti është duke u trajtuar nga gjykata kompetente, megjithatë kjo nuk e parandalon Avokatin e Popullit që të zhvillojë hetimet lidhur me ankesën në bazë të kompetencave të tij që burojnë nga Ligji për Barazi Gjinore dhe Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi. Lidhur me këtë IAP, është duke i monitoruar seancat gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë¹⁹⁹.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ka pranuar ankesë kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë për zvarritje procedurale lidhur me ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, e cila gjithashtu është në fazën e hetimeve nga ana e IAP.

Dhuna në familje

Ligji e përcakton dhunën në familje si formë e abuzimit që ushtrohet nga një person ndaj personit tjetër dhe që rezulton në cenim të integritetit të tij fizik, moral, psikologjik,

¹⁹⁸<http://www.ombudspersonkosovo.org/sq/lajme/Avokati-i-Popullit-mbajti-tryezen-me-temen-Barazia-Gjinore-dhe-drejta-ne-regjistrim-te-prones-se-perbashket-ne-emer-te-dy-bashkeshorteve-1564>

¹⁹⁹Rasti i regjistruar nën numrin A.nr.521/2017

seksual, social ose ekonomik. Kjo lloj dhune nuk njih asnjë mjedis kulturor, etnik, arsimor, apo ekonomik.

Dhuna ndaj grave shpesh nuk raportohet në polici, prandaj konsiderohet se numri i grave-viktimave të dhunës në familje është shumë më i madh se sa tregojnë statistikat. Institucionet përgjegjëse kanë shumë vështësi gjatë vlerësimit të dhunës në familje. Pengesë për paraqitjen e rastit të dhunës në familje është edhe presioni dhe paragjykimet shoqërore ku dhuna në familje shihet si turp dhe si çështje private, e cila nuk duhet të paraqitet jashtë rrethit familjar. Vet ekzistenca e Ligjit për mbrojtje nga Dhuna në Familje do të thotë se dhuna në familje nuk është vetëm çështja personale e një anëtarit të familjes, por është një çështje sociale dhe shtetërore e cila duhet të trajtohet nga ana e institucioneve dhe OJQ-ve të Republikës së Kosovës.

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për mbrojtje nga dhuna në familje, e miratuar nga Qeveria (2016- 2020), ka për qëllim që palët përgjegjëse të trajtojnë me prioritet të gjitha rastet e dhunës në familje, sigurojnë qasje në shërbime të integruara cilësore, garantojnë drejtësi dhe përgjegjësi për viktimat, sigurojnë rehabilitim dhe rintegrim të viktimave/mbijetuarve të dhunës në familje dhe të rrisin vetëdijësimin e mbarë shoqërisë tonë. Ajo është baza për punën në eliminimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave në përputhje me vizionin e Kosovës për një shoqëri ku nuk ka tolerancë ndaj çdo forme të dhunës.

Numri i rasteve të dhunës në familje, të paraqitura në IAP gjatë vitit 2017, nuk është i lartë. Është shumë e evidente se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje konsiderohet si një fakt shqetësues dhe konstatohet se përgjigja e institucioneve përkatëse, në këto situata, ishte e papërshtatshme dhe joadekuate. Rritja e numrit të rasteve të raportuara, përveç që tregon se aktet e dhunës janë në rritje, është tregues që viktimat gjatë kalimit të kohës, janë edukuar ligjërisht për të raportuar dhunën tek autoritetet kompetente. Gjithashtu, fuqizimi i grave për të njohur dhe të kërkuar të drejtat e tyre është fakt thelbësor në luftimin e dhunës, dhe jo vetëm në luftimin e dhunës fizike por edhe dhunës psikologjike, ekonomike apo politike.

Përveç kësaj, nevojitet punë shtesë për zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve për viktimat e dhunës, duke përfshirë ndihmën financiare, strehimin, arsimin, trajnimin dhe ndihmën për punësim, si dhe krijimi një numri të mjaftueshëm të shtëpive të sigurta për gratë dhe fëmijët që janë viktimat e dhunës.

Republika e Kosovës ende nuk ka ratifikuar dokumentet ndërkombëtare lidhur me parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna kundër grave dhe dhuna në familje, në kuadër të cilëve është edhe Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në familjes (Konventa e Stambollit)²⁰⁰.

²⁰⁰ Sipas të dhënave të OKB-së, më shumë se një e treta e grave në mbarë botën kanë përjetuar dhunë fizike ose psikike dhe 750 milionë gra janë martuar para moshës madhore.

Avokati i Popullit në raportet e tij të mëparshme vjetore rregullisht ka rekomanduar që në kuadër të Kushtetutës të Republikës së Kosovës të përfshihet edhe Konventa e Këshillit Evropian (Konventa e Stambollit) kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e cila u miratua në gusht të vitit 2014. Ky rekomandim është bërë në kuadër të Strategjisë për Zgjerim të Komisionit Evropian.

Me ratifikimin e kësaj Konvente shteti, në të ardhmen do të angazhohej për të marrë masat e nevojshme legjislative dhe masa të tjera për të krijuar një sistem efektiv, gjithëpërfshirës dhe të koordinuar të parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna në familje, e cila nënkupton mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të gjinisë.

Të drejtat e viktimave të krimit janë të drejta themelore të garantuara me Kushtetutë me ligjet e Republikës së Kosovës, me konventat ndërkombëtare dhe si të tilla duhet mbrojtur nga shteti. Legjislacioni i Kosovës parasheh një skemë të kompensimit të viktimave nga shteti, të cilat janë të rregulluara me Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit si dhe me Ligjin nr.05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Avokati i Popullit ka marrë pjesë në Konferencën Nacionale për Shënimin e javës për të drejtat e viktimave të krimit, 30-31 tetor 2017 e organizuar nga Prokurori i Shtetit e që ka të bëjë me kompensimin e viktimave të krimit, sipas Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit me të cilin mbulohen veprat e dhunshme të kompensueshme për disa kategori të viktimave të krimit. Avokati i Popullit përshëndet nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit, megjithëse pret që në të ardhmen lista e kategorive që do të përfshihen të zgjerohet.

Avokati i Popullit e sheh të domosdoshëm krijimin e bazës ligjore për kompensimin e viktimave të shkeljes së të drejtave të njeriut, në fushën e të drejtës civile dhe administrative.

Gratë viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës

Çdo lloj dhune ndaj grave, përfshirë edhe dhunën seksuale gjatë luftës nënkupton shkeljen e të drejtave të njeriut. Që nga viti 2006-2007, në raportin e shtatë vjetor, Institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar që gratë - viktimave të dhunës seksuale gjatë viteve 1998-99, të përfshihen në listën e personave që marrin kompensim, sipas Ligjit për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të viktimave civile të luftës. Megjithatë, edhe pse Kuvendi i Kosovës, më 20 mars 2014, ka miratuar Ligjin Nr.04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/1-054 për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre lidhur me dëmshpërblimin e viktimave të dhunës seksuale, viktimat ende mbesin në pritje të marrjës së pensionit.

Edhe pse Komisioni Qeveritar për pranimin dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale është formuar, puna e këtij komisioni nuk është funksionalizuar ende.

Avokati i Popullit duke mbështetur sundimin e ligjit në Kosovë, mbështet edhe çështjen e grave – viktimave të dhunës, duke rekomanduar ngritjen e bashkëpunimit të institucioneve dhe akterëve të tjerë të cilët janë përgjegjës në zbatimin e ligjit me qëllim që viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës të gëzojnë të drejtat e tyre si viktimat civile të luftës.

7.15 Komunitetet LGBT

Respektimi i të drejtave të popullatës LGBT mund të merret si tregues i zhvillimit demokratik të vendit, qoftë në nivelin legjislativ, qoftë në praktikë. Kjo popullatë gjithnjë e më shumë po bëhet objekt i vëmendjes së madhe të publikut në Kosovë.

Është evidente që qëndrimet homofobike ende janë të theksuara në shoqërinë kosovare. Jeta e personave LGBT në Kosovë nuk është aspak e lehtë dhe ata janë të diskriminuar në të gjitha fushat e jetës. Ata vazhdojnë të kanë frikë ta shprehin lirshëm orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor, për shkak të urrejtjes, të cilën e ndiejnë dhe me të cilën përballen. Megjithatë, është e dukshme se situata po ndryshon. Për këtë çështje në shoqërinë kosovare po diskutohet gjithnjë e më shumë. Komuniteti LGBT po bëhet më i dukshëm dhe nuk është më një temë tabu, për të cilën hesitet.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, mbështetja publike për personat LGBT është shumë më e pranishme dhe më e theksuar se gjatë viteve të mëparshme. Në Ditën Ndërkombëtare Kundër Homofobisë, u mbajt “Parada e Krenarisë” dhe nuk pati incidente. Këtij tubimi i dhanë mbështetje presidenti i Kosovës dhe qeveria në krye me kryeministrin, duke treguar se Kosova është e gatshme t’i respektojë të drejtat e këtij komuniteti. Këtij tubimi i dhanë mbështetje edhe përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit, po ashtu vërejti një rritje të aktiviteteve të sektorit civil, me qëllim të rishikimit të normave të rrënjosura tradicionale dhe konservative ndaj personave LGBT, thyerjes së këtyre paragjykimeve dhe avokimit të respektimit të diversitetit dhe të drejtave ligjore për popullatën LGBT, në mënyrë që ata të mbrohen nga diskriminimi dhe të bëhen pjesë e barabartë e shoqërisë. Mirëpo, komuniteti LGBT si pjesë e shoqërisë në Kosovë edhe më tutje mbetet i marginalizuar dhe situata është larg situatës së kënaqshme.

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*), ka dërguar një mendim juridik Gjykatës Themelore në Prishtinë, lidhur me gjendjen e homofobisë dhe transfobisë²⁰¹ në Republikën e Kosovës. Avokati i Popullit u paraqit në cilësinë *amicus curiae*, pas hetimeve të rasteve A.nr. 451/2016, Ex-officio 379/2016 dhe A.nr.72 / 2017, sipas të cilave ankuesit si pjesëtar të komunitetit LGBT, kanë qenë viktimat e dhunës fizike dhe diskriminimit.

Pas analizimit të rasteve të lartpërmendura, Avokati i Popullit vëren se krimet e kryera kundër anëtarëve të komunitetit LGBT, institucionet përgjegjëse i pranojnë dhe i trajtojnë

²⁰¹ Mendim juridik i Avokatit të Popullit lidhur me gjendjen e homofobisë dhe transfobisë, dërguar Gjykatës Themelore në Prishtinë, më 2 maj 2017.

në fazën fillestare të procedurës si vepra penale të përcaktuara me kodin penal, por nuk trajtohen si vepra penale të drejtuara kundër personave të komunitetit LGBT "*të motivuara dhe kryera mbi bazën e urrejtjes kundër orientimit seksual dhe identitetit gjinor*", prandaj Avokati i Popullit e konsideron se dispozitat për ndalimin e diskriminimit në bazë të cilësdo bazë, në veçanti në bazë të orientimit seksual, duhet të jenë në korrelacion me nenin 74 të Kodit Penal, i cili i përcakton faktet rënduese të veprës penale, më saktësisht në paragrafin 2, pika 12.²⁰²

Avokati i Popullit është i shqetësuar për faktin se ende nuk ka asnjë një vendim gjyqësor, lidhur me dhunën kundër cilitdo person ose grupi personash për shkak të orientimit të tyre seksual ose identitetit gjinor. Kjo gjë shikohet si dështim i gjykatave për ta shfrytëzuar mundësinë dhe kompetencën juridike, që në mënyrë rigoroze ta zbatojnë nenin 74, paragrafin 2, pikën 2.12 të Kodit Penal nr. 04/L-082 të Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit gjithashtu e konsideron se në kontestet e punës, në të cilat palët në procedurë pretendojnë të jenë viktima në bazë të orientimit seksual, gjykatat duhet t'i shqyrtojë dhe të vendosë në këto raste, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi dhe me nenin 5, paragrafin 1 të Ligjit të punës, meqë vetëm në këtë mënyrë garantohet trajtimi i barabartë i të gjithëve para ligjit.

Në këtë kontekst, Avokati i Popullit thekson se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë duhet të interpretohen në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, siç është thënë në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Analiza ligjore e çështjeve, pavarësisht nga dispozitat e instrumenteve të cekura ligjore, do të duhej të fillonte me praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe perceptimin ndaj homoseksualitetit dhe diskriminimit në bazë të gjinisë dhe orientimit seksual. Avokati i Popullit konstaton përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se kuadri ligjor kombëtar i zbaton standardet ndërkombëtare lidhur me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në lidhje me ndalimin e diskriminimit në bazë të gjinisë dhe orientimit seksual, që nënkupton zbatimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ. Interpretimi i Konventës nga ana e GJEDNJ ka krijuar një hapësirë të gjerë për zbatimin e ndalimit të diskriminimit bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen, siç thuhet në dokumentin e ekspertëve të Komisionit Evropian për luftën kundër diskriminimit të bazuar në orientimin seksual në BE, se sa i përket kornizës ligjore të Kosovës, pa asnjë dyshim mund të thuhet se i mbron të drejtat e garantuara nga KEDNJ dhe ndalon çfarëdo lloji të diskriminimit në bazë të

²⁰² Kodi penal i Kosovës, nr. 04/L-082, neni 74, paragrafi 2 pika 12 thotë: “2. Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme rënduese: (...) 2.12 nëse vepra penale kryhet ndaj personit ose grupit të personave, ose pronës, për shkak të origjinës etnike ose kombëtare, shtetësisë, gjuhës, besimeve fetare, ose mungesës së besimeve fetare, ngjyrës, gjinisë, orientimeve seksuale, ose për shkak të afërsisë e personat me karakteristikat e lartpërmendura;

orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Duke u nisur nga korniza ligjore në kombinim me praktikën e GJEDNJ-së, nuk mbetet asnjë zbrastësi në legjislacionin ekzistues, që kërkon plotësim lidhur me mbrojtjen e mëtejshme të të drejtave të njeriut në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Por, problemi qëndron në faktin se legjislacioni përkatës në këtë fushë nuk zbatohet në mënyrë adekuate.

Është detyrim i veçantë i shtetit që t'i mbrojë të drejtat e njeriut kryesisht, përmes sistemit të vet ligjor, duke ofruar garanci shtesë për individin, që t'i gëzojë këto të drejta në mënyrë efektive.

7.1 Liritë fetare në Kosovë

Pas dështimit shumëvjeçar që të miratojë Ligjin e ri për liritë fetare në Kosovë, Kuvendi i Kosovës më 29 nëntor të vitit 2017, parimisht miratoi Draftin e ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-31 për liritë fetare në Kosovë, dhe me vendimin e kryetarit të kuvendit nr. 06-V-014²⁰³ Ligji i është përcjellë Komisioneve Parlamentare në shqyrtim. Me nenin 8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është paraparë laiciteti dhe neutraliteti i konfesionit të shtetit.

Shoqëria kosovare është shoqëri multinacionale dhe shumëkombëshe, me një numër të madh të besimtarëve të cilët i përkasin religjioneve të ndryshme dhe rregullimi ligjor i funksionimit të komuniteteve fetare është shumë i rëndësishëm për shoqërinë dhe shtetin në tërësi. Përkatësia në bashkësitë fetare në Kosovë është e lidhur ngushtë me strukturën nacionale të popullsisë. Popullsinë shumicë në Kosovë e përbën komunitetit shqiptar pjesa e më e madhe e të cilit, janë pjesëtarë të besimit fetarë islam, kurse pjesa tjetër e popullsisë lidhet me komunitetet tjera fetare, në masën më të madhe me kishën katolike, kishën protestante, dhe komunitetin e Tarikatit. Komunitetet tjera nacionale në Kosovë janë të lidhura kryesisht me këto komunitete fetare, ndërsa pjesëtarët e nacionalitetit serb dhe malazez pothuajse në tërësi janë besimtarë të Kishës ortodokse serbe.

Imperativ i shtetit dhe shoqërisë bashkëkohore është respektimi i të drejtave dhe lirive të komuniteteve fetare të garantuara me Kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare, dhe sfidë e shtetit me rastin e nxjerrjes së ligjit për liritë fetare është se si të gjendet një masë midis lirisë së komuniteteve fetare që në mënyrë të pavarur të rregullojnë funksionimin e tyre dhe të ruajnë pavarësinë e tyre nga njëra anë, gjë që i garantohet me nenin 39 paragrafi 2 i Kushtetutës dhe me nenin 7 të Ligjit mbi liritë fetare dhe nga ana tjetër harmonizimi i rregullimit të tyre me normat ligjore të shoqërisë bashkëkohore. Sfidë për shtetin është që me rastin e rregullimit të pozitës ligjore të komuniteteve fetare të gjendet masë adekuate midis privilegjeve dhe diskriminimit, që të gjitha komunitetet fetare të cilat paraqesin traditën e shoqërisë kosovare në masë sa më të madhe të jenë të kënaqura me zgjidhjen e re ligjore.

²⁰³ http://ligjet.skupstinakosova.org/Uploads/Data/Documents/VendimperPLperlirinefetare_HUc5vzP faqes i është qasur 26.12.2017.

Komuniteti islam i Kosovës, Kisha ortodokse serbe, Kisha katolike, Komuniteti fetar hebre, Kisha protestante ungjillore e Kosovës dhe Komuniteti i Tarikatit të Kosovës, janë komunitete fetare të cilat ligji i ri i pranon dhe i jep të drejtë të jenë të regjistruara drejtpërdrejt si komunitete të cilat paraqesin trashëgiminë historike, kulturore dhe sociale të Kosovës. Me qëllim të shmangies së diskriminimit eventual ndaj ndonjë komuniteti të ardhëm fetarë i cili paraqet dëshirën dhe nevojën që të regjistrohet si e tillë, kurse me qëllim të ofrimit të mundësisë së lirisë së organizimit fetarë në kuadër të sistemit ligjorë, ligji ka paraparë një kusht shumë të pranueshëm për regjistrimin e vetëm 50 anëtarëve shtetas të Republikës së Kosovës.

Kushtëzimi me numër të vogël të anëtarëve për regjistrimin e komunitetit të ri fetarë gjithashtu është rekomanduar në opinionin 743-2013 e “Komisionit të Venecias”²⁰⁴.

Miratimi i këtij ligji paraqet përparim të madh në rregullimin e pozitës ligjore të komuniteteve fetare, kurse sjell zgjidhje për problemet e shumta të cilat janë theksuar në vitet e kaluara. Çështja e regjistrimit të komuniteteve fetare dhe zbatimi i Ligjit do të rregullohet nga Zyrat kompetente për komunitete fetare në kuadër të zyrës së kryeministrit. Ligji i ri rregullon çështjen e formimit dhe funksionimit të varrezave, duke mbrojtur të drejtat e besimtarëve për t’u varrosur në përputhje me zakonet e fesë të cilës i përkasin, dhe gjithashtu rregullon edhe çështjen e varrimit në varrezat publike të pjesëtarëve të komuniteteve të vogla fetare dhe njerëzve me bindje filozofike dhe mbrojtjen e nga ndikimi i komuniteteve të mëdha fetare.

Një nga zgjidhjet pozitive në krahasim me kërkesat e të gjitha komuniteteve fetare është që sipas këtij ligji krijohet mundësia që komunitetet fetare të gëzojnë privilegjet tatimore dhe doganore për aktivitetet ekonomike të cilat janë të rëndësishme për stabilitetin e tyre financiar, të cilat do të jenë në përputhje me rregullat të cilat do të përcaktohen nga ana e Ministrisë së Financave. Kjo është e rëndësishme sepse sipas ligjit, shteti nuk financon asnjë organizatë fetare, kështu që në këtë mënyrë mbrohet stabiliteti fetarë i komuniteteve fetare.

Për komunitetin fetarë islam, përveç çështjes rreth miratimit të ligjit, edhe në këtë vit mbetet pa rregulluar me ligj veshja e shamive në shkolla, dhe kjo ende varet nga qëndrimi i drejtorit të shkollës.

Komuniteti fetarë islam viteve të kaluara ka vënë në dukje nevojën e kthimit të numrit të madh të objekteve dhe pasurive tjera të patundshme të cilat i përkisnin në të kaluarën, kurse në mënyra të ndryshme janë tjetërsuar gjatë periudhës së Luftës së dytë botërore. Kjo çështje mbetet ende e pazgjidhur me mos nxjerrjen e Ligjit për kthimin e pronave.²⁰⁵ Këtë çështje, në periudhat e kaluara, e kanë theksuar edhe komunitetet tjera fetare.

²⁰⁴[http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2014\)012-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2014)012-e), qasja

²⁰⁵http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/RAPORTI_2014_-_SERBISHT_191899.pdf, faqe 57, qasur më 7.2.2018.

Statusi ligjor i Kishës ortodokse serbe (KOS) është një prej çështjeve e cila viteve të kaluara ishte prej rëndësisë së posaçme për Kishën ortodokse serbe, kurse në ligjin e ri për komunitetet fetare rregullohet përmes nenit 7A me të cilin KOS në Kosovë llogaritet pjesë e KOS, dhe respektohet emri, organizimi i brendshëm dhe hierarkia dhe aktivitetet e saj, kurse pasi është paraparë me nenin 13 të Ligjit nr. 04/L-115 mbi plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit i cili lidhet me përfundimin e monitorimit ndërkombëtarë të pavarësisë së Kosovës.

Për sa i përket problemit të dëmtimit të objekteve fetare të KOS, në vitin 2017 kishte më pak raste të tilla sesa më herët. Në disa raste, janë shënuar grafitë me përmbajtje të padëshiruar në muret përreth dhe afër objekteve fetare kurse rasti i dëmtimit ishte në tempullin e kishës “Shën Pjetri dhe Pali”, në Talinoc të Ferizajt, në fillim të prillit të vitit 2017, në kohën e festave të pashkëve, sulmuesit e panjohur kanë thyer xhamat në dritaret e kishës.

Kisha protestante ka pasur edhe këtë vit, sikur vitet e mëparshme, kërkesa të ngjashme, në rend të parë rregullimi i statusit ligjor të komuniteteve fetare. Më 23 dhjetor të vitit 2017, është përfunduar kisha e parë protestante në Kosovë.²⁰⁶

Komuniteti hebre i Kosovës gjatë vitit ishte i pranishëm në ngjarjet publike fetare, kurse në fund të nëntorit të vitit 2017 është shënuar java hebraike, në të cilën, në ngjarje të ndryshme, të pranishëm ishin përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe komuniteteve tjera fetare.

8. Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës

Republika e Kosovës nuk është palë nënshkruese e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese meqenëse ende nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare garantohen me këtë Kushtetutë. Këto marrëveshje dhe instrumentet ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Një ndër konventat e parapara në këtë nen është edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Me Ligjin për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019 parashihet që në kuadër të Institucionit të krijohet një mekanizëm i veçantë i cili do të kryejë të gjitha funksionet e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Personeli i këtij mekanizmi, përveç juristëve duhet të përfshijë profesionistë të fushave të ndryshme, posaçërisht mjekë, psikologë dhe punëtorë social me përvojë në këtë fushë.

²⁰⁶<http://www.ekonomiaonline.com/nacionale/afër-germis-sot-perurohet-kisha-e-pare-protestante-ne-kosove/> faqes i është qasur më 25.12.2017.

Ligji përcakton detyrat e këtij mekanizmi të cilat janë: që të vizitohet rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin në qendrat e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut.

Gjatë vitit për të cilin po raportohet Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm “MKPT”) ka kryer vizita në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, si dhe institucionet tjera ku personat mund të privohen nga liria ose nuk mund të largohen nga këto institucione me vullnetin e tyre për shkak të ndonjë vendimi të organeve kompetente.

Ekipi i MKPT ka identifikuar të gjitha institucionet që duhet të vizitohen nga MKPT. Numri i tyre sillet rreth 70 si: 4 qendra korrektuese; 6 qendra paraburgimi; qendra edukuese për të mitur; afërsisht 33 Qendra të Mbajtjes; mbi 24 institucione të shëndetit mendor (këtu përfshihen edhe repartet psikiatrike në kuadër të spitaleve të përgjithshme në regjione të ndryshme të Kosovës, institucionet e kujdesit social, Shtëpitë Integruese në Bashkësi); Qendra e Azilit dhe ajo e Mbajtjes për të huaj; Pikat Kufitare; Aeroporti; etj.

Gjatë vitit 2017, MKPT ka kryer vizitën tre ditore në Burgun e Sigurisë Lartë dhe pas vizitës ka publikuar raport me rekomandime.²⁰⁷ MKPT ka vërejtur se kushtet e akomodimit në Burgun e Sigurisë së Lartë janë të mira dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare, përveç disa dëmtimeve të dyshemeve në stacionarin e burgut dhe në dy pavijone të tjera. MKPT u njoftua nga drejtoria se këto renovime planifikohen të bëhen vitin e ardhshëm.

MKPT, lidhur me vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë u ka rekomanduar autoriteteve kompetente si në vijim: të ndërmerren hapat e duhur për të sanuar dëmtimin e dyshemeve në stacionarë dhe në pavijonet e BSL ku ato janë dëmtuar; të evitohet mangësia sa i përket ngjyrës së bardhë reflektuese e cila është pengesë për aktivitete jashtë qelive, të burgosurve; t’u mundësohet qasja në shtypin ditor; të funksionalizohet punësoria për trajnime profesionale; të shtohen aktivitetet për të paraburgosurit.

Më 9 shtator 2017, drejtoria e Burgut të Sigurisë së Lartë e njoftoi MKPT, se pas rekomandimeve të dala nga raporti kishte arritur të implementonte rekomandimin lidhur me ofrimin e shtypit ditor për të paraburgosurit dhe të dënuarit dhe se tani shtypi ditor ofrohet rregullisht. Po ashtu, drejtoria njoftoi se ka rritur aktivitetet për të paraburgosurit.

MKPT ka kryer 4 vizita *ad hoc* në Qendrën Korrektuese në Dubravë me qëllim të trajtimit të ankesave të të burgosurve të akomoduar në këtë qendër, 4 vizita në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur, 3 vizita në Qendrën Edukative Korrektuese për të Mitur, 4 vizita në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan. MKPT po ashtu ka kryer 1 *ad hoc* vizitë në Klinikën Psikiatrike në Prishtinë (QKUK).

²⁰⁷ http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/947-2017,_Raport_me_rekomandime_i_MKPT_921071.pdf

Drejtoria e Qendrës Korrektuese në Dubravë, gjatë këtij viti e njoftoi MKPT lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dërguara përmes raportit me rekomandime pas vizitës së MKPT në vitin 2016. Qendra Korrektuese në Dubravë e njoftoi MKPT se tani në pavijonin 1 ka furnizim të rregullt me ujë të ngrohtë, është zgjidhur çështja e furnizimit me shtypin ditor, të paraburgosurit janë transferuar në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, janë bërë gëlqerosje, janë evituar defektet në dushe dhe çezma sipas rekomandimit të MKPT. Pavijoni 4 ishte në renovim e sipër, pavijoni 5 është lëshuar në përdorim, pavijoni 8 është gëlqerosur në tërësi. Rekomandimi që qelitë e të dënuarve të furnizohen me dollapë për vendosjen e gjëseneve të tyre ende nuk është zbatuar, ende vazhdojnë problemet e kohëpaskohshme me furnizime me materiale për punë të zyrtarëve të burgut. MKPT është ende në pritje të zbatimit të rekomandimeve tjera.

MKPT ka kryer vizita komplete edhe në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, si dhe ka vizituar stacionet policore në Prishtinë (Qendra Rajonale e Mbajtjes), Mitrovicë, Vushtrri, Lipjan, Suharekë, Dragash, Prizren, Podujevë; Shtëpinë për Persona të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare. Lidhur me këto vizita, MKPT ka përpiluar raporte me rekomandime të cilat janë rezultat i gjetjeve gjatë vizitave në këto institucione.

Gjatë vizitës në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, MKPT ka konstatuar se qelitë ku mbaheshin të paraburgosurit nuk ishin në pajtim me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës sa i përket madhësisë,²⁰⁸ ndërsa disa prej tyre duhet të gëlqerosen. Bazuar në këtë standard hapësira për të paraburgosurit apo të dënuarit në qeli duhet të jetë së paku 4m² për person në një hapësirë ku akomodohen më shumë se një person, pa përfshirë aneksin e tualeteve.

Gjatë vizitës MKPT po ashtu ka vërejtur se në disa qeli për shkak të mungesës së hapësirës, disa të paraburgosur dhe të dënuar flinin në dysheme në dyshek të vjetruar dhe pa mbulesa adekuate. Prandaj, MKPT konstatoi se QPP përballet me mbipopullim i cili duhet të evitohet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe nuk mund të ofrojë hapësirë akomodimi në pajtim me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Pas vizitës në Qendrën e Paraburgimit në Prizren MKPT i ka dërguar Ministrisë së Drejtësisë raportin me rekomandime, si në vijim: Ministria e Drejtësisë të njoftojë Avokatin e Popullit lidhur me planifikimet për ndërtimin e Qendrës së re të Paraburgimit në Prizren; të krijohen kushte adekuate të punës për personelin mjekësor; numri i të paraburgosurve të akomoduar të jetë në pajtim me kapacitetin zyrtar të QPP dhe të zgjidhet çështja e mbipopullimit sa më shpejt që të jetë e mundur, të ndërmerren masat e duhura në mënyrë që të paraburgosurve t'u respektohet privatësia, të gëlqerosen qelitë sipas nevojës; të përmirësohen kushtet e punës së zyrtarëve korrektues. Drejtoria e Qendrës së Paraburgimit në Prizren nuk pati kundërshtime ndaj të gjeturave dhe rekomandimeve të MKPT.

²⁰⁸ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449> (14.11.2017)

MKPT ka pranuar ankesa të vazhdueshme nga të dënuarit lidhur me ndryshimet në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale i cili hyri në fuqi në maj të vitit 2017 me të cilin dukshëm u reduktuan ditët e tyre të pushimit të cilat u jepen në emër të privilegjeve të cilat fitohen me sjelljet e tyre të mira dhe me punën që bëjnë në institucionin korrektues si dhe ndalimit të pranimit të pakove ushqimore. Me ligjin e mëparshëm, kjo kategori e të dënuarve kishte të drejtë në 21 ditë pushimi në vit, ndërsa me ndryshimin e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale këto ditë u reduktuan në 7. Ministria kompetente është duke punuar në ndryshimin e serishëm të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe synon ndryshime sa u përket këtyre të drejtave të cilat ata i gëzonin me ligjin e mëparshëm.

Të gjitha institucionet e vizituara i ofruan MKPT bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat e këtyre institucioneve. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me personat e dënuar dhe të paraburgosur pa prezencë të zyrtarëve korrektues ose personelit tjetër.

MKPT gjatë vizitave në stacionet e lartpërmendura policore ka vërejtur se autoritet policore i kanë njoftuar të arrestuarit me të drejtat e tyre themelore të cilat janë të shkruara në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. MKPT nuk ka pranuar ankesa nga të arrestuarit e arrestuar për mosrespektim të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet në fuqi dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Sa u përket kushteve fizike, të gjitha stacionet policore të vizituara ofronin kushte për akomodim të personave të arrestuar në pajtim me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, përveç stacionit policor në Prizren për të cilin MKPT ka konstatuar se qelitë ku mbahen të arrestuarit duhet të gëlqerosen si dhe duhet të furnizohen me çarçafë dhe batanije të pastra. Asnjë nga stacionet e vizituara nuk posedonin sistem të thirrjes, gjë që do të mundësonte kontakt më të shpejtë dhe efikas ndërmjet personave të arrestuar dhe zyrtarëve policorë në rast nevojë.

MKPT i ka rekomanduar Ministrisë së Punëve të Brendshme që të vendosin sisteme të thirrjes në të gjitha qelitë ku mbahen personat e arrestuar dhe po ashtu ua ka përkujtuar se një rekomandim i tillë është bërë edhe nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës gjatë vizitës në Kosovë në vitin 2015.

Gjatë vizitave, MKPT është njoftuar nga zyrtarët policor se gjatë intervistimit të personave të arrestuar nuk praktikohet audio-video incizimi i intervistave. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT) konsideron se:

“Regjistrimi elektronik (audio dhe/ose video) i intervistave policore përbën një garanci të rëndësishëm shtesë kundër keqtrajtimit të të arrestuarve. KPT ka kënaqësinë të vërejë se vënia në përdorim e sistemeve të tilla po shqyrtohet nga një numër i vendeve. Një sistem i tillë mund të sigurojë një proces të intervistimit të kompletuar dhe autentik dhe në këtë mënyrë lehtëson shumë hetimin e çdo pohimi për keqtrajtim. Kjo është në interes të dy

palëve, respektivisht të personave të cilët janë keqtrajtuar nga policia dhe në interes të zyrtarëve policor të cilët përballën me pohime të pabazuara se janë përfshirë në keqtrajtim fizik dhe presion psikologjik. Po ashtu, regjistrimi elektronik e zvogëlon mundësinë e të pandehurve që më vonë rrejshëm të mohojnë se ata kanë bërë pohime të caktuara”.

Në raportin për vizitën në Irlandë në vitin 2006, KPT thekson:

“Të gjeturat gjatë vizitës në vitin 2006, sugjerojnë se audio-video incizimet në dhomat e intervistimit në stacionet e Garda, mund të kenë qenë faktor domethënës që ka kontribuar në zvogëlimin e pohimeve për keqtrajtim fizik të personave të arrestuar”.

Prandaj, MKPT e Avokatit të Popullit inkurajon Policinë e Kosovës që të shqyrtojë mundësinë e zbatimit të një sistemi të tillë të audio dhe video incizimeve të intervistave të të arrestuarve në pajtim me konstatimet e KPT-së dhe për këtë të njoftojë Avokatin e Popullit. MKPT ka vërejtur se në stacionet policore të vizituara, kamerat e sigurisë janë operacionale në hapësirat e stacioneve dhe në qelitë ku mbahen të arrestuarit, përveç në stacionin policor në Lipjan.

Pas vizitave në këto stacione policore, MKPT ka publikuar raportin për vizitën përmes të cilit i ka dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës rekomandimet si në vijim: të ndërmerren hapat e nevojshëm për të siguruar më shumë dritë natyrale në Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë; të krijohen kushte më të mira për punë për zyrtarët policorë në Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë; të bëhen rinovime dhe furnizime në Qendrën e Mbajtjes në Prizren; në të gjitha qelitë e stacioneve policore ku ka dhoma të mbajtjes të instalohen sistemet e thirrjeve; të funksionalizohen kamerat e sigurisë në Stacionin Policor në Lipjan.

Po ashtu, gjatë këtij viti MKPT ka vizituar Shtëpinë për të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare dhe ka konstatuar se në këtë institucion të kujdesit social nevojiten investime serioze nga autoritetet kompetente, sidomos në pjesën ku është vendosur shërbimi mjekësor. MKPT ka vërejtur se në këtë institucion janë të akomoduar edhe 3 persona të cilët janë nën moshën 65 vjeçare dhe persona me diagnoza të ndryshme psikiatrike, personat me aftësi të kufizuara mendore apo ngecje në zhvillim mendorë. Akomodimi i tyre në këtë institucion është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 07/2011 dhe Rregulloren Mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.

Gjatë vizitës, MKPT ka intervistuar një numër të rezidentëve dhe nuk ka pranuar asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo abuzime verbale, si dhe sjellje të cilat do të shkelnin dinjitetin njerëzor të rezidentëve në SHPMPF. MKPT çmon lartë angazhimin e personelit në kujdesin ndaj të moshuarve, sidomos ndaj të moshuarve të palëvizshëm. MKPT fitoi përshtypjen se marrëdhëniet e personelit me rezidentët janë të mira dhe miqësore.

Disa rezidentë u ankuan se gjatë natës është ftoftë, disa e njoftuan ekipin monitorues se përdorin nxehtësi gjatë mungesës së ngrohjes qendrore.

Bazuar në gjetjet gjatë vizitës, MKPT u rekomandoi autoriteteve kompetente si në vijim: Urgjentisht të bëhen investime sipas vlerësimit të nevojave, në ndërtesën e vjetër dhe hapësirat ku funksionon shërbimi mjekësor dhe shërbimi i stomatologjisë, rezidentët të furnizohen me inventar adekuat në dhomat e tyre, të furnizohet institucioni me një auto-ambulancë, shërbimi mjekësor të aplikojë protokolle për vetëlëndime, lëndime trupore, grevë urie, abuzime seksuale, vetëvrasje, si dhe vdekjeve në institucion, të organizohen trajnime specifike për personelin në pajtim me nevojat për trajtim të rezidentëve, të rritet numri i personelit sipas vlerësimit të nevojave nga shërbimi shëndetësor.

MKPT gjatë këtij viti ka vizituar edhe Qendrën e Mbajtjes për të Huajt. Në këtë qendër vendosen të huajt të cilët janë subjekt i kthimit me forcë. MKPT ka vërejtur se kushtet fizike të kësaj qendre janë të mira. Gjatë vizitës, MKPT ka intervistuar dy të huaj të cilët ishin të vendosur në këtë qendër të cilët nuk patën ankesa lidhur me kushtet e akomodimit dhe trajtimit nga zyrtarët e qendrës dhe zyrtarët e sigurisë. MKPT ka vërejtur se qendra posedon disa lloje broshurash në gjuhë të ndryshme përmes së cilave të huajt e akomoduar në këtë qendër njoftohen me të drejtat e tyre. Edhe më tej qendra nuk ofron mundësi për më shumë aktivitete për të huajt e akomoduar. Shërbimet mjekësore ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare dhe QKUK, kontrollet mjekësore për sëmundje ngjitëse në këtë qendër bëhen vetëm nëse shfaqen dyshime të cilat më pastaj verifikohen në institucionet përkatëse shëndetësore.

Gjatë vizitave në këto institucione, MKPT nuk ka pranuar asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues, zyrtarët policor apo sjellje të pahijshme në institucionet e kujdesit social të cilat do të cenonin dinjitetin e njeriut, të personave të moshuar.

Gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, MKPT ka pranuar 180 ankesa nga të burgosurit. Prej tyre 56 janë raste të hapura për hetim. Ndërsa, kundër Policisë, ka pranuar 85 ankesa, prej të cilave 35 janë hap për hetime të mëtejme. Ankesat e pranuar nga të burgosurit kanë qenë lidhur me vendimet e Panelit për Lirim me Kusht (PLK) të cilat ligjërisht nuk mund të ankimohen, e për të cilat IAP ka njoftuar PLK. MKPT ka pranuar ankesa edhe lidhur me të drejtën e shfrytëzimit të vikendeve dhe trajtimit jo të barabartë të të burgosurve; ankesa lidhur me çështjen e mos përgjigjeve të qendrave korrektuese në ankesat e parashtruara nga të burgosurit për shkak të zvarritjeve procedurale në trajtimin e rasteve të tyre në gjykata dhe prokurori, e të cilat nuk janë në mandatin e MKPT. Të gjitha këto ankesa MKPT i ka përcjellë tek departamenti i hetimeve për procedim të mëtejme dhe nga të cilat MKPT nxjerrë përfundime për situatën e përgjithshme në institucionin që inspektohet. Ankesat e pranuar nga MKPT lidhur me trajtimin shëndetësor, i ka hetuar dhe shumica e tyre kanë rezultuar të pabazuara.

Gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur, MKPT ka pranuar ankesa nga të miturit lidhur me ngecjet në vazhdimin e shkollimit për të mitur në këtë qendër, cilësinë e arsimit të ofruar dhe mos pajisjen me certifikata adekuate pas përfundimit të

shkollimit. Shqetësimet lidhur me këtë çështje MKPT ia ka përcjell departamentit të hetimit të ankesave dhe pas hetimit, IAP ka publikuar raportin me rekomandime përmes të cilit ka kërkuar nga autoritetet relevante që të nxjerrin aktet nënligjore të cilat janë relevante për mbarëvajtjen e procesit mësimor për personat e privuar lirie dhe të qartësohen kompetencat e ministrisë kompetente dhe komunave lidhur me këtë çështje. Kjo çështje vazhdon të mbetet pa u zgjedhur.

Edhe gjatë këtij viti shërbimi korrektuese ka vazhduar të udhëhiqet nga ushtruesit e detyrës. Gjatë vizitave MKPT ka vërejtur se institucionet korrektuese po përballen me kushte të vështira për punë dhe mungesa të kohëpaskohshme të materialeve për punë të përditshme, sidomos me mjete për radio-komunikim. Sipas zyrtarëve, kjo po ndodh për shkak të procedurave tenderuese për furnizime. Qendra e Paraburgimit në Lipjan dhe Qendra Korrektuese për Femra dhe të Mitur u përballën me mungesë të zyrtarëve korrektues për shkak se një numër i atyre ekzistues ishin duke ndjekur shkollimin në Akademinë e Sigurisë Publike në Vushtrri si dhe një numër kanë kaluar në Qendrën Edukativo – Korrektuese.

Gjatë këtij viti, Kosovën e ka vizituar Raportuesi Special i OKB-së kundër Torturës. Raportuesi Special u takua me Avokatin e Popullit dhe MKPT ku u shkëmbyen informata dhe diskutime lidhur me respektimin e të drejtave të personave të privuar lirie. Raportuesi Special po ashtu ka zhvilluar takime me zyrtarët qeveritar, shoqërinë civile dhe OJQ të cilat monitorojnë institucionet ku mbahen personat e privuar lirie. Gjatë vizitës në Kosovë, Raportuesi Special ka vizituar disa institucione ku mbahen personat e privuar lirie.

Edhe gjatë këtij viti, sfida për institucionet ku mbahen personat e privuar lirie ishte vendosja në njësi të veçanta e personave të paraburgosur dhe të dënuar me probleme mendore në pajtim me ligjet në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.

Një mbështetje në fuqizimin e MKPT – së është ofruar nga Këshilli i Evropës, i cili projekt shtrihet edhe te shërbimi korrektues dhe shërbimi shëndetësor i burgjeve. Në kuadër të kësaj, Departamenti i Shëndetësisë në Burgje në bashkëpunim me konsulentë nga Këshilli i Evropës ka përpiluar dokumentin e titulluar Praktikë Standarde e Veprimit në të cilën në hollësi do të përshkruhen veprimet e njësisve shëndetësore në qendrat e paraburgimit dhe burgje që nga momenti i pranimin të një të paraburgosuri apo të dënuari. MKPT ka qenë pjesë e punëtorisë ku janë diskutuar dispozitat e këtij dokumenti ku ka dhënë mendimin profesional lidhur me pajtueshmërinë e dokumentit me standardet ndërkombëtare për të drejtat e personave të privuar lirie. Ndërtimi i këtyre procedurave do të lehtësojë punën në shëndetësinë e burgjeve dhe njëkohësisht punën e MKPT.

9. Përmbledhja e raporteve me rekomandime

9.1 Raportet Ex Officio

Bazuar në autorizimet e dhëna Avokatit të Popullit me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 16, paragrafi 8 dhe nenin 27 të Ligjit

për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, Avokati i Popullit gjatë vitit 2017 ka publikuar raporte, opinione, amicus curiae, kërkesa për aplikim të masës së përkohshme, të përmbledhura si më poshtë:

9.2 Raport me rekomandime për rastin ex officio nr. 1/2017 lidhur me faturimin paushall të shpenzimeve të ujit nga kompanitë e ujësjellësit

Më 11 janar 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin ex officio nr 07/2017 i cili ka për qëllim të hulumtojë gjendjen brenda kornizave ligjore si dhe aplikueshmërinë e të njëjtave në praktikë, në lidhje me përcaktimin e tarifave të ujit aty ku nuk ka kushte teknike për vendosje të ujëmatësve. Raporti trajton sferën e mbrojtjes së konsumatorit në raport me aplikimin e rregullave të definuar me ligj dhe akte nënligjore si dhe ligjshmërinë e aplikimit të rregullave të përcaktuara nga ana e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (këtu e tutje referuar si: Autoriteti). Për më tepër, ky Raport shqyrton trajtimin e pabarabartë në bazë të përcaktimit të tarifave paushall, si dhe ndërhyrjen potenciale në të drejtën e pronës. Raporti bazohet në shkrimin e të përditshmes Koha Ditore me titull “*Ujësjellësi ua faturon ujin njësoj pronarëve të 20 banesave në Bregun e Diellit*” të datës 23 tetor 2016, që për bazë ka analizën e një problematike të tillë.

Pasuria e shprehur në të holla e konsumatorëve, e fituar përmes pagës apo edhe pensionit, paraqet “pronë” në pajtim me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, pjesë integrale kjo edhe e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në lidhje me këtë, çdo ndërhyrje në “pasurinë” e konsumatorit, që nuk është bërë në pajtim me ligj paraqet shkelje të kësaj të drejte. Faturimi i ujit assesi nuk mund të jetë shkelje e kësaj të drejte, por të njëjtën do ta shkaktojë faturimi i ujit në mënyrë jo proporcionale. Me gjithë faktin që ligji parasheh faturimin e ujit në mënyrë paushalle në raste të caktuara e në veçanti aty ku nuk ekzistojnë kushte teknike për të instaluar ujëmatës, ky faturim duhet të bëhet në mënyrë proporcionale dhe të drejtë. Faturimi i ujit paushall dhe në mënyrë jo proporcionale paraqet shkelje të së drejtës në pronë në bazë të nenit 1, Protokollit 1 të KEDNJ-së.,

Faturimi i ujit paushall dhe në mënyrë jo proporcionale, përveç që paraqet ndërhyrje në të drejtën pronësore të konsumatorëve ai paraqet edhe trajtim të pabarabartë. Me gjithë faktin se Ujësjellësi konsideron se me faturimin e ujit nëpër banesa kolektive bëhet njësoj, duke mos marrë për bazë faktorë të tjerë të cilët do të mund të kenë ndikim në faturimin proporcional të ujit paraqet trajtim të pabarabartë të konsumatorëve.

Me këtë raport Avokati i Popullit rekomandon që faturimi i ujit bëhet në bazë të konsumit real në njehsorin e konsumatorit dhe sipas shpenzimeve reale. Caktimi i çmimit paushall aty ku matja në bazë të ujëmatësit nuk është e mundur, të bëhet në pajtim me rregulloret në fuqi, veçanërisht në pajtim me Rregulloren për standardet minimale të shërbimit të ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë (R-03/U&K), neni 38 (b), dhe duke marrë parasysh licencimin e Ofruesit të Shërbimeve nga ana e Autoritetit, rekomandoi monitorimin më të rregullt të Ofruesit të Shërbimeve në lidhje me zbatimin e legjislacionit sekondar të miratuar nga vet Autoriteti. Pa marrë parasysh që një obligim i tillë është i paraparë me vet rregulloret e Autoritetit, ajo që është theksuar më lart, flet në

drejtim të ushtrimit të masave më të rrepta monitoruese në drejtim të parandalimit të ndërhyrjes së mëtutjeshme në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit dhe ushtrimin e së drejtës së pronës.

9.3 Raport me rekomandime ex officio nr. 44/2017 lidhur me zvarritjet procedurale në trajtimin e lëndëve nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

Më 31 janar 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime ex officio nr. 44/2017 i cili ka për qëllim të tërheqë vëmendjen autoriteteve përkatëse shtetërore lidhur me shkeljet e të të drejtave të njeriut të shkaktuara nga zvarritjet procedurale në trajtimin e lëndëve nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (Dhoma e Posaçme) dhe paraqitja e rekomandimeve për mënjanimin e këtyre shkeljeve. Raporti bazohet në 49 (dyzetëntë) ankesa të ndara të parashtruar para Institucionin e Avokatit të Popullit, lidhur me zvarritjet në trajtim nga Dhoma e Posaçme, duke mos llogaritur këtu edhe ankesat e paraqitura kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e që lidhen me çështjet që kanë të bëjnë me Dhomën e Posaçme, e që për nga natyra janë të ngjashme me ankesat kundër Dhomës së Posaçme, pasi që edhe këto ankesa varen nga vendimet përfundimtare të Dhomës. Ankesat e regjistruara në IAP datojnë që nga viti 2012 dhe lista e tyre i është bashkëngjitur si aneks Raportit të publikuar.

Në bazë të përgjigjeve që Avokati i Popullit ka pranuar nga Dhoma e Posaçme duket qartë se kemi të bëjmë me lëndë të grumbulluara dhe se një situatë e tillë është bërë e zakonshme për Dhomën e Posaçme që duket se është rezultat i numrit të kufizuar me ligj të gjyqtarëve, zëvendësimit të shpeshtë të gjyqtarëve, në veçanti gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe mungesës së këshilltarëve ligjor dhe përkthyesve. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se në rend të parë kemi të bëjmë me sjelljen e autoriteteve shtetërore karshi situatës në Dhomën e Posaçme.

KEDNJ përcakton obligimin e shteteve në organizimin sistemeve të tyre të drejtësisë, në mënyrë që gjykatat të përmbushin obligimin për të shqyrtuar rastet brenda afatit të arsyeshëm, pa marrë parasysh shpenzimet që mund të shkaktohen me këtë organizim. Përndryshe, shtetet do të mbahen përgjegjëse jo vetëm për zvarritjet në zgjidhjen e ndonjë rasti të veçantë por edhe për dështimin për të ngritur resurset për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara dhe mungesat strukturale në sistemin e drejtësisë që shkaktojnë zvarritje të tilla.

Kur bëhet fjalë për rastet e grumbulluara që presin të shqyrtohen, GJEDNJ dallon situatat kur kemi të bëjmë me rastet e grumbulluara për një kohë të caktuar, ku shteti mund të mos mbahet përgjegjës nëse me kohë ka ndërmarrë veprime të duhura për përmirësim të situatës dhe rastet e grumbulluara në mënyrë të vazhdueshme për të cilat shteti mbahet përgjegjës. Autoritetet përkatëse, me gjithë kërkesat nga Kryetari i Dhomës së Posaçme dhe ankesat e shumta të qytetarëve që janë palë në procedurë pranë Dhomës së Posaçme,

duket se nuk kanë ndërmarrë veprime për përmirësim të situatës sa i përket zgjidhjes së rasteve të grumbulluara.

Sipas praktikës së GJEDNJ është obligim i shteteve që të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të garantojnë të drejtën për marrjen e një vendimi përfundimtar për secilin qytetar lidhur me të drejtat dhe obligimet civile të tij, brenda një afati të arsyeshëm kohor (*Scordino kundër Italisë (no.1)*, § 183), ku ngarkesa e tepërt me lëndë nuk mund të merret në konsideratë (*Vocaturro kundër Italisë*, § 17; *Cappello kundër Italisë*, § 17). Në rast se zvarritja në vendosjen e rasteve është çështje e organizimit strukturor shteti duhet të sigurojë miratimin e masave efikase për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara (*Zimmermann dhe Steiner kundër Sëtzherland*, § 29; *Guincho v. Portugal*, § 40). Fakti se grumbullimi i rasteve është bërë i zakonshëm nuk arsyeton zvarritjet e jashtëzakonshme të procedurave (*Unión Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës*, § 40).

Avokati i Popullit konsideron se zvarritjet procedurale pranë Dhomës së Posaçme, mund të kenë shkaktuar shkelje të së drejtës në një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] si dhe të drejtës për mjete efektive juridike, neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore të të Drejtave] me të cilin parashihet e drejta në mjete efektive ligjore, të Kushtetutës dhe për këtë rekomandon që Qeveria e Kosovës, në bazë të rregullave dhe procedurave për nisma legjislative, të propozojë ndryshimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme, përkatësisht nenin 3.1 të Ligjit në mënyrë që të ofrohet qasje e drejtë dhe efektive për palët në procedurë pranë Dhomës së Posaçme. Po ashtu Këshilli Gjyqësor i Kosovës t'i ofrojë mbështetje Dhomës së Posaçme në aspektin organizativ dhe operativ në pajtim me kërkesat dhe nevojat e funksionimit adekuat të Dhomës së Posaçme. Ndërsa Dhoma e Posaçme të hartojë një strategji për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara duke vendosur jo vetëm shpërndarje të barabartë të rasteve për secilin gjyqtar, por edhe norma dhe afate brenda të cilave duhet të zgjidhet numër i caktuar i lëndëve nga secili gjyqtar.

9.4 Raport me rekomandime ex officio nr. 265/2017 lidhur me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës

Më 13 qershor 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime nëpërmjet të cili ngriti shqetësimin tij në lidhje me mënyrën e faturimit të energjisë elektrike. Energjia elektrike e shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, përkatësisht Leposaviq, Mitrovica Veriore, Zubin Potok dhe Zveçan, faturohet tek konsumatorët e pjesës tjetër të Republikës, në shumën 8 milion euro në vit. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (në tekstin e mëtejshëm: “ZRRE”) dhe Departamenti i Energjisë i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (në tekstin e mëtejshëm: “Departamenti i Energjisë”), në komunikime ndërinstitucionale me Avokatin e Popullit, kanë pretenduar se kjo praktikë e faturimit është në përputhje me ligjet në fuqi për rregullimin e fushës së energjisë, në veçanti, me Ligjin Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjin Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike. Në lidhje me këtë raporti ka tri qëllime kryesore a) që të

vlerësojë nëse kjo praktikë e faturimit është vërtet në përputhje me legjislacionin e cituar nga ZRRE dhe Departamenti i Energjisë; b) të vlerësojë nëse kjo praktikë e faturimit paraqet shkelje të të drejtave të njeriut, përkatësisht të së drejtës së pronës, të drejtës për të mos u diskriminuar dhe të drejtave të konsumatorit; c) dhe për t'ju dhënë institucioneve kompetente rekomandime specifike dhe konkrete lidhur me veprimet që duhet të ndërmarrin për respektimin e plotë të ligjeve në fuqi dhe të të drejtave të njeriut.

Meqenëse faturimi i rrymës së shpenzuar në veri nuk ka mbështetje në ligj, Avokati i Popullit ka analizuar edhe Vendimin e ZRRE V_399_2012, të datës 6 shkurt 2012, që sipas ZRRE përbën bazë për faturimin e rrymës në veri. Me sa mund të kuptohet vendimi ka të bëjë me rritjen e investimeve në KEDS për të evituar humbjet të cilat përcaktohen me ligj. Po ashtu, vërehet se Vendimi është nxjerrë më 6 shkurt 2012, ndërsa Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) dhe Kompania e Furnizimit Publik (KESKO) kanë marrë funksionet e shpërndarjes dhe furnizimit në maj të vitit 2013.²⁰⁹ Vërehet se autoritetet përkatëse të Republikës së Kosovës paraprakisht kanë krijuar kushte të favorshme për KEDS dhe KESKO duke u garantuar investime për të mbuluar ato humbje që përcaktohen me ligj. Arsyetimi i ZRRE se vlera prej 8 milionë euro është e papërbalueshme për KEDS nuk është i qëndrueshëm. Lidhur me këtë arsyetim, Avokati i Popullit, gjatë takimit të zhvilluar me ZRRE-në më 22 maj 2017, ka pyetur për shumën e përfitimeve vjetore të KEDS-it. Pyetje për të cilën nuk është pranuar përgjigje. Në mungesë të këtij informacioni kyç, Avokati i Popullit refuzon ta marrë si të mirëqenë pretendimin se humbjet në fjalë janë të papërbalueshme për KEDS-in. Nuk janë të qëndrueshme as pretendimet se shpenzimet e rrymës së shfrytëzuar në veri janë humbje të arsyeshme që duhet të mbulojnë nga qytetarët në pjesë të tjera të territorit të Kosovës, ndërsa të njëjtën kohë të arsyetohet se këto humbje kanë kosto të lartë për t'u përbaluar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sepse nuk dihet më të vërtetë nëse këto janë humbje të nivelit të arsyeshëm apo janë humbje me kosto të papërbalueshme.

Avokati i Popullit konsideron se pretendimet e ZRRE-së dhe Departamentit të Energjisë së MZHE-së se furnizimi me energji elektrike i qytetarëve është obligim ligjor duhet të jenë të qarta dhe të bazuara. Ligji për Energjinë Elektrike, neni 1, përcakton se qëllimi i ligjit është “. . . për të garantuar furnizim të sigurt . . . *me çmime reale* . . .” (theks i shtuar). Edhe ku flitet për “shërbimin universal të furnizimit”, Ligji e ndërlidh këtë koncept me caktimin e “çmimit të arsyeshëm” (*po aty*, neni 3, par. 1, nënpar. 72). Këto dispozita lënë të kuptohet se garantimi i furnizimit të energjisë elektrike nuk është falas.

Është e qartë se praktika e faturimit në fjalë përbën trajtim jo të barabartë ndërmjet personave në situata të ngjashme. Përkatësisht, disa shfrytëzues të energjisë elektrike nuk paguajnë për sasinë energjisë që e shpenzojnë, ndërsa shfrytëzuesit e tjerë paguajnë jo vetëm për pjesën që e shpenzojnë ata vetë, por edhe për pjesën e shpenzuar nga ata që

²⁰⁹ Informata e siguruar nga përgjigja e Departamentit të Energjisë të MZHE dërguar Avokatit të Popullit më 29 maj 2017.

nuk paguajnë. Në këtë mënyrë, KEDS-i, me autorizimin e ZRRE, nuk trajton të gjithë shfrytëzuesit e rrjetit elektrik sipas të njëjtit standard.

Avokati i Popullit konsideron se me gjithë perceptimin e mundshëm të publikut se pabarazia bazohet mbi *përkatësinë etnike*, këtu kemi të bëjmë me një pabarazi jo në bazë të *përkatësisë etnike*, por në bazë të *vendbanimit*: Banorët në veri të Republikës nuk detyrohen të paguajnë për sasinë e energjisë që e harxhojnë, ndërsa banorët në pjesën tjetër të Republikës detyrohen të paguajnë për sasinë e energjisë që e harxhojnë vetë, si dhe për atë të harxhuar nga banorët në veri. Kjo nuk mund të cilësohet si një pabarazi mbi baza etnike, përderisa në veri të Republikës ka banorë që nuk janë të komunitetit serb dhe, po ashtu, në pjesën tjetër të Republikës ka banorë që nuk janë të komunitetit shqiptar. Me këtë raport Avokati i Popullit autoriteteve ju drejtoi tri rekomandime a) ZRRE urgjentisht të ndalë praktikën e kundërligjshme të faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në veri të Republikës së Kosovës tek konsumatorët në pjesën tjetër të vendit; b) Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me ZRRE-në dhe KEDS-in, të gjejë një mënyrë alternative për t'iu shmangur humbjeve në veri të vendit, duke trajtuar të gjithë konsumatorët në mënyrë të barabartë sipas normave kushtetuese dhe ligjore kundër diskriminimit; c) ZRRE-ja, në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, të nxjerrë një vendim, me anë të të cilit do të miratohej zbritja e tarifave deri në atë masë që do të mundësonte kompensimin e konsumatorëve të cilët, padrejtësisht, janë faturuar, dhe vazhdojnë të faturohen, për energjinë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore.

Meqenëse rekomandimet nuk u morën parasysh, Avokati i Popullit në pajtim me autorizimet e dhëna me Kushtetutë dhe ligj, më 15 gusht 2017 parashtrij padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative për anulimin në tërësi të vendimit të ZRRE-së V_399_2012, të datës 6 shkurt 2012, si dhe të obligohet ZRR që të bëjë kompensimin e konsumatorëve të cilët faturohen për shpenzimin e energjisë elektrike në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës. Meqenëse vazhdimi i zbatimit të një vendimi të tillë do të shkaktonte dëme të pariparueshme për qytetarët e Kosovës Avokati i Popullit bashkë me padinë i parashtrij Gjykatës edhe kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit.

Përderisa padia është në procedura të shqyrtimit, Gjykata Themelore në Prishtinë veprimi në përputhje me kërkesën e Avokatit të Popullit shtyrje të ekzekutimit të vendimit duke e aprovuar në tërësi kërkesën me datë 11 shtator 2017. Ky vendim i Gjykatës Themelore, me datë 20 tetor 2017, u vërtetua edhe nga Gjykata e Apelit.

9.5 Raport me rekomandime ex officio nr. 278/2017 lidhur me mostrajtimin e personave me çrregullime kronike psikiatrike konform procedurave ligjore

Më 21 gusht 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime lidhur me mostrajtimin adekuat të personave me çrregullime kronike psikiatrike konform

procedurave ligjore nga komuna e Shtërpcës. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së autoriteteve të Komunës së Shtërpcës, Qendrës për Punë Sociale, Gjykatës Themelore në Ferizaj, lidhur me obligimet pozitive që kanë për trajtimin e personave me çrregullime të rënda mendore, e që do të rezultonte me mbrojtjen dhe sigurinë e cila është e atakuar nga veprimet e pa përgjegjshme të këtyre personave.

Avokati i Popullit në këtë rast i filloi hetimet duke u bazuar në artikullin e gazetës “*Koha Ditore*” me titull “*Personat e sëmurë Mendorë Rrezikojnë Qytetarët dhe Pronat*” të datës 11 prill 2017, ku përfaqësues të OJQ “Handicap Kosova”, dega në Ferizaj, kanë akuzuar institucionet komunale dhe Qendrën e Shëndetit Mendor për mostrajtimin e duhur të personave me çrregullime kronike psikiatrike, të cilët si pasojë e këtij mostrajtimi po shkaktojnë probleme duke dëmtuar pronën publike dhe private. Këta persona sipas shkrimit paraqesin rrezik potencial për sigurinë dhe pasurinë e qytetarëve.

Avokati i Popullit pas hetimi të rastit vëren se në rastin në fjalë dhe rastet tjera të natyrës së njëjtë, institucionet nuk kanë ndërmarrë veprimet për të cilat ligji i obligon, në drejtim të parandalimit të problemeve që lidhen personat me çrregullime mendore. Madje, vërehet mos veprim i institucioneve në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës së këtyre personave të cilët bredhin rrugëve të pa ushqyer dhe të pa trajtuar, duke paraqitur rrezik për rrethin, dhe njëherit janë vetë të rrezikuar. Neglizhenca e institucioneve dhe organeve kompetente ndaj personave të sëmurë mendorë, bie në kundërshtim të plotë me Ligjin për Shëndetin Mendor Nr. 05/L -025, i cili në nenin 1 përcakton qartë se: “*Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore*”.

Nga hetimi i këtij rasti rezulton se B.V. është nga Komuna e Shtërpcës, dhe kompetent për trajtimin psikiatrik të të cilit është QSHM në Ferizaj. Në këtë qendër aktualisht trajtohen pacientë me probleme psikiatrike (*neuroza, depresion, psikoza, Schizophreni*). Edhe pse disa nga këta pacientë kanë tentuar të vetë lëndohen, të vetëvriten, kanë kryer vepra penale të dëmtimit të pasurisë, vepra penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, këta nuk janë trajtuar konform ligjit nga ana e institucioneve kompetente. Për aq më tepër institucionet (QSHM, QPS, gjykatë) nuk kanë bashkëvepruar, që do të ishte një premisë e domosdoshme për trajtimin adekuat të këtyre personave konform ligjeve në fuqi. Ndërsa, QPS në Komunën e Shtërpcës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të paraqitjes së kërkesës për një urdhër kujdestarie për rastin B.V. i cili është pa përkujdesje familjare dhe vazhdimisht në bredhje.

Me këtë rast Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Shtërpcës dhe Qendrën për Punë Sociale që në pajtim me kompetencat ligjore, të ndërmarrë masa urgjente për trajtimin e rastit B.V. dhe rastet tjera eventuale të kësaj natyre brenda kompetencës së kësaj qendre. Ndërsa, Gjykatës Themelore në Ferizaj, që të trajtojë me urgjencë propozimin e Prokurorit të PTHF P.949/15, të datës 7 gusht 2015, për Shqiptimin e Masës së Trajtimin të Detyrueshëm Psikiatrik për B.V.

9.6 Raport me rekomandime ex officio nr. 575/2016 lidhur me të drejtën në arsim për personat e privuar nga liria - mosrespektimi i afatit ligjor për fillimin e procesit mësimor në Qendrën Korrektuese në Lipjan

Më 5 shtator 2017, Avokati i Popullit publikoj raportin me rekomandimi lidhur me të drejtën në arsim për personat e privuar nga liria - mosrespektimi i afatit ligjor për fillimin e procesit mësimor në Qendrën Korrektuese në Lipjan. Ky raporti ka për qëllim të tërheq vërejtjen për një nga të drejtat themelore të njeriut, siç është e drejta në arsim, përkatësisht mundësia e kësaj të drejte për të miturit në Qendrën Korrektuese në Lipjan (QKL). Në këtë drejtim raporti trajton problematikën e vonesave dhe mangësive të tjera në lidhje me organizimin e procesit mësimor në QKL, dhe në bazë të konstatimeve t'u rekomandohet institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës që të ndërmarrin masat e duhura që procesi mësimor në QKL të realizohet në mënyrë efikase. Raporti synon që të bëjë një analizë të përmbledhur të këtij problemi.

Avokati i Popullit thekson se arsimimi i të miturve që janë të dënuar dhe qëndrojnë në institucionet korrektuese është një nga detyrimet kryesore të institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës që buron nga Kushtetuta, ligjet në fuqi, dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare. Si i tillë ky detyrim i institucioneve për të realizuar një nga të drejtat themelore të njeriut, siç është ofrimi i mundësisë për arsim për të rinjtë nuk mund të shmanget as për të miturit që qëndrojnë në qendrat korrektuese, si në rastin konkret QKL. Për më tepër, Avokati i Popullit tërheq vërejtjen se kjo e drejtë për të miturit e dënuar duhet të mundësohet në kuadër të QKL ose edhe jashtë institucionit, përkatësisht në shkollat publike të rregullta.

Nga të dhënat e siguruara nga hulumtimi i realizuar nga zyrtarët e IAP, vërehet se vonesat në fillimin e procesit mësimor në QKL kanë qenë të vazhdueshme edhe në vitet paraprake. Këto vonesa kaë ndodhur për shkak të mos koordinimit me kohë ndërmjet institucioneve kompetente, përkatësisht DKA-së në Lipjan dhe MASHT, mungesa e mësimdhënësve, mungesa e ndarjes së mjeteve buxhetore (granteve specifike) nga MASHT, etj. Me këtë rast Avokati i Popullit rekomandoi MASHT që në bazë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të ndërmerren masat e nevojshme a) që të nxjerr aktet nënligjore që përcaktohen me ligj në lidhje me organizimin e procesit mësimor për personat e privuar nga liria, përfshirë edhe të miturit që qëndrojnë në QKL duke adresuar nevojat e tyre. Në këtë kuadër është e nevojshme të ndryshohet edhe *parag.1* i nenit 4 të *Udhëzimit Administrativ nr.16/2011, të datës 30.12.2011*, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje për kërkesat për ndërrimin e profileve arsimore për nxënësit në QKL edhe jashtë afateve që aktualisht janë përcaktuar në këtë udhëzim; b) Me akte nënligjore duhet të adresohen qartësisht përgjegjësitë që i takojnë MASHT-it dhe komunave, në këtë rast Komunës së Lipjanit për mbarëvajtjen e mësimimit në QKL; c) Që me kohë dhe sipas nevojave të ndaj buxhetin në lidhje me organizimin e procesit mësimor në QKL dhe qendrat e tjera korrektuese. Në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit si dhe ministritë

relevante të sigurohet buxhet i mjaftueshëm për angazhimin e mësimdhënësve në QKL. Ndërsa Komunës së Lipjanit i rekomandoi që duke u bazuar edhe në Vendimin e Ministrisë të MASHT Nr.294/01B të datës më 22 tetor 2012, dhe në bashkëpunim me MASHT-in, pa vonesa të mëtejme të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që të miturit të pajisen me dokumentacion shkollor me rastin e lirim të QKL.

9.7 Raport me rekomandime ex officio nr. 582/2017, lidhur me trajtimin e punëve të pambaruara nga legjislatura e kaluar, sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Më 12 shtator 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime në lidhje me trajtimin e punëve të pambaruara nga legjislatura e kaluar sipas rregullores së Kuvendit. Në verzionet e gjuhës shqipe dhe të gjuhës serbe të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: “Rregullorja”), neni 86 i Rregullores, i cili e ka titullin “Punët e pambaruara”, përcakton se: “Në fund të mandatit të Kuvendit, të gjitha punët që i janë besuar atij konsiderohen *të përfunduara*” (theks i shtuar). Në komunikime ndërinstitucionale me Avokatin e Popullit, zyrtarë ligjorë të Kuvendit kanë pretenduar se fjalët “*të përfunduara*”, siç përdoren në këtë dispozitë, duhet të trajtohen si të barabarta me “*të anuluar*”. Sipas këtij interpretimi, të gjitha punët e pambaruara në fund të një mandati nuk mund të vazhdohen më në fillim të mandatit tjetër, por duhet të rikthehen në hapin e parë. Ky raport ka katër qëllime kryesore: a) Të argumentojë se fjalët “*të përfunduara*”, sipas logjikës gjuhësore dhe në bazë të kontekstit, nuk duhet të interpretohen si të barabarta me “*të anuluar*”; b) Të argumentojë se fjalët “*të përfunduara*”, interpretuar saktë, e lënë të pavendosur çështjen se si një Kuvend i ri duhet t’i trajtojë punët e pambaruara prej Kuvendit të kaluar; c) Të argumentojë se, në bazë të parimeve të demokracisë dhe të efikasitetit legjislativ, si dhe në përputhje me praktikën e Parlamentit Evropian, Rregullorja duhet të plotësohet për t’i dhënë çdo Kuvend të ri të drejtën që, me vendimin e Kryesisë, t’i vazhdojë punët e pambaruara të Kuvendit të kaluar, në vend që t’i kthejë të gjitha këto punë në hapin e parë; ç) T’i japë Kuvendit rekomandime konkrete për rregullimin e kësaj çështjeje, në bazë të argumenteve të lartpërmendura.

Ndryshe nga versionet zyrtare, versioni i nenit 86 në gjuhën angleze përcakton se: “Në fund të mandatit të Kuvendit, të gjitha punët që i janë besuar atij konsiderohen të *papërfunduara* [unfinished]” (theks i shtuar). Kjo do të thotë se fjalët kyçe të kësaj dispozite (“*të përfunduara*” në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe; “*të papërfunduara*” në gjuhën angleze), jo vetëm që s’janë të barabarta në tri versionet e Rregullores por janë edhe *plotësisht kontradiktore dhe të kundërta*. Kjo mospërputhje serioze duket se është trashëguar nga edicioni i mëhershëm i Rregullores, në të cilin ekziston e njëjta mospërputhje ndërmjet versioneve gjuhësore të dispozitës në fjalë (*shih* Rregulloren e Punës së Kuvendit të vitit 2005, të ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2006, neni 63, në të tria versionet gjuhësore).

Në fakt, Avokati i Popullit konsideron se detyrimi i Kuvendit për të kthyer të gjitha punët e pambaruara në hapi në parë, jo vetëm që nuk kërkohet nga parimet demokratike, por do të përbënte shkelje të po atyre parimeve. Sipas parimeve demokratike, një Kuvend i zgjedhur nga populli, duhet të gëzojë kompetencë të gjerë për të vendosur vetë se si do të trajtojë secilën punë që ngelet nga legjislatura e kaluar. Duhet të gëzojë të drejtën për të vendosur, për secilën punë të tillë, ose të vazhdojë atë punë aty ku është lënë, ose ta anulojë dhe ta rinisë prej fillimit.

Neni 86 i Rregullores aktuale të Kuvendit e lë në pikëpyetje çështjen se si Kuvendi i sapo zgjedhur duhet t'i trajtojë punët e pambaruara nga legjislatura e kaluar. Respektimi i plotë i parimeve të efikasitetit legjislativ dhe të demokracisë, kërkon që Kryesia e Kuvendit të ketë kompetencë për të vendosur, me kërkesë të komisioneve dhe institucioneve të ndryshme, të vazhdojë punët e pambaruara nga legjislatura e vjetër, në vend që t'i rinisë këto punë nga hapi i parë. Në bazë të këtyre që u thanë më lartë, Avokati i Popullit rekomandoi Kuvendit të Kosovës që: të sqarojë shprehimisht se neni 86 i Rregullores së Kuvendit e lë të pavendosur çështjen se si një Kuvend i sapo zgjedhur duhet t'i trajtojë punët e pambaruara nga legjislatura e kaluar; dhe Të plotësojë Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës për të përcaktuar se Kryesia e Kuvendit, në fillim të çdo legjislature, do të gëzojë të drejtën për të vendosur, me kërkesë të komisioneve dhe institucioneve të ndryshme, të vazhdojë punët e pambaruara nga legjislatura e kaluar, në vend që t'i rifillojë këto punë nga hapi i parë.

9.8 Raport me rekomandime ex officio nr. 594/2017, lidhur me mbrojtjen efektive në procedurë penale dhe garantimin e barazisë së palëve – caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike

Më 19 shtator 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime lidhur me mbrojtjen efektive në procedurë penale dhe garantimin e barazisë së palëve – caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike. Në zbatim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, Avokati i Popullit nëpërmjet këtij raporti trajton bazën ligjore në lidhje me të drejtën e të pandehurve në procedurë penale që të kenë avokat mbrojtës, duke u fokusuar edhe në të drejtën e caktimit të mbrojtësit pa pagesë (me shpenzime publike) në raste kur i pandehuri nuk ka mundësi financiare. Barazia e palëve si parim themelor i procedurës penale bashkëkohore është pjesë integrale e gjykimit të drejtë, si e drejtë që përcaktohet edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ). Raporti të drejtën për të pasur avokat mbrojtës në procedurë penale e analizon në frymën e KEDNJ dhe vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si burime primare sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Janë tri qëllime që raporti synon: të analizojë problemet dhe sfidat aktuale në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë në lidhje me mos garantimin e të drejtës për mbrojtje efektive, përkatësisht garantimin e mbrojtësit pa pagesë për të pandehurit; të analizojë detyrimet e institucioneve të drejtësisë (në veçanti gjykatës) që burojnë nga Kushtetuta, KPP dhe legjislacioni tjetër në fuqi për të garantuar të drejtën në mbrojtje efektive në

procedurë penale, duke interpretuar me saktësi dispozitat ligjore në fuqi; të rikujtojë detyrimet për organet e drejtësisë që dalin nga aktet ndërkombëtare në raport me garantimin e të drejtës për mbrojtje efektive në çështjen penale, në veçanti nga KEDNJ dhe vendimet e GJEDNJ në lidhje me këtë të drejtë; në bazë të konstatimeve të arritura të jap rekomandime konkrete si zgjidhje për të ardhmen, në pajtim me autorizimet kushtetuese dhe ligjore të Avokatit të Popullit.

Duke u nisur nga vetë pozita e personit të pandehur në procedurë penale, i cili përballet me dyshimin e kryerjes së veprës penale, dhe mundësinë e shqiptimit të sanksioneve penale, e bën të domosdoshme nevojën e respektimit rigoroz të të drejtave dhe garancive procedurale ndaj tij. Në këtë drejtim, ka rëndësi të posaçme që i pandehuri të jetë i barabartë me prokurorin e shtetit i cili përfaqëson organin e akuzës, që shprehet me parimin e barazisë së palëve në procedurë penale. Barazia e palëve në procedurë penale nënkupton në rend të parë një barazi nga aspekti profesional ndërmjet të pandehurit dhe prokurorit të shtetit. Në këtë drejtim, duke u nisur nga fakti se të pandehurit në shumicën e rasteve janë laik (pa përgatitje juridike) dhe në anën tjetër kanë një ngarkesë të veçantë emocionale për shkak të pozitës procedurale, një barazi e tillë profesionale mund të vijë në shprehje vetëm nëse i pandehuri përfaqësohet nga avokati.

Në sistemin e drejtësisë në Kosovë në lidhje me mbrojtjen në procedurë penale përcaktohet sistemi i mbrojtjes së detyruar dhe sistemi i mbrojtjes jo të detyruar (fakultative). Problemi kryesor që paraqitet në praktikën e gjykatave në Kosovë ka të bëjë me caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike në rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar sipas ligjit, pra është fakultative e që përbën edhe fokusin kryesor të analizës.

Detyrimi i institucioneve të drejtësisë së Kosovës për të zbatuar standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut buron nga Kushtetuta, përkatësisht neni 22 i saj, ku listohen disa nga aktet themelore për të drejtat e njeriut të cilat *“zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike...”*. Ky parim vlen edhe në lidhje me të drejtën për të pasur avokat mbrojtës në procedurë penale, përfshirë edhe caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike. Me qëllim të argumentimit të kësaj të drejte themelore, Avokati i Popullit në vijim do të analizoj dispozitat e këtyre akteve, me fokus interpretimet e dhëna në vendimet e GJEDNJ.

Përderisa Kodi i Procedues Penale përveç rasteve kur mbrojtja është e detyruar (në rastet kur i pandehuri nuk angazhon avokat mbrojtës, ai caktohet sipas detyrës zyrtare), përcaktohet edhe mundësia e caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike kur mbrojtja nuk është e detyruar. Kjo e fundit, sipas KPP është lënë në diskrecion të gjykatës, që pas kërkesës se personit të pandehur dhe deklaratës se nuk ka mundësi financiare të paguaj shpenzimet e mbrojtjes, të vlerësohet nëse këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë.

Avokati i Popullit, në lidhje me objektin kryesor të trajtimit në këtë raport, dhe duke u bazuar nga të gjeturat e monitorimit të praktikës së gjykatave penale në Kosovë, konstaton se: Gjykatat në Kosovë në shumicën absolute të rasteve penale, ku sipas KPP

mbrojtja nuk është e detyruar, nuk kanë caktuar mbrojtës me shpenzime publike. Madje, edhe në rastet kur është shqiptuar dënimi me burgim, të pandehurit janë gjykuar pa avokat mbrojtës.

Kjo praktikë, parqet shkelje të detyrimeve ligjore dhe kushtetuese që kanë gjykatat në lidhje me garantimin e të drejtës për mbrojtje efektive për të pandehurin në procedurë penale. Si e tillë, kjo praktikë e gjykatave paraqet shkelje të parimit të barazisë së armëve në procedurë penale. Për me tepër, kjo përbën shkelje të obligimeve që dalin nga aktet ndërkombëtare, si PNDCP, KEDNJ dhe me vendimet e GJEDNJ në lidhje me të drejtën që i pandehuri të ketë mbrojtje juridike falas.

Avokati i Popullit e konsideron të domosdoshme që këto praktika të mos përsëriten në të ardhmen, në mënyrë që vendimet e organeve të drejtësisë penale, në lidhje me caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike (në rastin kur mbrojtësi nuk caktohet sipas detyrës zyrtare) të jenë në pajtim me detyrimet kushtetuese, ligjore dhe standardet ndërkombëtare që janë të obligueshme (me theks KEDNJ dhe vendimet e GJEDNJ). Avokati i Popullit rekomandoi Ministrinë e Drejtësisë/Departamentin Ligjor që në kuadër të reformës për ndryshim/plotësim të KPP të përcaktohet në mënyrë me të qartë e drejta për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike, që kjo e drejtë të jetë e obligueshme dhe në pajtim me praktikën e ndërtuar nga GJEDNJ; Gjykatën Supreme të Kosovës, që në bazë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të nxjerrë mendim juridik për të udhëzuar gjykatat e shkallës me të ultë që të zbatojnë vendimet e GJEDNJ, edhe në lidhje me caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike, dhe mbi standardet e kësaj gjykate të respektohet edhe parimi i barazisë së palëve në procedurë penale; Këshillin Gjyqësor të Kosovës që të udhëzoj të gjitha gjykatat, në mënyrë që gjyqtarët në çështjet penale të kenë kujdes të shtuar për respektim rigoroz të të drejtës së të pandehurit për të pasur mbrojtës, në veçanti për të drejtën që mbrojtësi të caktohet me shpenzime publike. Në këtë qëllim si referencë kryesore të jetë praktika e GJEDNJ si dhe të kujdeset për të propozuar një buxhet me të lartë në lidhje me mbulimin e shpenzimeve të mbrojtjes, për rastet kur mbrojtësi duhet të caktohet me shpenzime publike; Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Kryeprokurorin e Shtetit: që në bazë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të ndërmarrim masat e nevojshme që të udhëzojnë dhe mbikëqyrin respektimin e të drejtës së personave të pandehur për t'u informuar në kohë mbi të drejtën për të pasur mbrojtës, në veçanti për të drejtën e caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike, dhe që e drejta e mbrojtjes dhe parimi i barazisë së armëve në procedurë penale (me theks në fazën e hetimit dhe ngritjes së aktakuzës) të respektohet në mënyrë rigoroze dhe në pajtim me standardet me të larta profesionale; Akademinë e Drejtësisë/Këshillin Programor që në kuadër të programit të tyre të ofrojnë trajnime shtesë të fokusuara mbi të drejtën e personit të pandehur për të pasur avokat mbrojtës, në veçanti për të drejtën e caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike. Që trajnimet për këtë qëllim të kenë si referencë kryesore praktikën e GJEDNJ.

9.9 Raport me rekomandime ex officio nr. 551/2017, lidhur me heqjen e kompetencave të caktuara të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, sipas Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Më 19 tetor 2017, Avokati i Popullit Ligji publikoi raportin lidhur me heqjen e kompetencave të caktuara të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, sipas Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Sipas ligjit në fjalë parashihet heqja e dy kompetencave të rëndësishme të kësaj Agjencie (në tekstin e mëtejshëm: “Agjencia” ose “AKKVP”). Së pari, Ligji përcakton se, pas 18 muajsh nga hyrja në fuqi e Ligjit, Agjencia nuk do të vazhdojë më administrimin e pronave nën kujdesin e saj. Së dyti, për çdo rast ku AKKVP kryen dy dëbime të uzurpuesve të një prone të njëjtë, Ligji për AKKVP parashikon se përgjegjësia për çdo dëbim tjetër lidhur me atë pronë, do të kalohet tek vetë pronari, brenda sistemit të rregullt të përmbartimit privat. Raporti ka dy qëllime kryesore: të vlerësoi nëse heqja e këtyre dy kompetencave të AKKVP-së paraqet shkelje të të drejtave të pronarëve sipas Kushtetutës dhe standardeve evropiane dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; dhe për t’u dhënë autoriteteve kompetente rekomandime konkrete dhe specifike për hapat që duhet të ndërmerren për respektimin e plotë të të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit vlerëson se heqja e këtyre dy kompetencave prej fushëveprimit të AKKVP-së — kompetenca për të administruar pronat, duke përfshirë skemën e qirasë, si dhe kompetenca për të kryer dëbime pas dy uzurpimeve të së njëjtës prone — paraqet shkelje të *së drejtës së pronës*, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe instrumenteve evropiane dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Parimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Rikthim të Banimit dhe Pronave për Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur (të ashtuquajtur “Parimet e Pinheiros”), japin mbështetje të mëtejshme këtij qëndrimi, duke theksuar obligimin pozitiv të shtetit për mbrojtjen e së drejtës së pronës. Këto parime e bëjnë të qartë se shteti nuk mund të heqë dorë prej mbrojtjes të së drejtës së pronës të personave të zhvendosur. Kjo mbrojtje është pjesë e obligimit të tij pozitiv. Ndërprerja e mekanizmit të vetëm ekzistues për administrimin e pronave pas afatit 18 muajsh paraqet mosrespektim të këtij obligimi dhe shkelje të së drejtës së pronës, sipas Kushtetutës dhe instrumenteve evropiane dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit konsideron, gjithashtu, se kjo ndërprerje mund të ketë pasoja të rënda për shkak të disa rrethanave të veçanta të Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit, gjithashtu konstaton se, kalimi i barrës për ekzekutimin e vendimeve për dëbim tek pronarët, paraqet shkelje të së drejtës së pronës. Duke u bazuar në vendimet e GJEDNJ-së, të cituara më lart, Avokati i Popullit konsideron se, me kalimin e ekzekutimit të dëbimeve tek vetë pronarët, Ligji e pengon përmbushjen e obligimit pozitiv për të mbrojtur të drejtën e pronës, duke përfshirë obligimin për të siguruar që, “pasi një zgjidhje të miratohet nga Shteti, ajo . . . të implementohet me qartësi dhe

koherencë të arsyeshme, në mënyrë që t'i shmanget, aq sa të jetë e mundur, pasigurisë juridike dhe mëdyshjes për personat e prekur nga masat e implementimit të saj” (Paduraru, GJEDNJ, *op. cit.*, par. 92).

Duke e detyruar Agjencinë që të heqë dorë prej kryerjes së dëbimit pas dy riuzurpimeve, Ligji e shkel obligimin që “çdo Shtet . . . t'i sigurojë vetes një arsenal adekuat dhe të mjaftueshëm për të siguruar përbushjen e obligimeve pozitive të imponuara mbi të” (*po aty*, par. 93; theks i shtuar).

Në këtë raport Avokati i Popullit rekomandoi që neni 21, par. 7, i Ligjit për AKKVP, (“Agjencia administron pronat dhe zbaton skemën e qirasë sipas këtij neni, më së largu deri tetëmbëdhjetë (18) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji”), të hiqet në tërësi; Neni 19, par. 7 i Ligjit për AKKVP, (“Për çdo ri uzurpim pasues [pas dy dëbimeve] të pronës se njëjtë, do të zbatohen rregullat e procedurave të përgjithshme të përmbarimit bazuar në të njëjtin vendim/aktgjykim dhe urdhër dëbimi si dokumente përmbaruese”), të hiqet në tërësi; dhe Neni 19, par. 6, Ligji për AKKVP, të ndryshohet si në vijim: “Për çdo ri uzurpim pas kohës së përmbarimit të urdhëresës për dëbim, pas njoftimit nga parashtruesi i kërkesës për ri uzurpimin e kundërligjshëm të pronës Agjencia do ta ri përmbaroj atë edhe një herë përmes ri dëbimit të uzurpuesit nga prona bazuar në urdhëresën e re të lëshuar, duke i respektuar procedurat e paragrafit 3-5 të këtij neni. Për ri dëbim, Agjencia do ta informojë paraqitësin e kërkesës për ditën e ri dëbimit dhe do ta ftojë të jetë i pranishëm gjatë ri dëbimit. Nëse parashtruesi i kërkesës apo i autorizuari i tij/saj dështon të merr pjesë në ri dëbim, Agjencia do ta përmbarojë dëbimin dhe do të lëshojë vërtetim të ri posedimit”.

9.10 Raport me rekomandime ex officio nr. 707/2017 lidhur me lirinë e shprehjes (medieve) dhe sigurinë e gazetarëve

Më 2 nëntor 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime ex officio lidhur me lirinë e shprehjes (medieve) dhe sigurinë e gazetarëve. Qëllimi i këtij raporti është trajtimi i lirisë së shprehjes, si e drejtë themelore në Republikën e Kosovës, me theks të veçantë, sigurinë e gazetarëve në përbushjen e misionit që kanë. Ky raport është iniciuar si përgjigje ndaj shqetësimeve mbi cenimin e lirisë së shprehjes, me theks në lirinë e medieve dhe sigurisë së gazetarëve në Kosovë.

Tendenca për kufizim të lirisë së shprehjes, sfidat e gazetarëve në ushtrimin e profesionit dhe kërcënimet ndaj tyre, dhe në anën tjetër rreziku i cenimit të privatësisë, nxitjes së urrejtjes dhe problemet e tjera që lidhen me lirinë e shprehjes dhe medieve kanë qenë pjesë e debatit të vazhdueshëm në Kosovë. Ky raport është iniciuar për shkak të shqetësimeve të vazhdueshme në këtë drejtim, dhe informimit të Avokatit të Popullit në mënyra të ndryshme, mbi sfidat dhe problemet në këtë fushë, në veçanti mbi mungesën e efikasitetit të gjyqësorit për trajtimin e rasteve të tilla.

Një shkas i veçantë për hartimit të këtij raporti nga ana e Avokatit të Popullit, është rasti i sulmit ndaj gazetarit dhe drejtorit të gazetës “Insajder” z. Parim Olluri, pastaj rasti i

sulmit ndaj gazetarit z. Vehi Kajtazi, kërcënimet ndaj gazetarit z. Leonard Kerquki, dhe sulmi ndaj ish-kryeredaktores së gazetës së përditshme “Zëri”, znj. Arbana Xharra, e cila para se të ndodhte sulmi kishte kaluar në politikë. Këto raste paraqesin format më të rënda të rrezikimit të integritetit trupor dhe jetës ndaj gazetarëve në Kosovë. Si i tillë përbën një nga format më të rënda të cenimit të lirisë së shprehjes dhe rrezikimit të gazetarëve në Kosovë.

Në këtë raport, liria e shprehjes si e drejtë themelore do të identifikohet kryesisht me konceptin e lirisë së medieeve. Avokati i Popullit thekson ndjeshmërinë e lartë dhe sfidën komplekse që paraqet vendosja e ekuilibrit midis lirisë së shprehjes, si e drejtë fundamentale në çdo shoqërie demokratike, dhe përcaktimi i kufijve të saj në raport me të drejtat e tjera. Duhet theksuar se kjo tematikë paraqet sfidë të vazhdueshme në të gjitha vendet, dhe përbën një detyrë të vështirë për interpretimin e këtyre kufijve edhe në institucionet me të larta ndërkombëtare siç është edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Megjithatë, përcaktimet në dokumentet kryesore ndërkombëtare dhe sidomos jurisprudenca e GJEDNJ kanë ndërtuar një standard mbi garantimin e lirisë së shprehjes dhe përcaktimin e limiteve të nevojshme. Kompleksiteti i kësaj tematike, parashtron sfidën për trajtim të balancuar dhe me shumë kujdes për të parandaluar gjuhën e urrejtjes dhe garantuar të drejtat e tjera të njeriut. Në anën tjetër, garantimi i sigurisë së gazetarëve dhe efikasiteti i organeve të drejtësisë në luftimin dhe parandalimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve, paraqet parakusht të ndërtimit të një shoqërie demokratike.

Nëpërmjet këtij raporti Avokati i Popullit tërheq vërejtjen mbi domosdoshmërinë e garantimit të lirisë së shprehjes, përkatësisht lirisë së medieeve si e drejtë themelore, si tregues i nivelit të demokracisë dhe respektimit të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në përgjithësi.; tërheq vëmendjen mbi nevojën e mbrojtjes efektive të gazetarëve nga çdo formë e cenimit të sigurisë dhe pengimit të ushtrimit të lirë të profesionit. Sidomos, duke vënë në pah detyrimet e institucioneve të Kosovës që me efikasitet të hetohen dhe gjykohen kryesit e veprave penale kundër gazetarëve; tërheq vërejtjen mbi kufijtë e lirisë së shprehjes në raport me të drejtat e tjera dhe rrezikut të cenimit të privatësisë, dinjitetit të njeriut, nxitjes së dhunës, urrejtjes, mos durimit apo prishjes së rendit publik; që përmes analizës së bazës ligjore dhe standardeve ndërkombëtare nga kjo fushë, të jap rekomandime konkrete mbi garantimin e lirisë së shprehjes në raport me të drejtat e tjera themelore, si dhe vë theksin mbi domosdoshmërinë që institucionet e Republikës së Kosovës, në veçanti gjykatat të bazohen në vendimet e GJEDNJ në të gjitha rastet e vendosjes në lidhje me lirinë e shprehjes dhe kufizimin e saj.

Avokati i Popullit me këtë raport rikujton se është detyrim i veçantë i shtetit të Kosovës që të garantojë në mënyrë efektive lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve, si një nga standardet kryesore të demokracisë. Përveç nga dispozitat e akteve ndërkombëtare të përmendura me lartë dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ky detyrim i shtetit del edhe nga standardet e përcaktuara në disa dokumente të tjera për këtë qëllim.

Në nivel global, është me rëndësi Rezoluta e OKB-së Nr. 68/163 mbi sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit,²¹⁰ ku ndër të tjera përcaktohet se shtetet duhet “...të ndërmarrin masat maksimale për të parandaluar dhunën ndaj gazetarëve... për të siguruar llogaridhënie nëpërmjet kryerjes së hetimeve të paanshme, të shpejta dhe efektive në të gjitha rastet e dhunës së pretenduar kundër gazetarë dhe punëtorë të medieeve që janë brenda juridiksionit të tyre dhe për të sjellë autorët e krimeve të tilla të drejtësisë dhe për të siguruar që viktimat të kenë qasje në mjetet e duhura “(pika 5). Pastaj në nivel evropian si referencë është edhe Rekomandimi i vitit 2016 mbi mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe akterëve të tjerë të medieeve,²¹¹ i cili vë në dukje nevojën e miratimit të një kornize legjislativë gjithëpërfshirëse nga shtetet me qëllim të garantimit të lirisë së medieeve, me theks të veçantë zbatimin efektiv të legjislacionit penal me qëllim të garantimit të integritetit fizik dhe moral të gazetarëve.

Avokati i Popullit, tërheq vërejtjen mbi nevojën që edhe në Kosovë të avancohet aspekti legjislativ, të ndërtohet një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse që garanton mbrojtje të mjaftueshme për lirinë e medieeve dhe sigurinë e gazetarëve. Gjithashtu, me rëndësi të posaçme është që të gjitha rastet e dhunës dhe kërcënimeve të hetohen dhe gjykohen me efikasitet nga organet e sistemit të drejtësisë. Për këtë qëllim është e nevojshme që organet drejtuese të sistemit prokurorial dhe gjyqësor të përcaktojnë që rastet e veprave penale kundër gazetarëve të trajtohen me prioritet dhe mbi bazën e parimit të efikasitetit.

Në bazë të analizës së bazës ligjore dhe konstatimeve të arritura Avokati i Popullit rekomandon institucionet e Republikës së Kosovës, që të ndërmarrin masat e nevojshme me qëllim të garantimit të lirisë së shprehjes (medieeve) dhe sigurisë së gazetarëve, përkatësisht që Qeveria e Republikës së Kosovës në kuadër të kompetencave të saj kushtetuese dhe ligjore, të ndërmarrë masat e nevojshme që: Të sigurojë transparencë të vazhdueshme në funksion të llogaridhënies publike dhe lirisë së shprehjes si bazë e zhvillimit të demokracisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut; Të referohet dhe zbatojë rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në lidhje me lirinë e shprehjes dhe sigurinë e gazetarëve (*sidomos Rekomandimet e KB-së për Sigurinë e Gazetarëve dhe Çështjen e Mosndëshkimit, dhe Rekomandimet e nxjerra nga institucionet e BE-së*); të kujdeset që legjislacioni për të gjitha çështjet që ndërlidhen me lirinë e shprehjes të jetë në harmoni të plotë me dokumentet ndërkombëtare dhe standardet e ndërtuara nga GJEDNJ. Për këtë qëllim është e nevojshme të avancohet baza ligjore që garanton lirinë e shprehjes, mediave dhe në veçanti sigurinë e gazetarëve. Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit rastet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve të trajtohen me prioritet dhe të zgjidhen në mënyrë efektive nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor në Kosovë. Të ketë një koordinim të duhur të prokurorit të shtetit me policinë, dhe shfrytëzimi efikas i të gjitha mjeteve ligjore për hetimin e këtyre

²¹⁰ Kjo rezolutë është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e KB-së me 18 dhjetor 2013 (Resolution 68/163. The safety of journalists and the issue of impunity).

²¹¹ Shih Recommendation CM/Rec(2016)4 of the Committee of Ministers to member States on the protection of journalism and safety of journalists and other media actors.

veprave; Gjykatat në rastet e vendosjes për lirinë e shprehjes të bazohen në standardet e ndërtuara nga praktika GJEDNJ si burim primar, dhe në të gjitha rastet kur provohet fajësia e të pandehurve të shqiptohet dënimi meritor, duke zbatuar një politikë parandalues duke përdorë masa ndëshkimore të përshtatshme për arritjen e qëllimit të dënimit si dhe Policia e Kosovës të ndërhyjë me prioritet në rastet e kërcënimeve ndaj gazetarëve, si masë parandaluese për degradimin e situatave nga kërcënimet verbale në sulme fizike.

10.Raportet e bazuara në ankesa

10.1 Raport me rekomandime nr. 12/2017, lidhur me trajtimin e pabarabartë në caktimin e koeficientit të pagës për zyrtarët e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prishtinë

Më 3 mars 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime në lidhje me trajtimin e pabarabartë në caktimin e koeficientit të pagës për zyrtarët e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prishtinë. Qëllimi i këtij raporti është promovimi i barazisë dhe tërheqja e vëmendjes Komunes së Prishtinës, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve për harmonizimin e pozitave dhe koeficienteve për zyrtarët e Drejtorisë Komunale të Arsimit në përputhje me ligjin, për të eliminuar kështu pabarazinë që ekziston aktualisht në trajtimin e tyre. Raporti është bazuar në ankesat individuale të zyrtarëve të kësaj drejtorie dhe synon të tërheqë vëmendjen për të drejtën për t'u informuar në lidhje me kërkesën e parashtruar më 23 shtator 2016, me Nr. Prot. 01-120-240188.

Parashtruesit e ankesës shprehën pakënaqësinë e tyre për trajtim të pabarabartë, duke kërkuar që të përmirësohet koeficienti i pagës sipas kualifikimit, përgatitjes profesionale, përvojës së punës, detyrave dhe përgjegjësi në punë. Ata po ashtu ankohen se koeficienti i pagës së tyre është më i vogël dhe dallon në krahasim me koeficientin e pagës në pozitat e njëjta në Drejtorinë Komunale të Arsimit në komunat tjera. Për krahasim janë përdorur listat e pagave të drejtorive komunale të arsimit në komunat: Prishtinë, Gjiilan, Ferizaj, Gjakovë, Rahovec, Pejë, Prizren, Kamenicë, Klinë, Vushtri, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Istog, Skenderaj dhe Podujevë, e po ashtu listat e pagave të institucioneve parauniversitare në komunën e Prishtinës.

Avokati i Popullit, në bazë të të gjitha dëshmive të paraqitura dhe fakteve të mbledhura në këtë rast konstatoi se ka pasur shkelje të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, meqë përgjegjësit në Ministrinë e Administratës Publike, nuk kanë ndërmarrë veprimet e duhura për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë punonjësit e DKA-ve në Kosovë, sipas pozitës, kualifikimit dhe përgjegjësi në punë, ndërsa përgjegjësit në Komunën e Prishtinës nuk kanë ndërmarr masat e duhura për shqyrtimin e kërkesës së parashtruar dhe për këtë shkak ankuesve ju është mohuar e drejta e shfrytëzimit të mjeteve efikase juridike. Vlerësohet si e domosdoshme që ministrinë relevante dhe komunat të kenë një koordinim më të mirë me qëllim që dallimet e cekura më lartë të eliminohen pa vonesa të mëtutjeshme. Standardizimi i vendeve të punës ndihmon institucionet për të ofruar shërbime me cilësi më të mirë dhe efikase, mundëson menaxhim efikas të buxhetit dhe mund të ndikoj edhe në ngritjen e cilësisë në arsim. M këtë rast Avokati i Popullit rekomandoi Komunës së Prishtinës që: të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që kërkesa e ankuesve të shqyrtohet në pajtueshmëri me Ligjin për Procedurën Administrative; Të siguroj që të gjithë nëpunësit civil – ankuesit, në situata të njëjta të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta. Ndërsa Ministrisë së Administratës Publike që të bëhen vlerësime të individualizuara për titujt e punës dhe koeficientin e pagës për çdo pozitë të nëpunësve civil në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Republikën e Kosovës.

10.2 Raport me rekomandime nr. 347;729;730;333/2015 lidhur me kushtëzimin e qytetarëve nga komunat për pagesën e tatimit në pronë me rastin e regjistrimit të automjeteve

Më 20 mars 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime lidhur me kushtëzimin e qytetarëve nga komunat për pagesën e tatimit në pronë me rastin e regjistrimit të automjeteve. Raporti ka për qëllim të tërheq vëmendjen autoriteteve lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe rekomandimi për ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 07/2011 të Ministrisë së Financave për Urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë, të datës 13 korrik 2011 (UA nr. 07/2011).

Avokati i Popullit e konsideron se vendosja e pagesës së taksave, në këtë rast taksës komunale, të nevojshme për regjistrimin e automjetit është në kompetencë të autoriteteve përkatëse shtetërore, në këtë rast Ministrisë së Punëve të Brendshme me rastin e regjistrimit të automjetit apo vazhdimin e regjistrimit të tij. Kushtëzimi nga ana komunave, sipas UA nr. 07/2011, me të cilin qytetarët detyrohen ta paguajnë tatimin në pronë në mënyrë që atyre t'u lëshohet dëshmia për pagesën e taksës komunale të nevojshme për regjistrimin e automjetit, sipas Udhëzimit Administrativ nr.16/2016 të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nuk është një metodë e ligjshme për vjelje të tatimit në pronë. Avokati i Popullit e ka parasysht, se vjelja e tatimit në pronë është jetike për funksionimin e komunave, mirëpo ai e konsideron se kjo duhet të bëhet në pajtim me ligjin. Dispozitat e cekura të UA nr. 07/2011, e anashkalojnë procedurën për vjeljen e detyruar të tatimit, të përcaktuar me nenin 18 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme Nr.03/L-204. Këto dispozita jo vetëm që e anashkalojnë Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, por e anashkalojnë edhe Ligjin nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Anashkalimi i Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat mëton "lehtësimin" dhe shkurtimin rrugës në vjeljen e tatimit, duke vënë kështu në rrezik të drejtat e qytetarëve në një proces të rregullt, të përcaktuar me këto ligje. Nisur nga këto Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që" ta ndryshojë qëndrimin e saj zyrtar të shprehur në Shkresën shpjeguese të datës 20 qershor 2012, drejtuar Kryetarëve të Komunave të Republikës së Kosovës dhe Kryesuesit e Kuvendeve Komunale dhe të nxjerrë një qëndrim të ri me konstatimin se kushtëzimet për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve nga ana e komunave me pagesën e tatimit në pronë nuk kanë bazë ligjore dhe janë në kundërshtim me të drejtat e njeriut dhe si të tilla nuk mund të aplikohen; dhe të kërkojë nga komunat të cilat e aplikojnë këtë kushtëzim shfuqizimin e rregulloreve dhe urdhëresave komunale për kushtëzimet e shërbimeve komunale. Ndërsa Ministrisë së Financave që ta ndryshojë Udhëzimin Administrativ nr. 07/2011 për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë,

10.3 Raport me rekomandime nr. 11/2017 lidhur me moszbatimin e kontratës së punës dhe vendimit përfundimtar në procedurë administrative nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime

Më 19 qershor 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime lidhur me moszbatimin e kontratës së punës dhe vendimit përfundimtar në procedurë administrative nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime. Ky raport është bazuar në një ankesë individuale dhe ka për qëllim promovimin e barazisë dhe tërheqjen e vëmendjes Komunës së Shtimes - Drejtorisë Komunale të Arsimit, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për zbatimin e ligjit.

Ankuesja kishte shfrytëzuar mjetet juridike administrative që kishte në dispozicion, mirëpo edhe përkundër shkeljeve të konstatuara sipas Sektorit të Inspeksionit të Arsimit, ajo ende nuk ka mundur të rivendos të drejtën e saj për të zbatuar kontratën e saj të punës për shkak të moszbatimit të vendimit përfundimtar në procedurë administrative nga DKA në Shtime.

Pas analizimi të rastit Avokati i Popullit konstaton se, aktivi profesional në shkollë, fillimisht duhet të shqyrtojë kërkesat e mësimdhënësve të punësuar në shkollën përkatëse, e pastaj nëse mbeten orë mësimore mund të plotësohen nga mësimdhënësit e shkollave të tjera, në rastin konkret pasi që aktivi profesional në shkollë nuk janë pajtuar për ndarjen e fondit të orëve, sipas përgjigjes së DKA-së, drejtorja e shkollës ka vendosur për ndarjen e orëve, lidhur me këtë, Avokati i Popullit, konstaton se, drejtori i institucionit shkollor është kompetent të shpërndaj fondin e orëve mësimore, mirëpo ai është kompetent që të kujdeset që fillimisht të plotësoj orët mësimore sipas kontratave të lëshuara për mësimdhënësit e punësuar në shkollën të cilën e udhëheqë, ndërsa orët e mbetura duhet t'i lajmërojë në DKA, e cila si punëdhënëse do të vendos lidhur me orët e mbetura dhe do të angazhoj mësimdhënësit e shkollave tjera për të plotësuar këto orë. Drejtori i shkollës ka tejkaluar kompetencat e veta duke angazhuar mësimdhënëse nga shkollat tjera, edhe pse kjo është kompetencë e DKA-së si punëdhënëse, prandaj dhënia e përparësisë kandidatëve të cilët janë të punësuar nga DKA në shkollat tjera si dhe zvogëlimi i fondit të orëve të ankueses nga 20 orë mësimore, siç parashihet me kontratë të punës në 14 orë mësimore është në kundërshtim me kontratën e punës.

Avokati i Popullit e konsideron si dështim të autoriteteve komunale moszbatimin e vendimit përfundimtar në procedurë administrative duke cenuar në këtë rast sigurinë juridike dhe sundim të drejtës. Nisur nga kjo Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Shtimes që të zbatojë pa vonesa të mëtutjeshme kontratën e punës nr. 05/308, të datës 26.01.2016, në kohë të pacaktuar, sipas të cilës ankuesja është arsimtare e lëndës së fizikës me 20 orë mësimi në javë, si dhe të rivendos të drejtën e fituar të mësimdhënëses sipas vendimit përfundimtar në procedurë administrative të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nr. 2-1086, të datës 24.02.2017.

10.4 Raport me rekomandime nr. 597/2014 lidhur me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë

Më 20 qershor 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Raporti është i bazuar në ankesë individuale dhe ka për qëllim të analizoj rastin mbi bazë e fakteve që ka në dispozicion Institucioni, dhe të vlerësoi ndikimin e tej zgjatjes së procedurës gjyqësore në të drejtat e njeriut në frymën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ankuesi kishte iniciuar padinë asokohe në Gjykatën Komunale, tani Gjykata Themelore në Prishtinë, më 14 korrik 2008 për të konfirmuar të drejtat e pronësisë dhe posedimit të pronës së paluajtshme të uzurpuar në mënyrë të paligjshme.

Në këtë raport Avokati i Popullit vë në pah se kontestet civile për përcaktimin e të drejtave të pronësisë dhe posedimit të pronës së paluajtshme konsiderohen si të drejta qytetare në kuptim të nenit 6 të Konventës, i cili për këtë arsye është i zbatueshëm në procedurën e këtij rasti. Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut konstatoi se në rastin që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave zakonisht llogaritet nga koha e fillimit të procedurave gjyqësore (*shih shembullin, Sienkiewicz kundër Polonisë, aktgjykimi i datës 30 shtator 2003*) deri në kohën kur rasti përfundimisht vendoset dhe/ose aktgjykimi përmbahet (*shih Vocaturo kundër Italisë (II) aktgjykimin e datës 24 maj 1991*). Procedurat e filluara në tërësi, atëherë Gjykata Komunale, ndërsa tani Gjykata Themelore në Prishtinë më 14 korrik 2008, kur është ngritur padia kundër të paditurit vazhdojnë sot e kësaj dite për pothuajse 8 vjet vetëm në shkallën e parë. Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes dhe duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara me praktikën gjyqësore, sidomos kur është në pyetje kompleksiteti i rastit, sjellja e palëve dhe autoriteteve që punojnë në këtë rast, si dhe ajo çfarë është në interesat e ankuesit (*shih rastin Gollner kundër Austrisë, aktgjykimi i datës 17 janar 2002*).

Avokati i Popullit vuri në pah se ankuesi me sjelljen e tij nuk kishte kontribuar në asnjë lloj vonese. Sipas komunikimeve të zhvilluara ndër-institucionale vonesa në shqyrtimin e rastit të ankuesit ndodhi për shkak të mungesës së gjyqtarëve dhe për faktin se gjykata është e mbingarkuar me numër të madh të rasteve me prioritet.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vlerëson se neni 6, paragrafi 1 uu imponon shteteve detyrimin që t'i organizojnë sistemet e tyre ligjore në atë mënyrë që gjykatat t'i përmbushin kërkesat e Konventës. Avokati i Popullit vëren se nuk ekziston asnjë qasje ligjore nëpërmjet së cilës ankuesi në rastin konkret ka mund të ankohej për zvarritjen e procedurës me mundësi të realizimit të ndihmës parandaluese apo kompensuese, Nisur nga kjo Avokati i Popullit rekomandoi Gjykatën Themelore në Prishtinë që duke pasur parasysh vonesat e mëhershme, të ndërmerren veprime në drejtim të shqyrtimit dhe vendosjes në lëndën e ankuesit pa vonesa të mëtejme. Ndërsa Këshillin Gjyqësor të Kosovës të iniciojë përpilimin e një instrumenti ligjor që do të përbënte mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësim në

formën e parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zvarritje të procedurës gjyqësore.

10.5 Raport me rekomandime nr. 438/2015 lidhur me zvarritjet e procedurave gjyqësore në shqyrtimin e padisë të parashtruar në Gjykatën Themelore në Ferizaj

Më 20 qershor 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime lidhur me zvarritjen e procedurave gjyqësore në shqyrtimin e padisë të parashtruar në Gjykatën Themelore në Ferizaj. Raporti është i bazuar në ankesën individuale dhe qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës Themelore në Ferizaj, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen në padinë e parashtruar nga ankuesi në vitin 2003, pa vonesa të mëtutjeshme.

Bazuar në analizën e dëshmive dhe fakteve, e drejta për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm dhe e drejta për mjete efektive juridike, të garantuara me aktet ligjore të lartpërmendura, nuk është përmbushur në këtë rast për faktin se Gjykata Themelore, ka zvarritur shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës së ankuesit për më shumë se 14 vite, procedurat e së cilës janë iniciuar që nga viti 2003 dhe ende nuk janë vendosur përfundimisht deri në ditën e nxjerrjes së këtij raportit. Zvarritja e tepërt e procedurave gjyqësore pa një vendim gjyqësor janë në kundërshtim me të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në shumë raste ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor, paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih rasti *Azdajic v. Slovenia*, 8 tetor 2015). Avokati i Popullit konsideron se një procedurë gjyqësore e pa përfunduar për 14-vite si në rastin e *ankuesit* do të krijonte një situatë të përgjithshme të pasigurisë juridike, do të zvogëlonte dhe humbiste besimin e qytetarëve në drejtësi dhe në shtetin ligjor.

Avokati i Popullit në këtë rast rekomandoi Gjykatën Themelore në Ferizaj që të marrë masa për shqyrtimin dhe vendosjen e rastit C.nr.133/2003 të datës 7 mars 2003, të z. Isuf Qorolli e cila sipas aktvendimit Ac.nr.887/2008, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, është rikthyer në procedurë në Gjykatën Themelore në Ferizaj, pa vonesa të mëtejme; ndërsa Këshillit Gjyqësor të Kosovës i rekomandoi që të inicioj përpilimin e një instrumenti ligjor që do të përbënte mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësim në formën e parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zvarritje të procedurës gjyqësore.

10.6 Raport me rekomandime nr. 765/2016 lidhur me të drejtën në jetë dhe detyrimet pozitive për hetime efektive

Më 14 shator 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime në lidhje me të drejtën për jetë dhe detyrime pozitive për hetime efektive. Raporti trajton të drejtën

elementare në jetë, të garantuar me Kushtetutë dhe instrumentet ndërkombëtare të inkorporuara brenda të njëjtës. Në rastin e ankuesit e drejta për jetën pretendohet të jetë shkelur nga neglizhenca e personelit mjekësor brenda Qendrës Klinike Universitare dhe mos veprimi efektiv të prokurorisë së shtetit. Raporti shqyrton gjendjen faktike të rastit të parashtruar nga ankuesi dhe paraqet analizën ligjore për shkeljen potenciale të të drejtës në jetë duke analizuar legjislacionin vendor, dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

E drejta për jetën është listuar si e para në katalogun e të drejtave dhe lirive të njeriut të mbrojtura me KEDNJ për faktin që është *e drejtë më bazike* nga të gjithat. Ajo që dëshmon këtë fakt është edhe pamundësia në derogimin e kësaj të drejtë, qoftë edhe në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme. Praktika e GJEDNJ-së nisat prej lëndës McCann dhe të tjerët kundër MB²¹² ku: *e drejta për jetën, sidomos në lidhje me nenin 3 të Konventës (Ndalimi i torturës), paraqet një nga vlerat më bazike të shoqërisë demokratike*. Neni 2 i Konventës paraqet detyrat e përgjithshme të shtetit për ta mbrojtur të drejtën për jetë dhe përfshin aspektet pozitive dhe negative: a) obligimin pozitiv për ta mbrojtur jetën dhe b) obligimin negativ që të përmbahet nga marrja e paligjshme e jetës. Obligimi pozitiv imponon detyrime të parandalimit dhe hetimit. Detyrimi i parandalimit²¹³ i obligon qeveritë e shteteve t'i pengojnë dhe luftojnë veprat penale. Nëse vërtetohet që qeveritë kishin njohuri, ose do to duhej të kishin njohuri në kohën e ekzistimit të rrezikut real dhe të drejtpërdrejtë për jetën e një personi të identifikuar, nga veprat penale të palëve të treta dhe nëse nuk kanë ndërmarrë masa të duhura në kuadër të kompetencave të veta, të cilat sipas një vlerësimi të arsyeshëm mund të priteshin në mënyrë që të shmangej rreziku për jetë, të njëjtat duhet të jenë përgjegjëse për moszbatim të detyrimeve pozitive.

Praktika gjyqësore e GJEDNJ, rekomandon se duhet të shfrytëzohen të gjitha mjetet juridike në dispozicion, edhe atëherë kur pala nuk beson që të njëjtat mund të jenë të efektshme apo të prodhojnë rezultat të drejtë për palën. Në të kundërtën, mosshfrytëzimin e të gjitha mjeteve juridike në dispozicion, GJEDNJ nuk e trajton si shkelje të nenit 2, përveç nëse nuk është e qartë që mjetet e tilla juridike nuk kanë mundur të adresojnë çështjet e shtruara faktike apo ligjore.²¹⁴ Shterja e mjeteve juridike nënkupton edhe procedurën civile ku mund të kërkohet kompensimi i dëmit jo material por i cili, në bazë të praktikës së GJEDNJ-së, përjashton mundësinë e hetimit të mëtutjeshëm mbi rrethanat e vdekjes së personit, rasti Powell kundër Mbretërisë së Bashkuar “Kur i afërmi i personit të vdekur pranon kompensim të dëmit përmes padisë civile mbi neglizhencën mjekësore, ai apo ajo nuk ka të drejtë të konsiderohet viktimë në lidhje me rrethanat mbi trajtimin e të ndjerit apo të kërkojë hetime të mëtutjeshme në lidhje me vdekjen e tij/saj”. Me këtë

²¹² McCann and others v UK e datës 27 shtator 1995; gjetur në:

[http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"appno":\["18984/91"\],"itemid":\["001-57943"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{);

²¹³ Osman v The United Kingdom e datës 28 shkurt 1998, gjetur në:

<file:///C:/Users/Ideapad/Downloads/001-58257.pdf>;

²¹⁴ Douwe Korff: A guide to implementation of Article 2 of the European Convention on Human Rights, Nëntor 2006, gjetur në: <https://rm.coe.int/168007ff4e>, fq.80.

raport Avokati i Popullit i rekomandoi Prokurorisë Themelore në Prishtinë që në pajtim me kompetencat dhe autorizimet që burojnë nga ligji, si dhe në bashkëpunim me të gjitha agjencitë relevante të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e hetimeve të shpejta dhe efektive në çështjen e ankuesit, duke i zbardhur të gjitha rrethanat dhe shkaktarët e vdekjes së bashkëshortes së ankuesit; të vlerësohet përgjegjësia duke përfshirë përgjegjësinë objektive dhe subjektive e që do të mund të lehtësonte çështjen e kompensimit për palën, ndërsa Ministrinë e Shëndetësisë që në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore të themelojë komision të posaçëm për vlerësimin e gjendjes, i cili pas vlerësimit të situatës në terren do të hartonte protokole pune me rregulla strikte për rastet e dhënies së transfuzionit të gjakut.

10.7 Raport me rekomandime nr. 592/2016 lidhur me mosllogaritjen e stazhit të punës për ish zyrtarët policor sipas mënyrës që rregullonte Ligji për Punë të Brendshme i vitit 1978

Më 23 tetor 2017 Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime lidhur me mosllogaritjen e stazhit të punës për ish zyrtarët policor sipas mënyrës që rregullonte Ligji për Punë të Brendshme i vitit 1978. Raport ka për qëllim të trajtoj çështjen e mos njohjes së stazhit të punës kontributdhënës gjatë viteve 1989-1999, për ish zyrtarët policor si dhe mosllogaritjes të stazhit të punës sipas ligjit të atëhershëm në fuqi.

Raporti është nxjerrë si rezultat i ankesës individuale nga ankuesi në emër të sindikatës së ish zyrtarëve policor të cilët ndihen të diskriminuar meqë stazhi i punës për punëtorët e arsimit dhe shëndetësisë të asaj periudhe (1989-1999) është njohur, ndërsa një gjë e tillë nuk u njihet ish zyrtarëve policor. Po ashtu kësaj kategorie nuk po u njihet stazhi i beneficuar, i paraparë me Ligjin për Punë të Brendshme 1978, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur ata kanë qenë në detyrë.

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut konceptin e "posedimeve" i përmendur në pjesën e parë të Nenit 1 të Protokollit nr. 1, e përkufizon si koncept i cili nuk kufizohet në pronësinë e të mirave fizike, si dhe është i pavarur nga klasifikimi formal në ligjin vendor. Disa të drejta dhe interesa tjera që përbëjnë asete munden gjithashtu të shihen si "të drejta pronësore" dhe kështu si "posedime" për qëllimin e Nenit 1, Protokollit nr. 1.

Për më shumë, "posedimet" mund të jenë ose "posedime ekzistuese" apo asete, duke përfshirë pohimet, në kuptimin e të cilave parashtruesi mund të argumentojë që ai apo ajo ka "pritje legjitime" të fitimit dhe të gëzimit efektiv të një të drejtë pronësore. Duke u bazuar në Ligjin për Punë të Brendshme 1978, si dhe Ligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) ish zyrtarët policor kanë pasur pritje legjitime që do të gëzojnë njohjen e stazhit të punës për të përfituar nga skemat pensionale. Pritja e tillë legjitime garantohet me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, të Konventës, natyra e saj është konkrete dhe jo vetëm shpresë e thjeshtë, si dhe bazohet në akte ligjore, pra ligjit të asaj kohe. Kjo e drejtë nuk mund të anulohet përmes miratimit të

një ligji të ri sepse do të ishte në kundërshtim me drejtat themelore të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për Drejtat e Njeriut si dhe parimin e jo-retroaktivitetit të ligjit. Jo-retroaktiviteti i ligjeve është parim i përgjithshëm dhe ekziston që nga e drejta romake. Kushtetuta dhe Ligjet përcaktojnë formën e veprimeve juridike në të ardhmen dhe nuk mund të shtrihen edhe në veprimet të cilat janë krijuar më herët, nëse nuk është paraparë shprehimisht se ato kanë të bëjnë edhe me kohën e mëhershme dhe atë vetëm ndaj veprimeve juridike të cilat akoma nuk janë përfunduar. Në këtë raport Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që ish-punonjësit e Policisë së Kosovës të larguar dhunshëm nga puna të gëzojnë të drejtën e pensionit bazuar në stazhin e beneficuar që dikur e rregullonte Ligji për Punë të Brendshme i vitit 1978; kjo e drejtë absolute statusore e njohur mbi bazën e ligjit t'i njihet kësaj kategorie që nga momenti i aplikimit; nëpërmjet akteve nënligjore të qartësohet neni 8, paragrafi 6 i Ligjit 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, se cilave kategori tjera të mundshme u njihet stazhi i punës gjatë viteve 1989-1999.

10.8 Raport me rekomandime nr. 71/ 2015 lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në vendosjen e lëndës në Gjykatën Themelore në Mitrovicë në lëndën C.nr. 82/ 2013

Më 25 tetor 2017 Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në vendosjen e lëndës në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes gjykatës, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen efikase të lëndëve gjyqësore në afate të arsyeshme kohore. Raporti është i bazuar në ankesën individuale të ankuesit dhe mbështetet në dëshmitë dhe faktet e ankuesit, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore për të vendosur në lëndën C.nr. 82/ 2013, në çështjen juridike të marrëdhënies së punës për kompensimin e të ardhurave personale. Rasti i ankuesit ka filluar të procedohet në gjykata nga data 3 mars 2003 dhe deri më sot. Pra, ankuesi për 14 vite është në pritje të vendimit, lënda e të cilit ende nuk është vendosur përfundimisht me vendim meritor. Gjykata e shkallës së dytë e ka kthyer në rigjykim vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në kontestet nga marrëdhënia e punës bazuar në nenin 475 të LPK, ligjdhënësi ka paraparë se gjykata duhet t'i ndërmarrë të gjitha masat që këto konteste të zgjidhen urgjentisht. Masat të cilat duhet t'i ndërmerr gjykata për zgjidhjen me urgjencë të këtyre kontesteve, konsistojnë në marrjen e lëndëve të kësaj natyre me prioritet, para lëndëve të tjera, në caktimin e afateve sa më të shkurtra për mbajtjen e seancave gjyqësore që palëve ndërgjyqës t'u caktojë afate më të shkurtra për ndërmarrjen e veprimeve procedurale, por pa e cenuar mundësinë e ndërmarrjes së tyre dhe që të kujdeset që kontesti të përfundojë sa më parë. Gjithashtu, gjykata duhet të kujdeset që distanca kohore midis seancave të jetë sa më e shkurtër dhe që palët në afat sa më të shkurtër ta paraqesin tërë materialin

shqyrtues të çështjes me të cilin pretendojnë që t'i realizojnë apo mbrojnë të drejtat apo interesat e tyre subjektive. Zvarritjet e procedurës gjyqësore shkaktojnë pasoja serioze në sundimin e ligjit dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Me këtë raport Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës Themelore në Mitrovicë që të shqyrtoj mundësinë e ndërmarrjes së veprimeve lidhur me vendosjen e rastit C.nr. 82/ 2013, meqenëse kjo lëndë daton që nga 3 marsi 2003.

10.9 Raport me rekomandim nr. 500/2015 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 3141/2013

Më 1 dhjetor 2017 Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës së Apelit lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës së ankuesit pa vonesa të mëtutjeshme. Raporti është i bazuar në ankesë individuale dhe mbështetet në dëshmi, faktet dhe shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore të lëndës AC 3141/2013, të datës 9 shtator 2013, për kompensim të dëmit material dhe jo material, për shkak të lëndimit në punë.

Avokati i Popullit përkujton që praktika e GJEDNJ-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin, *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005). Neni 6 i KEDNJ-së nuk përshkruan ndonjë afat absolut të caktuar zgjatjen e arsyeshme të procedurës por një përcaktim i tillë varet nga rrethanat e veçanta të çështjes. Në rastin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsiderim është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative, dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizoj punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre brenda një kohe të arsyeshme. Sipas praktikës së GJEDNJ “arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet ... duke iu referuar kritereve si në vijim: ndërlikueshmëria e rastit, sjelljet e aplikuesit dhe të autoriteteve përkatëse dhe se çfarë ishte në rrezik për aplikuesin në çështjen në fjalë” (GJEDNJ [Dhoma e Madhe], *Frydlender v.France*, Aplikimi Nr.30970/96(2000), par.43, duke e cituar GJEDNJ [Dhoma e Madhe], *Comingersoll S.A. v. Portugal*, Aplikimi Nr.35382/97, par.19 (2000), par.19).

Në rastin në fjalë periudha për t'u shqyrtuar lënda e ankuesit fillon prej 27 janar 2012 kur ankuesi e ka paraqitur padinë në Gjykatën Themelore në Gjilan. Pasi që, ende nuk është marr vendim përfundimtar lidhur me rastin, data e fundit e hetimit të këtij rasti në shqyrtim, konsiderohet data e publikimit të këtij raporti. Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se procedurat kanë zgjatur mbi 5 vite, dhe se ka pasur shkelje të së drejtës për një proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme. Në këtë rast Avokati i Popullit

rekomandoi gjykatës që pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmerr të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës AC. Nr. 3141/2013

10.10 Raport me rekomandim nr. 929/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC 1553/2014.

Më 1 dhjetor 2017 Avokati i Popullit publikoi raport me rekomandim lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes gjykatës lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC 1553/2014, pa vonesa të mëtutjeshme. Raporti bazohet në ankesë individuale dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankueses, si dhe në shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore që ka të bëjë me vërtetimin të pronësisë.

Avokati i Popullit rithekson se gjykata ka për detyrë që procedura gjyqësore të zbatohet, pa ndonjë zvarritje të paarsyeshme. Nga informatat në dispozicion, ankuesja nuk i ka kontribuar zvarritjes së procedurës me veprimet apo mosveprimet e saj, ndërsa zvarritjet pa një vendim përfundimtar i kanë kontribuar shkeljeve të të drejtave për mbrojtje gjyqësore, të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në çështjen në fjalë deri më tani janë nxjerr tri aktgjykime nga Gjykata Komunale, respektivisht Gjykata Themelore në Prishtinë, dhe se gjykata e shkallës së dytë dy aktgjykimet e para i ka kthyer në rigjykim, dhe pas nxjerrjes së aktgjykimit të tretë C.nr.3344/12, të datës 26 dhjetor 2013, lënda për të tretën herë ndodhet në Gjykatën e Apelit (Ac.nr. 1553/14).

Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka vërtetuar se kohëzgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin, *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003), deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih, aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005). Në rastin e ankueses procedura gjyqësore është iniciuar më 16 korrik 2004.

Përveç tjerash, në këtë raport Avokati i Popullit vë në pah se neni 13 i KEDNJ pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht dhe në mënyrë primare të mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor duke vendosur me këtë rast një garanci shtesë për një individ për të siguruar që ai apo ajo gëzon të drejtat në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individi për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efikase nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtrojë këtë ankesë pranë një autoriteti vendor. Kërkesat e nenit 13 përkrahin ato të nenit 6 (shih aktgjykimin *Kudla vs Polland*). Kështu, neni 13 garanton një mjet ankimi efektiv pranë një autoriteti vendor për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6 për ta shqyrtuar një rast brenda një kohe të arsyeshme. Sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit përkujton se GJEDNJ disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë lidhur me palët kontestuese të cilat nuk kanë mjete,

përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit vendor ligjor (shih aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999, dhe aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999). Në këtë rast Avokati i Popullit rekomandoi gjykatën që pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmerret të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtim dhe vendosje për lëndën AC 1553/2014.

10.11 Raport me rekomandim nr. 503/2015 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.1926/14

Më 1 dhjetor 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.1926/14. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes gjykatës lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC.1926/14 pa vonesa të mëtutjeshme. Raporti është i bazuar në ankesë individuale dhe mbështetet në dëshmitë, faktet si dhe nga shkresat tjera të cilat i posedon Institucionit i Avokatit të Popullit lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në lëndën e ankuesit të proceduar në gjykatë nga 14 janari i vitit 2002, e cila deri në publikimin e këtij raporti nuk ka ndonjë vendim përfundimtar. Procedurat kanë zgjatur rreth 16 vjet dhe ende nuk ka një vendim përfundimtar. Avokati i Popullit përkujton se gjykata ka për detyrë që procedura gjyqësore të zbatohet, pa ndonjë zvarritje të paarsyeshme. Nga informatat në dispozicion nuk ka ndonjë nderlikueshmëri apo kompleksitet tjetër të çështjes e cila ka kontribuar në çfarëdo zvarritje të procedurës, ndërsa zvarritjet pa një vendim përfundimtar, i kanë kontribuar shkeljeve të drejtave për mbrojtje gjyqësore, në dëm të ankuesit. Kjo mënyrë e veprimit të gjyqësorit dëshmon për mohimin e drejtësisë dhe ligjshmërisë për mbrojtje gjyqësore të të drejtave. Në këtë rast ka pasur shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me aktet ligjore të lartpërmendura në çështjen në fjalë. Nisur nga kjo Avokati i Popullit rekomandoi Gjykatën e Apelit të Kosovës që pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmerret të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës AC.1926/14.

10.12 Raport me rekomandim nr. 161/2015 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 1457/2014

Më 1 dhjetor 2017 Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandim nr. 161/2015 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 1457/2014. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës së Apelit lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. nr. 1457/2014, pa vonesa të mëtutjeshme. Raporti është i bazuar në ankesën individuale dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankuesit, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore për lëndën AC. nr. 1457/2014, që ka të bëjë me kompensimin e pagave jubilarë pas daljes në pension.

Në raste të shumta Gjykata Evropiane për te Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se drejta e palës që çështja e tij, të vendoset në afat të arsyeshëm kohor, paraqet element genësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Praktika e GJEDNJ ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin, *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003), deri në kohën kur çështja ka përfunduar ose aktgjykimi është ekzekutuar, (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005). Megjithatë, Avokati i Popullit përkujton se neni 6 i Konventës nuk e përcakton ndonjë afat absolut të caktuar për përcaktimin e zgjatjes së arsyeshme të procedurës por një përcaktim i tillë varet nga rrethanat e veçanta të çështjes.

Në vendimet e saj, GJEDNJ ka theksuar se autoritetet gjyqësore duhet t'u japin vëmendje të veçantë rasteve ku interesi në fjalë është me rëndësi jetësore për aplikuesin (shih, p.sh. GJEDNJ, *Doustaly v. France*, rasti Nr. 26256/95 91998), par. 48).

Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit përkujton se efekti i këtij neni është që të kërkojë që një dispozitë e një mjeti vendor të merret me substancën e “një ankese të kontestueshme” sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih, p.sh. aktgjykimi në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih, p.sh. aktgjykimi në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000). Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit përkujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej që ose të kishin qenë në gjendje ta parandalonin shkeljen e pohuar ose vazhdimin e saj, ose për të ofruar përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih, aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla*). Andaj nisur nga kjo Avokati i Popullit rekomandon gjykatën që pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmerr të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. Nr. 1457/2014.

10.13 Raport me rekomandim nr. 238/2015 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prizren në lëndën C.Nr.450/2009

Më 1 dhjetor 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime nr. 238/2015 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prizren në lëndën C.Nr.450/2009. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Gjykatës Themelore në Prizren, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C.Nr.450/2009, pa vonesa të mëtutjeshme. Raporti është i bazuar në ankesë individuale të ankueses e cila në këtë çështje juridike është palë ndërhyrëse, dhe mbështetet në dëshmi, faktet si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore për lëndën C.Nr.450/2009 që ka të bëjë me vërtetimin e pronësisë dhe dorëzimin e pronës se paluajtshme.

Avokati i Popullit përkujton që praktika e GJEDNJ ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih aktgjykimin

Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin, *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003), deri në kohën kur çështja ka përfunduar ose aktgjykimi është ekzekutuar, (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005). Megjithatë, Avokati i Popullit përkujton se neni 6 i Konventës nuk e përcakton ndonjë afat absolut të caktuar për përcaktimin e zgjatjes së arsyeshme të procedurës por një përcaktim i tillë varet rrethanat e veçanta të çështjes. Në rastin Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës, ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsiderim është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative, dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre brenda një kohe të arsyeshme (*Aktgjykim Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983). Shqyrtimi i lëndës së ankuesit fillon prej viti 2000, kur është iniciuar padia në ish Gjykatën Komunale në Prizren (tani Gjykata Themelore). Pasi ende nuk është marrë vendim përfundimtar lidhur me rastin, data e fundit e hetimit të këtij rasti në shqyrtim, konsiderohet data e publikimit të këtij raporti. Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se, pa marrë parasysh pohimet e gjykatës për ndërlíkueshmërinë e rastit, gjykata ka dështuar që të gjejë zgjidhje për 17 vite me radhë prandaj Avokati i Popullit konstaton se shkelje të nenit 6 të KEDNJ. Në këtë rast Avokati i Popullit i rekomandoi gjykatës që pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmerr të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C.nr 450/2009.

10.14 Raport me rekomandim nr. 236/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 1717/2015

Më 1 dhjetor 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime nr. 236/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 1717/2015. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Gjykatës së Apelit, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC.nr.1717/2015, pa vonesa të mëtutjeshme. Raporti bazohet në ankesën individuale të ankueses si e paditur e rendit të tretë dhe mbështetet në dëshmitë, faktet dhe si dhe shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore për lëndën AC.nr. 1717/2015, që ka të bëjë me vërtetimin e pronësisë, në bazë të të drejtës së parablerjes sipas kundërpadisë së palës së paditur-ankueses.

Sipas dëshmive që kemi në dispozicion, më 20 qershor 2013, ankuesja ka paraqitur kundërpadi kundër paditëses, duke kërkuar dorëzimin e paluajtshmërisë në parcelën kontestuese, në disponim dhe shfrytëzim të lirë ku theksohet se parcelën kontestuese e ka blerë bashkëshorti i ankueses në bazë të kontratës së shitblerjes e legalizuar më 1 prill 1992 deri sa ajo dhe fëmijët e saj janë trashëgimtarë të vetëm ligjor pas vdekjes së të ndjerit, dhe në bazë të trashëgimisë parcelat kontestuese në evidencën katastrale udhëhiqen në emër të tyre. Më 10 dhjetor 2014, me aktgjykimin C. Nr. 1250/92, Gjykata Themelore në Prizren, ka përfunduar shqyrtimin kryesor duke i refuzuar të gjitha

kërkesëpaditë e paditësve, dhe duke aprovuar si të bazuar kundër kërkesëpadinë e të paditurve *ankueses*, që të ia dorëzojnë në posedim dhe shfrytëzim të lirë parcelën katastrale. Më 6 prill 2015, përfaqësuesi i palëve paditëse ushtron ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit C.Nr.1250/92 të datës 10 dhjetor 2014. Ankuesja konsideron se kjo gjykatë nuk i ka zhvilluar procedurat brenda një afati të arsyeshëm kohor që do të mund të përbënte shkelje të së drejtës së tij për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ, i cili thotë: “*Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile [...], çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm [...]*”. Në disa raste GJEDNJ ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij, të vendoset në afat të arsyeshëm kohor, paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (në mes tjerash shih rastin *Azdaçic v. Slovenia*, 8 tetor 2015). Po ashtu GJEDNJ ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin, *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003), deri në kohën kur çështja ka përfunduar ose aktgjykimi është ekzekutuar, (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005). Megjithatë, Avokati i Popullit përkujton se neni 6 i Konventës nuk e përcakton ndonjë afat absolut të caktuar për përcaktimin e zgjatjes së arsyeshme të procedurës por një përcaktim i tillë varet nga rrethanat e veçanta të çështjes.

Nisur nga analiza e informatave, dëshmive dhe fakteve në dispozicion, Avokati i Popullit konstaton se për shkak të zvarritjes procedurale: ekzistojnë shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm kohor, të garantuar me aktet ligjore të lartpërmendura në çështjen në fjalë; dhe ekzistojnë shkelje të së drejtës për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave. Në këto rrethana Avokati i Popullit i rekomandon gjykatës që pa vonesa të mëtutjeshme t’i ndërmerr të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtim dhe vendosje të lëndës AC. Nr. 1717/2015

10.15 Raport me rekomandim nr. 306/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 3194/2015

Më 1 dhjetor 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime nr. 306/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 3194/2015. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës së Apelit, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. nr. 3194/2015, pa vonesa të mëtutjeshme. Raporti bazohet në ankesën individuale të ankuesit dhe mbështetet në dëshmitë, faktet dhe shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore për lëndën AC. nr. 3194/2015, që ka të bëjë me kompensim dëmi.

Ankuesi ankohet për zvarritje të procedurës në Gjykatën e Apelit. Ai konsideron se kjo gjykatë nuk i ka zhvilluar procedurat brenda një afati të arsyeshëm kohor, që do të mund të përbënte shkelje të së drejtës së tij për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ, i cili thotë: “*Në*

përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile [...], çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm [...]” Në raste të shumta Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar të drejtën e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. GJEDNJ ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin, *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003), deri në kohën kur çështja ka përfunduar ose aktgjykimi është ekzekutuar, (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005). Megjithatë, Avokati i Popullit përkujton se neni 6 i Konventës nuk e përcakton ndonjë afat absolut të caktuar për përcaktimin e zgjatjes së arsyeshme të procedurës por një përcaktim i tillë varet nga rrethanat e veçanta të çështjes.

Avokati i Popullit në këtë rast vlerëson se periudha përkatëse për t’u shqyrtuar lënda e ankuesit fillon prej vitit 2011, kur është iniciuar padia në Gjykatën Komunale në Prizren. Pasi ende nuk është marrë vendim përfundimtar lidhur me rastin, data e fundit e hetimit të këtij rasti në shqyrtim, konsiderohet data e publikimit të këtij raporti. Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se procedurat kanë zgjatur mbi 6 vite, dhe se ka pasur shkelje të nenit 6 të KEDNJ.

Gjithashtu, mungesa e mjeteve efektive në shkeljen e të drejtës për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme, siç është garantuar me nenin 6 të KEDNJ, përbën shkelje të nenit 13 të Konventës, i cili thotë: *“Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë e kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare”*.

Sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit përkujton se GJEDNJ disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë lidhur me palët kontestuese të cilat nuk kanë mjete për ankesë brenda sistemit të brendshëm vendor, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit.

Nisur nga analiza e informatave, dëshmime dhe fakteve në dispozicion, Avokati i Popullit konstaton se për shkak të zvarritjes procedurale ekzistojnë shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm kohor, të garantuar me aktet ligjore të lartpërmendura në çështjen në fjalë; dhe ekzistojnë shkelje të së drejtës për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave. Prandaj në këto rrethana Avokati i Popullit rekomandon gjykatën që pa vonesa të mëtutjeshme ti ndërmerret të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. Nr. 3194/2015.

10.16 Raport me rekomandim nr.262/2014 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr.3930/2016

Më 1 dhjetor 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime nr.262/2014 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr.3930/2016.

Raporti bazohet në ankesën individuale të paraqitur nga ankuesi dhe bazohet në dëshmitë, faktet dhe në shkresat, të cilat i disponon Institucioni i Avokatit të Popullit. Raporti ka për Qëllimi i këtij raporti është që t'i tërhiqet vëmendja Gjykatës së Apelit në Prishtinë në lidhje me domosdoshmërinë e ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme për shqyrtimin dhe vendosjen e rastit të e ankesës pa vonesa të mëtejshme, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për lëndën që i është dorëzuar gjykatës së shkallës së parë në Prizren që në vitin 2004 dhe deri më sot lënda e njëjtë nuk e ka epilogun e vet final.

Ankuesi ankohet se ka pritur aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës Themelore gati 10 vite por pas marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë dhe parashtrimit të ankesës kundër të njëjtit nga ana e paditurit Gjykata e Apelit e ktheu lëndën në rishqyrtim, ndërsa aktgjykimi përsëri u nxor në favor të ankuesit në prill të vitit 2016, kundër të cilit përsëri u parashtrua ankesë nga ana e Komunës së Prizrenit, kurse lënda sipas ankesës përsëri i është përcjellë për shqyrtim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e cila që nga dita e parashtrimit të ankesës kundër aktgjykimit të shkallës së parë të Gjykatës Themelore në Prizren deri në ditën e publikimit të këtij raporti nuk ka e vendosur rastin. Ankuesi ankohet që rasti qëndron i pazgjidhur një kohë relativisht të gjatë, përkatësisht procedura në këtë çështje kontestimore ka zgjatur për më shumë se 13 vjet që përbën shkelje të së drejtës së tij për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, i cili thotë “*Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile [...] çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm [...].*” Kontestet civile për kompensim të dëmit për eksproprijimin e padrejtë të pasurisë së paluajtshme nga autoritetet publike konsiderohen si të drejta civile, në kuptim të nenit 6 të Konventës, i cili për këtë arsye është i zbatueshëm në procedurat e këtij rasti.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në disa raste ka konstatuar se në rastet të cilat përfshijnë caktimin e të drejtës civile, kohëzgjatja e procedurave llogaritet nga koha e fillimit të procedurës gjyqësore (shih shembullin, *Sienkiewicz kundër Polonisë*, aktgjykimi i 30 shtatorit 2003) deri në kohën kur për çështjen vendoset përfundimisht dhe/ose aktgjykimi ekzekutohet (shih *Vocaturò kundër Italisë (II)*, aktgjykimi i datës 24 maj 1991). Avokati i Popullit përkujton se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të caktuara të çështjes, duke marrë parasysh kriteret e caktuara nga praktika gjyqësore, veçanërisht kur bëhet fjalë për kompleksitetin e çështjes, sjelljen e palëve në procedurë dhe autoriteteve që punojnë në rast, si dhe asaj se çfarë është në interes të ankuesit (shih rastin *Gollner kundër Austrisë*, aktgjykimi i datës 17 janar 2002).

Avokati i Popullit vëren se rasti i ankuesit nuk ishte i ndërlikuar dhe se sjellja e ankuesit nuk ka kontribuar në ndonjë vonesë. Andaj Avokati i Popullit i rekomandoi gjykatës që pa vonesa të mëtejshme t'i ndërmerr të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën. AC.nr.3930/2016

10.17 Raport me rekomandim nr. 477/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 1168/14

Më 1 dhjetor 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime nr. 477/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 1168/14. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës së Apelit, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës pa vonesa të mëtutjeshme. Raporti është i bazuar në ankesën individuale të ankuesit dhe mbështetet në dëshmitë, faktet dhe shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucionit i Avokatit të Popullit e që dëshmojnë zvarritjen e procedurës gjyqësore në lëndën AC.NR 1168/14 që ka të bëjë me çështjen e vërtetimit të pronësisë. Ankuesi konsideron se kjo gjykatë nuk i ka zhvilluar procedurat brenda një afati të arsyeshëm kohor, që do të mund të përbënte shkelje të së drejtës së tij për proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili thotë “*Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile[...], çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm [...]*”

Në raste të shumta, GJEDNJ ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor, paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Praktika e GJEDNJ ka vërtetuar se zgjatja e procedurës llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin, *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar, (shih, aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit përkujton se GJEDNJ disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë në çështjet e palëve të cilat në shtetet e tyre nuk kanë mjete efektive të ankesës lidhur me këto vonesa, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit vendor ligjor (shih aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999, dhe aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999). Avokati i Popullit, gjithashtu përkujton se edhe pse GJEDNJ ka vendosur se mjetet efektive do të duhej të interpretohen në atë mënyrë që të kuptohet se mjetet mund të jenë efektive në kuptim të spektrit të kufizuar të një mjeti efektiv brenda një konteksti të veçantë (aktgjykimi në rastin *Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, më 6 shtator 1978), GJEDNJ, gjithashtu ka vendosur edhe si vijon “*Për sa i përket dështimit të pohuar për të siguruar seancë gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm [...] asnjë kualifikim i tillë i përmbajtur në fushën e nenit 13 nuk mund të dallohet. Në të kundërtën, vendi i nenit 13 në skemën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të paraparë me Konventë do të përkrahte mbajtjen në minimum të kufizimeve të nënkuptuara me nenin 13 (aktgjykimi në rastin *Kudla kundër Polonisë*, më 26 tetor 2000).*” Prandaj, Avokati i Popullit konkludon se ka pasur shkelje të së drejtës së ankuesit për ankim efektiv të garantuar me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e me këtë ka pasur shkelje edhe të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të

arsyeshëm kohor. Me këtë rast Avokati i Popullit rekomandoi gjykatës që pa vonesa të mëtutjeshme ti ndërmerr të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC.nr 1168/14.

10.18 Raport me rekomandim nr. 553/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.Nr 2823/16

Më 1 dhjetor 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.Nr 2823/16. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës së Apelit, lidhur me nevojën e ndërmarjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës AC. Nr. 2823/16, pa vonesa të mëtutjeshme. Raporti është i bazuar në ankesën individuale të ankuesit dhe mbështetet në dëshmitë, faktet dhe shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucionit i Avokatit të Popullit lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në lëndën AC.Nr 2823/16, për çështjen e kthimit në vendin e punës.

Ankuesi konsideron se gjykata nuk i ka zhvilluar procedurat brenda një afati të arsyeshëm kohor e që do të mund të përbënte shkelje të së drejtës së tij për proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili thotë *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile[...], çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm [...]”* Avokati i Popullit tërheqë vëmendjen tek praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së. Në raste të shumta, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor, paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. E drejta precedente e GJEDNJ ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin, *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar, (shih, aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005). Megjithatë, Avokati i Popullit përkujton se neni 6 i Konventës nuk e përshkruan ndonjë afat absolut të caktuar për përcaktimin e zgjatjes së arsyeshme të procedurës por një përcaktim i tillë varet nga rrethanat e veçanta të çështjes.

Procedurat gjyqësore në rastin e ankuesit kanë zgjatur mbi shtatë (7) vite e katër (4) muaj, dhe se ka shkelje të nenit 6 të KEDNJ. Mungesa e mjeteve efektive në shkeljen e të së drejtës për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme, siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përbën shkelje të nenit 13 të Konventës, i cili thotë *“Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit*

të funksioneve të tyre zyrtare.”.

Nisur nga analiza e informatave, dëshmime dhe fakteve në dispozicion, Avokati i Popullit konstaton se ka pasur shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm kohor, të garantuar me aktet ligjore të lartpërmendura në çështjen në fjalë. Avokati i Popullit konstaton që në rastin konkret nga vonesa e zhvillimit të procedurës gjyqësore nga Gjykata e Apelit është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Nisur nga kjo Avokati i Popullit i rekomandoi gjykatës që pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmerr të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. Nr 2823/16.

10.19 Raport me rekomandim nr. 690/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan

Më 1 dhjetor 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandim nr. 690/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan. Qëllimi i këtij raporti të tërheqë vëmendjen Gjykatës Themelore e Prishtinës – Dega në Lipjan lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës C.Nr.187/15, pa vonesa të mëtutjeshme. Raporti është i bazuar në ankesën individuale të ankuesit dhe mbështetet në dëshmitë, faktet dhe shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucionit i Avokatit të Popullit lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në lëndën C.Nr.187/15 përkitazi më çështjen e anulimit të kontratës së shitblerjes.

Ankuesi pretendon se mungesa e mjeteve efektive në shkeljen e të së drejtës për proces të rregullt brenda kohës së arsyeshme, siç është e garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së, përbën shkelje të nenit 13 të Konventës, i cili thotë: “Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.”

Sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit përkujton se GJEDNJ disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë lidhur me palët kontestuese, të cilat nuk kanë mjete, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit vendor ligjor (shih aktgjykimin në rastin Bottazi kundër Italisë, më 28 korrik 1999 dhe aktgjykimin në rastin Di Mauro kundër Italisë, më 28 korrik 1999). Avokati i Popullit, gjithashtu përkujton se edhe pse GJEDNJ ka vendosur se mjetet efektive do të duhej të interpretohen në atë mënyrë që të kuptohet se mjetet mund të jenë efektive në kuptim të spektrit të kufizuar të një mjeti efektiv brenda një konteksti të veçantë (aktgjykimi në rastin Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë, më 6 shtator 1978). Avokati i Popullit konkludon se ka pasur shkelje të së drejtës së ankuesit për ankim efektiv të garantuar me nenin 13 të KEDNJ-së; ka pasur shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda afatit të arsyeshëm kohor, të garantuar me aktet ligjore të lartpërmendura në çështjen në fjalë; dhe ka pasur shkelje të së drejtës për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave. Nisura nga kjo Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës

Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan që pa vonesa të mëtutjeshme t’i ndërmerr të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C.nr.187/15.

10.20 Raport me rekomandime nr. 431/2017 në lidhje me kufizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike

Më 20 dhjetor 2017, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime nr. 431/2017 në lidhje me kufizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike. Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen Komunës së Ferizajt, lidhur me ankesën e ankueses të parashtruar në emër të Organizatës Jo Qeveritare “Iniciativa për Progres – INPO” për mohimin e qasjes në dokumente publike, analizimin e ligjit për Qasje në Dokumente Publike, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse në raport me zbatimin e këtij ligji në rastet e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike.

Drejtoresha ekzekutive e OJQ “Iniciativa për Progres - NPO” më 18 maj 2017 i është drejtuar me kërkesë kryetarit të atëhershëm të Komunës së Ferizajt që t’i ofrojë qasje në marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Ferizajt dhe kompanisë “Doranova Oyme”, marrëveshje e realizuar në vitin 2014, si dhe raportin e studimit të fizibilitetit lidhur me vlerësimin e pronës komunale. Më 25 maj 2017, parashtruesja e kërkesës, OJQ “Iniciativa për Progres - INPO” ka marr njoftimin 01. Nr. 215/17 në të cilën përveç tjerash thuhet; “ ... Kërkesa e juaj nuk aprovohet në afatin e paraparë ligjor nga shkaku se zyrtari ligjor në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik, nëpërmes postës elektronike me ka njoftuar se për përgjigjen në kërkesën e juaj na duhet kohë për përgatitje që të japim përgjigje nëse kjo bie në kompetencën tonë, ... për informata të duhura të kontaktoni pas datës 29.05.2017, me zyrtarin e drejtorisë së lartë cekur...” Pas kësaj Drejtoresha Ekzekutive e OJQ “Iniciativa për Progres - NPO”, i është drejtuar me parashtrësë Avokatit të Popullit duke kërkuar që në kuadër të përgjegjësive ligjore, të mbrojë të drejtën për qasje në dokumente publike për faktin se edhe pse kishte kaluar gati 1 muaj, ajo nuk kishte marrë asnjë përgjigje

Në komunikimet Avokatit të Popullit me komunën i është thënë se ankueses nuk i është lejuar qasje për shkak se mund të keqpërdoret. E drejta për t’u informuar është e drejtë e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 19 i së cilës përcakton se: “Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë”. Lirinë për të marrë dhe dhënë informacion e parasheh edhe neni 10, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)- [Liria e Shprehjes]: “Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...”. Fryma e nenit 41 të Kushtetutës është përcjellë edhe në nenin 1, të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike Nr. 03/L-215 (në tekstin e mëtejme LQDP), sipas të cilit: “Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo

pranuara nga institucionet publike". Avokati i Popullit vëren se, lidhur me kërkesën e parashtruar të palës komuna nuk ka nxjerrë vendim. LQDP më nenin 8, paragrafi 7, parasheh shprehimisht se "Institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes së plot, apo të pjesërishme. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh se "Vetëm ligji ka autoritetin për përcaktimin të drejtave dhe detyrimeve për personat juridik dhe fizik", si dhe duke u bazuar në faktet e ofruara, konstaton se mos përgjigja e Komunës së Ferizajt, përkitazi me kërkesën e OJQ "Iniciativa për Progres – INPO", bie në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike. Përveç obligimit të organit të përcaktuar me LQDP, që mbi kërkesën e parashtruar të vendosë çështjen me vendim, Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative në nenin 47, parasheh në mënyrë të detajuar strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar.

Dështimi për të nxjerrë një vendim në formën adekuate dhe me një arsytim të qëndrueshëm përbën keqadministrim.

Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) që sipas Kushtetutës, neni 53 paraqet bazë për interpretimin e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë. GJEDNJ thekson se vonesat në dhënien e informatës mund t'i heqin në mënyrë të vazhdueshme të gjithë vlerën informatës dhe interesimin lidhur me të, sepse një lajm përbën një shërbim që ikën shpejt dhe vonimi i botimit të tij, edhe për një periudhë të shkurtër kohore, mund t'i mohojë këtij lajmi tërë vlerën dhe interesin (shih rasti *The SundayTimes v. The United Kingdom*.²¹⁵

Bazuar në këto që u thanë më lartë Avokati i Popullit me qëllim të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies e në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit rekomandoi Komunën e Ferizajt që të shqyrtojë kërkesën e OJQ "Iniciativa për Progres-INPO" të datës 18 maj 2017, për qasje në dokumente publike dhe t'i jepet përgjigje e arsyetuar, si dhe të ndërmarë hapa për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve publik lidhur me zbatimin Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

²¹⁵ Case Of The Sunday Times V. The United Kingdom, (Application no. 6538/74 , 26 April 1979)

11.Raportet e Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës

11.1 Raport me rekomandime lidhur me monitorimin e Qendrës Korrektuese në Dubravë

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejme “MKPT”) i Avokatit të Popullit më 21, 22 dhe 23 nëntor 2016 ka vizituar Qendrën Korrektuese në Dubravë (në tekstin e mëtejme “QKD”). Grupi monitorues përbëhej nga dy juristë, një mjek dhe një psikologe.

QKD ka filluar të ndërtohet në vitin 1976 dhe është përfunduar në vitin 1986 kur edhe është hapur. Në atë kohë kapaciteti ka qenë diku rreth 1000 të burgosur si dhe ka ekzistuar nëndega e QKD në Gurrakoc, ku më shumë kanë qenë të koncentruar të burgosurit me dënime të shkurtra të cilët kanë punuar, duke pasur parasysh se aty ka ekzistuar ferma e pulave, punëtorja e axhustatorëve, etj.²¹⁶ Pas luftës ky institucion filloi të administrohet nga UNMIK-u dhe të rindërtohet në saje donacioneve të huaja. Fillimisht u rindërtuan pavijonet 2,3,7 dhe 8 dhe në qershor të vitit 2000 filloi punën. QKD është institucion i nivelit të lartë të sigurisë i përbërë prej disa sektorëve të ndryshëm. Pjesa e Brendshme është e ndarë në dy pjesë ku njëra prej tyre është zona për zhvillimin bujqësisë dhe përdorime të tjera, dhe në pjesën e banueshme, ku janë të vendosur të burgosur kryesisht të dënuar të rritur.

Zakonisht të burgosurit janë të vendosur në 8 pavijone banimi, por gjatë vizitës MKPT u njoftua se pavijoni 5 ishte duke u rinovuar, ndërsa në pavijonin e spitalit janë të vendosur pacientët ku u ofrohet ndihma mjekësore, përveç rasteve të rënda të cilat dërgohen në spitalet publike. Ndërsa, jashtë murit rrethues të Burgut gjendet pavijoni gjysmë i hapur ku janë të vendosur të burgosur të rrezikshmërisë së ultë të cilët kanë përcjellje minimale. Kapaciteti i QKD është 1183 shtretër. Në kohën kur MKPT e vizitoi këtë qendër ishin të vendosur 840 të dënuar. MKPT u njoftua se për shkak të para përgatitjeve për mbyllje të Qendrës së Paraburgimit në Lipjan (QPL), në QKD ishin vendosur 40 të paraburgosur të transferuar nga QPL. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës e ka vizituar QKD në vitin 2007, 2010 dhe 2015.

Gjatë vizitës së MKPT në QKD, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha vendet e vizituara. U siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan bisedat me personat e dënuar dhe të paraburgosur pa prezencë të zyrtarëve korrektues ose personelit tjetër. Po ashtu, MKPT u lejua të përdor edhe foto aparat.

Gjatë vizitës në QKD, MKPT ka vizituar edhe kuzhinën ku ushqehen të dënuarit të cilët punojnë jashtë perimetrit të burgut dhe personeli i qendrës korrektuese, ndërsa të

²¹⁶ Të dhëna nga ueb faqja e Ministrisë së Drejtësisë e Republikës së Kosovës, në: <http://www.md-ks.net/?page=1,70> (31.10.2016).

burgosurve tjerë, ushqimi u shërbehet neper qelit e tyre. Gjatë vizitës në pavijone, MKPT nuk ka pranuar ankesa serioze lidhur me kualitetin e ushqimit. Gjithashtu MKPT u njoftua se Stafi i kuzhinës si dhe të burgosurit e punësuar në kuzhinë posedonin librezat sanitare. MKPT ka kontrolluar frigoriferët ku mbahen ushqimet, si dhe ka kontrolluar afatet e ushqimit. MKPT nuk ka hasur në ushqime me afate të skaduara.

Raporti në formën e tij të plotë është publikuar dhe rekomandimet përkatëse lidhur me gjetjet gjatë vizitës u janë adresuar autoriteteve përgjegjëse. Është e rëndësishme të theksohet se ekipi nuk ka hasur në raste të keqtrajtimit fizik që do të përbënin shkelje të të drejtave të njeriut.

11.2 Raport me rekomandime lidhur përkitazi me monitorimin në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt në Vranidoll

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejme “MKPT”) i Avokatit të Popullit më datë 7 dhe 12 dhjetor 2016 ka vizituar Qendrën e Mbajtjes për të Huajt (në tekstin e mëtejme QMH) në Vranidoll. Grupi monitorues përbëhej nga një juristë dhe një psikologe. Raporti në formën e tij të plotë u publikua më 7 shkurt 2017.

QMH u hap në qershor të vitit 2015 dhe funksionon në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM) të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Sipas nenit 2 të Rregullores (MPB) nr. 03/2014 për Funksionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve (në tekstin e mëtejme “Rregullorja”), në këtë qendër vendosen të huajt të cilët janë subjekt i largimit me forcë, si dhe të huajt për të cilët konsiderohet se e cenojnë sigurinë publike, me qëllim të vërtetimit të identitetit të tyre dhe për arsye tjera. Kapaciteti i kësaj Qendre është 76 persona. Gjatë vizitës në QMH, personeli i Qendrës i ofroi MKPT bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat e Qendrës. Ekipit i’u siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën. Gjatë vizitës në QMH nuk kishte të huaj të vendosur.

Bazuar në dispozitat e ligjit për të huajt, i huaji i cili vendoset në Qendër njoftohet në formë të shkruar, në njërën nga gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze, për ndalimin në Qendrën e Mbajtjes, i cili përmban arsyen e ndalimit, afatet e ndalimit, të drejtën të sigurojë mbrojtjen ligjore të tij, si dhe të kontaktojë me të afërmit e vet”.²¹⁷ MKPT, bazuar në dokumentacionin e kontrolluar, ka vërejtur se këto të drejta u respektohen të huajve në Qendër.

Më tej, neni 114 paragrafi 3 i Ligjit për të Huajt përcakton të drejtën e të huajit për të njoftuar përfaqësuesin diplomatik apo konsullor lidhur me ndalimin e tij. MKPT u njoftua nga zyrtarët e Qendrës se në disa raste hasin në vështirësi për shkak se shtetet nga janë disa të huaj nuk e njohin Republikën e Kosovës si shtet të pavarur dhe nuk kanë vendosur marrëdhënie diplomatike me Kosovën. Bazuar në dokumentacionin e shfletuar

²¹⁷ Ligji 04/L-219 për të Huajt, paragrafi 108.

gjatë vizitës, Qendra të huajve ua ka ofruar mundësinë për të njoftuar ambasadat apo konsullatat e shteteve nga ata vijnë.

1. MKPT ka vërejtur se në të gjitha korridoret e Qendrës operojnë kamerat e sigurisë të cilat janë vazhdimisht operacionale. Në raportin për vizitën në Irlandë në vitin 2010, KPT konsideroi ekzistimin e kamerave të sigurisë si një nga garancitë kundër keqtrajtimit fizik në qendrat ku mbahen personat e privuar lirie.²¹⁸

Standardet e përcaktuara nga KPT lidhur me të drejtat e të ndaluarit të huaj përcaktojnë të drejtën për të pasur shërbimin e një mjeku si e drejtë themelore dhe një nga garancitë kundër keqtrajtimit. MKPT u njoftua se shërbimet mjekësore të huajve në këtë qendër u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Prishtinë dhe Qendra Klinike Universitare. Neni 10 i Rregullores (Ekzaminimi mjekësor) shprehimisht përcakton se personeli profesional mjekësor kryen ekzaminimin e përgjithshëm mjekësorë të të huajve pas vendosjes së tyre në këtë qendër. Rregullorja më tej parasheh se të gjithë të huajve të moshës mbi pesë vjeçare duhet t'u bëhet testi i tuberkulozes dhe në kuadër të kësaj duhet t'u bëhet rëntgeni i mushkërive.

Lidhur me të huajt me aftësi të kufizuara mendore, apo ata të cilët manifestojnë simptoma të çrregullimeve mendore, Rregullorja parasheh se duhet të sigurohet trajtimi psikologjik dhe këshillim profesional mjekësor. Sipas rregullores, këto shërbime mund të ofrohen nga Organizatat Jo-Qeveritare relevante në bazë të kërkesës nga i huaji.

MKPT gjatë vizitës u njoftua se të huajve të vendosur në këtë Qendër nuk u bëhen ekzaminime të përgjithshme mjekësore, përveç nëse ata e kërkojnë një gjë të tillë.

MKPT rekomandon që të huajve të akomoduar në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt t'u bëhen kontrole mjekësore me rastin e pranimit me qëllim të detektimit të hershëm të sëmundjeve siç janë tuberkulozi, hepatiti dhe HIV AIDS.

11.3 Raport me rekomandime përkitazi me monitorimin në Qendrën për Azilkërkues

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm "MKPT") i Avokatit të Popullit në nëntor 2016 ka vizituar Qendrën për Azilkërkues në fshatin Magurë, Komuna e Lipjanit (në tekstin e mëtejshëm "Qendra"). Grupi monitorues përbëhej nga një juristë dhe një psikologe. Raporti u publikua më 7 shkurt 2017.

Qendra për Azilkërkues në Magurë u inaugurua në vitin 2012 dhe funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Me Rregulloren (MPB) nr. 02/2014 për Funksionim e Qendrës për Azilkërkues (në tekstin e mëtejshëm "Rregullorja") rregullohet çështja e funksionimit dhe menaxhimit të Qendrës, përfshirë procedurën e pranimit, regjistrimit dhe lëvizjes së azilkërkuesve brenda dhe jashtë Qendrës.²¹⁹ Kjo Rregullore po ashtu rregullon edhe kushtet sanitare, higjienike, ushqimin, ndihmën mjekësore,

²¹⁸ Raporti i KPT për vizitën në Irlandë në vitin 2010, publikuar në vitin 2011, paragrafi 18.

²¹⁹ Rregullorja (MPB) nr. 02/2014 për Funksionim e Qendrës për Azilkërkues, neni 1.

mirëmbajtjen e rendit dhe disiplinës, si dhe çështje tjera të rëndësishme lidhur më punën e saj.²²⁰

Gjatë vizitës në këtë Qendër, personeli i Qendrës i ofroi MKPT bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat e Qendrës. Ekipit i u siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën, si dhe mundësia për të intervistuar azilkërkuesit pa prezencë të zyrtarëve të Qendrës.

Neni 19 i Ligjit për Azil përcakton të drejtat e azilkërkuesve të cilat janë: të qëndrojnë në Republikën e Kosovës, të ketë kushtet themelore të jetesës, kujdesin shëndetësor, ndihmën sociale themelore, ndihmën ligjore pa pagesë, të drejtën e arsimimit për azilkërkuesit fëmijë, të drejtën në lirinë e mendimit dhe besimit fetar, të drejtën për punësim dhe të drejtën në trajnime profesionale. MKPT nuk ka pranuar ankesa nga azilkërkuesit e akomoduar në këtë Qendër lidhur me gëzimin e këtyre të drejtave të garantuara me Ligjin për Azil.

MKPT konstaton se azilkërkuesve të akomoduar në Qendrën për Azilkërkues u ofrohen kushte për jetesë në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe ligjet relevante vendore dhe se nuk ka pranuar ankesa nga të akomoduarit për shkeljen e të drejtave të tyre apo lidhur me trajtimin në këtë Qendër.

11.4 Raport me rekomandime përkitazi me monitorimin në Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm “MKPT”) i Avokatit të Popullit më datë 14 dhjetor 2016 ka vizituar Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë. Grupi monitorues përbëhej nga një juristë dhe një psikologe. Raporti u publikua më 7 shkurt 2017.

Gjatë vizitës në Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë, Policia e Kosovës i ofroi MKPT bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat. Ekipit i u siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën, si dhe iu mundësua intervistimi i personave të arrestuar pa prezencë të zyrtarëve policor.

Personat e dyshuar për kryerje të veprës penale mund të mbahen nga policia deri në 48 orë para se të dërgohen para gjyqtarit të procedurës paraprake. Policia mund të mbaj dhe të mbledhë informata nga personat të cilët gjenden në vendin ku është kryer vepra penale të cilët mund të sigurojnë informata relevante (periudha maksimale kohore: gjashtë orë)²²¹.

Gjatë vizitës së MKPT, në Qendër ndodheshin tre persona të arrestuar. MKPT ka kontrolluar dosjet e tyre dhe më pastaj i ka intervistuar veç e veç këta persona. Njëri nga

²²⁰ Rregullorja (MPB) nr. 02/2014 për Funkcionim e Qendrës për Azilkërkues, neni 1paragrafi 2.

²²¹ Nenet 162, 163, 164 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

të arrestuarit iu ankua MKPT se gjatë intervistimit të tij në stacionin policor në Fushë Kosovë ishte keqtrajtuar fizikisht nga dy zyrtarë policorë.

Policia e Kosovës i ka ofruar bashkëpunim të plotë MKPT-së në trajtimin e këtij pretendimi duke i ofruar qasje në dosjen e të arrestuarit dhe raportet relevante mjekësore. MKPT përmes një shkrese zyrtare ka kërkuar nga Inspektorati Policor i Kosovës që të hetojë pretendimin e ankuesit për keqtrajtim nga dy zyrtarët policorë në Stacionin Policorë në Fushë Kosovë dhe të njoftojë MKPT për rezultatin e hetimit.

Sipas standardeve të KPT tri të drejtat themelore (e drejta për të njoftuar të afërmin apo familjen lidhur me ndalimin, e drejta për të pasur një avokat dhe për të pasur qasje në shërbime mjekësore) duhet të aplikohen që nga momenti i ndalimit. Këto të drejta duhet të zbatohen jo vetëm në rastin e personave të ndaluar por edhe në rastet tjera kur qytetarët detyrohen të qëndrojnë në polici apo me policinë edhe për arsye tjera (për shembull, për qëllime identifikimi).

Neni 13 i Kodit të Procedurës Penale përcakton çdo person i privuar nga liria duhet të njoftohet menjëherë në gjuhën të cilin ai/ajo e kupton për të drejtën për ndihmë juridike sipas dëshirës së tij, për të drejtën për të njoftuar anëtarët e familjes apo ndonjë person tjetër për faktin se është arrestuar dhe se këto të drejta aplikohen gjatë gjithë kohës së privimit nga liria.²²²

Sa i përket njoftimit për arrestin, neni 168 i Kodit të Procedurës Penale më tej përcakton se personi i arrestuar ka të drejtë të njoftojë anëtarin e familjes apo personin tjetër sipas përzgjedhjes së tij për arrestin dhe vendin e ndalimit menjëherë pas arrestimit; njoftimi i familjarit apo personit tjetër lidhur me arrestimin mund të vonohet më së shumti deri në 24 orë kur prokurori i shtetit çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetim të rastit. Kjo vonesë nuk aplikohet në rastin e personave të mitur.

Sipas Ligjit për Policinë²²³ e drejta për të njoftuar familjen apo personin tjetër për arrestimin gjithashtu vlen edhe për personat të cilët janë në “ndalim të përkohshëm” me qëllim të identifikimit ose për shkak të mbrojtjes së tyre dhe mbrojtjes së të tjerëve. MKPT nuk ka pranuar ankesa nga personat e arrestuar të cilët gjendeshin në Qendrën Rajonale të Mbrojtjes në Prishtinë lidhur me këto të drejta. Po ashtu, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar del se Policia e Kosovës ka respektuar këto të drejta. Gjatë vizitës, MKPT ka vërejtur se në secilën qeli ndodheshin informata të shkruara lidhur me të drejtat e personave të arrestuar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Gjatë vizitës në këtë Qendër, MKPT nuk ka hasur në të mitur të arrestuar.

Kjo Qendër është rinovuar gjatë vitit 2016. MKPT ka vërejtur se qelitë ishin të pastra, kishin mjaftë hapësirë, secila qeli kishte dyshek dhe çarçaf të pastër, por kishte shumë pak dritë natyrale dhe qelitë nuk ishin të pajisura me sistem të thirrjes. Brenda Qendrës funksiononte sistemi i ventilimit. Tualetet dhe dushet ishin në gjendje të mirë dhe kishte

²²² Shih po ashtu nenet 29 dhe 30 të Kushtetutës.

²²³ Ligji për Policinë, neni 20.

edhe ujë të ngrohtë. MKPT ka vërejtur se kushtet për punë të zyrtarëve policorë të cilët punonin në këtë Qendër nuk ishin të mira. MKPT konsideron se autoritet relevante duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm për evitimin e këtyre mangësive.

Shërbimet mjekësore janë e drejtë themelore e personave të cilët arrestohen nga policia. Shërbimet mjekësore ofrohen nga institucionet publike siç janë Qendra e Mjekësisë Familjare dhe Qendra Klinike Universitare, varësisht nga nevojat për trajtim. MKPT nuk ka pranuar ankesa nga personat e intervistuar lidhur me këtë të drejtë. Po ashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar është vërejtur se policia ka evidentuar në dosjet e tyre personale njoftimin për të drejtën për të pasur shërbime mjekësore. MKPT ka vërejtur se të gjitha të dhënat lidhur me shërbimet e ofruara mjekësore ndaj të arrestuarve mbahen në dosjen e tij/saj personale.

Prandaj, bazuar në të gjeturat e vizitës, MKPT u rekomandon autoriteteve relevante që të ndërmarrin hapa për të siguruar më shumë dritë natyrale në këtë Qendër; të arrestuarve të cilët qëndrojnë në Qendër më shumë se 24 orë, brenda mundësive, t'u mundësohet ajrosje ditore; Në qeli të instalohet sistemi i thirrjeve si dhe të krijohen kushte më të mira për punë për zyrtarët policorë në Qendër.

11.5 Raport përkitazi me monitorimin në pikat e kalimit të kufirit në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë, pikën kufitare “Hani i Elezit” dhe pikën kufitare “Vërmicë”

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm “MKPT”) i Avokatit të Popullit gjatë muajit nëntor 2016 ka vizituar pikat e lartpërmendura të kalimit kufitar. Grupi monitorues përbëhej nga një juristë dhe një psikologe. Raporti u publikua më 7 shkurt 2017.

Gjatë vizitës në këto pika të kalimit kufitar, MKPT ka hasur në bashkëpunim të plotë të zyrtarëve policorë të cilët ishin në detyrë gjatë vizitës.

Gjatë vizitës është vizituar dhoma ku mbahen personat e ndaluar përkohësisht të cilët qëndrojnë aty jo më shumë se 6 orë dhe ky ndalim bëhet mbi bazën e ndonjë urdhërese nga gjykata apo prokuroria si dhe mbi bazën urdhër arresti ndërkombëtar. Këta persona mbahen në këtë dhomë vetëm derisa të merren nga aty nga njësia përkatëse e Policisë së Kosovës.

MKPT është njoftuar nga zyrtari kompetent policor se aeroporti nuk posedon zonë transiti. Gjatë vizitës në këtë pikë të kalimit kufitar MKPT ka vizituar edhe hapësirat (2 dhoma me nga 8 shtretër) ku akomodohen personat të cilëve u mohohet hyrja në territorin e Republikës së Kosovës për arsye të ndryshme. Këta persona duhet të kthehen në vendet nga kanë ardhur brenda 72 orëve. Nëse kjo nuk ndodhë brenda kësaj periudhe kohore, ata dërgohen në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt.

Këto dhoma ofrojnë kushte të mira për akomodim, kanë pastërti të duhur, tualete dhe dushe në gjendje shumë të mirë, si dhe u ofrohet edhe qasja në internet përmes “WI-FI”, gjë që u mundëson edhe kontaktet me familjet e tyre apo personat tjerë. MKPT konsideron se këto dhoma plotësojnë standardet e përcaktuara nga Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës lidhur me kushtet e mbajtjes së personave të cilëve u refuzohet hyrja në territorin e shtetit të caktuar.

Gjatë vizitës së MKPT nuk kishte persona të akomoduar në këto dhoma, si dhe në dhomën ku përkohësisht mbahen personat e ndaluar mbi bazën e vendimeve të gjykatave apo kërkesave të prokurorisë. Personeli i shërbimit mjekësor i aeroportit përbëhet nga 6 infermiere dhe 3 mjekë të përgjithshëm. Shërbimet mjekësore ofrohen 24 orë për personat e ndaluar dhe personelin e aeroportit. Gjatë vizitës MKPT ka vërejtur se kjo qendër mjekësore është pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për punë, tre shtretër, barna dhe dy auto ambulanca me pajisje.

Pika e kalimit kufitar “Hani i Elezit”

Gjatë vizitës në këtë pikë të kalimit kufitar me Republikën e Maqedonisë, MKPT u njoftua se në këtu gjendet një dhomë e ndalimit të përkohshëm i cili nuk zgjat më shumë se 6 orë. Zakonisht ndalohen personat mbi bazën e flet arrestit të gjykatave dhe prokurorive vendore dhe sipas urdhër arrestit ndërkombëtarë.

MKPT ka vërejtur se dhoma e ndalimit të përkohshëm në këtë pikë kufitare kishte hapësirë të mjaftueshme, dyshek dhe çarçaf të pastër, ngrohje, si dhe ventilim të duhur. Sipas zyrtarëve kompetentë, në këtë pikë të kalimit kufitar, pas ndalimit policia kufitare menjëherë e njofton njësinë përkatëse të Policisë së Kosovës e cila e merr të ndaluarin dhe e dërgon në institucionin përkatës. Kjo njësi e njofton të ndaluarin me të drejtat e tij/saj dhe procedurat tjera.

Pika e kalimit kufitar “Vërmicë”

Gjatë vizitës në këtë pikë të kalimit kufitar me Republikën e Shqipërisë, MKPT u njoftua se kjo pikë e kalimit kufitar posedon dy dhoma të ndalimit të përkohshëm (6 orë), si dhe një dhomë të intervistimit. Policia kufitare kishte formularë të gatshëm në gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze përmes së cilave të ndaluarit njoftohen me të drejtat e tyre. Ndërsa lidhur me të drejtën për avokat angazhimi i tyre sigurohet nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe zakonisht janë avokatë nga Prizreni për shkak të afërsisë dhe komunikimi të lehtë. Sipas zyrtarëve të kësaj pike të kalimit kufitar, Policia Kufitare posedon një listë të përkthyesve në gjuhët evropiane dhe arabe.

Dhomat e ndalimit të përkohshëm ishin në gjendje të mirë sa i përket hapësirës, pastërtisë, posedonin dyshek dhe çarçafë të pastër, si dhe ngrohje në nivel të kënaqshëm, ndërsa shërbimet mjekësore ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Prizren.

Pas vizitës në këto pika të kalimit kufitar, MKPT konstaton se ato i plotësojnë standardet për mbajtjen e përkohshme të personave të cilët ndalohen për arsye të ndryshme.

11.6 Raport me rekomandime lidhur me vizitën në Institutin Special në Shtime

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm “MKPT”) i Avokatit të Popullit më 13 dhjetor 2016, ka vizituar Institutin Special në Shtime (në tekstin e mëtejshëm “ISSH”). Grupi monitorues përbëhej nga një juristë, një mjek dhe një psikologe. Raporti u publikua më 22 shkurt 2017

Instituti Special në Shtime (ISSH), menaxhohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), të cilën e udhëheqë drejtori i Institutit. Është institucion i tipit të hapur i cili ofron shërbime 24 orës: ushqim, veshmbathje, përkujdesje shëndetësore, terapi të punës edukative dhe aftësuese, trajtim social. Përfitues të shërbimeve në këtë institucion janë kryesisht personat me aftësi të kufizuar mendore -ngecje në zhvillimin mendor. Kapaciteti i ISSH-së është për 64 rezidentë, ndërsa gjatë vizitës së fundit ishin prezent 59 rezidentë, prej tyre 39 të gjinisë mashkullore, 20 të gjinisë femërore, mosha mesatare e tyre është 45 vjeç.

Stafi i ISSH-së gjithsej janë 70 persona, të ndarë në disa shërbime si: shërbimi shëndetësor i përbërë nga: 1 mjek i përgjithshëm, 11 infermier, 1 teknik i farmacisë, 23 ndihmës mjekësor, si dhe një floktarë; shërbimi teknik i përbërë nga: 1 shef i shërbimit, 1 axhustatorë, 4 rrobalarës, 4 garda, 2 vozitës; shërbimi social i përbërë nga: 1 punëtor social, 1 teknik i bujqësisë, 1 terapeut profesional, 1 instruktor artizanati, 1 instruktore e rrobaqepësisë, 1 instruktor i zdrukthëtarisë; shërbimi i kuzhinës i përbërë nga: 1 shef i shërbimit, 4 kuzhinier, 2 ndihmës kuzhinier, 2 enëlarës-servues, 1 ndihmës mjekësor; shërbimi i administratës i përbërë nga zyrtari i financave, zyrtari i personelit, zyrtari i parasë së imtë, depoisti.

Ligji për Shëndetin Mendor nr. 05/L-025 ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2015, ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore. Neni 18 i këtij Ligji parasheh nxjerrjen e aktit nënligjor për trajtimin e rezidentëve që gjenden në institucionet e kujdesit social²²⁴. Deri më tani nuk është nxjerr asnjë akt nënligjor, apo ligj i veçantë që rregullon trajtimin e rezidentëve në Institucionet e kujdesit social, të cilat menaxhohen nga MPMS dhe Komunitat.

Këto Institucione vazhdojnë të rregullohen me dy Udhëzime Administrative të MPMS: UA nr.11/2014 për punën dhe vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor në Institutin Special në Shtime dhe në shtëpitë me

²²⁴ Neni 18, paragrafi 1 i Ligjit me Nr 05/L-025 Për Shëndetin Mendor, thekson: “Personave, që gjenden në institucionet rezidenciale të përkujdesit social, u ofrohet këshillim, trajtim, rehabilitim dhe kujdes në shëndet mendor në mënyrë të barabartë dhe sipas standardeve shëndetësore, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë”. Paragrafi 2 i këtij neni thotë: Mënyra e organizimit dhe e dhënies së shërbimeve, të parashikuara në paragrafin 1, të këtij neni, përcaktohet me akt të veçantë nënligjor të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të miratuar nga Qeveria.

bazë në komunitet, si dhe UA nr. 13/2010 për ofrimin e shërbimeve në komunitet- shtëpi për persona me aftësi të kufizuara mendore -ngecje në zhvillimin mendor. Në bazë të UA nr.11/2014 Për punën dhe vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor në Institutin Special në Shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet, parashihet trajtimi i personave që u është marrë zotësia e veprimit nga Gjykata Themelore. MKPT i AP-së ka hetuar të gjitha rastet e rezidentëve pa vendim gjyqësor dhe në shkurt të vitit 2016 ka publikuar raportin me rekomandime.²²⁵ Gjatë vizitës së datës 13 dhjetor 2016, MKPT u njoftua se rekomandimi i AP-së është zbatuar nga ISSH.

Gjatë vizitës së MKPT-së, personeli i ISSH-së i ofroi bashkëpunim të plotë ekipit monitorues. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat ku qëndronin rezident dhe iu mundësua biseda me disa nga rezidentët me shkallë të lehtë të ngecjes në zhvillim mendor, të cilët ishin në gjendje të bisedonin.

Gjatë vitit 2016 në hapësirat e ISSH-së është ndërtuar një objekt i ri në të cilin janë vendosur administrata e këtij institucioni, ndërsa pjesa ku ka qenë administrata, është përshtatur për banim, e cila e ka lehtësuar punën e stafit dhe është mundësuar që të bëhet kategorizimi i rezidentëve sipas gjinisë dhe gjendjes shëndetësore. Në repartin A1 ishin të vendosur kategoria e lehtë e rezidentëve, në repartin A2 kategoria e mesme dhe në repartin B kategoria e rëndë.

ISSH kishte edhe hapësirat e aktiviteteve, sallë për pikturim, salla për artizanate dhe rrobaqepësi si dhe salla rekreative e pajisur me mjete si: shah, domino, letra gjithashtu e kishte edhe një restorant ku në çdo kohë kanë mundësi të shërbehen me çaj rezidentët. MKPT e vlerëson pozitivisht ristrukturimin e reparteve brenda Institucionit, si dhe kategorizimin e rezidentëve sipas gjinisë dhe gjendjes shëndetësore, i cili ofron edhe siguri për rezidentët.

Krijimi i një mjedisi terapeutik pozitiv përfshinë vënien në dispozicion të hapësirës jetike të mjaftueshme për pacientë si: ndriçim, ngrohje, ajrim të përshtatshëm si dhe pastërti në nivel të kënaqshëm. Gjatë vizitës së MKPT-së në dhomat ku akomodoreshin rezidentët, kryesisht ishin 2 deri 3 shtretër në një dhomë, kishte ndriçim natyral, ishin të ngrohta dhe të pastër, dhe ishin në pajtim me nenin 6, paragrafi 1.10 të Ligjit për Shëndetin Mendor, nr.05/L-025.²²⁶

Sipas standardeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, vëmendje duhet t'i kushtohet edhe dekorimit të dhomave të pacientëve dhe mjediseve të argëtimit, për t'u dhënë pacientëve stimulim pamorë, gjithashtu vënia në dispozicion e komodinave pranë krevatit dhe garderobave është shumë e dëshirueshme. Gjatë vizitës së MKPT-së, në

²²⁵ Raport Ex-Officio: 757/2015 lidhur me vendimet gjyqësore për heqjen dhe kthimin e zotësisë për të vepruar, rezidentëve në ISSH dhe në shtëpitë me bazë në komunitet, shih në:

http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/150-2016,_Raport_me_rekomandime_875017.pdf

²²⁶Neni 6, paragrafi 1.10 i Ligjit Nr.05/L-025 Për Shëndetin Mendor, përcakton “të drejtën për t’u siguruar kushtet e përshtatshme jetësore, higjienike, të ushqyerjes dhe sigurisë”

dhomat e rezidentëve kishte komodina për vendosjen e rrobave dhe gjërave personale, gjithashtu kishte edhe dekorime për stimulim pamorë p.sh. piktura të ndryshme, të cilat janë punuar nga disa rezidentë në bashkëpunim me instruktorët.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës i është rekomanduar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që të nxirren aktet nënligjore në pajtim me nenin 18, paragrafi 2 i Ligjit për Shëndetin Mendor, nr. 05/L-025; Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që të sigurohen kushtet (hapësirat) adekuate për punën e personelit shëndetësor; Institutin Special në Shtime që të krijohen regjistra të veçantë të rasteve të vetëlëndimeve, lëndimeve trupore, tentim vetëvrasjes, vdekjeve dhe rasteve kur përdoren mjetet e kufizimit, si dhe Komunën e Shtimes që të merren masat për evitimin e problemit të prezencës së qenve endacak në oborrin e Institucionit.

11.7 Raport me rekomandime lidhur me vizitën në Qendrën për Integrim dhe Rehabilitim të sëmurve kronik psikiatrik në Shtime

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejme “MKPT”) i Avokatit të Popullit më 26 qershor 2016 dhe 13 dhjetor 2016, ka vizituar Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime (në tekstin e mëtejme “QIRSKP”). Grupi monitorues përbëhej nga një juristë, një mjeke dhe një psikologe. Raporti u publikua me 6 mars 2017.

Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime (QIRSKP), si Institucion është në kuadër të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), e cila ofron shërbime 24 orë. Është themeluar në vitin 2006, me 3270m², me 4 reparte (A1-A4) ku janë gjithsej 48 dhoma, me kapacitet deri në 80 shtretër.

QIRSKP është institucion i tipit të hapur, rezidentët në këtë Qendër ishin kryesisht të diagnostikuar me çrregullime psikotike, si *Schizophreniae*. Gjithsej ishin 63 rezidentë prej tyre 36 të gjinisë mashkullore, 27 të gjinisë femërore, mosha mesatare sillej rreth 54 vjeç, kishte rezidentë me nacionalitete të ndryshme si: 43 shqiptarë, 8 serb, 5 ashkali, 1 maqedonas, 2 boshnjak.

Personeli i QIRSKP përbëhet nga 39 persona, prej tyre, 1 psikiatër i cili është edhe drejtor i institucionit, 9 infermier, 12 ndihmës mjekësor, një punëtor social, pesë punëtor në kuzhinë si dhe pjesa tjetër në shërbime teknike, sigurim etj.

Ligji për Shëndetin Mendor, me nr. 05/L-025 i hyrë në fuqi në dhjetorë të vitit 2015, ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore. Neni 18 paragrafi 2, parasheh nxjerrjen e aktit nënligjor për

trajtimin e rezidentëve që gjenden në institucionet e kujdesit social²²⁷. Gjithashtu, neni 34 i Ligjit për Shëndetin Mendor parasheh nxjerrjen e akteve nënligjore të cilat duhet të jenë në pajtim me këtë ligj²²⁸. Deri më tani nuk është nxjerr asnjë akt nënligjor.

Gjatë vizitës së MKPT, personeli i QIRSKP-së i ofroi bashkëpunim të plotë ekipit monitorues. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat dhe iu mundësuan bisedat me disa nga rezidentët të cilët ishin koshient dhe ishin në gjendje të komunikonin me ne, si dhe biseda u realizua pa prezencën e personelit të Qendrës.

Qendra ishte e ndarë në 4 reparte (A1-A4). Në katin e parë ishte reparti A1, ku në të kaluarën ishte si seksion i rehabilitimit, tani në këtë repart ishin vendosur rastet që kërkojnë vëmendje të shtuar pasi ishin identifikuar si raste me ide suicidale, ndërsa reparti A4 ishte vetëm për gjininë femërore ku edhe dushet dhe tualetet ishin të ndara sipas gjinisë dhe kjo ishte mundësi e lehtë edhe për stafin për ti mbajtur nën kontroll rezidentët.

Krijimi i një mjedisi terapeutik pozitiv përfshinë vënien në dispozicion të hapësirës jetike të mjaftueshme për pacientë si: ndriçim, ngrohje, ajrim të përshtatshëm si dhe pastërti në nivel të kënaqshëm. Gjatë vizitës së MKPT-së në dhomat ku akomodoheshin rezidentët, kryesisht ishin 2 deri 3 shtretër në një dhomë, kishte ndriçim natyral dhe kryesisht ishin të ngrohta dhe të pastra, dhe ishin në pajtim me nenin 6, paragrafi 1.10 të Ligjit Nr.05/L-025 Për Shëndetin Mendorë.²²⁹

Sipas standardeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, vëmendje duhet t'i kushtohet edhe dekorimit të dhomave të pacientëve dhe mjediseve të argëtimit, për tu dhënë pacientëve stimulim pamorë, gjithashtu vënia në dispozicion e komodinave pranë krevatit dhe gardërobave është shumë e dëshirueshme. Gjatë vizitës së MKPT-së, në dhomat e rezidentëve kishte komodina për vendosjen e rrobave dhe gjërave personale, mirëpo rezidentët nuk kishin veshmbathje personale, pas çdo pastrimi ato ndërrohen mes rezidentëve, gjithashtu nuk kishte as dekorime për stimulim pamorë.

Gjithashtu MKPT u njoftua që në këtë Qendër janë duke e rinovuar lavanterin, e cila ishte e pajisur me makina të mëdha për larjen, tharjen dhe hekurosjen e rrobave, e çarçafëve.

Gjatë vizitës në QIRSKP, ekipi i MKPT-së ka vizituar edhe kuzhinën ku përgatitet dhe servohet ushqimi. Kuzhina ishte në katin përdhese, nuk kishte ndriçim dhe ventilim të

²²⁷Neni 18, paragrafi 1 i Ligjit me Nr 05/L-025 Për Shëndetin Mendor, thekson: “Personave, që gjenden në institucionet rezidenciale të përkuajdesit social, u ofrohet këshillim, trajtim, rehabilitim dhe kujdes në shëndet mendor në mënyrë të barabartë dhe sipas standardeve shëndetësore, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë”. Paragrafi 2 i këtij neni thotë: Mënyra e organizimit dhe e dhënies së shërbimeve, të parashikuara në paragrafin 1, të këtij neni, përcaktohet me akt të veçantë nënligjor të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të miratuar nga Qeveria.

²²⁸Neni 34.1 i Ligjit për Shëndetin Mendor: “Për zbatimin e këtij ligji, në afat brenda një (1) viti, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Qeveria e Kosovës dhe ministrinë përkatëse nxjerrin aktet përkatëse nënligjore të cilat parashihen me këtë ligj”.

²²⁹Neni 6, paragrafi 1.10 i Ligjit Nr.05/L-025 Për Shëndetin Mendorë, përcakton “të drejtën për t’u siguruar kushtet e përshtatshme jetësore, higjienike, të ushqyerjes dhe sigurisë”

duhur, nyjat sanitare ishin shumë afër kuzhinës, ndërsa pastërtia ishte në nivel. Në vizitën e fundit MKPT vërejti se në sallën e ushqimit, ishin furnizuar me tavolina dhe karrige të reja.

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës rëndësi të veçantë i kushton edhe ushqimit të pacientëve, ushqimi jo vetëm që duhet të jetë i përshtatshëm nga pikëpamja e sasisë dhe cilësisë, por edhe të jepet në kushte të kënaqshme²³⁰. Gjatë vizitës, MKPT u njoftua që qendra është e furnizuar mirë dhe me rregull me ushqim, dhe se stafi i kuzhinës posedonin librezat sanitare. MKPT nuk ka hasur në ushqime me afate të skaduar. Në qendër ushqimi përgatitet sipas menysë dhe ju jepet në tri shujta. MKPT përhëndet angazhimin e stafit për kujdesin dhe pastërtinë në kuzhinë. MKPT u rekomandon autoriteteve relevante që të ndërmarrin masat e duhura për ndërtimin e një kuzhine të re.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16 paragrafi 4 i Ligjit 05/L019 për Avokatin e Popullit, i është rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë që të nxjerrë aktet nënligjore në pajtim me Ligjin për Shëndetin Mendor; të ndërmerr masa për ndërtimin e njësisë vokacionale në kuadër të QIRSKP-së; të ndërmerr hapa për ndërtimin e kuzhinës së re; të angazhohet në punë një psikolog klinik dhe një punëtorë social shtesë; të rritet numri i infermierëve në këtë Qendër. Komunës e Shtimes dhe QIRSKP që të merren masat për evitimin e problemit të prezencës së qenve endacak në oborrin e Institucionit. Qendrës për Integrim dhe Rehabilitim të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime që të ofrohen rezidentëve shërbime të rregullta gjinekologjike; të bëhen rezidentëve rregullisht analizat laboratorike.

11.8 Raport me rekomandime lidhur me vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm “MKPT”) i Avokatit të Popullit më 17, 21 dhe 31 mars 2017 ka vizituar Burgun e Sigurisë së Lartë (në tekstin e mëtejshëm “BSL”). Grupi monitorues përbëhet nga dy juristë, një mjek dhe një psikologe.

BSL gjendet në fshatin Gërdoc, Komuna e Podujevës, në magjistralen Prishtinë-Podujevë. BSL filloi punën në maj të vitit 2014 kur edhe filloi pranimi i të dënuarve me rrezikshmëri të lartë. Ky burg ofron tri regjime: regjimin themelor, standard dhe atë të avancuar. Kapaciteti i BSL-së është 390 persona. BSL përbëhet nga sektori i administratës, stacionari shëndetësor, pavijoni 1,2 dhe 3, si dhe objektet përcjellëse.

Në kohën kur MKPT e vizitoi BSL, aty ishin të vendosur 123 persona të dënuar (pavijoni 1 dhe 2), 23 të paraburgosur (të cilët mbahen në pavijonin 3) dhe 3 dëshmitarë të mbrojtur. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) e ka vizituar BSL gjatë

²³⁰ Normat e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga Raporti i 8-të i Përgjithshëm

vizitës *Ad Hoc* në Kosovë në vitin 2015.²³¹

Gjatë vizitës së MKPT në BSL, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat e burgut. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan bisedat me personat e dënuar dhe të paraburgosur pa prezencë të zyrtarëve korrektues ose personelit tjetër. Po ashtu, MKPT u lejua të përdor edhe pajisjet teknike për të kryer detyrën në pajtim me nenin 17 të Ligjit për Avokatin e Popullit.

MKPT gjatë vizitave në BSL ka intervistuar një numër të konsiderueshëm të të burgosurve dhe nuk ka pranuar ankesa për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues.

Kushtet materiale në BSL në përgjithësi janë të mira dhe ofrojnë komoditet për të burgosurit, të cilët janë të vendosur në qeli vetëm. Të gjitha qelitë ofrojnë dritë natyrale të mjaftueshme, hapësirë të mjaftueshme, TV, tualete të pastra dhe të burgosurit mund të bëjnë dushe sa herë që dëshirojnë. Qelitë janë të pajisura me krevat, çarçafë, tavolinë, karrige dhe sistem të thirrjes.

BSL u siguron të burgosurve pako higjienike mujore dhe pako për pastrim të krahut ku ata janë të vendosur. MKPT nuk ka pranuar ankesa sa i përket kushteve të akomodimit në BSL. Po ashtu, MKPT nuk ka pranuar ankesa sa i përket cilësisë së ushqimit i cili u ofrohet të dënuarve dhe të paraburgosurve në BSL.

Gjatë vizitës, MKPT ka vërejtur se dyshemetë në pavijonin 1, 2 dhe në stacionarin e BSL-së janë dëmtuar dukshëm, gjithashtu në pavijonin 1 banjat nuk kishin izolim të mirë, kishin filluar me pikë ujë, muret kishin lagështi. Sipas drejtorisë këto dëmtime janë pasojë e punimeve jo kualitative të kryera nga kompania e angazhuar.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës i është rekomanduar Shërbimit Korrektues të Kosovës që të ndërmerren hapat e duhur për të sanuar dëmtimin e dyshemeve në stacionarë dhe në pavijonet e BSL ku ato janë dëmtuar; të evitohet mangësia sa i përket ngjyrës së bardhë reflektuese e cila është pengesë për aktivitete jashtë qelive; të burgosurve t'u mundësohet qasja në shtypin ditor; të funksionalizohet punësoria për trajnime profesionale si dhe të shtohen aktivitetet për të paraburgosurit;

11.9 Raport i Mekanizmit Kombëtar Për Parandalimin e Torturës lidhur me Vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm “MKPT”) i Avokatit të Popullit më 31 tetor 2017 ka vizituar Qendrën e Paraburgimit në Prizren (në tekstin e

²³¹ Raporti i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për vizitën në Kosovë, nga 15 deri më 22 prill 2015, raporti u publiku në shtator të vitit 2016, shih në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806a1efc>

mëtejme “QPP”). Grupi monitorues përbëhej nga dy juristë, një mjekë dhe një psikologë. Ndërtesa e QPP është ndërtuar në vitin 1964, fillimisht ka funksionuar nën administrimin e UNMIK-ut, deri në shkurt të vitit 2005 ku kompetencat e plotë të menaxhimit i ka marrë stafi vendor. QPP është e dedikuar për të paraburgosurit e regjioneve të afërta me Prizrenin, si dhe pranon personat për vuajtje të dënimit të shqiptuar nga Gjykata Themelore deri në tre muaj. Ky Institucion ka kapacitetin prej 92 të burgosur, ka gjithsej katër krah, në tre krahë janë të vendosur të paraburgosurit dhe në një krah janë të vendosur të dënuarit me dënime të shkurtra.²³²

Të burgosurit janë të vendosur në krahët A, B, C, D. Kapaciteti i përgjithshëm është për 92 persona. Në kohën kur MKPT e vizitoi këtë qendër ishin të vendosur 100 të burgosur, prej tyre 22 të dënuar. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës e ka vizituar QPP në vitin në vitin 2010.²³³

Gjatë vizitës në QPP, ekipi monitorues u njoftua se planifikohet ndërtimi i një qendre të re të paraburgimit në Prizren, por procedurat kanë stagnuar dhe ende nuk është shënuar progres në këtë drejtim. Personeli i Shërbimit Korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat e QPP. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me personat e dënuar dhe të paraburgosur pa prezencë të zyrtarëve korrektues ose personelit tjetër.

MKPT gjatë vizitave në QPP ka intervistuar një numër të konsiderueshëm të të paraburgosurve dhe të dënuarve dhe nuk ka pranuar asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues.

Kapaciteti zyrtar i QPP-së është 92. Gjatë vizitës në qelitë e QPP-së, MKPT ka vërejtur se aktualisht numri i të burgosurve kishte arritur në 100 persona. MKPT ka vizituar një numër të qelive dhe ka verifikuar nëse hapësira e akomodimit nuk është në pajtim me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës.²³⁴ Bazuar në këtë standard hapësira për të paraburgosurit apo të dënuarit në qeli duhet të jetë së paku 4m² për person në një hapësirë ku akomodohen më shumë se një person, pa përfshirë aneksin e tualeteve.

Po ashtu, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale parasheh që secili i burgosur duhet të ketë 4m² hapësirë në qeli të përbashkët.²³⁵ Gjatë vizitës MKPT ka vërejtur se në disa qeli për shkak të mungesës së hapësirës, disa të paraburgosur dhe të dënuar flinin në dysheme në dyshek të vjetruar dhe pa mbulesa adekuate. Prandaj, MKPT konstaton se QPP përballet me mbipopullim e cila duhet të evitohet sa më shpjet që të jetë e mundur

²³² Të dhëna nga ueb faqja e Shërbimit Korrektues të Kosovës, në: <http://shkk.rks-gov.net> (31.10.2017)

²³³ Shih: <https://rm.coe.int/16806972c7> (14.11.2017)

²³⁴ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449> (14.11.2017)

²³⁵ Ligji nr. 05/L0-129, neni 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

dhe nuk mund të ofrojë hapësirë akomodimi në pajtim me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Gjatë vizitës në disa qeli, MKPT ka vërejtur se të paraburgosurve u mungon hapësira për vendosjen e gjësendeve të domosdoshme personale. Përveç kësaj, në dy qeli ku akomodoheshin të paraburgosurit, tualetet nuk ishin të pajisura me dyer dhe në këtë mënyrë të paraburgosurve nuk u respektohej privatësia.²³⁶ Rregulli 15 i Rregullave të Mandelës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 29 shtator 2015 përcakton se: *“Instalimet sanitare duhet të jenë adekuate dhe të mundësojë që secili i burgosur të përmbush nevojat fiziologjike në mënyrë dinjitoze dhe të pastër”*.

Gjatë vizitës, MKPT ka vërejtur se qelitë në përgjithësi ishin të ngrohta, kishin ndriçim të mjaftueshëm, në përgjithësi nuk kishte lagështi (me përjashtim të qelisë A3 ku vërehej pak lagështi), ndërsa dushet ishin në gjendje të mirë. Gjithashtu sallat ku ushqehen të burgosurit, ishin të pastra, kishte dritë natyrale dhe ventilim. MKPT ka konstatuar se qelitë në përgjithësi kanë nevojë të gëlqerosen (lyhen).

Sa i përket furnizimit, MKPT u njoftua se kishte mungesa të letrave higjienike, mungesa të çarçafëve, batanijeve ku sipas drejtorisë ka kohë të gjatë që nuk janë furnizuar. Zakonisht të burgosurve u lejohet që çarçafët t’i sjellin nga familjarët. Gjatë bisedës me të burgosurit, MKPT ka pranuar ankesa për mungesë të mjeteve higjienike, ndërsa sa i përket ujit, ky problem ishte evituar. Autoritetet duhet t’iu sigurojnë të paraburgosurve produkte higjienike që ju mundësojnë atyre pastrimin e qelive dhe të mbajnë higjienën në mënyrë adekuate.²³⁷

MKPT u njoftua se të paraburgosurit mund të bëjnë dushe 2 herë në javë gjë që është në pajtim me Rregullat Evropiane të Burgjeve.²³⁸ MKPT nuk ka pranuar ankesa nga të paraburgosurit dhe të dënuarit sa i përket kësaj të drejte.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës i është rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë që të njoftojë Avokatin e Popullit lidhur me planifikimet për ndërtimin e Qendrës së re të Paraburgimit në Prizren; Të krijohen kushte adekuate të punës për personelin mjekësor; Numri i të paraburgosurve të akomoduar të jetë në pajtim me kapacitetin zyrtar të QPP dhe të zgjidhet çështja e mbipopullimit sa më shpejtë që të jetë e mundur; Të ndërmerren masat e duhura në mënyrë që të paraburgosurve t’u respektohet privatësia (shih paragrafin 9 të këtij raporti; Të gëlqerosen qelitë sipas nevojës (shih paragrafin 10); Të përmirësohen kushtet e punës së zyrtarëve korrektues.

²³⁶ Rregullat Evropiane të Burgjeve, neni 18.1.

²³⁷ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, neni 38.2 përcakton: “Me qëllim të sigurimit të higjienës së personave të dënuar dhe higjienës së lokaleve, personave të dënuar iu sigurohet sasi e mjaftueshme e ujit të ftohtë dhe të nxehtë si dhe artikuj adekuat për pastrim dhe tualet. Pajisjet dhe mjetet për higjienë personale sigurojnë privatësinë e mjaftueshme dhe ata mirëmbahen dhe pastrohen me rregull”.

²³⁸ Rregullat Evropiane për Burgjet, paragrafi 19.4.

11.10 Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës lidhur me vizitën në Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa përkujdesje familjare

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm “MKPT”) i Avokatit të Popullit më 2 dhe 30 nëntor 2017 ka vizituar Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (në tekstin e mëtejshëm “SHPMPF”). Grupi monitorues përbëhej nga një juristë, një mjekë dhe një psikologë.

Gjatë vizitës së MKPT-së në SHPMPF, personeli i institucionit i ofroi ekipit monitorues bashkëpunim të plotë, qasje në dokumentacionin relevant, si dhe ia mundësoi bisedat me rezidentët pa prezencë të zyrtarëve të institucionit.

SHPMPF është institucion me karakter social dhe vepron në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (Në tekstin e mëtejshëm “MPMS”). Kapaciteti zyrtar i këtij institucioni është 110 persona. Numri i rezidentëve në momentin e vizitës ishte 63 rezidentë, prej tyre 27 meshkuj dhe 36 femra. Nga ky numër 3 persona janë nën moshën 65 vjet. Me Rregulloren nr. 09/2008 Mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (në tekstin e mëtejshëm “Rregullorja”) rregullohet çështja e kriterëve të pranimit të rezidentëve, organizimi i jetës dhe punës me rezidentët, rregullat shtëpiake dhe aktivitetet. Po ashtu, kriteret e vendosje në këtë institucion më hollësisht rregullohen me Udhëzimit Administrativ nr. 07/2011 për Punën dhe Kriteret e Vendosijes së Rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet.

Legjislacioni i Republikës së Kosovës nuk përcakton vendosje të pavullnetshme në institucionet e kujdesit social. Të gjithë rezidentët e vendosur në këtë institucion janë të vendosur bazuar në kontratën e nënshkruar me institucionin në fjalë. Prandaj, konsiderohet se të gjithë rezidentët janë vendosur këtu mbi bazën e vullnetit të tyre.

Në SHPMPF vendosen kategoritë e rezidentëve si në vijim: personat e varur të cilët nuk mund përmbushin nevojat e tyre ditore në mënyrë të pavarur, por duhet të asistohen gjithmonë nga të tjerët. Po ashtu, ata pranojnë kujdes të veçantë mjekësor. Kategoria e rezidentëve gjysmë të varur janë rezidentë gjendja shëndetësore e të cilëve ka shënuar rënie dhe pranojnë kujdes të veçantë. Kategoria tjetër janë rezidentët të cilët janë të pavarur dhe të cilët edhe pse janë të moshuar plotësojnë nevojat e tyre ditore pa ndihmën e të tjerëve.²³⁹ Gjatë vizitës MKPT u njoftua se 13 rezidentë janë të varur dhe 5 gjysmë të varur, ndërsa 4 rezidentë vuajnë nga demenca.

Neni 7 i Udhëzimit Administrativ 07/2011 përcakton kriteret themelore për vendosjen e rezidentit në SHPMPF. Sipas këtij neni duhet të plotësohen kriteret në vazhdim: personi të jetë banorë i përhershëm i Republikës së Kosovës, të jetë në moshën mbi 65 vjeç, të

²³⁹ Neni 10 i Rregullores nr. 09/2008 Mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.

mos ketë pasardhës-fëmijë biologjik apo të birësuar, të jetë në gjendje të mirë psikike dhe të mos ketë sëmundje infektive.

Megjithatë, gjatë vizitës dhe kontrollit të dokumenteve relevante MKPT ka vërejtur se në këtë institucion janë të akomoduar edhe persona me diagnoza të ndryshme psikiatrike, personat me aftësi të kufizuara mendore apo ngecje në zhvillim mendorë. Sipas njoftimit të punëtorit social, 7 rezidentëve u është marrë zotësia e veprimit dhe kujdestarët ligjorë nga Qendrat për Punë Sociale të Komunave nga kanë ardhur rezidentët nuk interesohen për rastet e tyre, me përjashtim të QPS Gjilan e cila përmes zyrtarit të caktuar si kujdestar ligjor u përgjigjet obligimeve ligjore.

MKPT ka vërejtur se në këtë institucion janë të akomoduar edhe 3 persona të cilët janë nën moshën 65 vjeçare. Akomodimi i tyre në këtë institucion është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 07/2011 dhe Rregulloren Mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.

Gjatë vizitës, MKPT ka intervistuar një numër të rezidentëve dhe nuk ka pranuar asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo abuzime verbale, si dhe sjellje të cilat do të shkëlqenin dinjitetin njerëzor të rezidentëve në SHMPMF. MKPT çmon lartë angazhimin e personelit në kujdesin ndaj të moshuarve, sidomos ndaj të moshuarve të palëvizshëm. MKPT fitoi përshtypjen se marrëdhëniet e personelit me rezidentët janë të mira dhe miqësore.

MKPT ka vërejtur se hapësirat e jashtme të institucionit janë të mbuluara me kamera të sigurisë të cilat mbulojnë hapësirat e jashtme të SHMPMF.

Ndërtesa e institucionit daton që nga vitet 1960-ta. MKPT gjatë vizitës ka vërejtur se oborri dhe trotualet e institucionit ishin rregulluar dhe qasja për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara ishte dukshëm më e lehtë. Po ashtu, ata kanë qasje ditore në kopshtin e institucionit i cili posedon gjelbërim të mjaftueshëm. Sipas drejtorisë, ashensori është funksional por është shumë i vjetër dhe shpesh pëson defekte. Nuk ka probleme me furnizime me ujë, edhe pse bojlerët janë të vjetër dhe të dëmtuar. Shqetësim kryesor për drejtorinë janë bojlerët e vjetruar dhe lavatriqet ekzistuese, të cilat janë të vogla dhe nuk mjaftojnë për të pastruar rrobat e rezidentëve, çarçafët dhe gjërat tjera, gjë që e vështirëson punën e ndihmësve mjekësorë. MKPT ka vërejtur se ndërtesa ka nevojë për investime serioze, sidomos në pjesën ku është i vendosur shërbimi mjekësor ku depërtimi i ujit shpesh shkakton dëmtime serioze të inventarit.

Gjatë vizitës, drejtorja i prezantoi MKPT kërkesat të cilat ia ka adresuar në MPMS lidhur me nevojat për investime për të cilat pretendon se nuk ka marrë përgjigje.

Dhoma ku vendosen rezidentët kanë ndriçim të mjaftueshëm, në përgjithësi nuk kanë lagështi, por inventari është tepër i vjetërsuar dhe dëmtuar. Rezidentët janë të vendosur në dhoma nga 3, 2 dhe 1 person. Sipas drejtorisë, ngrohja qendrore aktivizohet në periudha të caktuara dhe jo 24 orë në mungesë të karburantit për ngrohje. Disa rezidentë u ankuan se gjatë natës është ftohtë, disa e njoftuan ekipin monitorues se përdorin nxehtësi elektrike gjatë mungesës së ngrohjes qendrore.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës i është rekomanduar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që urgjentisht të bëhen investime sipas vlerësimit të nevojave, në ndërtesën e vjetër dhe hapësirat ku funksionon shërbimi mjekësor dhe shërbimi i stomatologjisë; Rezydentët të furnizohen me inventar adekuat në dhomat e tyre; Të furnizohet institucioni me një auto-ambulancë; Shërbimi mjekësor të aplikojë protokolle për vetëlëndime, lëndime trupore, grevë urie, abuzime seksuale, vetëvrasje, si dhe vdekjeve në institucion; Të organizohen trajnime specifike për personelin në pajtim me nevojat për trajtim të rezidentëve; Të rritet numri i personelit sipas vlerësimit të nevojave nga shërbimi shëndetësor.

11.11 Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës për Vizitat në Stacionet Policore

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejme MKPT) i Avokatit të Popullit ka vizituar stacionet policore si në vijim: Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë, stacioni “Qendër”, 30 tetor 2017; Stacionin Policor në Lipjan, 9 tetor 2017; Stacionin Policor në Podujevë, 18 tetor 2017; Stacionin Policor në Mitrovicë, 19 tetor 2017; Stacionin Policor në Vushtrri, 19 tetor 2017; Stacionin Policor në Prizren, 27 tetor 2017; Stacionin Policor në Suharekë, 27 tetor 2017; Stacionin Policor në Dragash, 27 tetor 2017. Grupi monitorues përbëhej nga një juristë, një psikologe dhe një mjeke.

Gjatë vizitës në stacionet e lartpërmendura, Policia e Kosovës i ofroi MKPT bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat. Ekipit i u siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe qasja në të gjitha dokumentet e kërkuara, si dhe iu mundësua intervistimi i personave të arrestuar pa prezencë të zyrtarëve policor.

Sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës, personat e dyshuar për kryerje të veprës penale mund të mbahen nga policia deri në 48 orë para se të dërgohen para gjyqtarit të procedurës paraprake. Policia mund të mbaj dhe të mbledhë informata nga personat të cilët gjenden në vendin ku është kryer vepra penale të cilët mund të sigurojnë informata relevante (periudha maksimale kohore: gjashtë orë)²⁴⁰.

Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejme “KPT”), në raportin e 2-të të përgjithshëm të publikuar në vitin 1992 ka theksuar rëndësinë e tri të drejtave themelore të personave të arrestuar nga policia për të njoftuar personin e tretë sipas përzgjedhjes së tij/saj për arrestimin e tij (anëtarin e familjes, mikun, konsullatën), e drejta për të pasur një avokat, e drejta për t’u ekzaminuar nga mjeku sipas dëshirës së tij (përveç ekzaminimit mjekësor nga një mjek i thirrur nga autoritetet policore).²⁴¹

²⁴⁰ Nenet 162, 163, 164 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

²⁴¹ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f> (15.11.2017).

Këto të drejta duhet të zbatohen jo vetëm në rastin e personave të ndaluar por edhe në rastet tjera kur qytetarët detyrohen të qëndrojnë në polici apo me policinë edhe për arsye tjera (për shembull, për qëllime identifikimi). Sipas KPT, këto të drejta janë garanci themelore kundër keqtrajtimit fizik dhe duhet të zbatohen që nga momenti i parë i privimit nga liria, pa marrë parasysh se si përshkruhet në kuadër të sistemi ligjor. Po ashtu, këto të drejta themelore parashihen edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Policinë.²⁴²

Neni 13 i Kodit të Procedurës Penale përcakton çdo person i privuar nga liria duhet të njoftohet menjëherë në gjuhën të cilin ai/ajo e kupton për të drejtën për ndihmë juridike sipas dëshirës së tij, për të drejtën për të njoftuar anëtarët e familjes apo ndonjë person tjetër për faktin se është arrestuar dhe se këto të drejta aplikohen gjatë gjithë kohës së privimit nga liria.²⁴³

Sa i përket njoftimit për arrestin, neni 168 i Kodit të Procedurës Penale më tej përcakton se personi i arrestuar ka të drejtë të njoftojë anëtarin e familjes apo personin tjetër sipas përzgjedhjes së tij për arrestin dhe vendin e ndalimit menjëherë pas arrestimit; njoftimi i familjarit apo personit tjetër lidhur me arrestimin mund të vonohet më së shumti deri në 24 orë kur prokurori i shtetit çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetim të rastit. Kjo vonesë nuk aplikohet në rastin e personave të mitur.

Sipas Ligjit për Policinë²⁴⁴ e drejta për të njoftuar familjen apo personin tjetër për arrestimin gjithashtu vlen edhe për personat të cilët janë në “ndalim të përkohshëm” me qëllim të identifikimit ose për shkak të mbrojtjes së tyre dhe mbrojtjes së të tjerëve.

Gjatë vizitave, MKPT është njoftuar nga zyrtarët policor se gjatë intervistimit të personave të arrestuar nuk praktikohet audio-video incizimi i intervistave. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT) konsideron se:

“Regjistrimi elektronik (audio dhe/ose video) i intervistave policore përbën një garanci të rëndësishëm shtesë kundër keqtrajtimit të të arrestuarve. KPT ka kënaqësinë të vërejë se vënia në përdorim e sistemeve të tilla po shqyrtohet nga një numër i vendeve. Një sistem i tillë mund të sigurojë një proces të intervistimit të kompletuar dhe autentik dhe në këtë mënyrë lehtëson shumë hetimin e çdo pohimi për keqtrajtim. Kjo është në interes të dy palëve, respektivisht të personave të cilët janë keqtrajtuar nga policia dhe në interes të zyrtarëve policor të cilët përballën me pohime të pabazuara se janë përfshirë në keqtrajtim fizik dhe presion psikologjik. Po ashtu, regjistrimi elektronik e zvogëlon mundësinë e të pandehurve që më vonë rrejshëm të mohojnë se ata kanë bërë pohime të caktuara”.²⁴⁵

²⁴² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 29 dhe 30. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 13. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës,

²⁴³ Shih po ashtu nenet 29 dhe 30 të Kushtetutës.

²⁴⁴ Ligji për Policinë, neni 20.

²⁴⁵ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, ekstrakt nga raporti i 12 i përgjithshëm, paragrafi 36. Për më shumë shih: <https://rm.coe.int/16806cd1ed> (24.11.2017).

Në raportin për vizitën e Irlandë në vitin 2006, KPT thekson:

“Të gjeturat gjatë vizitës në vitin 2006, sugjerojnë se audio-video incizimet në dhomat e intervistimit në stacionet e Garda, mund të kenë qenë faktor domethënës që ka kontribuar në zvogëlimin e pohimeve për keqtrajtim fizik të personave të arrestuar”.

MKPT e Avokatit të Popullit inkurajon Policinë e Kosovës që të shqyrtojë mundësinë e zbatimit të një sistemi të tillë të audio dhe video incizimeve në pajtim me konstatimet e KPT-së dhe për këtë të njoftojë Avokatin e Popullit.

MKPT ka vërejtur se në stacionet policore të vizituara, kamerat e sigurisë janë operacionale në hapësirat e stacioneve dhe në qelitë ku mbahen të arrestuarit, përveç në stacionin policor në Lipjan.

MKPT nuk ka pranuar ankesa nga personat e arrestuar të cilët gjendeshin në Qendrën Rajonale të Mbjajtjes në Prishtinë lidhur me këto të drejta. Po ashtu, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar vërehet se Policia e Kosovës në të gjitha stacionet e vizituara ka respektuar këto të drejta. Gjatë vizitave, MKPT ka vërejtur se në secilën qeli ndodheshin informata të shkruara lidhur me të drejtat e personave të arrestuar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Gjatë vizitave, MKPT nuk ka hasur në të mitur të arrestuar.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës u është rekomanduar stacioneve policore që të ndërmerren hapat e nevojshëm për të siguruar më shumë dritë natyrale në Qendrën Rajonale të Mbjajtjes në Prishtinë; Të krijohen kushte më të mira për punë për zyrtarët policorë në Qendrën Rajonale të Mbjajtjes në Prishtinë; Të bëhen rinovime dhe furnizime në Qendrën e Mbjajtjes në Prizren siç është specifikuar në paragrafin 20 të këtij raporti; Në të gjitha qelitë e stacioneve policore ku ka dhoma të mbajtjes të instalohen sistemet e thirrjeve; Të funksionalizohen kamerat e sigurisë në Stacionin Policor në Lipjan.

12.Letër Rekomandimet

12.1 Letër rekomandim - Ankesa nr. 318/2016

Në këtë rast ankuesi i ishte drejtuar Avokatit të Popullit me ankesë në lidhje me kufizimin e qasjes në dokumente publike nga Banka Qendrore e Kosovës, dhe atë në kufizimin e qasjes në “...në të dhënat e punësimit nga janari i vitit 2013 deri me 05.04.2016. Këto të dhëna duhet të përfshijnë listën me emrat e të punësuarve gjatë kësaj periudhe dhe pozitat në të cilat janë punësuar”.

Sipas komunikimeve që Avokati i Popullit kishte me Bankën Qendrore u kuptua se arsyeja e mospërgjigjes në kërkesën për qasje në dokumente publike, ishte mos parashtrimi i kërkesës sipas formularit të paraparë në Politikën për Qasje në Dokumente Publike në BQK, duke e konsideruar kështu si heqje dorë nga kërkesa, mos parashtrimin sipas mënyrës së kërkuar nga BQK.

Avokati i Popullit konsideroi se neni 4, par. 2 i Ligji Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), është dispozitë e cila qartazi specifikon mënyrën e parashtrimit të kërkesës “*Dokumentet janë të hapura për publikun në bazë të kërkesës së drejtpërdrejt, në bazë të kërkesës së bërë me shkrim ose në formë elektronike, me përjashtim të informacioneve të kufizuara me ligj*”. Duke u bazuar në këtë e vlerësojmë se formulari i paraparë në nenin 6, si pjesë përbërëse e Politikës për Qasje në Dokumente Publike në BQK, nuk është në përputhje të plotë me nenin 4, par. 2, të LQDP.

Me qëllim të respektimit të nenit 41, par. 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], sipas së cilit “*Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike*”; dhe realizimi i së drejtës për Qasje në Dokumente Publike në harmoni me Ligjin në fjalë, i cili “*garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike*”; Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenin 27, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit i rekomandoi BQK-së që kërkesat për qasje në dokumente publike t’i trajtoi në përputhje me nenin 4, par. 2, të LQDP, pavarësisht asaj nëse ato janë parashtruar sipas formularit të paraparë në nenin 6, të Politikës për Qasje në Dokumente Publike në BQK.

12.2 Letër rekomandim - Ex officio nr. 700/2016

Institucioni i Avokatit të Popullit në kuadër të aktiviteteve promovuese gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2016, ka zhvilluar fushatën informuese “Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit” për nxënës të shkollave fillore të mesme të ulëta dhe të larta, lidhur me rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Ky aktivitet është organizuar në pajtim me nenin 18 paragrafi 1.3 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019. Qëllimi kryesor i organizimit të fushatës ishte informimi i nxënësve për rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe për mundësitë që për shkeljet e të drejtave të njeriut, t’i drejtohen IAP-së,

po ashtu edhe ofrimi i mundësive fëmijëve që të dëgjohen nga përfaqësuesit e IAP-së, përkatësisht të shprehin mendimet, qëndrimet apo shqetësimet e tyre për probleme të ndryshme me të cilat ata ballafaqohen çdo ditë, jo vetëm në shkollë, por edhe në rrugë e gjetiu.

Gjatë kësaj fushate, ndër të tjera janë vizituar edhe SHFMU “Ganimete Tërbeshi” në fshatin Llukar dhe paralelja e saj e ndarë fizike në fshatin Siqevë. Është vërejtë se shkolla në Siqevë po përballlet me shumë mungesa dhe vështirësi në realizimin e procesit mësimor, e të cilat i kanë theksuar edhe nxënësit e kësaj shkolle, gjatë bisedës me përfaqësuesen e IAP-së. Në këtë objekt shkollor në Siqevë është i theksuar problemi me kanalizim, rrjedhja e ujit në tualete dhe lavamanë, problemet me nxehje me stufa të cilat e kthejnë tymin, si dhe mungesa e dritave. Ndërsa, në shkollën në Llukar është vërejtur se mungojnë shenjat e sinjalizimit në afërsi të shkollës dhe se ka rrjedhje të ujit në sallën e edukatës fizike. Zyrtarët e Avokatit të Popullit nga menaxhmenti u njoftuan se disa herë i janë drejtuar Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) në Prishtinë, për ndërmarrjen e masave konkrete për përmirësimin e kushteve mësimore në shkollën në Siqevë si dhe në Llukar, por deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Për këtë Avokati i Popullit rekomandoi Komunës së Prishtinës që për paralelen e ndarë të SHFMU “Ganimete Tërbeshi” në Siqevë të ndërmerrni masa për përmirësimin e kushteve për vijimin e procesit mësimor, si në vijim: Mënjanimin e problemeve me kanalizim; Pajisjen e shkollës me drita; Gëlqerosjen e klasave; Pajisjen e shkollës me stufa të përshtatshme për ngrohjen e klasave. Ndërsa për SHFMU “Ganimete Tërbeshi” (shkolla amë) në Llukar të ndërmerrni masa për përmirësimin e kushteve për vijimin e procesit mësimor, si në vijim: Vendosijen e shenjave të sinjalizimit në afërsi të shkollës; Pastrimin e urës pranë shkollës për t’i shërbyer nxënësve si nënkalin; Mënjanimin e rrjedhjes së ujit në sallën e edukatës fizike.

12.3 Letër rekomandim - Ex officio nr. 43/2017

Në Ferizaj, Gjilan, Pejë dhe Prizren funksionojnë qendra të kujdesit ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara. Aktivitetet e këtyre qendrave në dhënien e shërbimeve sociale dhe familjare për fëmijët me aftësi të kufizuara menaxhohen nga OJQ “PEMA”, organizatë e cila është e licencuar nga organet shtetërore. Në fund të vitit 2016, përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, kanë vizituar këto qendra. Gjatë takimeve ata janë informuar se për shkak të vështirësive financiare qendrat e kujdesit ditor në fjalë rrezikohen të mbyllen dhe fëmijët me aftësi të kufizuara nuk do të mund të vazhdojnë të gëzojnë të drejtën për shërbime sociale dhe familjare në disa nga qendrat e kujdesit ditor, për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Pamundësia e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, fëmijëve me aftësi të kufizuara përbën shqetësim për Avokatin e Popullit. Mbyllja e qendrave të kujdesit ditor, ekzistimi i të cilave edhe ashtu nuk ka qenë i mjaftueshëm për të plotësuar nevojat dhe të drejtat e kësaj pjese të popullsisë, kërkon vëmendjen dhe ndërmarrjen e veprimeve përkatëse. Me situatën e krijuar në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, gjendja e shumë fëmijëve

me aftësi të kufizuara që kanë ndjekur këto qendra mund të rëndohet dhe përkeqësohet, me vet faktin që tanimë ata nuk do të marrin mbështetjen e nevojshme dhe kujdesin e specializuar.

Fusha e shërbimeve sociale nuk është e vetmja fushë në të cilën fëmijët me aftësi të kufizuara hasin në vështirësi. Në realitet, fëmijët me aftësi të kufizuara përballen me vështirësi dhe barriera të shumta në të gjitha fushat e jetës, prandaj mbetet shumë për të bërë në këtë drejtim nga institucionet shtetërore në rend të parë. Është më se e nevojshme që të bëhet më shumë edhe sa i përket shërbimeve sociale me bazë në komunitet, prandaj Avokati i Popullit rithekson se mbështetja e qendrave të kujdesit ditor, për të vazhduar punën në dhënien e shërbimeve sociale, do të duhej të bëhej nga institucionet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara të gëzojnë të drejtën për shërbime cilësore sociale, gjithëherë duke pasur parasysh nevojat e tyre.

Avokati i Popullit në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 18 paragrafi 3 Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, i rekomandoi ministrit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që të ndërmerr masat e nevojshme që Qendrave të Kujdesit Ditor t'u ofrohet mbështetja e nevojshme, përfshirë këtu edhe atë financiare që të vazhdojnë punën dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara t'u ofrohet ndihma dhe shërbimet përkatëse sociale, në mënyrë që t'u sigurohet integrimi shoqëror dhe realizimi i të drejtave në pajtim me standardet ligjore vendore e ndërkombëtare.

12.4 Letër rekomandim - Ankesa nr. 549/2015

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, ka pranuar ankesën e ankuesit kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë për shkak të zvarritjes së procedurës lidhur me lëndën C.41/2014 që ka të bëjë me një kontest nga marrëdhënia e punës.

Ankuesi pohon se deri në pensionimin e tij ishte punonjës në Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës (KEK). Ankuesi më tutje pohon se KEK-u me anë të një vendimi, në vitin 2005, e kishte sistemuar atë në vendin e punës si punëtor fizik. Sipas ankuesit, ai deri në pensionimin e tij nuk ishte kthyer në vendin e tij të punës si metal-gdhendës dhe se me këtë ai është dëmtuar si në aspektin profesional ashtu dhe në të ardhura personale. Më 15 shkurt 2005, ankuesi kishte parashtruar padi kundër KEK-ut, në atëherë Gjykatën Komunale të Prishtinës. Në bazë të dokumenteve që ankuesi i ka paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit, shihet se çështja ka kaluar nëpër të gjitha instancat, për t'u kthyer në rigjykim në GJTHP me anë të Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev.nr.213/2013, të datës 4 dhjetor 2013. Ankuesi pohon se rigjykimi i rastit ka filluar, por se procedimi nga ana e gjykatës është i ngadalshëm.

Avokati i Popullit kishte kontaktuar ankuesin i cili nuk ishte në gjendje që të jepte informata lidhur me zhvillimet në GJTHP sepse në atë kohë gjendej në spital dhe ankohej për gjendje të rënduar shëndetësore. Avokati i Popullit vëren se rasti i ankuesit ka filluar

më parashtrimin e padisë më 15 shkurt 2005, dhe se çështja ka të bëjë me një kontest nga marrëdhënia e punës dhe që nga data 24 qershor 2015 nuk është ndërmarrë asnjë veprim lidhur me vendosjen e lëndës që përbënte zvarritje të jashtëzakonshme në procedimin e këtij rasti gjyqësor. Andaj Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës Themelore e Prishtinës të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme, në pajtim me Ligjin për Procedurën Kontestimore si dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që ky rast të procedohet me urgjencë.

12.5 Letër rekomandim - Ankesa nr. 914/2016

Avokati i Popullit në bazë të nenit 16.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 95/L-019, ka pranuar ankesë kundër Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) në Ferizaj, për shkak të diskriminimit dhe të drejtave nga marrëdhënia e punës.

Në bazë të deklaramentit të ankuesit dhe të provave që ka në dispozicion Avokati i Popullit, ankuesi, arsimtar i gjuhës shqipe ka përvojë pune 33 vite në punë dhe detyra të punës së mësimdhënësit, ndërsa në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (SHFMU) “Ahmet Hoxha” në Ferizaj, mësimdhënës i lëndës për gjuhë shqipe është punësuar më 1 shtator 2005, për kohë të pacaktuar. Për shkak të shkuarjes në detyrë të re të mësimdhënëses së gjuhës shqipe në muajin nëntor 2016, në këtë shkollë janë liruar 10 orë të gjuhës shqipe (mësim zgjedhor), por edhe pse ankuesi punëtor me kohë të pacaktuar, ka normën mësimore prej 15 orëve në javë (75% të vëllimit të punës), atij nuk i është bërë plotësimi i normës, por për këto orë mësimore DKA ka punësuar një mësimdhënës tjetër pa konkurs, pa kualifikim adekuat si dhe me mungesë edhe të kushteve tjera të cilat shprehimisht parashihen sipas dispozitave ligjore për themelimin e marrëdhënies së punës.

I pakënaqur me trajtimin lidhur me normën e tij të punës, ankuesi i është drejtuar DKA me kërkesë për plotësimin e normës më datën 30 nëntor 2016, por edhe pse deri më tani kanë kaluar mbi 3 muaj, lidhur me kërkesën e tij, ai nuk ka pranuar asnjë përgjigje.

Në këtë rast Avokati i Popullit vëren se, autoritetet komunale nuk e kanë trajtuar kërkesën në afatin ligjor ashtu siç e parasheh LPA, se organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizikë dhe juridikë duke precizuar saktësisht situatat dhe afatet për përgjigje. Kjo situatë e mos trajtimit të parashtrës së ankuesit është dështim i organeve komunale, dhe në këtë rast kemi situatën që mjeti juridik i përdorur nga ankuesi nuk ka prodhuar efektin juridik në realizimin e të drejtës së tij.

Avokati i Popullit, vëren se mos shqyrtimi i kërkesës, të parashtruar më 30 nëntor 2016, përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafin 1 të nenit 6, lidhur me nenin 13 të Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), si dhe nenet 11, 38.4 dhe 131.1 të Ligjit për Procedurën Administrative. Avokati i Popullit konsideron se procedura e shqyrtimit të kërkesës duhet të zhvillohet pa zvarritje të mëtejme dhe çështja e ngritur duhet të vendoset në mënyrë meritore nga autoritetet publike.

Zvarritja dhe jo-efikasiteti i procedurave sjellin në situata që janë në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit, parim ky i sanksionuar me aktet më të larta ligjore si dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare, që autoritetet e Kosovës kanë për obligim t'i respektojnë pa përjashtim. Prandaj Avokati i Popullit i rekomandon komunës së Ferizajt rrespektivisht Drejtorisë Komunale të Arsimit që të anulohet në tërësi rekomandimin e saj të datës 25.11.2016, për sistemimin e punëtores në vendin e punës arsimtare e gjuhës shqipe në SHFMU "Ahmet Hoxha", për shkak të mungesës së bazës juridike; të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që kërkesa e ankuesit të shqyrtohet në pajtueshmëri me Ligjin për Procedurën Administrative; lidhur me tepricat teknologjike, përkatësisht për rastet e punëtorëve që kanë mungesë të orëve mësimore, të ndërmarrë masa për sistemimin e tyre, përkatësisht për plotësimin e normave të tyre të punës, ndërsa konkurse për vende të lira të punës të shpallen vetëm pasi të plotësohen kushtet ligjore.

12.6 Letër rekomandim - Ankesa nr.792/2016

Avokati i Popullit në bazë të nenit 16.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 95/L-019 ka pranuar ankesë kundër Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) në Ferizaj, për shkak të mos sigurimit të transportit për bartjen e fëmijëve të tij, në relacionin shtëpi-shkollë dhe anasjelltas, në një largësi prej 8 kilometra në dy drejtime.

Në bazë të deklaramentit të ankuesit dhe të provave që ka në dispozicion Avokati i Popullit, ai ka parashtruar kërkesë me shkrim në DKA më 23.9.2016, për transportimin e nxënësve (2 fëmijëve të tij), mirëpo edhe pse deri më tani kanë kaluar 5 muaj, ai nuk ka pranuar asnjë përgjigje lidhur me të.

Shkolla Filllore e Mesme e Ulët (SHFMU) "Skënderbeu" në fshatin Jezerc, gjendet në terren malor dhe shumica e nxënësve transportohen me kombibus në relacionin shtëpi-shkollë dhe anasjelltas. Meqenëse është zonë malore shtohet prezenca e kafshëve të egra sidomos gjatë dimrit si ujçer, arinj, derra të egër etj. e që paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë për jetën e njeriut. Fëmijët e ankuesit, nuk janë përfshirë në transportin me kombibus me arsyetim se këto janë vetëm dy nxënës që banojnë në fshatin Verrishtë (lagje e Jezercit), e cila lagje nuk graviton me lagje tjera, ku qarkullon kombibusi për transportimin e nxënësve të kësaj shkolle. Si pasojë e kësaj situatë këto nxënës nuk mund të vijojnë mësimin rregullisht, prandaj edhe kanë numër të madh të mungesave.

Avokati i Popullit konstaton se zvarritja e përgjigjes në kërkesën e ankuesit e cila përpos problemit të transportit për nxënës, ngërthen në vete, në radhë të parë të drejtën për arsim i cili është njëherit i obligueshëm sipas ligjit, andaj DKA duhet trajtuar kërkesat brenda afatit ligjor, për shkak të peshës dhe rëndësisë të veçantë. Në këtë rast Avokati i Popullit rekomandoi që DKA të vendosë urgjent lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 23 shtator 2016 për transportin publik (të fëmijëve të tij) shtëpi-shkollë dhe anasjelltas, duke e trajtuar atë konform dispozitave ligjore që trajtojnë këtë problematikë.

12.7 Letër rekomandim - Ex officio nr. 87/2017

Më 26 janar 2017, përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) në kuadër të vizitave në komunat e Kosovës, vizituan fshatrat Gurrakoc dhe Srbobran të Komunës së Istogut, me ç'rast u njoftuan me gjendjen e disa familjeve të komunitetit shqiptar dhe egjiptian. Fillimisht, janë vizituar familjet e vendosura në një objekt që nga paslufta, ku shumica e tyre janë të përkatësisë etnike egjiptiane kurse familjet e tjera janë shqiptare.

Janë gjithsej 32 banorë dhe pjesa më e madhe e tyre janë fëmijë, persona të moshuar, të pa punë dhe disa vuajnë nga sëmundje të ndryshme. Objekti i banimit nuk i plotëson as kushtet më elementare për jetesë pasi që hyrja dhe pjesët e tjera të këtij objekti rrezikohen nga shembja, kurse në korridore gjithandej kundërmon si pasojë e mungesës së infrastrukturës së duhur dhe mungesës së ujit të pijshëm. Në oborrin e kësaj ndërtese ka rrjedhje të madhe të ujërave të zeza duke shfaqur rrezikun e shpërthimit të ndonjë sëmundje epidemike. Sipas pohimeve të disa prej banorëve të këtij objekti, ky objekt kohë më parë ka shërbyer si burg.

Duke marrë parasysh gjendjen e mjerueshme të banorëve që jetojnë në këtë objekt në fshatin Gurrakoc Avokati i Popullit konsideron se qëndrimi i mëtejshëm në këtë hapësirë rrezikon jetën e banorëve nga mundësia e shembjes së vet ndërtesës dhe mungesa e kushteve të përshtatshme për jetesë, në veçanti ato higjienike-sanitare gjë që përbën rrezik për paraqitjen e ndonjë sëmundje epidemike e cila mund të rrezikojë jetën dhe shëndetin e banorëve, sidomos të fëmijëve dhe të moshuarve.

E drejta në banim është njëra nga çështjet mjaft të rëndësishme për stabilitetin social, shëndetin dhe zhvillimin kualitativ të mirëqenies njerëzore. Në shumicën e vendeve të zhvilluara, banimi është e drejtë sociale e qytetarëve. E drejta e banimit, ka efekte të gjera, si sociale, kulturore, financiare, etj. Andaj, projektet e banimit social janë mjaft të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve të pastrehë. Kjo e në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut është duke u vlerësuar si pjesë integrale e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, në nivel të njëjtë me të drejtat civile dhe politike.

Në këtë kuptim, Avokati i Popullit konstaton se sigurimi i banimit është përgjegjësi e vet komunave duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit të Republikës së Kosovës, neni 25 [Përgjegjësitë e komunave], par.1, në *“Identifikimin e nevojave për banim, sipas programeve të hartuara për popullsinë nën juridiksionin territorial të tyre në bazë të këtij ligji”*, par. 2, *“hartimin e programeve dhe projekteve tre (3) vjeçare për banim, bazuar në burimet financiare”* dhe par. 3, *“sigurimin e zonave për ndërtim dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë, në zbatimin e programeve të banimit”*.

Në këto rrethana Avokati i Popullit i rekomandon komunës së Istogut dhe Klinës të ndër marrin veprime të menjëhershme për zhvendosjen e familjeve që janë qytetar të komunës së Istogut dhe komunës së Klinës, nga objekti i ish-burgut në Fshatin Gurrakoc

dhe vendosjen e tyre në ndonjë hapësirë të përshtatshme për banim në pajtim me Ligjin Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit të Republikës së Kosovës apo përmes formave të tjera të përcaktuara sipas ligjeve në fuqi dhe ndërmarrjen e veprimeve nga Komuna e Istogut në rregullimin e kanalizimit në lagjen e banuar nga komuniteti egjiptian në Fshatin Srbobran.

12.8 Letër rekomandim - Ankesa nr. 497/2016

Avokati i Popullit, në bazë të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, pranuar ankesë kundër Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), lidhur me mos përgjigje në ankesë. Sipas pohimeve të ankuesit ai ka qenë profesor në Universitetin e Prizrenit (UPZ) “Ukshin Hoti”, të cilit me vendim të Këshillit Drejtues të UPZ (nr. 231/2016, nr. i protokollit 01-95, datë 7 mars 2017), i është ndërprerë marrëdhënia e punës, me arsyetimin se i ka skaduar kontrata. Ankuesi i pakënaqur me këtë vendim, ka ushtruar ankesë në MASHT, më 11 mars 2016, por e cila ende nuk është shqyrtuar nga autoritet përkatëse të MASHT-it. Meqë ankuesi nuk pranoi përgjigje, ai më 10 qershor 2016, i është drejtuar edhe me një kërkesë MASHT-it, por as në këtë kërkesë nuk pranoi përgjigje.

Ligji për Procedurën Administrative nr. 02/L-28 (në tekstin e mëtejshëm Ligji i Procedurës Administrative), neni 11, shprehimisht e përcakton obligimin për vendimmarrje, *“Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizikë dhe juridikë.”* Po ashtu, neni 38, i këtij ligji, në mënyrë të qartë parasheh obligimin e organit administrativ për veprim pas pranimit të kërkesave të palëve dhe për njoftimin e tyre me shkrim, lidhur me vendimin e organit. Në rastin konkret, organi nuk ka vepruar në përputhje me neni 38, të Ligjit të Procedurës Administrative, pala nuk ka pranuar përgjigje me shkrim. Ndërsa, neni 90 në paragrafin 1, të po këtij ligji, rregullon shprehimisht mënyrën e shpalljes së akteve administrative, *“Aktet administrative individuale dhe kolektive iu dërgohen palëve të interesuara në afat prej 30 ditësh.”* Në rastin e ankuesit, vërejmë se, edhe pse kanë kaluar disa muaj, ai nuk ka pranuar asnjë përgjigje lidhur me kërkesën e tij.

Institucionit të Avokatit të Popullit bazuar në provat dhe shkresat e ofruara nga ankuesi, konstaton se MASHT ka dështuar në zbatimin e ligjit, pasi që ankuesi në dy parashtrësat e tij më 13 shtator 2016 dhe 11 nëntor 2016, nuk ka pranuar përgjigje nga MASHT përkundër detyrimit ligjor për të shqyrtuar parashtrësën e ankuesit sipas ligjit në fuqi.

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Populli i rekomandoi MASHT që të vendosë urgjentisht lidhur me parashtrësën e ankuesit të datës 13 shtator 2016 dhe 11 nëntor 2016, duke e trajtuar atë konform dispozitave ligjore

12.9 Letër rekomandim - Ankesa nr. 24/2016

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019 ka pranuar ankesë kundër Komunës së Prishtinës për shkak të mosndërmarrjes së veprimeve

për mbrojtën e të drejtës së privatësisë dhe mjedisit. Në bazë të deklaramit të ankueses dhe të provave tjera që ka në dispozicion Avokati i Popullit, banorët e lagjes “Rexhep Luci” ndërtesa nr. 9 dhe 7, parashtruan ankesë në Drejtorinë për Financa dhe Pronë (DFP), për shkak të problemeve që u sillte auto parkingu i ngritur si rezultat i uzurpimit të pronës shoqërore. DFP e Komunë së Prishtinës me procesverbalin 10.Nr. 466-93524 ka konstatuar se pala i ka tejkualuar kufijtë e ngastrës së tij dhe ka vendosur rrethojën në dëm të ngastrës së pasurisë shoqërore dhe e ka obliguar atë që në afat prej 2 ditësh të largojë rrethojën nga ngastra shoqërore. Ndërsa, më 30 korrik 2013, DFP - Sektori i Pronës i Komunës së Prishtinës nxori vendim me të cilin *“Urdhërohet A. Latifi, me vendbanim në rr. “Rexhep Luci” pn. Prishtinë, të lirojë sipërfaqen e uzurpuar në mënyrë arbitrare në të cilën ka ndërtuar rrethojë me material jo të fortë në sipërfaqe prej 85 m², parcela nr.6220-0 Zona Kadastrale Prishtinë, pasuri shoqërore Prishtinë.”*

Meqë ankuesja nuk kishte pranuar përgjigje lidhur me kërkesën e parashtruar dhe gjendja lidhur me uzurpimin e pronës kishte mbetur e njëjtë, Avokati i Popullit, nëpërmjet shkresës drejtuar Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës, kërkoi të informohet për atë se në cilën fazë ndodhej procedura në çështjen e ankueses dhe cilat veprime ishin ndërmarrë nga kjo drejtori, që rasti të procedohej brenda afatit të arsyeshëm kohor, në pajtim me ligjin. Avokati i Popullit pranoi përgjigje në shkresën e lartpërmendur me këtë përmbajtje: *“[...] Gjatë ekzekutimit të rastit, zyrtarët e Drejtorisë së Inspeksionit kanë hasur në pengesa dhe sulme fizike, rast i cili është proceduar edhe në polici [...]”*.

Avokati i Popullit konstaton se Komuna e Prishtinës, përkatësisht DPF dhe DI ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të saja pozitive, në kuptim të vendosjes së çështjes së palës lidhur me heqjen e auto parkingut të ngritur në pronën shoqërore me sipërfaqe prej 85m². Parcelë kjo cila tani me vite të tëra është duke u mbajtur në posedim dhe shfrytëzim faktik nga uzurpuesi, ndaj të cilit siç shihet nga kronologjia e veprimeve, komuna nuk është duke ndërmarrë asnjë veprim, përkatësisht mjete juridik për rikthimin në posedim të asaj prone edhe pse pengim posedimi, prishja e qetësisë, cenimi i privatësisë; (sirenat e veturave, zhurma, tymi i karburanteve të automjeteve të parkuara) ka përfshirë një numër të konsideruar qytetaresh, të moshave të ndryshme dhe gjendjeve të ndryshme edhe shëndetësore. Duke u bazuar në gjendjen faktike të rastit në fjalë, lidhur me obligimin e ndërmarrjes së detyrimeve pozitive, Avokati i Popullit përkujton se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, përkitazi me situata analoge ka konstatuar se: *“Jo vetëm autoritetet publike duhet të përmbahen nga mos ndërhyrja në të drejtat e individëve, por ato duhet ndërmarrë hapa konkret në mbrojtjen e të drejtave të tyre ”*²⁴⁶

Prandaj, zvarritja dhe jo-efikasiteti i procedurave sjellin në situata që janë në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit, parim ky i sanksionuar me aktet më të larta ligjore si dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare, që autoritetet e Kosovës kanë për obligim t'i respektojnë pa përjashtim. Për këto arsye Avokati i Popullit i rekomandon Komunës së

²⁴⁶ GJEDNJ, rasti Hatton and Others v. the United Kingdom , Application no. 36022/97, 8 july 2003

Prishtinës që ta ekzekutojë sa më shpejt që është e mundur vendimin për lirim të pronës së shoqërore të uzurpuar në mënyrë arbitrare; të garantojë shqyrtimin e ankesave për të gjitha palët, brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe në pajtim me ligjet në fuqi

12.10 Letër-rekomandim - Ankesa nr. 312/2017

Avokati i Popullit ka pranuar ankesë ndaj Komunës së Podujevës për shkak të mungesës së kushteve për banim të familjes tetëmbëdhjetë (18) anëtarëshe që jetojnë tek ish-Stationi i Hekurudhës në Podujevë. Më 25 korrik 2017, përfaqësuesit e Avokati i Popullit të shoqëruar edhe nga gazetarët nga Redaksia e Emisionit "Zëri i Ashkalinjëve" në Radio Televizionin e Kosovës kanë vizituar familjen në fjalë që i përkasin komunitetit ashkali. Kjo familje jeton në gjendje jashtëzakonisht të rëndë socio-ekonomike, duke filluar që nga shtëpia që rrezikon të shembet, pastaj mungesa e ujit të pijshëm, ndërprerja e rrymës elektrike për shkak të pamundësisë financiare për ta paguar. Megjithatë jetesën akoma më të vështirë e bën numri i madh i anëtarëve të familjes tetëmbëdhjetë (18), që jetojnë në këtë shtëpi e cila nuk i plotëson as kushtet më elementare për banim. Nga ky numër i anëtarëve të kësaj familje, shtatë (7) nga ata janë fëmijë, tre (3) prej tyre janë përfitues të ndihmës sociale.

Sipas ankuesit, vështirësitë për jetesë në një shtëpi të tillë nuk paraqiten vetëm gjatë stinës së dimrit, por gjatë gjithë vitit dhe në fillim të këtij viti, njëri nga fëmijët kishte ndërruar jetë për shkak të ftohtit. Gjithashtu, ankuesi pohon se ai asnjëherë nuk është ndihmuar nga Komuna e Podujevës apo nga ndonjë institucion tjetër, përkundër premtimeve të vazhdueshme. Sikurse pjesa më e madhe e fëmijëve, edhe ankuesi dhe gruaja e tij vuajnë nga disa sëmundje. Kjo familje që trembëdhjetë (13) vite jeton në këtë shtëpi e që nuk është pronë e tyre. Ata para se të vendoseshin në këtë pronë, jetonin me qira me të ardhura që mund të siguronin nga ndonjë punë e herë pas hershme..

Avokati i Popullit konsideron se qëndrimi i mëtejshëm në këtë hapësirë rrezikon jetën e anëtarëve të kësaj familje nga mundësia e shembjes së vet shtëpisë. Ndërsa mungesa e kushteve të përshtatshme për jetesë, përbën rrezik serioz për paraqitjen e ndonjë sëmundje epidemike, e cila mund të rrezikojë jetën dhe shëndetin e anëtarëve të familjes posaçërisht fëmijëve por ashtu edhe banorëve të tjerë përreth.

E drejta në banim është njëra nga çështjet mjaft të rëndësishme për stabilitetin social, shëndetin dhe zhvillimin kualitativ të mirëqenies njerëzore. Në shumicën e vendeve të zhvilluara, banimi është e drejtë sociale e qytetarëve. E drejta e banimit, ka efekte të gjera, si sociale, kulturore, financiare, etj. Andaj, projektet e banimit social janë mjaft të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve të pastrehë. E drejta në banim në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut vlerësohet si pjesë integrale e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, në nivel të njëjtë me të drejtat civile dhe politike. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), në nenin 8, paragrafin 1 përcakton: "*Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës [...]".* Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

(GJEDNJ-) ka konstatuar në rastin *Marzari v. Italy*²⁴⁷, "edhe pse neni 8 nuk garanton të drejtën e dikujt për banim duhet të zgjidhet nga autoritetet, refuzimi i autoriteteve për të siguruar ndihmë në këtë drejtim për një individ që vuan nga një sëmundje e rëndë, në rrethana të caktuara mund të ngrit një çështje në bazë të nenit 8 të Konventës për shkak të ndikimit të një refuzimi të tillë në jetën private të individit ..., kjo dispozitë thjesht nuk e detyron shtetin që të përmbahet nga ndërhyrja e tillë; përveç kësaj, për këtë veprim negativ, mund të nxirren obligime pozitive të qenësishme në respektimin efektiv të jetës private. Një shtet ka detyrime të këtij lloji, ku ka një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm në mes të masave të kërkuara nga kërkuesi dhe jetën private të këtij fundit. "

Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Podujevës që të ndërmarr veprime të menjëhershme për zhvendosjen e kësaj familje nga shtëpia e cila gjendet në ish-Stacionin Hekurudhor në Podujevë dhe vendosjen e tyre në ndonjë hapësirë të përshtatshme për banimi.

12.11 Letër rekomandim - Ankesa nr. 619/2017

Avokati i Popullit, nëpërmjet adresës postare ka pranuar ankesë në lidhje me kriteret e konkursit Nr.Ref.01/1066/, të datës 05.09.2017, për pranimin e studentëve të rinj në vitin e parë të studimeve themelore-bachelor dhe të studimeve master në afatin e dytë për vitin akademik 2017/2018. Ankuesi më 6 shtator 2017 nëpërmjet web sajtit i është drejtuar me ankesë Universitetit "Kadri Zeka" në Gjiilan (UKZ), përmes të cilës ka kundërshtuar kriterin e paraparë sipas paragrafit 2 të konkursit për studimet master, mirëpo edhe përkundër kësaj ankuesi pohon se nuk ka marrë përgjigje në ankesën e parashtruar.

Më 29 shtator 2017, përfaqësuesi i IAP-it, lidhur me kriterin e konkursit sipas të cilit parashihet se: "Në studimet master mund të konkurrojnë kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet bachelor me notë mesatare me së paku 7.50 [...]" bisedoi me Sekretarin e Përgjithshëm të UKZ, i cili pohoi se do të bisedoj me rektorin lidhur me çështjen dhe do na njoftoj për veprimet e mëtutjeshme.

Më 17 tetor 2017, pas shpalljes së njoftimit nga UKZ, lidhur me shtyrjen e afatit për konkurrim, përfaqësuesi i IAP-it, përsëri vizitoi UKZ dhe bisedoi me Sekretarin e Përgjithshëm, i cili njoftoi se lidhur me shtyrjen e afatit dhe heqjen e kriterit për kufizimin e notës, është biseduar në Kolegjiumin e Dekanëve, mirëpo është vendosur vetëm për shtyrjen e afatit të konkursit deri më 20.10.2017, ndërsa heqja kriterit sipas të cilit parashihet se në studimet master mund të konkurrojnë kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet bachelor me notë mesatare me së paku 7,50 ka mbetur i njëjtë. Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, neni 2, paragrafi 1, pika 1,3, përcakton se "mundësi të barabarta për të gjithë studentët [...]", ndërsa sipas nenit 29, paragrafi 4, përcaktohet se "Studentët pranohen në studime Master mbi bazën e konkurrimin, sipas rezultateve të studimeve paraprake ekuivalencës së tyre, sikurse përcaktohet në këtë ligj."

²⁴⁷ *Marzari v. Italy* (1999) 28 EHRR CD 175. at 179

Duke u bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë si dhe në Statutin e UKZ, Senati i këtij universiteti më 16.02.2017, ka nxjerrë Rregulloren e Studimeve Posdiplomike (Master), sipas paragrafit 1 dhe 2 të nenit 10, parashihet se të gjithë studentët të cilët kanë përfunduar studimet themelore kanë të drejtë t'i regjistrojnë studimet postdiplomike një vjeçare dhe dy vjeçare, aq më tepër paragrafi 3, i nenit 10 përcakton se : *“Studentët të cilët gjatë studimeve themelore (Bachelor), kanë arritur notën mesatare 7.5 e më lartë, mund të pranohen drejtpërdrejtë në studimet master, sipas rangimit deri te kufiri i numrit të paraparë me konkurs.”*, ndërsa paragrafi 4, përcakton se: *“Në rastet kur numri i kandidatëve të paraqitur është më i vogël se numri i shpallur me konkurs, atëherë mund të pranohen edhe student me notë mesatare nën 7.5, por që ata do t'i nënshtrohen provimit kualifikues, mbi bazën e kritereve të cilat i përcakton Fakulteti.”*

Bazuar në informatat të cilat i posedon Avokati i Popullit, edhe pse konkursi është shpallur dy herë dhe tani është shtyrë afati për konkurrim deri më 20 tetor 2017, vetëm nga fusha e Ekonomike është tejkualuar numri i kandidatëve të interesuar, ndërsa në fushën e Shkencave Kompjuterike dhe Juridike ende nuk është plotësuar numri i kandidatëve. Një kufizim i tillë i notës mesatare nuk është paraparë sipas konkurseve të universiteteve tjera publike në Republikën e Kosovës, mund të konstatohet se kandidatët të cilët janë të interesuar të konkurrojnë për studimet Master në Universitetin “Kadri Zeka” nuk kanë pasur mundësi të barabarta me kandidatët të cilët kanë konkurruar sipas konkurseve të universiteteve tjera publike dhe ju është mohuar e drejta e konkurrimit. Andaj nisur nga kjo që u tha më lart Avokati i Popullit rekomandoi që të pezullohet kriteri që *“Në studimet master mund të konkurrojnë kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet baçelor me notë mesatare me së paku 7.50 [...]”*, i paraparë sipas konkursit Nr.Ref.01/1066/, të shpallur më datën 05.09.2017.

12.12 Letër rekomandim - Ankesa nr. 742/2015

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, më 17 dhjetor 2015, ka pranuar ankesë kundër Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mjedis (DUM) të Komunës së Ferizajt, për shkak të mosrespektimit të procedurave përkatëse për emërtimin e rrugëve në fshatin Kosinë të Komunës së Ferizajt. Në bazë të deklaramit të ankuesit dhe të provave tjera që ka në dispozicion Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ai i është drejtuar DUM të Komunës së Ferizajt më 17 dhjetor 2015, me ankesë kundër mënyrës së emërtimit të rrugëve të fshatit Kosinë, për shkak se komisioni kompetent për emërtimin e rrugëve nuk i ka respektuar procedurat ligjore për emërtimin e rrugëve.

Meqenëse, organet kompetente nuk ndërmorën ndonjë veprim të dukshëm e as nuk dhanë kurrfarë përgjigje me shkrim për rastin e ankuesit për rreth 11 muaj, më 10 nëntor 2016 Avokati i Popullit, nëpërmjet shkresës, kërkoi të informohet nga drejtori i DUM, për fazën në të cilën ndodhet procedura në çështjen e ankuesit. Më 25 nëntor 2016, Avokati i Popullit mori përgjigje nga drejtori DUM në të cilën thuhet: *“Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, i është adresuar ankesa e z. Maloku, e cila është në procedurë, por komisioni nuk e ka përfunduar punën për shkak të numrit të madh të ankesave. Me*

të përfunduar punën Komisioni propozimet i sjell në kuvend ku ato marrin formën e tyre”.

Nga të gjeturat e Avokatit të Popullit për këtë rast, rezulton se sa i përket trajtimit të kërkesës së ankuesit, ka zvarritje procedurale të paarsyeshme. Kjo bie ndesh në radhë të parë me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031 (LPPA), ku në nenin 10, paragrafi 2 përcaktohet shprehimisht obligimi për efikasitetin kohor të vendimmarrjes. “*Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*”.

Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Ferizajt që sa më shpejt të trajtoj ankesën nr. 04-16-117968 të datës 17 dhjetor 2015 duke i dhënë ankuesit përgjigje me shkrim, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

12.13 Letër rekomandim - Ankesa nr. 692/2017

Avokati i Popullit ka pranuar ankesë kundër Rektoratit të Universitetit të Prishtinës”Hasan Prishtina”. Sipas pohimeve të ankueses dhe dokumentacionit që ajo ka paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit vërehet se, më 21 shkurt 2017, ankuesja ishte në zyrën e arkivit të rektoratit për të dorëzuar një shkresë me dokumentacion përcjellës, por që zyrtarja e arkivit ka refuzuar ta pranojë shkresën e saj. Në pamundësi të dorëzimit të shkresës në zyrën e arkivit të rektoratit, ankuesja e ka dërguar atë përmes postës me rekomandë, më 23 shkurt 2017. Megjithatë, po atë ditë, ankueses i është kthyer dërgesa me fletëkthim.

Veprimet e tilla bien ndesh në radhë të parë me parimet e Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative²⁴⁸(ligj i cili ishte në fuqi në kohën kur ankuesja ka dorëzuar kërkesë në Rektorat) përkatësisht parimin e objektivitetit dhe paanësisë, nga i cili rrjedh obligimi për organet e administratës publike që të veprojnë në mënyrë objektive dhe të paanshme, dhe se veprimtaria e organeve të administratës publike nuk duhet të ndikohet nga ndonjë interes personal, familjar, miqësor apo politik.²⁴⁹

Organi kompetent i institucionit publik është i detyruar që ta pranojë kërkesën e dorëzuar nga pala. Në funksion të krijimit të një administrate më të efektshme, të përgjegjshme, transparente dhe etike, do të ishte domosdoshme që pa marrë parasysh se a e kërkon pala apo jo vërtetimin apo dëshminë për dorëzimin, respektivisht pranimin e kërkesës, organi i administratës publike ta bëjë praktikë dhënien e dëshmisë me shkrim të dorëzimit të kërkesës.²⁵⁰ Për më tepër, qëllim i miradministrimit të organeve të administratës publike ndër të tjera duhet të jetë edhe krijimi i praktikave të mira duke promovuar një kulturë administrative të harmonizuar dhe të fokusuar te qytetarët, e cila mëson nga

²⁴⁸ Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka hyrë në fuqi më 21 qershor 2017.

²⁴⁹ Ligji nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, neni 7.

²⁵⁰ M. Baraliu& E. Stavileci, Komentari, Ligji për Procedurën Administrative, botimi I, fq.126 -127.

bashkëveprimi me qytetarët.²⁵¹

Duke u bazuar në këtë Avokati i Popullit rekomandoi që zyra për pranimin e kërkesave e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina,” ta pranojë, shqyrtojë kërkesën e znj. Shala dhe kërkesat tjera eventuale në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative

12.14 Letër rekomandim - Ankesa nr. 315/2016

Avokati i Popullit ka pranuar ankesë në emër të Këshillit Grevist të Fabrikës për prodhimin e tubave të çelikut IMK, për moszbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KI 08/09, të datës 17 dhjetor 2010. Rasti i Fabrikës së Tubave në Ferizaj është rast i njohur për publikun, për të cilin punëtorët e fabrikës kishin paraqitur ankesë edhe në Institucionin e Avokatit të Popullit . Avokati i Popullit është takuar disa herë me ankuesit dhe ka dëgjuar shqetësimet e tyre. Së fundi, ankuesit kanë paraqitur në IAP Qëndrimin e Bordit të AKP-së lidhur me çështjen e ish-punëtorëve të Fabrikës së Gypave në Ferizaj, të datës 21 qershor 2016 (të bashkëngjitur këtu për bindjen tuaj). Më sa kuptohet nga Qëndrimi i Bordit të AKP-së pagesa për ish punëtorët e Fabrikës së Tubave nuk mund të realizohet për shkak të procedurave gjyqësore të shqyrtimit të ankesave në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK) për Fabrikën e Tubave. Bordi i AKP-së ka udhëzuar që nga DHPGJSK të kërkohet trajtimi me prioritet i ankesave të parashtruara në procedurën e likuidimit të Fabrikës së Tubave.

Duke marrë parasysh faktin se Gjykata Kushtetuese e Kosovës tanimë ka konstatuar se ka pasur shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm për shkak të mosekzekutimit të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Ferizaj, Avokati i Popullit rekomandoi DHPGJSK t'i kushtoj prioritet ankesave që kanë të bëjnë me procedurën e likuidimit të Fabrikës së Tubave në mënyrë që ish-punëtorët e fabrikës të jenë në gjendje t'i realizojnë të drejtat e tyre.

²⁵¹ Kodi Evropian i Sjelljes së Mirë Administrative, i miratuar nga Parlamenti Evropian më 2001.

13.Amicus Curiae

13.1 Mendim juridik i Avokatit të Popullit, në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) në lidhje me gjendjen e homofobisë dhe transfobisë

Ky mendim juridik i Avokati i Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës përqendrohet në zhvillimet e fundit në Republikën e Kosovë që përbëjnë shkelje të dispozitave të cilat e ndalojnë diskriminimin në çfarëdo baze duke përfshirë seksin, orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Fokusi i saj do të jetë në gjendjen që lidhet me çështje të homofobisë duke ofruar një analizë të detajuar ligjore, me qëllim të nxjerrjes në pah të zbrazëtirave potenciale, brenda strukturës ligjore në nivel shtetëror, të cilat e pengojnë në një formë implementimin e Konventës dhe Protokolleve të saj (me tej në tekst i referohemi si: KEDNJ).

Avokati i Popullit paraqitet me këtë Amicus Curiae pas hetimit të rasteve A.451/2016, Ex-officio nr. 379/2016 dhe A. 72/2017 sipas së cilave ankuesit i takojnë komunitetit LGBTI dhe nën këtë pretekst kanë qenë viktime të dhunës fizike dhe diskriminimit.

Komuniteti LGBT si pjesë e shoqërisë në Kosovë, konsiderohet të jetë kategori e marginalizuar edhe përkundër faktit se ekziston bazë ligjore e cila i mbrohet të drejtat e tyre. Duke marrë parasysh qasjen aktuale të shoqërisë ndaj këtij problemi, është me rëndësi të ritheksojmë se të drejtat e njeriut janë të pacenueshme dhe të pandashme dhe kështu ato krijojnë bazën për rend ligjor. Në këtë mënyrë ato janë të konceptuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, instrument ligjor i cili i garanton të drejtat e të gjithë qytetarëve të vet, duke garantuar dhe mbrojtur liritë e tyre civile dhe barazinë e të gjithëve përpara ligjit. Avokati i Popullit thekson se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë duhet të të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane mbi të drejtat e njeriut, siç është cekur në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Analiza ligjore e çështjes, pavarësisht dispozitave të instrumenteve ligjore të lartcekura, do të duhej të fillojë nga praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (tani e tutje do t'i referohemi: GJEDNJ) dhe perceptimin e tyre mbi homoseksualitetin, diskriminimin e bazuar në seks dhe orientim seksual.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek e ashtuquajtura dispozita “Cinderella” (Hirushja), neni 14 i KEDNJ që ndalon diskriminimin në çfarëdo baze duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm më seks, pa përmendur në mënyrë të veçantë ndalimin e diskriminimit në bazë të orientimit seksual. Neni 14 garanton mbrojtje nga diskriminimi vetëm për të drejtat e cekura në Konventë, duke nënkuptuar se atij mund t'i referohemi vetëm, nëse një situatë e caktuar bie nën fushën e një të drejte të Konventës.²⁵²

²⁵² Rory O'Connell, “Cinderella comes to ball -Hirushja vie në ballo”: Neni 14 dhe e drejta në mos diskriminim në KEDNJ, (2009) 29 (2) Studimet Ligjore: Revistë e shoqatës së hulumtuesve ligjor, 211-229, f.5

Neni 14 nuk i referohet diskriminimit të bazuar në orientim seksual si bazë për mbrojtje sipas KEDNJ-së por vjen në pyetje nëse baza për ndalim të diskriminimit të bazuar në orientim seksual bie përbrenda konceptit të “seksit” ose “çfarëdo baze” siç është cituar në Konventë. Avokati i Popullit thekson se GJEDNJ-ja ka sqaruar këtë çështje në rastin *Salgueiro da Silva Mouta kundër Portugalisë*. Në vendimin e lëshuar nga kjo gjykatë ndalimi i diskriminimit të bazuar në orientim seksual është koncept padyshim i mbuluar me nenin 14, i cili në dispozitën e vet përmban një listë ilustruese dhe të pafund, e cila qartë buron nga nocioni “çfarëdo baze”.²⁵³ Bazuar në atë që u tha më lartë, rezulton se Kushtetuta e Kosovës duke e garantuar zbatimin e KEDNJ-së dhe të vendimeve të GJEDNJ-së ndalon çfarëdo lloji të diskriminimit të bazuar në orientim seksual.

Për më tepër Avokati i Popullit thekson se dispozita e përfshirë në nenin 14 të KEDNJ-së është konkretizuar më tej edhe në Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi, Neni 1 i këtij Ligji, parasheh një listë të pafund bazash, për të cilat diskriminimi është i ndaluar, ku mes tyre është orientimi seksual afër bazës së “seksit” duke e përfshirë në termin e përgjithshëm dhe në “çfarëdo baze tjetër”.

Përtej çdo dyshimi korniza ligjore vendore i aplikon standardet e caktuara me instrumentet ndërkombëtare për sa i përket implementimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në lidhje me ndalimin e diskriminimit të bazuar në seks dhe orientim seksual, që nënkupton zbatimin e KEDNJ-së dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, me konkretizim të mëtejshëm të dispozitës së nenit 14 të KEDNJ në Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi.

Avokati i Popullit, në bazë të të gjitha dëshmive të paraqitura dhe fakteve të mbledhura, si dhe ligjeve në fuqi, konstaton se ankesat e ankuesve lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të përcaktuara me ligje vendore dhe instrumente ndërkombëtare është e arsyeshme dhe e ligjshme. Në rastet e lartpërmendura ka shkelje të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, sepse që në fillim trajtimi i rasteve të dhunës në Policinë e Kosovës nuk regjistrohen për tu trajtuar “si dhunë e ushtruar për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”.

Ekziston bazë e mjaftueshme ligjore për mbrojtjen e komunitetit LGBT por jo të zbatueshëm në raste konkrete. Duke pas parasysh ndjeshmërinë e rastit Prokuroritë Themelore kallëzimet penale në këto raste duhej t’i trajtonin me prioritet për të argumentuar mbrojtje ligjore për komunitetin LGBT. Tek kontestet e punës ku palët në procedurë, që pretendojnë se janë viktima mbi bazën e orientimit seksual, Gjykata duhet t’i trajtoi dhe të vendos në këto raste, në përputhje me Ligjin nr. 05/L-021, për Mbrojtje nga Diskriminimi si dhe nenin 5, paragrafi 1 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, ngase vetëm në këtë formë do të garantohet një trajtim i barabartë para ligjit për të gjithë.

²⁵³ GJEDNJ Salgueiro da Siva Muta kundër Portugalisë, Kërkesa nr. 33290/96, Aktgjykimi i 21 dhjetorit 1999, para.28

13.2 Mendim juridik i Avokatit të Popullit, në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) në lidhje me paditë ndaj Autoritetit të Likuidimit që janë duke u trajtuar në këtë Gjykatë të paraqitura nga ish-punëtorët e Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr Salloniti” nga Hani i Elezit

Ky mendim juridik në cilësinë e mikut të gjykatës ka për qëllim ofrimin e ndihmës ligjore për krijimin e mundësisë së zgjidhjes efektive të rastit A.nr.595/2016 që ka të bëjë me të drejtat legjitime për dëmshpërblim të ish-punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr Salloniti” nga Hani i Elezit.

Më 11 tetor 2016, Avokati i Popullit ka pranuar ankesën e përfaqësuesit ligjor të ish-punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr Salloniti” nga Hani i Elezit, i cili ankohet në zvarritje të procedurës në ekzekutimin e vendimeve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), për shkak të mungesës së informatave lidhur me paditë e paraqitura në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Dhoma e Posaçme), ndaj vendimeve të AKP-së. Nga informatat dhe dokumentacioni me të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit disponon, rezulton se ish-punëtorët e Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr Salloniti” e cila ka hyrë në procedurë të likuidimit në vitin 2011, kanë paraqitur kërkesat e tyre pranë AKP për kompensim dëmi shëndetësor, të përfituar si pasojë e ekspozimit ndaj asbestit gjatë punës. Ndërmarrja në të cilën kanë punuar këta punëtorë, si aktivitet i saj primar ka qenë puna ndaj të cilës punëtorët i janë ekspozuar detyrimisht dhe pa mbrojtje materialit të rrezikshëm të quajtur *asbest*, ekspozimi ndaj të cilit në ambientin e punës pretendohet të ketë rezultuar në sëmundje profesionale.

Autoriteti i Likuidimit pranë AKP-së, ka përfunduar vendimmarrjen lidhur me këtë ndërmarrje dhe bazuar në nenin 41 të shtojcës së Ligjit për AKP-në (Nr. 04/L-034), ka vendosur mbi të gjitha kërkesat në likuidim dhe ka dërguar vendimet tek parashtruesit e kërkesave. Sipas këtij neni, lejohet shpërndarja e fondeve të likuidimit, për përmbushjen e kërkesave të kreditorëve vetëm në kushtet kur ka fonde të mjaftueshme pasi që reduktohet vlera e kërkesave që janë ende të pavendosura në gjykatë. Vendimet e Autoritetit të Likuidimit lidhur me këto kërkesa janë lëshuar për secilin kërkues në mënyrë individuale. Meqenëse procedura e likuidimit për këtë ndërmarrje ende nuk ka përfunduar, AKP, në bazë të nenit të cekur më lartë, paragrafi 3 dhe 4²⁵⁴, ka të drejtë të bëjë shpërndarjen e pjeseshme të fondeve. Kërkesat në fjalë ende nuk janë përmbushur nga AKP, që do të thotë ende nuk janë shpërndarë fondet për kreditorët, pasi që kësaj të

²⁵⁴ Nenin 41 i shtojcës së Ligjit për AKP-në (Nr. 04/L-034) paragrafi 3 dhe 4:” Nëse resurset janë të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha kërkesat e një kategorie të caktuar, duke përfshirë mbulimin për rezervimet e bëra nga Autoriteti i Likuidimit për kërkesat e kontestuara të një kategorie apo renditje, Autoriteti i Likuidimit mund të propozojë shpërndarjen e përkohshme në këto kategori të kreditorëve para Bordit. 4. Nëse resurset janë të pamjaftueshme për të përmbushur tërësisht të gjitha Kërkesat apo interesat e një kategorie apo niveli të caktuar, përfshirë mbulimin për rezervimet e Autoritetit të Likuidimit për kërkesat e kontestuara të një kategorie apo niveli, Kërkesat e asaj kategorie apo niveli përmbushen në proporcion me shumën e çdo Kërkese, përfshirë kërkesat për të cilat Autoriteti i Likuidimit ka bërë rezervime”.

fundit i duhet informacion nga Dhoma e Posaçme mbi numrin dhe vlerën e ankesave ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit.

Më 28 shtator 2016, ankuesi ka pranuar njoftim nga AKP se kjo e fundit ka më shumë se një vit që ka kërkuar zyrtarisht informacion nga Dhoma e Posaçme lidhur me numrin dhe vlerën e ankesave ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit, mirëpo ende nuk kanë pranuar përgjigje.

Asbesti tanimë është i njohur botërisht si element i dëmshëm për shëndetin. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka vlerësuar se ekspozimi ndaj këtij materiali është një nga elementet kryesorë për shkaktimin e sëmundjeve profesionale.²⁵⁵ Pas këtij konstatimi, në nivel global janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për mbrojtje të punëtorëve nga ekspozimi ndaj tij, gjithashtu është shtuar kujdesi dhe janë vendosur rregullat për përdorimin të tij në industri. Një numër i madh shtetesh kanë miratuar legjislacion të posaçëm për parandalimin e shkaktimit të dëmeve shëndetësore nga ky material duke përfshirë edhe kriteret për dëmshpërblimin e punonjësve të dëmtuar në këtë fushë. Në Kosovë nuk është e rregulluar me legjislacion specifik kjo problematikë, gjithashtu as edhe mënyra e dëmshpërblimit të atyre të cilët janë prekur nga kjo dukuri.

Më 24 korrik 2014 GJEDNJ shpalli gjykimin e saj në çështjen Brincat dhe të tjerët kundër Maltës (çështja Brincat).²⁵⁶ Ky rast ishte rezultat i 21 aplikimeve të ish-punëtorëve të portit për riparimin e anijeve publike të ekspozuar ndaj asbestit. Qeveria e Maltës ishte përgjegjëse për shkeljen e detyrimeve pozitive për të mbrojtur të drejtën për jetë dhe të drejtën për respektimin e jetës private. Një shkelje e së drejtës për jetë u gjet kur vdekja e punonjësit ishte rezultat i ekspozimit ndaj asbestit. Aty ku punonjësit kishin vuajtur nga sëmundje të ndryshme, Gjykata gjeti shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare.

Ndërmarrja Shoqërore “Sharr Salloniti” nga Hani i Elezit, pjesë e kombinatit “SHARR”, e cila ka vepruar nga viti 1974, si aktivitet kryesor kishte punën me materialin asbest. Studimi ambiental mbi ndotjen nga asbesti, i financuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim, më 29 mars 2001, ka përcaktuar prezencë të pluhurit të asbestit në ambientet e fabrikës, duke rekomanduar edhe masa mbrojtëse për mbrojtjen e punëtorëve ndaj ekspozimit. Ish-punëtorët e kësaj ndërmarrje kanë punuar me vite të tëra pranë saj. Autoriteti i Likuidimit, bazuar në provat lidhur me këtë çështje ka konstatuar se ekspozimi i ish-punëtorëve ndaj asbestit ka ndodhur.²⁵⁷ Ndërmarrja, për arsyet e cekura më lartë me një vendim të veçantë është mbyllur nga UNMIK-u, dhe nga viti 2011 ka hyrë në procedurë likuidimi. Që nga atëherë është konstatuar se kanë vdekur rreth 100

²⁵⁵Health World Organization, “Asbestos: elimination of asbestos-related diseases”, <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs343/en/>.

²⁵⁶ GJEDNJ, Brincat dhe të tjerët v Maltës (60908/11, 62110/11, 62129/11, 62312/11, 62338/11), 24 korrik 2014.

²⁵⁷ Agjencia Kosovare e Privatizimit, Vendim, 27.10.2014, lidhur me kërkesën e S.D. për dëmshpërblim, për shkak të përfitimit të sëmundjes profesionale nga ekspozimi ndaj asbestit.

ish-punëtorë të ndërmarrjes “Sharr Salloniti”, dhe të tjerët janë duke i vuajtur pasojat shëndetësore të shkaktuara nga ekspozimi i pambrojtur i tij.²⁵⁸

Avokati i Popullit, duke u bazuar në analizën procesit të deritanishëm të rastit konsideron se kemi të bëjmë me ngecje të procedurave administrative, për përmbushjen e të drejtave legjitime ndaj palëve. Sipas informatave në dispozicion kjo procedurë është stopuar për faktin se Dhoma e Posaçme nuk i ka ofruar AKP-së numrin dhe vlerën e ankesave ndaj vendimeve të kësaj të fundit, që do të hapte rrugën për zgjidhjen e mundshme të problemit. Sipas një formule të përgjithshme të GJEDNJ që zbatohet si për detyrimet pozitive ashtu edhe për ato negative thotë: *“një pengesë reale (faktike) mund të përbëjë shkelje të Konventës po aq sa dhe një pengesë juridike”*.²⁵⁹

Avokati i Popullit shpreh shqetësimin nëse këto lëndë, meqë janë të natyrës së njëjtë, do të trajtohen në mënyrë individuale nga Dhoma e Posaçme. Kjo do të shkaktonte kohëzgjatje të paarsyeshme procedurale deri në zgjidhjen e tyre. Shtojca e Ligjit për Dhomën e Posaçme, Nr.04/L-33, neni 33, paragrafi 1, përcakton: *“Kurdoherë gjatë procedurave, Dhoma e Posaçme mund të urdhërojë bashkimin e dy apo më shumë kërkesave/ankesave që kanë të bëjnë me të njëjtën çështje për qëllim të procedurave me shkrim apo me gojë ose të Aktgjykimit. Para nxjerrjes së një Aktgjykimi për të gjitha kërkesat/ankesat që do të bashkohen, mund të ndahet çfarëdo kërkesë/ankesë për të cilën nuk është nxjerrë një Aktgjykim”*. Në vitin 2006, Dhoma e Posaçme ka nxjerrë Aktgjykimin RE: SCCL-05-009, rasti Radomir Milutinovic (Punëtorët e Lamkos-it) kundër KTA. Gjatë trajtimit të këtij rasti Dhoma e Posaçme i ka bashkuar të gjitha ankesat për të njëjtën çështje, dhe ka vendosur për të gjitha në një aktgjykim. Meqë, ankesat e ish-punëtorëve “Sharr Salloniti” janë të natyrës së njëjtë, konkludojmë se Dhoma e Posaçme duhet ndjekur të njëjtën praktikë si në aktgjykimin e sipërpërmendur. Autoritetet kanë obligim pozitiv *“për të organizuar sistemet e tyre të drejtësisë në atë mënyrë që gjykatat e tyre mund të plotësojnë të gjitha kushtet e tyre, përfshirë edhe obligimin për t’i dëgjuar rastet brenda kohës së arsyeshme”*.²⁶⁰ Ky detyrim ekziston pa marr parasysh shpenzimet.²⁶¹

Standardet e të drejtave të njeriut kanë për qëllim të garantojnë jo të drejta teorike dhe të paarritshme, por të drejtat që janë *“praktike dhe efektive”*.²⁶² Për sa i përket gjykatave ndërkombëtare, pohimi i thjeshtë i ekzistencës së të drejtave apo ligjeve, që i mbrojnë të

²⁵⁸ Po aty.

²⁵⁹ GJEDNJ, Airey c. Irlande, 11 shtator 1979.

²⁶⁰ Süßmann kundër Gjermanisë, GJEDNJ, aktgjykimi 16 shtatorit 1996, paragrafi 55. Për më tepër, autoritetet mund të mbahen përgjegjëse jo vetëm për çfarëdo vonese në trajtimin e një rasti të veçantë në operimin e një sistemi përgjithësisht të shpejtë për administrimin e drejtësisë, por po ashtu edhe për dështimin për të rritur resurset në përgjigje ndaj mbingarkesës me lëndë dhe për mangësi strukturore në sistemin e vet të drejtësisë që shkaktojnë vonesa. Shih Harris, O’Boyle & Warbrick. Law of the European Convention on Human Rights, edicioni i dytë, Oxford University Press, 2009, faqet 278-284.

²⁶¹ Airey kundër Irlandës, GJEDNJ, aktgjykimi i 9 tetorit 1979, paragrafi 20.

²⁶² Ky parim është miratuar nga Komiteti i të Drejtave të Njeriut, OKB, Doc.CCPR/C/21/Rev.1/Add/13 (2004).

drejtat teorikisht ose vetëm formalisht, nuk mjafton për të përmbushur testin e “prakticitetit dhe efektivitetit” të këtyre të drejtave.

Në këto raste Avokati i Popullit konsideron se do të ishte e përshtatshme që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të tregoj praktikitet efektiv për zgjidhjen e rastit të ish-punëtorëve të ndërmarrjes “Sharr Salloniti”, duke i dërguar informacion specifik AKP-së, lidhur me numrin dhe vlerën e ankesave të paraqitura kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit. Për të parandaluar vonesat e mëtutjeshme në trajtimin e lëndëve të paraqitura nga këta ish-punëtorë pranë Dhomës së Posaçme, kjo e fundit do të duhej të praktikojë bashkimin e lëndëve për çështje të njëjta, t’i trajtojë ato bashkërisht me një aktgjykim. Për shkak të ndjeshmërisë së rastit, duke marrë parasysh aspektin moral dhe njerëzor, të tregojë prioritet ndaj trajtimit të këtyre lëndëve duke mënjeluar pengesat strukturore që do të shkaktonin vonesa, dhe gjithashtu t’i kushtohet vëmendje e posaçme praktikës së GJEDNJ-së, për zgjidhjen efektive të tyre.

13.3 Mendim juridik i Avokatit të Popullit, në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) në lidhje me padinë e Komunës së Ferizajt, kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,

Ky mendim juridik në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) do të përqendrohet në sqarimin e procedurave ligjore përkitazi me procesin e rekrutimit të personelit arsimor, sipas konkurseve të shpallura nga Drejtoritë Komunale të Arsimit në Republikën e Kosovës. Duke pasur parasysh faktin se Komuna e Ferizajt ka ngritur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me punësimet e personalit arsimor nga Drejtoria e Arsimit e Komunës së Ferizajt, rasti A.nr.398/15. Duke pasur parasysh faktin se Avokati i Popullit, ka hapur hetimet sipas detyrës zyrtare, rasti nr.499/2016, lidhur me mosrespektimin e procedurave ligjore gjatë procesit të rekrutimit të personelit, sipas konkurseve të shpallura nga Drejtoritë Komunale të Arsimit në Republikën e Kosovës(DKARK) dhe ka hartuar raport me rekomandime për DKARK. Duke pasur parasysh faktin se Avokati i Popullit gjatë hetimit të rastit ka marr informacione se lidhur me çështjen e trajtuar në nivel të vendit (rekrutimet e personelit arsimor), në Gjykatën Themelore të Prishtinës është ngritur një padi lidhur me temën e trajtuar nga IAP. Andaj, për këtë qëllim Avokati i Popullit, Gjykatës Themelore në Prishtinë, i paraqet këtë mendim juridik në cilësinë e mikut të gjykatës për ta njoftuar lidhur me gjetjet dhe konstatimet e tij.

Është i pakontestueshëm fakti se shumica e DKA-ve në Republikën e Kosovës, sipas konkurseve të shpallura për pozitat e mësimdhënësve zbatojnë Ligjin e Punës, përzgjedhja e kandidatëve në disa komuna është bërë sipas dispozitave të veçanta ligjore, ndërsa në disa sipas dispozitave të Ligjit të Punës, konkretisht në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, prandaj, institucionet publike të cilat zbatojnë ligjet duhet t’i zbatojnë njësoj ndaj të gjithëve dhe secilit t’i ofrojnë mbrojtje të njëjtë.

Padyshim që një shembull i këtillë i kontribuon mosbesimit të qytetarëve në drejtësi, prandaj, duke u bazuar në këto fakte, zbatimi i dispozitave të ndryshme ligjore nga komunat, sjellin në situata që janë në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit, parim ky i sanksionuar me aktet më të larta ligjore si dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare, që autoritetet e Kosovës kanë për obligim t'i respektojnë pa përjashtim.

Se duke u bazuar në nenit 2, paragrafi 2, të Ligjit të Punës, DKA-të në Kosovë duhet të zbatojnë dispozitat e veçanta ligjore të cilat rregullojnë çështjen e punësimit të stafit arsimor në institucionet e arsimit parauniversitar, si që janë: neni 35, i Ligjit për Arsimin Parauniversitar, neni 4, i Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ nr.17/2009, Procedura e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë,²⁶³ dhe Udhëzimi Administrativ nr.26/2013, Zgjedhja e nëpunësve për ofrimin e shërbimeve profesionale në institucionet edukative-arsimore parauniversitare.²⁶⁴

Zgjedhja e personelit arsimor për të gjitha lëndët mësimore bëhet në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.05/2015, Normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional,²⁶⁵ dhe Udhëzimi Administrativ nr.06/2015, për Normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm,²⁶⁶ të gjitha këto dispozita të cekura më lartë, parashohin zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës në institucionet arsimore dhe përbëjnë një bazë të mjaftueshme ligjore e cila kërkohet pikërisht sipas nenit 2.2 të Ligjit të Punës.

Rekrutimi stafit arsimor në institucionet arsimore duhet të bëhet në pajtim me udhëzimet, procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT-i.²⁶⁷

²⁶³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=7744> dhe në <http://masht.rks-gov.net/>

²⁶⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10072> dhe në <http://masht.rks-gov.net/>

²⁶⁵ http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/07/ua-05-2015-normativi-per-mesimdhenesit-e-arsimit-profesional-final-ilovepdf-compressed_1.pdf

²⁶⁶ <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/07/convert-jpg-to-pdfnet-2015-07-30-16-32-24.pdf>

²⁶⁷ Neni 5, i Ligjit Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës

14. Kërkesat për masë të përkohëshme

14.1 Kërkesë për shfuqizimin e nenit 55, paragrafët 4–5, dhe neneve 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, si dhe për pezullimin e menjëhershëm të këtyre dispozitave deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate

Ligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje delegon tek organet administrative dhe ekzekutive kompetencën për të gjykuar dhe për të vendosur sanksione, në një varg të gjerë të rasteve kundërvajtëse. Vendimet e këtyre organeve i nënshtrohen vetëm një forme të kufizuar të kontrollit gjyqësor. Pyetja e parashtruar është:

Ky delegim i kompetencave gjyqësore tek organet administrative dhe ekzekutive, a paraqet shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë nga një tribunal i pavarur, siç garantohet nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut?

Në këtë kërkesë, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës kërkon (1) shfuqizimin e nenit 55, paragrafët 4–5 dhe neneve 56–68 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, dhe (2) masë të përkohëshme për pezullimin e menjëhershëm të këtyre dispozitave deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate.

Kërkesa e Avokatit të Popullit për shfuqizimin e dispozitave të lartpërmendura, si dhe për masë të përkohëshme, janë brenda jurisdikcionit lëndor të Gjykatës Kushtetuese. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: “Kushtetuta”) përcakton, në pjesën relevante, se “Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute” (*po aty*, neni 135, par. 4); dhe në veçanti, Avokati i Popullit është “i autorizuar të ngrenë . . . çështjen e përputhshmërisë së ligjeve . . . me Kushtetutën” (*po aty*, neni 113, par. 2, nënpar. 1).

Për sa i përket kërkesës për masë të përkohëshme, Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, përcakton se Gjykata “me kërkesë të palës mund të vendosë përkohësisht masa të përkohëshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohëshme është në interes publik” (*po aty*, neni 27, par. 1).

Kërkesa e Avokatit të Popullit ndodhet gjithashtu brenda jurisdikcionit kohor të Gjykatës: “Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohe[t] . . . nga ana e Avokatit të Popullit . . . brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar” (Ligji për Gjykatën Kushtetuese, neni 29, par. 1 dhe neni 30). Ligji që po kontestohet në këtë kërkesë hyri në fuqi në muajin janar të vitit 2017 (*shih* Ligjin për Kundërvajtje, neni 171). Prandaj, kërkesa e Avokatit të Popullit vjen brenda afatit gjashtëmuor të përcaktuar nga Ligji për Gjykatën Kushtetuese.

Përpara se Ligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje të hynte në fuqi, lëndët kundërvajtëse në përgjithësi ishin trajtuar sipas një ligji nga koha e ish-Jugosllavisë: Ligji Nr. 011/15-79 (i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës) mbi Kundërvajtjet. Sipas këtij ligji, rastet kundërvajtëse gjykoheshin nga gjykatat komunale të kundërvajtjes, të vendosura në secilën komunë (*shih po aty*, neni 30, par. 1). Kjo procedurë u ndryshua pakëz në vitin 2013, kur Ligji Nr. 03/L-199 (i Republikës së Kosovës) për Gjykatat, hyri në fuqi. Ky ligj i ri përcaktoi se lëndët kundërvajtëse do të gjykoheshin nga “Gjykatat Themelore”, në shtatë degë rajonale, dhe jo nga gjykatat e komunave individuale (*shih po aty*, neni 9, par. 2 dhe neni 39, par. 2). Mirëpo, me gjithë këtë ndryshim të vogël, të dyja ligjet pasqyronin të njëjtin parim themelor: gjykimi i rasteve kundërvajtëse ndodhet ekskluzivisht në jurisdikcionin e gjykatave.

Ky parim, i njohur për një kohë të gjatë, u përmyt me miratimin e Ligjit të fundit për Kundërvajtje, i cili po kontestohet në këtë Kërkesë. Ky ligj delegon tek “organet e kundërvajtjes” kompetencën për të gjykuar dhe për të vendosur sanksione në disa raste kundërvajtëse.²⁶⁸ Siç është e qartë në Ligj, organet e kundërvajtjes nuk janë gjykata. Përkundrazi, ato janë organe administrative ose ekzekutive, të ngarkuara me detyrën e zbatimit të ligjeve: “Për disa kundërvajtje të përcaktuara me ligj apo rregullore të Kuvendit të Komunës, procedura e kundërvajtjes mund të zhvillohet, dhe sanksionin kundërvajtës mund të shqiptojë *organi i administratës shtetërore* ose *organi i cili kryen autorizime publike (në tekstin e mëtejme: organi për kundërvajtje) të mbikëqyrjes për zbatimin e ligjit*, në të cilin janë paraparë kundërvajtje” (*po aty*, neni 55, par. 4; theks i shtuar). Në strukturën kushtetuese të Republikës së Kosovës, organe të tilla, që ngarkohen me zbatimin e ligjeve, janë në përgjithësi organet *ekzekutive* të Qeverisë. *Shih* Kushtetutën, neni 4, par. 4 (“Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve”).²⁶⁹ Duke deleguar kompetenca gjykuese tek organet e tilla administrative dhe ekzekutive, Ligji për Kundërvajtje paraqet një devijim prej ndarjes tradicionale ndërmjet kompetencave gjykuese dhe ekzekutive.

Përveç delegimit të kompetencave gjykuese tek organet e kundërvajtjes, Ligji për Kundërvajtje gjithashtu përcakton jurisdikcionin e tyre lëndor, duke parashikuar se organi i kundërvajtjes është “kompetent që të veprojë sipas të gjitha kundërvajtjeve, për të cilat është paraparë sanksioni i gjobës në shumën e caktuar; për të cilat është paraparë sanksioni për personin fizik gjoba deri në pesëqind (500) euro; për të cilat është paraparë sanksioni për personin juridik gjoba deri në njëmijë (1.000) euro; dhe për të cilat është paraparë shqiptimi i gjobës në vend” (*po aty*, neni 56, par. 2). Përveç këtyre rasteve, organeve të kundërvajtjes gjithashtu mund t’u jepet jurisdikcioni mbi raste të tjera kundërvajtëse—pavarësisht nga sanksioni i parashikuar—nëse “me ligj është paraparë kompetenca

²⁶⁸ Ligji e parashikon këtë delegim të kompetencave gjykuese tek organet e kundërvajtjes, në nenin 55, paragrafët 4–5 dhe nenet 56–63.

²⁶⁹ Më e rëndësishme është se kundërvajtjet në komunikacion rrugor, të cilat përbëjnë shumicën e rasteve kundërvajtëse, trajtohen nga Policia e Kosovës, e cila “është shërbim publik në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme” (Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, neni 4, par. 1; theks i shtuar) dhe prandaj është pjesë e degës ekzekutive.

ekskluzive për veprimin e saj” (*po aty*, neni 56, par. 1). Në këtë mënyrë, Ligji për Kundërvajtje e bën të qartë se organet e kundërvajtjes kanë juridiksion mbi një varg të gjerë të rasteve kundërvajtëse. Të gjitha rastet e tjera të kundërvajtjes, që ngelen jashtë juridiksionit të organeve kundërvajtëse, do të vazhdojnë të gjykoen nga gjykatat e shkallës së parë (*shih po aty*, nenin 55, par. 1–3)

Për sa i përket mënyrës se si organet e kundërvajtjes do të emërojnë personat përgjegjës për gjykimin e lëndëve kundërvajtëse, Ligji për Kundërvajtje tregon shumë pak. Ligji bën përpjekje të sigurojë që këta persona të jenë profesionalisht kompetentë, duke përcaktuar se “procedura zhvillohet pranë organit të kundërvajtjes nga komisioni për vendosje, në përbërje prej së paku tre (3) anëtarëve” dhe që këta anëtarë do të jenë “personat zyrtarë të autorizuar me shkallën përkatëse të përgatitjes profesionale dhe përvojës së punës të nevojshme, nga të cilët së paku një nga anëtarët të jetë jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës” (*po aty*, neni 60, par. 1 dhe 2). Megjithatë, Ligji nuk parashikon asnjë mbrojtje nga presioni i jashtëm mbi këta anëtarë të komisionit.

Kjo paraqet një dallim të prerë midis situatës së këtyre anëtarëve dhe situatës së gjyqtarëve të gjykatave të rregullta. Një linjë e gjatë e vendimeve gjyqësore të GJEDNJ-së tregon se, edhe kur kundërvajtjet nuk klasifikohen si “vepra penale” brenda sistemit ligjor kombëtar, ato mund të quhen “vepra penale” në kontekstin e Konventës, nëse penalizimi i kundërvajtjeve u shërben qëllimeve parandaluese dhe ndëshkuese. Ky parim u dëshmuar qartë në rastin *Öztürk kundër Gjermanisë*, Aplikimi Nr. 8544/79, GJEDNJ (1984). Në këtë rast, Aplikuesi u akuzua për një shkelje të rregullave të komunikacionit dhe pastaj u penalizua me një gjobë të vogël (*shih po aty*, § 10–11). I pakënaqur me trajtimin e rastit të tij në nivelin kombëtar, ai dërgoi një ankesë tek GJEDNJ, duke pretenduar shkelje të nenit 6. Qeveria e Gjermanisë u përgjigj që neni 6 “nuk aplikohet në këto rrethana sepse z. Öztürk nuk ‘u akuzua për një vepër penale,’” por vetëm për një kundërvajtje (*po aty*, § 46). Sipas ligjeve gjermane, këto dy kategori janë juridikisht të ndara.

GJEDNJ hodhi poshtë plotësisht argumentin e Qeverisë. Gjykata konstatoi se, mes faktorësh të tjerë, “qëllimi i sanksionimit, duke qenë edhe parandalues edhe ndëshkues, [është] i mjaftueshëm për të dëshmuar se vepra në fjalë ishte, në termat e nenit 6 . . . të Konventës, e natyrës penale” (*id.*, § 53; theks i shtuar). Prandaj, edhe pse Aplikuesi nuk është akuzuar për “vepër penale” sipas klasifikimeve juridike të brendshme të Gjermanisë, ai megjithatë po përballej me “akuzë penale” brenda kuptimit të Konventës dhe prandaj kishte të drejtë të gëzonte mbrojtjet e nenit 6.

Në bazë të argumenteve të lartcekura, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës bashkë me kërkesën kryesore për shfuqizim të neneve të theksuara më lartë, i adresoi Gjykatës edhe kërkesë që kjo Gjykatë të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të dispozitave të kontestuara, përkatësisht, neni 55, paragrafët 4–5 dhe nenet 56–68 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje.

Rregullorja e Punës së Gjykatës Kushtetuese, Rregulli 55, paragrafi 4, përcakton tri kushte që duhet të përmbushen në mënyrë që masa e përkohshme të rekomandohet: (a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës; (b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe (c) masa e përkohshme është me interes publik. Të tria prej këtyre kushteve janë përmbushur në rastin konkret. Së pari, argumentet e parashtruara në këtë kërkesë japin baza më shumë se prima facie për shfuqizimin e dispozitave të kontestuara. Së dyti, në mungesën e masës së përkohshme, ka një rrezik substancial që, derisa kjo Gjykatë të arrijë vendimin e saj përfundimtar, funksionimi i “organeve të kundërvajtjes” të imponojë sanksione mbi persona të akuzuar, pa u dhënë këtyre personave qasje në një tribunal të pavarur. Në mënyrë që të shmanget funksionimi kushtetutshmërisht i dyshimtë i “organeve të kundërvajtjes”, është e domosdoshme që kjo Gjykatë të pezullojë menjëherë dispozitat e kontestuara. Së treti, është me interes publik që masa e përkohshme të miratohet. Gjykata duhet të sigurojë, të paktën gjatë periudhës në të cilën vendimi i tij është në pritje, që personat e akuzuar të mos u nënshtrohen procedurave të “organeve të kundërvajtjes”, të cilat janë kushtetutshmërisht të dyshimta.

Për këto arsye Avokati i Popullit konsideron se neni 55, paragrafët 4–5, dhe nenet 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, duhet të shfuqizohen dhe duhet të pezullohen menjëherë deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

14.2 Padi dhe kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.4, të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, më 7 prill 2017, ka iniciuar hetime me iniciativën e vet (*ex officio*) duke u bazuar në shkrimin e gazetës “Zëri”, të datës 7 prill 2017, me titull: “*KEDS-i na faturon 8 milionë euro në vit për rrymën e serbëve të veriut.*”. Më 4 maj 2017, Avokati i Popullit i ka drejtuar një letër ZRRE-së, me të cilën ka kërkuar informata, si në vijim: 1) Nëse vlera e energjisë që shpenzohet në veri të Kosovës është 8 milionë euro në vit dhe nëse kjo vlerë u shpërndahet nëpër fatura të qytetarëve në të gjithë Kosovën, ashtu siç është raportuar në shkrimin e gazetës “Zëri”; 2) Cilat janë dispozitat ligjore që përcaktojnë se çfarë janë “humbjet e arsyeshme të cilat janë jashtë ndikimit të operatorit” dhe nëse këto dispozita lejojnë faturimin e energjisë elektrike, pjesës tjetër të konsumatorëve, që janë konsumatorë të rregullt; dhe 2) Nëse përveç ligjeve në fuqi, ekziston ndonjë vendim i ZRRE-së, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik apo Qeverisë së Kosovës me të cilin rregullohet çështja e faturimit të rrymës në veri të Kosovës.

Më 18 maj 2017, ZRRE e ka njoftuar Avokatin e Popullit se sipas operatorëve të licencuar, energjia e pa faturuar në vitin 2016, në pjesën veriore të Kosovës, është 252 GWh, që përbën rreth 5.24% të kërkesës së shpërndarjes dhe se vlera e gjithmbarshme e energjisë së faturuar në veri të vendit është rreth 8 milionë euro. ZRRE ka shtuar se, duke

marrë parasysh se kjo vlerë është e pambuluar nga institucionet e Kosovës dhe duke mos pasur zgjidhje tjetër për të mbajtur sistemin elektroenergjetik në gjendje funksionale, ZRRE ka qenë e detyruar që kostot për mbulimin e humbjeve, duke përfshirë edhe humbjet në veri, t'i shpërndajë te të gjithë konsumatorët.

Sa i përket pyetjes së dytë, ZRRE i referohet nenit 48 [Miratimi i tarifave], paragrafi 3, pika 3.3, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.05/L-084 dhe nenit 28 [Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes], paragrafi 1, pikat prej 1.21 deri 1.25 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085. Sipas ZRRE, neni 48, paragrafi 3, pika 3.3 përcakton se ZRRE, gjatë miratimit apo caktimit të tarifave, do të sigurojë që të licencuarve t'iu mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme, duke përfshirë përveç tjerash edhe kostot e niveleve të humbjeve të energjisë në sistemet e transmetimit dhe të shpërndarjes. ZRRE më tej ka pretenduar se furnizimi me energji elektrike i të gjithë konsumatorëve është obligim ligjor, prandaj gjatë miratimit të tarifave, ZRRE merr në konsideratë një nivel të arsyeshëm të humbjeve, të cilat i trajton në mënyrë të barabartë në tërë territorin e Kosovës. ZRRE, për më shumë, ka theksuar se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) e ka të pamundur qasjen në veri të vendit dhe se humbjet që shkaktohen në veri të vendit nga OSSH konsiderohen si “humbje politike” që janë jashtë kontrollit të OSSH dhe se OSSH nuk mund të kryejë funksionet e veta për shkak të kostos së lartë të këtyre humbjeve, gjë që do të rrezikonte furnizimin e rregullt me energji elektrike në të gjithë vendin.

Në pyetjen e tretë të Avokatit të Popullit, ZRRE është përgjigjur se ka një vendim të datës 6 shkurt 2012, nr. V_399_2012 me të cilin përcaktohet niveli i reduktimit të humbjeve në shpërndarje. Sipas ZRRE, ky vendim për reduktim të humbjeve përcakton nivelin e reduktimit të të gjitha humbjeve në sistemin elektroenergjetik, duke përfshirë edhe humbjet në veri të Kosovës.

Avokati i Popullit pas shqyrtimit të rastit dhe analizës ligjore, më 13 qershor 2017 ka nxjerrë një Raport me Rekomandime ku ka identifikuar shkeljet dhe ka dhënë rekomandimet, si në vijim: a) ZRRE, urgjentisht, të ndalë praktikën e kundërligjshme të faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në veri të Republikës së Kosovës, tek konsumatorët në pjesën tjetër të vendit; b) Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me ZRRE-në dhe KEDS-in, të gjejë një mënyrë alternative për t'iu shmangur humbjeve në veri të vendit, duke trajtuar të gjithë konsumatorët në mënyrë të barabartë sipas normave kushtetuese dhe ligjore kundër diskriminimit; c) ZRRE-ja, në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, të nxjerrë një vendim, me anë të të cilit do të miratohej zbritja e tarifave deri në atë masë që do të mundësonte kompensimin e konsumatorëve, të cilët, padrejtësisht, janë faturuar, dhe vazhdojnë të faturohen, për energjinë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore.

ZRRE kundërshtoi gjetjet e Avokatit të Popullit lidhur me faturimin e energjisë elektrike në veri të vendit dhe nuk shprehu interesim për zbatim të rekomandimeve.

Avokati i Popullit duke u bazuar në nenin 10, paragrafi 2, të Ligjit për Konfliktet Administrative Nr.03/L-202 “*Organi i administratës, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesave publike mund të fillojnë konfliktin administrativ.*”; në nenin 17 i Ligjit për Konfliktet Administrative Nr.03/L-202 “*Në procedurën e konfliktit administrativ mund të kërkohet edhe kthimi i sendeve të marra, si dhe kompensimi i dëmit që i është shkaktuar paditësit me ekzekutimin e aktit që kontestohet.*”; Neni 18 i Ligjit për Konfliktet Administrative Nr.03/L-202 “*Paditës në konfliktin administrativ mund të jetë personi fizik, personi juridik, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesit publik, që konsideron se me aktin administrativ i është shkelur ndonjë e drejtë apo ndonjë interes i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i bazuar në ligj.*” Parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, ndaj Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), Prishtinë, për anulimin në tërësi të Vendimit të ZRRE-së V_399_2012, të datës 6 shkurt 2012; dhe që ZRRE të obligohet që të bëjë kompensimin e konsumatorëve të cilët faturohen për shpenzimin e energjisë elektrike në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës.

Në këtë rast Avokati i Popullit e konsideroi të domosdoshme që së bashku me padinë të kërkohet edhe aplikimi i masës së përkohshme, respektivisht shtyrjen e ekzekutimit të vendimit V_399_2012, të datës 6 shkurt 2012, deri në marrjen e një vendimi gjyqësor lidhur me padinë e paraqitur. Shtyrja e ekzekutimit të këtij vendimi u kërkua për shkak se: a) vazhdimi i ekzekutimit është në dëm të qytetarëve të Kosovës, sepse prek të drejtat e tyre të njohura ligjërisht; b) shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në dëm të interesit publik, përkundrazi vetë ekzekutimi i vendimit është në kundërshtim me interesin publik; dhe c) shtyrja e ekzekutimit nuk i sjell dëm të madh ZRRE-së, për shkak se sipas ZRRE-së, gjatë miratimit të tarifave, ajo merr në konsideratë një nivel të arsyeshëm të humbjeve, e të cilat i trajton në mënyrë të barabartë në tërë territorin e Kosovës. Përderisa po flitet për një nivel të arsyeshëm të humbjeve, nuk mund të thuhet se kemi të bëjmë me dëm të madh që mund t’i shkaktohet ZRRE-së.

14.3 Kërkesë për pezullimin e zbatimit të vendimit – Rasti Ex officio 551/2017

Avokati i Popullit, në bazë të neni 16.4 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, ka nisur hetimet *ex officio* rasti nr. 551/2017, përkitazi me ndryshimet e bëra në Ligjin për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës nr. 05/L-010 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2017 për Procedurat, Kushtet dhe Kriteret rreth Përfundimit të Administrimit të Pronave nën Administrimin dhe Atyre të Përfshira në Skemën e Qirasë të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Pezullimi i zbatimit të Vendimit Nr. 06/149 të datës 17 korrik 2017, të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me të cilin është miratuar Udhëzimi Administrativ nr. 07/2017 për Procedurat, Kushtet dhe Kriteret rreth Përfundimit të Administrimit të Pronave nën Administrimin dhe Atyre të Përfshira në Skemën e Qirasë të Agjencisë

Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, u kërkua për shkak se: a) vazhdimi i ekzekutimit të vendimit është në dëm të personave të zhvendosur nga Republika e Kosovës, sepse mund të cenohet të drejtat e tyre të njohura ligjërisht dhe me standarde ndërkombëtare; c) përfundimi i skemës së administrimit të pronave të personave të zhvendosur nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës pas skadimit të afatit prej tetëmbëdhjetë (18) muajve, të përcaktuar me nenin 21, paragrafi 7 të ligjit për AKKVP, mund të ketë ndikim negativ në pronat e personave të zhvendosur që aktualisht administrohen nga Agjencia. ç) në tetë muajt e parë, pothuajse gjysmën e afatit të përcaktuar me ligj (18 muaj), Agjencia nuk ka qenë operacionale dhe ka qenë në pamundësi që të angazhohet në çfarëdo detyre që ka të bëjë me njoftimin e pronarëve të pronave që aktualisht administrohen nga Agjencia. d) duke pasur parasysh procesin sfidues dhe të vështirë të njoftimit të personave të zhvendosur Avokatit i Popullit konsideron se afati kohor prej 18 muajve mund të jetë përgjithësisht tepër i shkurtër. Njoftimi i duhur është shumë i vështirë edhe nuk mund të garantohet madje as për periudhën e plotë kohore prej 18 muajsh, e lëre më sigurimi i njoftimit brenda “afatit optimal” siç përcaktohet me UA nr. 07/2017. Rrjedhimisht, kjo cenon të drejtën e përgjithshme për riposeditim.

Avokati i Popullit kërkoi që kërkesa për pezullim të ekzekutimit të vendimit të mbetet në fuqi deri në marrjen e një vendimi nga qeveria për çështjen e rregullimit ligjor të skemës së administrimit të pronave të personave të zhvendosur, nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

15. Aktivitetet e Institucionit të Avokatit të Popullit në fushën e promovimit për vitin 2017

Në tabelat vijuese janë elaboruar të dhënat statistikore të aktiviteteve të IAP të cilat janë realizuar gjatë vitit 2017. Tabela e parë paraqet aktivitetet në të dhëna numërore në cilësinë e një vjetari statistikor, të cilat IAP i ka organizuar me qëllim të promovimit edukimit dhe ngritjes së vetëdijes për të drejtat e njeriut. Ndërsa tabela e dytë tregon numerikisht pjesëmarrjen e IAP nëpër aktivitetet e organizuara nga institucione dhe organizata të ndryshme në vend.

Tabela 1.

Lloji i aktivitetit	Qëllimi i aktivitetit	Zyrat e Avokatit të Popullit	Nr. i aktiviteteve
Tryeza, Konferenca, Trajnime të organizuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2017	Promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; Promovimi i mandatit të IAP; Edukimi dhe ngritja e vetëdijes për të drejtat e njeriut tek institucionet përgjegjëse për zbatimin e standardeve kushtetuese dhe ligjore në vend.	Zyra qendrore në Prishtinë	55
		Zyra regjionale në Prizren	1
		Zyra regjionale në Gjiilan	5
		Zyra regjionale në Pejë	2
		Zyrat regjionale në Mitrovicë	8
		Zyra regjionale në Ferizaj	8
		Zyra regjionale në Gjakovë	16
		Zyra regjionale në Graçanicë	4

Tabela 2.

Lloji i aktivitetit	Qëllimi i aktivitetit	Zyrat e Avokatit të Popullit	Nr. i aktiviteteve
Pjesëmarrja e IAP në Tryeza, Konferenca, Trajnime dhe aktivitete tjera organizuar nga Institucione dhe organizata të ndryshme në vend, gjatë vitit 2017	Promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; Promovimi i mandatit të IAP; Edukimi dhe ngritja e vetëdijes për të drejtat e njeriut tek institucionet përgjegjëse për zbatimin e standardeve kushtetuese dhe ligjore në vend.	Zyra qendrore në Prishtinë	160
		Zyra regjionale në Prizren	6
		Zyra regjionale në Gjiilan	7
		Zyra regjionale në Pejë	
		Zyrat regjionale në Mitrovicë	5
		Zyra regjionale në Ferizaj	5
		Zyra regjionale në Gjakovë	16
		Zyra regjionale në Graçanicë	12

16. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Avokati i Popullit, duke vlerësuar lartë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar, në Strategjinë dhe Planin Zhvillimor të Institucionit të Avokatit të Popullit, për periudhën 2017 – 2019, ka përcaktuar qartë se një nga prioritetet me rëndësi për Institucionin e Avokatit të Popullit është edhe avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimi i praktikave më të mira për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.²⁷⁰

Si një mekanizëm i vetëm kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës, në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare në vend dhe përmes bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, në vazhdimësi ka kërkuar të mobilizojë të gjithë faktorët e rëndësishëm për të zbatuar së bashku aktivitetet dhe për të imponuar të drejtat e njeriut si prioritet në kontekstin social dhe si një nga parakushtet për zhvillim të një shoqërie demokratike.

Megjithatë, meqë Republika e Kosovës ende nuk është anëtarësuar në Kombet e Bashkuara, Institucioni i Avokatit të Popullit e ka të kufizuar mundësinë për të kontribuar në sistemin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, për shkak të barrierave politike, mirëpo, si institucion i pavarur kushtetues është i përkushtuar që të veprojë si urë lidhëse për shkëmbimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut dhe të kontribuojë aty ku ka mundësi, por edhe të përgatis kapacitetet e tij, që në një të ardhme, kurdo që të ndodh anëtarësimi, të jetë në gjendje të marrë përsipër obligimet e veta në kuadër të sistemit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Pavarësisht kësaj, Avokati i Popullit nuk e sheh institucionin që ai drejton, duke vepruar në izolim nga pjesa tjetër e botës. Mirëpo, pikërisht ashtu siç kanë bërë shumë kërkesat dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për të përmirësuar kornizën e brendshme ligjore të Kosovës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, beson se duke intensifikuar bashkëpunimin midis Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ) mund të arrijmë së bashku më shumë për qytetarët tanë dhe për kauzën e të drejtave të njeriut në përgjithësi, sesa mund të arrijmë vetëm.

Në këtë kontekst, më 14 nëntor 2017, Avokati i Popullit u dërgoj letër rrjeteve të Ombudsmanëve dhe Institucioneve për të Drejtat e Njeriut me kërkesë dhe propozime që së bashku të marrim hapa konkret drejt zhvillimit të një sërë standardesh të unifikuar dhe praktikave më të mira për IKDNJ në mbarë botën, të cilat mund të shërbejnë si burim i këshillave të dobishme dhe jo të detyrueshme për të udhëhequr punën e IKDNJ.

Në këtë letër iu propozua IKDNJ-ve, të trajtohet çështja e standardeve ndërkombëtare për refugjatët, duke konsideruar krizën aktuale me të cilën shumë vende janë përballur ose do të përballen së shpejti me fluks masiv të emigrantëve që kërkojnë statusin e refugjatëve. Tashmë ekzistojnë standarde ndërkombëtare, të përcaktuara në Konventën e 1951 për Statusin e Refugjatëve dhe Protokollin e 1967, këto standarde edhe pse mund të jenë thelbësore duhet të specifikohen më tej për t'i sjellë ato të përditësuara me krizën e

²⁷⁰ http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/296-2017,_Strategjia_finale_shqip_272523.pdf

tanishme globale të refugjatëve. Gjithashtu, duke qenë se refugjatët janë ndër popullatat më të rrezikuara në botë dhe duke pasur parasysh se veprimet dhe politikat e çdo vendi kanë mundësi të kenë implikime domethënëse për vendet fqinje, është me rëndësi të madhe që IKDNJ të zhvillojnë standarde konsistente për trajtim adekuat të refugjatëve. Në këtë rastë, IKDNJ mund të punojnë drejt hartimit të standardeve specifike për zbatimin e parimit të "non-refoulement" të përcaktuar në nenin 33, paragrafin 1 të Konventës. Gjithashtu, mund të punojmë drejt zhvillimit të standardeve në bazë të koncepteve dhe parimeve që nuk përmenden shprehimisht në Konventën e vitit 1951 ose në Protokollin e vitit 1967, por që janë bërë më të rëndësishme dhe më të përhapura në diskursin e të drejtave të njeriut që nga koha e ratifikimit të Konventës dhe Protokollit. Përgjatë këtyre linjave, propozimi ishte që IKDNJ-të së bashku të hartojnë rregulla lehtësisht të zbatueshme dhe të monitorueshme, që mund të sigurojnë, për aq sa është e mundur, që refugjatët të trajtohen me *dinjitet* gjatë gjithë procesit të aplikimit për azil. Zhvillimi i standardeve të unifikuara për të drejtat e njeriut, të dakorduara nga IKDNJ në mbarë botën, do të ofronte standarde të qarta dhe publike përmes të cilave veprimet qeveritare në këtë fushë mund të vlerësohen dhe, nëse është e nevojshme, të kritikohen për arsye të të drejtave të njeriut.

IKDNJ gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e institucioneve të tjera shtetërore në lidhje me praktikën e tyre administrative, duke gëzuar një mandat specifik për të luftuar "keqadministrimin". Megjithatë, nuk ekzistojnë standarde të unifikuara për të përcaktuar se çfarë saktësisht përbën keqadministrim. Në mënyrë të ngjashme mungojnë edhe udhëzimet se si të luftohet në mënyrë efektive keqadministrimi. Prandaj, përveç bashkëpunimit për një sërë standardesh të unifikuara për këto çështje, IKDNJ gjithashtu mund të ndërmarrin hapa drejt ndërtimit të një "baze të dhënash" të opinionëve dhe raporteve të lëshuara nga IKDNJ në mbarë botën. Këto opinione dhe raporte mund të përfshijnë modele për mënyrën e reagimit ndaj llojeve të caktuara të rasteve, por gjithashtu mund të përfshijë mendime *ad hoc* të hartuara për tema kyçe. Si model i dobishëm, në këtë drejtim mund të shërbejnë opinionet e Komisionit të Venecias.

Këto propozime u mirëpritën nga IKDNJ, duke u konsideruar si propozime me interes. Ndërsa, u konfirmua që Asociacioni i Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM)²⁷¹ ka planifikuar që këto propozime të diskutohen më gjërësisht në Asamblen Gjenerale e cila do të mbahet në Maqedoni në maj të vitit 2018.

Gjithashtu, IAP ka vazhduar të kontribuoj përmes takimeve në të cilat ka marrë pjesë dhe ka pasur bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë me institucione homologe, rrjete dhe organizata të tjera ndërkombëtare për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

Pjesëmarrja në takimet e paraqitura më poshtë, ka shërbyer në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe rrjetizimin e tij në arenën ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

²⁷¹ Për më shumë informata rreth Asociacionin e Ombudsmanëve të Mesdheut, vizitoni këtë uebfaqe: www.ombudsman-med.org

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Data
1.	Konferenca e Parë Ndërkombëtare, me titull “Seksualiteti dhe Rinia në Shqipëri- Konteksti kulturor, Sjelljet dhe Media” Tiranë, Shqipëri	11 - 12 shkurt 2017
2.	Takimi i Ombudsmanëve dhe Komisionereve për Lirinë e Shprehjes Berlin, Gjermani	22 - 24 shkurt 2017
3.	Fourth International Symposium on Ombudsman Institutions on “Migrations and Refugees” Ankara, Turqi	2 - 3 mars 2017
4.	Takimi vjetor i Aleancës Botërore për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (GANHRI) Gjenevë, Zvicër	6 - 8 mars 2017
5.	Simpoziumi vjetor Robert L. Bernstein për të drejtën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut me temën “Religjioni dhe të drejtat e njeriut” Konektikat, SHBA	23-24 mars 2017
6.	Akademia e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut Poznan, Poloni	29 maj – 2 qershor 2017
7.	Konferenca me temën “ Mbrojtja e të drejtave të njeriut- Sfidat dhe mundësitë e mekanizmave me shumë mandate” Zagreb, Kroaci	11 – 12 maj 2017
8.	Seminar për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të reja me mandat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve Sofie, Bullgari	16 - 17 maj 2017
9.	Takimi i Rrjetit të MKT-ve të Evropës Juglindore me temën” Trajtimi i Personave me Aftësi të Kufizuara në Ndalim” Beograd, Serbi	25 – 26 maj 2017
10.	Takimi me temën “ Të drejtat e njeriut dhe menaxhimi i krizës së migrimit në vitet 2015-2016” Athinë, Greqi	29 – 30 maj 2017
11.	Takimi i Mekanizmave për Parandalimin e Torturës (MKT) me qëllim diskutimit lidhur me hartimin e Rregullorës Evropiane për Emigrantët në ndalim dhe takimit me Observatorët e Rinj të MKT-ve Strasburg, Francë	31 maj – 1 qershor 2017
12.	Kurs trajnues lidhur me edukimin në të drejtat e njeriut Sarajevë, Bosnje	12 – 14 qershor 2017
13.	Konferenca e përbashkët e Këshillit të Evropës dhe UNHCR për të drejtat ekonomike dhe sociale të personave të zhvendosur	27 - 28 qershor 2017

	Sarajevë, Bosnje	
14.	ENNHRI- takimi i grupit punues për komunikim Paris, Francë	4 – 5 korrik 2017
15.	Konferenca me temë “ Mbrotja shendetësore në burgje dhe institucione psikiatrike” Podgoricë, Mali i Zi	5 - 6 korrik 2017
16.	Vizitë zyrtare tek Avokati i Popullit në Shqipëri Tiranë, Shqipëri	11 korrik 2017
17.	Trajnimi 10 ditor për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve Hagë, Mbretëria e Holandës	13 – 22 shtator 2017
18.	Konferenca e katërt për Ambientin dhe të Drejtat e Njeriut: Pjesëmarrja publike në çështje ambientale Lubjanë, Slloveni	15 shtator 2017
19.	Konferenca Ndërkombëtare për Komisionerët e Informimit 2017 Manchester, Britani e Madhe	19 – 21 shtator 2017
20.	Konferenca Ndërkombëtare e Stambollit për Ombudsmanët Stamboll, Turqi	25 – 26 shtator 2017
21.	Trajnim i kombinuar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore Riga, Latoni	25 – 29 shtator 2017
22.	Vizit Studimore tek Ombudsmeni i Austrisë Vjenë, Austri	4 – 6 tetor 2017
23.	Konferenca e Nëntë Vjetore e Institucioneve të Ombudsmanëve për Forcat e Armatosura, me temën “ Kompas Moral i Forcave të Armatosura: Si mund të theyejnë barrierat Institucionet e Ombudsmanëve për të arritur ndryshimet” Londër, Mbretëria e Bashkuar	8 – 10 tetor 2017
24.	ENNHRI Takim i Grupit Punues mbi Azilin dhe Migracionin	17 – 18 tetor 2017
25.	AOM Trajnim mbi temen e “Deontologjia e forcës së sigurisë dhe të drejtat e emigranteve: roli i institucioneve të Ombudsmanëve”	18 – 19 tetor 2017
26.	Seminar mbi zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe garancionet ligjore për mbrojtjen kundër diskriminimit, Tiranë, Shqipëri	26 – 28 tetor 2017
27.	Punëtorja për përkrahjen e zhvillimit të planit të veprimit për reagim të perbashkët të shoqërisë civile ndaj diskriminimit në Kosovë; Budva, Mali i Zi.	30 tetor – 1 nëntor 2017

28.	Konferencen Regjionale për NPM e shteteve të prekura nga kriza e refugjateve të Kosovës: Shqipëria, Kosova, Serbia dhe Mali i Zi; Tema: "Integrimi i refugjateve Kosovar, zgjidhje të qëndrueshme dhe kthim vullnetar", Shkup, Maqedoni	20 – 21 nëntor 2017
29.	Asambleja e Përgjithshme Vjetore e Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, Bruksel, Belgjikë	29 – 30 nëntor 2017
30.	Konferenca Regjionale mbi matjen e barazise gjinore në Ballkanin Perëndimor, Danilograd, Mal të Zi	1 dhjetor 2017
31.	Konferenca Vjetore e Terre des Hommes në kuadër të projektit "Qendra Rajonale e Burimeve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Evropën Juglindore (www.childhub.org)"; Tema: 'Mekanizmat kualitativ në mbrojtjen e fëmijëve', Tiranë, Shqipëri	5 – 6 dhjetor 2017
32.	Takimi i Rrjetit të NPM në Evropën Juglindore, "Metodologjia e vizitave parandaluese në vendet e paramburgimit", Beograd, Serbi	12 – 13 dhjetor 2017

Tabela: Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare

16.1 Bashkëpunimi me homolog dhe organizata të tjera ndërkombëtare

Bashkëpunimi me homolog dhe organizata të tjera ndërkombëtare në Kosovë është një element i rëndësishëm i punës së Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP). Kemi kënaqësinë të raportojmë që bashkëpunimi me homologë nga vende të ndryshme, me rrjete dhe organizata ndërkombëtare jashtë vendit dhe ato që janë me mision në Kosovë, është jashtëzakonisht i mirë. Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë realizuar një sërë aktivitete, të cilat janë të elaboruara më poshtë.

Në sesionin parapak u raportua që IAP gjatë vitit 2017 ka marrë pjesë në 32 aktivitete të ndryshme ndërkombëtare. Pjesëmarrja në këto aktivitete ka qenë edhe mundësi e mirë e shkëmbimit të informatave dhe praktikave më të mira, në mënyrë që të njëjtat të fillojë t'i zbatojë edhe në Kosovë.

Vlen të përmendet që Avokati i Popullit mori pjesë në Konferencën IV-të Ndërkombëtare mbi Mjedisin dhe të Drejtat e Njeriut "Pjesëmarrja e Publikut në çështje ambientale", e cila është mbajtur në Lubjanë të Sllovenisë. Konferenca është mbajtur nën patronatin e Presidentit të Republikës së Sllovenisë, që kishte për qëllim të identifikojë angazhimin e shteteve në respektimin e të drejtës për të jetuar në një ambient të shëndetshëm, me theks të veçantë pjesëmarrjen e publikut në draftimin dhe miratimin e rregulloreve për mjedisin, si dhe sa ato përmbushin parimet e transparencës, saktësisë dhe qasshmërisë.

Në këtë Konferencë, Ombudsmanët nga Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia, Sllovenia dhe Serbia, kanë nënshkruar Deklaratën mbi bashkëpunimin e Ombudsmanëve në fushën e mjedisit dhe të drejtave të njeriut, duke vënë në dukje se e drejta për të jetuar në një ambient të shëndetshëm është e drejtë

fundamentale dhe se shtetet duhet të përpiqen që masat e ndërmarra të jenë në funksion të respektimit të kësaj të drejte.

Po ashtu, duke pasur parasysh rolin e Ombudsmanëve për të pranuar dhe trajtuar kërkesa që kanë të bëjnë me çështje mjedisore, të cilat afektojnë jo vetëm shtetet përkatëse, por edhe shtetet në fqinjësi e më tej në kontekstin global, si dhe duke theksuar se pjesëmarrja e publikut për çështje mjedisore është nën nivelin e dëshirueshëm, nënshkruan themelimin e Rrjetit të Ombudsmanëve për Mjedis dhe të Drejta të Njeriut. Ky rrjet do të ketë për qëllim bashkëpunimin e ngushtë, shkëmbimin e njohurive, praktikave dhe përvojave, zhvillimin e formave në të cilat Ombudsmanët do t'i përgjigjeshin sfidave mjedisore, në përmbushje të mandatit që kanë.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare me temë "Përmirësimi i të drejtave të njeriut në Evropë: Si të rritet hapësira demokratike" ("Reclaiming Human Rights in Europe: How to Enhance Democratic space"), e cila u mbajt më 11 dhe 12 maj 2017 në Zagreb, me rastin e 25 vjetorit të themelimit të Institucionit të Ombudsmanit të Kroacisë. Në qendër të diskutimeve gjatë dy ditëve sa zgjati Konferenca ishin tema që momentalisht po e shqetësojnë Evropën, si: luftimi i terrorizmit, integrimi dhe respektimi i dallimeve, luftimi i diskriminimit, ruajtja e demokracisë në Evropë etj. Në përmbyllje të punimeve të Konferencës u nënshkrua edhe Deklarata e Zagrebit me qëllim që të përkujtoj rolin dhe përkushtimin e institucioneve të ombudsmanëve në nivel kombëtar, si dhe nëpërmjet rrjeteve të IOI, ENNHRI dhe Equinet.

Gjatë këtij viti është realizuar edhe një vizitë studimore tek Ombudsmani i Austrisë, që kishte në fokus shkëmbimin e praktikave të mira ndërkombëtare duke iu referuar mandatit shtesë të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Gjithashtu, është zhvilluar një vizitë zyrtare tek Avokati i Popullit të Shqipërisë, me rastin e marrjes së mandatit të ri të Avokatit të Popullit të Shqipërisë, znj. Erinda Ballanca, e që gjithashtu, kishte qëllim thellimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve dhe çështje të tjera të ndërlidhura me mandatin dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi.

Bashkëpunim i mirë ekziston edhe me institucione të tjera homologe në rajon dhe më gjërë, me të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës është në komunikim të përhershëm për çështje të interesit të përbashkët.

16.2 Projektet me mbështetje të organizatave ndërkombëtare

Edhe gjatë vitit 2017, Institucioni i Avokatit të Popullit i kushtoi vëmendje të veçantë koordinimit të aktiviteteve me organizatat ndërkombëtare në vend me qëllim të fuqizimit të institucionit, promovimit të të drejtave të njeriut dhe ngritjes së besueshmërisë së qytetarëve ndaj Avokatit të Popullit, si i vetmi mekanizëm kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës.

Në këtë kontekst IAP ka vazhduar bashkëpunimin me Komisionin Evropian, Këshillin e Evropës, OSBE-në, UNICEF-in, UNMIK-un dhe shumë organizata të tjera që veprojnë në vend, me qëllim të zbatimit të projekteve të ndryshme në lidhje me promovimin, mbrojtjen dhe edukimin e të drejtave të njeriut, të cilët kanë dhënë ndihmë të pakursyer për fuqizimin e institucionit, ngritjen e kapaciteteve të tij dhe promovimin e mandateve.

Një nga këto organizata është padyshim edhe Këshilli i Evropës, i cili vite me radhë ka ndihmuar institucionin në fuqizimin e rolit dhe mandatit, si dhe në ngritjen e kapaciteteve. Këtë vit ka ndihmuar institucionin me projektin "Forcimi i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin në Kosovë", i mbështetur nga Këshilli i Evropës, Qeveria e Zvicrrës dhe Qeveria e Norvegjisë. Nëpërmjet këtij projekti synohet të ngriten kapacitetet e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), i themeluar në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit për të zbatuar standardet ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit dhe për të rritur ndërgjegjësimin e aktorëve përkatës mbi rolin dhe mandatin e MKPT. Në fazën fillestare të projektit është angazhuar një ekspert i Këshillit të Evropës me përvojë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave të privuar nga liria, me qëllim të vlerësimit të nevojave të mëtutjeshme të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT). Në kuadër të projekti është realizuar një trajnim për monitorimin e kujdesit shëndetësor në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Më tej, janë realizuar tri tryeza të rrumbullakëta një ditore si në: Prizren, Gjilan dhe Pejë me qëllim të njoftimit të Institucioneve për mandatin dhe detyrat e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Gjithashtu janë rekrutuar 4 këshilltarë të jashtëm ligjor. Të gjitha këto aktivitete kanë pasur ndikim të qëndrueshëm në ngritjen e performancës dhe realizimit më të mirë të mandatit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Vlen të theksohet se si rezultat i bashkëpunimit shumë të mirë me Komisionin Evropian, e arritur e suksesshme e IAP për këtë vit, është edhe shtytja e procesit me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Kjo çështje është përfshirë në Marrëveshjen e Financimit ndërmjet Kosovës dhe Komisionit Evropian për Programin e Veprimit për Kosovën për vitin 2016, Pjesa II, Buxheti i Sektorit për Mbështetje në kuadrin e IPA II, për Reformën e Administratës Publike (PAR SBS) përmes treguesit (indiktorit) nr. 7, i cili parashikon që deri në vitin 2020, zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet e nivelit qendrorë të arrijë jo më pak se 60%. Kjo marrëveshja ka hyrë në fuqi më 15 dhjetor 2017.

Ndërsa, edhe këtë vit, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), si në të kaluarën, e mbështeti IAP me disa aktivitete. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, janë realizuar disa tryeza vetëdijuese me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë, të cilat e kanë ndihmuar institucionin në promovimin e mandateve të reja të cilat kanë dalë si rezultat i miratimit të pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut, duke përfshirë Ligjin për Avokatin e Popullit, Ligjin për Barazi Gjinore dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe promovimi i platformës "Know your rights" (Njih të Drejtat Tua)

dhe mundësinë e përdorimit të saj nga të rinjtë. Këto tryeza janë realizuar në këto komuna të Republikës së Kosovës: Komuna e Prishtinës (7 dhe 8 gusht), Komuna e Prizrenit (8 gusht), Komuna e Mitrovicës (9 gusht), Komuna e Gjakovës (10 gusht), Komuna e Ferizajit (11 gusht).

Gjithashtu, në kuadër të këtij bashkëpunimi, nga OSBE ka vazhduar fushata promovuese nëpërmjet video spotit të lansuar në televizionin publik, e cila kishte për qëllim promovimin e Ligjit për Avokatin e Popullit, Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligjit për Barazi Gjinore.

Për më shumë, OSBE në kuadër të projektit “Promovimi i sektorëve ligjorë dhe të drejtësisë që respektojnë të drejtën për barazi para ligjit, pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, religjioni apo karakteristikat e tjera personale” ka mbështetur IAP në zhvillimin e web faqes të IAP dhe platformës “online”. Platforma është dizajnuar në mënyrë që të ofrojë qasje gjithëpërfshirëse ndërinstitucionale ku do të paraqiten raporte dhe rekomandime nga organizatat e shoqërisë civile që punojnë dhe kontribuojnë për të drejtat e njeriut në Kosovë.

Një bashkëpunim shumë i mirë ka vazhduar me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë, të cilët kanë mundësuar zhvillimin e platformës “Know your rights” (Njih të Drejtat Tua) dhe gjithashtu kanë vazhduar të mbështesin IAP në promovimin e kësaj platforme. Kjo është një platformë online, me të cilën Institucioni i Avokatit të Popullit ka për qëllim të promovojë të drejtat e të rinjëve të moshës 16-29 vjeçare, sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë. Platforma ofron udhëzime për disa nga të drejtat në fushët e arsimit, shëndetësisë, komuniteteve jo shumicë, punësimit, familjes, sistemit të drejtësisë, punës në komunitet, përfitimet sociale, dhe fuqizimit të rinisë. Përshkrimet e të drejtave janë të shoqëruara me një hartëzim të institucioneve që janë përgjegjëse për zbatimin e të drejtave, si dhe ato në të cilat të rinjtë mund të drejtojnë ankesat në rast të shkeljes së të drejtave të tyre.

Në kuadër të promovimit dhe me qëllim të riaktualizimit të platformës “Know your rights” (Njih të Drejtat Tua), më 18 prill 2017, IAP në bashkëpunim me UNICEF organizoi ngjarjen, në të cilën morën pjesë përfaqësues të institucioneve publike, OJQ-ve dhe të rinjë të përfshirë në aktivitete promovuese për të drejtat e njeriut.

Gjithashtu në kuadër të këtij bashkëpunimi, nga UNICEF është realizuar edhe një fushatë promovuese, përmes një TV spoti e cila kishte për qëllim promovimin e platformës “Know your rights” (Njih të drejtat tua). Kjo fushatë u lansua me 18 tetor 2017 dhe u transmetua në televizion gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017.

Ndërsa, as këtë vit nuk ka munguar bashkëpunimi dhe mbështetja nga UNMIK-u në promovimin e IAP duke financuar një fushatë mediale nëpërmjet debateve televizive (në televizionet që veprojnë në pjesën e Mitrovicës Veriore), publikimin dhe shpërndarjen e broshurave, me qëllim të informimit të qytetarëve të Mitrovicës Veriore rreth të drejtave

të njeriut, rolin dhe mandatin e IAP. Kjo mbështetje ka ndikuar pozitivisht në informimin e qytetarëve ku vërehet ngritje e numrit të ankesave në IAP nga qytetarët e kësaj pjese.

IAP falënderon Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, zyrat dhe organizatat e tjera ndërkombëtare të cilat e kanë mbështetur IAP në sfidat dhe problemet me të cilat është përballur, por edhe i kanë dalë në ndihmë sa herë që është konsideruar e nevojshme. Avokati i Popullit shpreh mirënjohje dhe vlerëson lartë këtë bashkëpunim.

16.3 Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare

Anëtarësimi në mekanizma që merren me të drejtat e njeriut është një mjet i rëndësishëm në punën e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut dhe ka ndikim të jashtëzakonshëm në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ofron mundësi të shkëmbimit të praktikave më të mira në fushën e të drejtave të njeriut.

IAP, siç është raportuar edhe në raportin vjetor të vitit të kaluar, është i anëtarësuar në këta mekanizma ndërkombëtar:

- Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI)²⁷²
- Instituti Evropian i Ombudsmanëve (EOI)²⁷³
- Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI)²⁷⁴
- Rrjeti i Ombudsmanëve për Fëmijë i Evropës Juglindore (CRONSEE)
- Asociacionin e Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësve të Frankofonisë (AOMF)²⁷⁵
- Asociacionin e Ombudsmanëve të Mesdheut(AOM)²⁷⁶
- Aderues në *Deklaratën e Sarajevës për bashkëpunim*²⁷⁷

Ndërsa, më 15 shtator 2017, në Lubjanë, Slloveni, u nënshkrua nga Ombudsmanët e rajonit (Bosna dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia, Sllovenia dhe Serbia) themelimi i Rrjetit të Ombudsmanëve për Mjedis dhe të Drejta të Njeriut, ku nga ai moment IAP u bë edhe anëtarë i këtij rrjeti.

IAP gjithashtu ftohet dhe merr pjesë edhe në aktivitete të disa mekanizmave dhe rrjeteve të tjera, në të cilat për shkak të barrierave politike është vetëm anëtar vezhgues, si në:

²⁷² Për më shumë informata rreth Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve, vizitoni këtë uebfaqe: www.theioi.org

²⁷³ Për më shumë informata rreth Institutit Evropian të Ombudsmanëve, vizitoni këtë uebfaqe: www.eoi.at

²⁷⁴ Për më shumë informata rreth Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, vizitoni këtë uebfaqe: www.ennhri.org

²⁷⁵ Për më shumë informata rreth Institutit Evropian të Ombudsmanëve, vizitoni këtë uebfaqe:

<http://www.aomf-ombudsmans-francophonie.org/>

²⁷⁶ Për më shumë informata rreth Asociacionin e Ombudsmanëve të Mesdheut, vizitoni këtë uebfaqe: www.ombudsman-med.org

²⁷⁷ Kjo deklaratë ka formalizuar bashkëpunimin dhe aktivitetet e të gjitha institucioneve të Ombudsmanëve në regjion. Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë e ka nënshkruar këtë Deklaratë me datën 4 prill 2014.

- Aleanca Botërore për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut- GANHRI (nga e cila bëhet shqyrtimi i pajtueshmërisë së IKDNJ-ve me Parimet e Parisit)
- Rrjeti Evropian i Ombudspersonëve për Fëmijë- ENOC
- Rrjeti i Mekanizmave Kombëtar për Parandalimin e Torturës të Evropës Juglindore- SEE NPM (në kuadër të të cilit IAP, merr pjesë në takime të ndryshme që kanë për qëllim bashkëpunimin, promovimin dhe shkëmbimin e përvojës, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave të privuar nga liria).

16.4 Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtar

IAP çdo vit pranon pyetësor të tematikave të ndryshme nga organizata ndërkombëtare për të raportuar për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Edhe këtë vit janë dërguar pesë pyetësor të cilët janë të listuar në tabelën e mëposhtme.

Data	Tema e raportit/hulumtimit	Organizata/institucionit të cilit i është dërguar raporti
13 prill 2017	Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës	ENNHRI
2 maj 2017	Fëmijët e privuar nga liria	European Inter-University Center for Human Rights and Democratisation
3 maj 2017	Migracioni dhe Ligji Migracioni Ekonomik në Kosovë	Banka Botërore
15 maj 2017	Alternativat e ndalimit në kontekstin e migracionit	Këshilli i Evropës, Komiteti drejtues për të drejtat e njeriut
4 shtator 2017	Roli, aktivitetet dhe përvoja e IKDNJ në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve	GANHRI - UNICEF
8 gusht 2017	Roli i Ombudsmanëve mbi fuqizimin e qeverisë së hapur	OBEZH – Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
11 gusht 2017	OIK comments on Joan Barata’s report on “How to strengthen soft powers for press freedom: National Human Rights Institutions”	Këshilli i Evropës

Tabela: Lista e raporteve të derguara në organizata ndërkombëtare

17. Komunikimi me publikun dhe mediat

Në përmbushje të përgjegjësisë dhe obligimeve që ka, si dhe duke ndjekur objektivat e përcaktuara me Strategjinë e Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Mediat 2016 – 2018, Zyra për Komunikim me Publikun dhe Mediat ka fokusuar punën në rritjen e transparencës, informimin e vazhdueshëm dhe proaktiv, me qëllim ngritjen e vetëdijes

përkitazi me të drejtat dhe liritë e garantuara në Republikën e Kosovës, si dhe mbi rolin e mandatin që ka Avokati i Popullit brenda strukturës institucionale në vend.

Në funksion të transparencës, IAP ka shpërndarë në format elektronik, në përfaqësim të 20 000 e-mail-a të zyrtarëve të autoriteteve publike, të nivelit qendror dhe lokal, si publikime të veçanta:

- Raportin vjetor 2016
- Raportin e parë të MKPT-së
- Përmbledhjen e raporteve gjatë vitit 2016
- Përmbledhjen e raporteve gjatë vitit 2015

Në rutinën e punës që bën Avokati i Popullit dhe në pajtim me mandatin dhe përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore që ka, janë lansuar për publikun 46 Raporte, prej tyre: 20 Raporte mbi rastet, 13 Raporte Ex Officio, 1 Raport i veçantë dhe 12 Raporte të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT). Plasimi i tyre, i shpërndarë statistikisht sipas muajve, duket si në Tabelën 1:

Tabela 1. 46 Raporte/ opinione/Amicus Curiae të publikuara në ueb faqen zyrtare, sipas muajve

2017	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Raportet mbi rastet			1			3			1	3		12
Raportet Ex Officio	3				3	1		1	3	1	1	
Raporte të veçanta			1									
Raporte të MKPT		6	1			1		1		3		

Këto Raporte janë publikuar në ueb faqen zyrtare të IAP-së, të përcjella me informatë përmbledhëse. Më tej, Raportet dhe informatat janë përcjellë tek mediat dhe janë shpërndarë, po ashtu, përmes faqes zyrtare dhe profilit të IAP në rrjetin social Facebook.


Po ashtu, në periudhën raportuese 1 janar – 31 dhjetor 2017, nëpërmjet web faqes zyrtare të IAP-së, si dhe nëpërmjet postës elektronike dhe faqes e profilit të IAP-së në rrjetin social Facebook, janë shpërndarë edhe informata e njoftime të tjera lidhur me aktivitete dhe angazhime të Avokatit të Popullit. Numri i përgjithshëm i tyre arrin në 79. Të shpërndara në numra, sipas muajve, duken si në Tabelën 2.

Tabela 2. 79 informata/deklarata/njoftime të publikuara në ueb faqe, sipas muajve

2017	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
	4	5	3	9	8	6	3	2	10	7	9	13
Totali	79 informata/deklarata/njoftime/lajme											

Të dhënat lidhur me audiencën e ueb faqes, në periudhën janar - dhjetor 2017, tregojnë se faqja është parë (vizituar) afro 148 000 (njëqind e dyzet e tetë mijë) herë, që, krahasuar me vitin e kaluar, do të thotë se këtë vit ajo është vizituar 45000 (dyzet e pesëmijë) herë më shumë. Numri i përdoruesve (vizitorëve) shkon në 22 158 (njëzet e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë), që po ashtu shënon rritje në krahasim me vitin e kaluar për mbi 4000 (katër mijë) vizitor. Nga numri i përgjithshëm i vizitorëve të faqes, 41 % kanë klikuar për herë të parë ueb faqen e IAP-së, përderisa 59% e vizitorëve i janë rikthyer ueb faqes zyrtare të IAP-së (shih të dhënat nga brendia e ueb-faqes në Tabelën 3)

Tabela 3. Të dhëna nga brendia e ueb faqes për numrin e vizitave dhe përdoruesve



Duke pasur prioritet informimin e saktë dhe të shpejtë, Avokati i Popullit ka realizuar 189 paraqitje mediale, në radio dhe televizione, portale elektronike dhe shtypin e shkruar. Në këtë numër të paraqitjeve mediale të Avokatit të Popullit dhe stafit të IAP-së nuk përfshihet shpërndarja apo afishimi i mëtejme i të njëjtave, ashtu siç nuk përfshihen edhe rastet kur mediat i janë referuar qëndrimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit, goftë në mediat tradicionale apo në ato të reja.

Tabela 4. liston shpërndarjen e paraqitjeve mediale sipas medimeve, bazuar në kërkesa të mediave dhe gazetarëve për prononcime, intervista, emisione të hapura për pyetje të qytetarëve, debate e të tjera. Duhet theksuar se prezenca e vazhdueshme, në rritje, e Avokatit të Popullit në media, të shumtën e herave vjen si rrjedhojë e mënyrës proaktive të ndërveprimit IAP – media dhe efektit që kanë pasur për interesin e publikut kryesisht raste të trajtuara nga IAP, apo aktivitetete ku Avokati i Popullit ka prezantuar qëndrimet e tij.

Tabela 4. 189 paraqitje mediale, të shpërndara sipas medimeve

PARAQITJE MEDIALE TË IAP-së, TË SHPËRNDARA SIPAS MEDIUMEVE			
Agjencia e Lajmeve KosovaLive	4	Portali Gazeta e re	3
Agjencia e Lajmeve kosovapress	3	Portali Lajmi.net	3
Aljazeera Balkans	1	Radio Evropa e lire	4
Betimi për Drejtësi	4	Radio Gjakova	1
BIRN/Kallxo.com/Jetan'Ks/Drejtësia n'Ks	11	Radio gjermane ARD	1
Gazeta Bota sot	2	Radio Romano Avazo Prizren	1
Gazeta Fjala	7	RTV 21	7
Gazeta INTRO	1	Radio Televizioni Dukagjini/	2
Gazeta MONITOR	1	RTK (TV kanalet + Radiot)	41
Gazeta OBSERVER	5	Radio Vala Rinore	3
Insajder	2	Telegrafi	2
Indeksonline	6	Televizioni Rrokum	2
Klan Kosova	13	Tribuna Channel	5
Koha ditore	9	TV MIR	1
Kosova Sot	3	TV Syri Vizion	1
KTV	27	ZËRI	4
Portali Arberesh.info	5	Zëri i Amerikës (VoA)	1
Portali Ekonomia online	3	TOTALI	189

Tematika e kërkesave nga ana e mediave për deklaramë/intervista të Avokatit të Popullit, ka ndryshuar në varësi të lansimit të shkeljeve që kanë trajtuar Raportet e publikuara nga Avokati i Popullit, por po ashtu ka pasur ndërlidhje me dinamikën e zhvillimeve dhe diskursin publik të krijuar për çështje me interes për publikun.

Përgjatë tre mujorit të parë të vitit 2017 në fokus të kërkesave të mediave kanë qenë çështje përkitazi me personat me aftësi të kufizuara; me fëmijët (mbrojtja e tyre nga puna e detyrueshme); faturimi paushall i ujit (pas publikimit të Raportit për këtë çështje); rreth Masës së Përkohshme së Gjykatës Kushtetuese lidhur me Ligjin për Kundërvajtje sipas kërkesës së Avokatit të Popullit; çështje lidhur me pensionistët (përfshirë rastin Grudiq); lidhur me komunitetin LGBT; lidhur me faljen e të burgosurve; lidhur me zvarritjet në Dhomën e Posaçme në Gjykatën Supreme; gjendja shëndetësore e personave që mbahen në burgjet e Kosovës etj.

Në tremujorin e dytë temat për të cilat janë drejtuar mediat tek IAP kanë qenë gjithashtu të larmishme. Gjatë kësaj periudhe IAP është deklaruar rreth faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në komunat në veri të vendit, tek banorët në pjesët tjera të Kosovës (pas publikimit të Raportit të Avokatit të Popullit lidhur me këtë çështje); për kushtëzimet nga komunat për regjistrimin e automjeteve; për të drejtat e fëmijëve; gjendja e komuniteteve rom, ashkali, egjiptas; rreth shqetësimeve të ngritura sa i përket procesit elektoral (barazia gjinore, përdorimi i fëmijëve në fushatë etj); qasja në dokumente publike; etj.

Tremujori i tretë karakterizohet po ashtu nga deklaratimet rreth faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të vendit, si dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore sipas kërkesës së Avokatit të Popullit lidhur me këtë çështje; kërkesa për deklarime mbi raste palësh që kanë pohuar se kanë në proces të trajtimit raste tek Avokati i Popullit; shtëpitë e të moshuarve – monitorimi, strehimi, trajtimi; etj.

Në tremujorin e katërt fokusi sërish ka mbetur tek çështja e faturimit të energjisë elektrike, përfshirë aktvendimin e Gjykatës së Apelit për pezullimin e vendimit të ZRRE-së; gjithashtu janë kërkuar deklarime sai përket çështjeve që kanë bëjnë me diskriminimin; lidhur me dhunën në baza gjinore, ashtu siç edhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me Ligjin për Barazi Gjinore; gjendjen e komuniteteve rom, ashkali, egjiptas; të drejtat e fëmijëve etj.

Në përgjithësi, shumica e deklaratimeve kanë qenë intervistime dhe prani mediale e vetë Avokatit të Popullit, përderisa interesimi i mediave kryesisht ka qenë i orientuar në çështje të ngritura nga Avokati i Popullit nëpërmjet Raporteve të publikuara apo aktiviteteve të zhvilluara. Të shpërndara sipas muajve, kërkesat e mediave për deklaratimet e Avokatit të popullit, kanë qenë si në Tabelën 5.

Tabela 5. Kërkesat e mediave për deklaratimet e AP, të shpërndara në numra, sipas muajve

2017	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Kërkesa të mediave	15	13	14	20	13	16	6	7	12	12	18	43

Në funksion të drejtpërdrejtë të partneritetit me mediat dhe me qëllim të diskutimit të përbashkët lidhur me çështje që ndërlidhin natyrën e punës ndërsjellazi, janë zhvilluar tre aktivitete të veçanta, të inicuar dhe organizuar nga Zyra për Komunikim me Publikun dhe Mediat, e me mbështetjen e sektorëve gjegjës, me qëllim mbarëvajtjen e tyre:

- Në maj 2017, shënimi i Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, - Tryezë me temën “*Reflektim mbi rolin e medias në dinamikën e proceseve shoqërore*”. Pjesëmarës

ishin kryeredaktorë, redaktorë, gazetarë dhe zyrtarë të Zyrave për komunikim publik në institucionet e nivelit qendror në vend.

- Në shtator 2017, -shënimi i Ditës Ndërkombëtare të të Drejtës për të Ditur - Forum Diskutimi me temën “*E drejta për të ditur - legjislacioni dhe praktika në Kosovë*”. Pjesëmarrës, kryesisht ishin gazetarë, zyrtarë lidhor ashtu siç edhe përgjegjës për qasjen në dokumente publike dhe njohës të fushës.
- Në dhjetor 2017, IAP ka organizuar seminarin për zyrtarë të njësive të të drejtave të njeriut dhe zyrtarë të komunikimit, të autoriteteve qeveritare në nivel qendror, me temën “*Roli i Avokatit të Popullit brenda strukturës institucionale në vend*”.

Po ashtu në fundvit, IAP ka bërë prezantimin medial, në një konferencë të veçantë për shtyp, të të dhënave preliminare të statistikave dhe punës së bërë përgjatë 2017.

Zyra për Komunikim me Publikun dhe Mediat menaxhon gjithashtu procesin e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike që i drejtohen IAP-së, si dhe procesimin tek palët të përgjigjeve të institucionit. Së këndejmi, gjatë vitit 2017, IAP ka pranuar 11 kërkesa. Të gjitha kërkesat kanë marrë përgjigje pozitive dhe palëve u janë dorëzuar dokumentet e kërkuara, në pajtim me kërkesat nga ana e tyre (në format fizik, në format elektronik, por herë herë edhe në të dyja format). Shumica e kërkesave janë drejtuar për më shumë se një dokument, e nganjëherë kërkuar të ndryshëm kanë kërkuar dokumente të njëjta.

18.Financimi

18.1 Buxheti i IAP-së

IAP është institucion i pavarur i cili financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit “*IAP e përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës*”.²⁷⁸ Po sipas kësaj dispozite ligjore, IAP-së i sigurohet buxhet i nevojshëm shtesë edhe për rastet e shtimit të obligimeve dhe kompetencave me këtë ligj dhe ligjet tjera, respektivisht edhe burime shtesë përkatëse dhe adekuate financiare dhe njerëzore.²⁷⁹

18.2 Financimi i IAP-së nga Buxheti i Republikës së Kosovës

Duke u bazuar në procesin ligjor për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës së rregullt buxhetore, Avokati i Popullit e ka parashtruar kërkesën e vet buxhetore për vitin 2017 në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kërkesa buxhetore e Avokatit të Popullit për vitin 2017, është përgatitur mbi bazën e planit të punës dhe të aktiviteteve të planifikuara për realizim nga ana e IAP-së. Buxheti i IAP-së në fillim të vitit fiskal buxhetor të vitit 2017 është ndarë në masën monetare prej

²⁷⁸ Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, neni 35, paragrafi 3.

²⁷⁹ Po aty.

1.336.218.99 €, dhe ky buxhet iu është ndarë IAP jo edhe plotësisht sipas kërkesës buxhetore të vitit 2017.

Pasqyrimin e buxhetit të IAP për vitin 2017, sipas kërkesës buxhetore, të buxhetit fillestar dhe të kursimeve dhe shpenzimeve buxhetore do t’u paraqesim në formën tabelare dhe me të dhëna të përgjithshme sipas kategorive ekonomike buxhetore. kurse, raportin dhe pasqyrimin e detajuar të të gjitha rrjedhave në buxhetin e IAP-it për vitin buxhetor 2017, sipas të gjitha kategorive ekonomike buxhetore dhe nënkategorive të veçanta ekonomike buxhetore, do t’i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës mbi bazën e formularit të unifikuar për raportime financiare nga institucionet e pavarura, ashtu siç kërkohet çdo vit buxhetor nga ana e Komisionit për Buxhet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.²⁸⁰

Në tabelën si në vijim e paraqesim buxhetin e IAP-it, duke filluar me *Kërkesën buxhetore, buxhetin e ndarë*, në bazë të Ligjit për plotësimin dhe ndryshimn e Ligjit, *deklarimin e kursimeve buxhetore nga IAP, shkurtimeve buxhetore me vendimin e Qeverisë të Republikës të Kosovës në muajin dhjetor 2017 dhe buxhetin final për vitin 2017.*

Tabela 1: Buxheti sipas Kërkesës buxhetore, buxheti i ndarë, deklarimi i kursimeve buxhetore nga IAP dhe shkurtimeve me vendim të Qeverisë dhe buxheti final për vitin 2017

<i>Kategoria Ekonomike</i>	Kërkesa buxhetore për vitin 2017	Buxheti i ndarë – fillestar për vitin 2017	Deklarimi i kursimeve buxhetore dhe shkurtimeve me vendim të Qeverisë	Buxheti Final për vitin 2017	Buxheti Final i vitit 2016
Paga dhe mëditje	1.034.002.00	920.365.99	100.000.00	820.365.99	596.477.50
Mallra dhe shërbime	390.353.00	324.353.00	34.500.00	289.853.00	326.720.26
Shpenzime komunale	25.500.00	25.500.00	0.00	25.500.00	22.992.22
Shpenzimet kapitale	66.000.00	66.000.00	51.000.00	15.000.00	50.200.00
<i>Gjithsej buxheti</i>	1.515.855.00	1.336.218.99	185.500.00	1.150.718.99	996.389.98

Planifikimi i buxhetit, shpenzimi i buxhetit dhe deklarimi i kursimeve buxhetore për vitin 2017 nga IAP është realizuar sipas nevojave të planifikuara dhe destinacionit të përcaktuar për plotësimin e nevojave dhe të aktiviteteve të punës të IAP-së, të cilat kanë qenë me

²⁸⁰ Raporti financiar i detajuar për buxhetin e IAP-së do t’i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas formularit unik për raportime financiare.

interes të sigurimit të ushtrimit të mandatit, të mbarëvajtjes të punës dhe funksionimit të IAP, kurse nuk ka munguar monitorimi dhe kontrolli i brendshëm në shfrytëzimin ekonomik dhe efikas të buxhetit.

Për sqarime, IAP për vitin 2017 ka bërë edhe deklarin e kursimeve buxhetore në këto kategori buxhetore:

- a) Paga dhe Mëditje në shumën prej prej 230.000.00 €,
- b) Mallra dhe Shërbime në shumën prej 34.500.00 €, dhe
- c) Shpenzime Kapitale në shumën prej 51.000.00 €.

Mirëpo, Ministria e Financave e ka administruar vetëm pjesërisht deklarin e kursimeve buxhetore të IAP, respektivisht MF e ka administruar plotësisht deklarin e kursimeve buxhetore për dy kategori ekonomike buxhetore: Mallra dhe Shërbime dhe ato të Shpenzimeve Kapitale, kurse e ka administruar vetëm pjesërisht deklarin e kursimeve buxhetore për Pagat dhe Meditjet për shumën prej 100.000.00 €, dhe jo për shumën e deklaruar prej 230.000.00€ siç janë deklaruar nga IAP .

Një nga kufizimet dhe pengesat kryesore të mos shpenzimit të buxhetit të IAP për vitin 2017 për kategorinë ekonomike të Shpenzimeve Kapitale dhe për shumën buxhetore prej 51.000.00 €, ka qenë papërgjegjshmëria e punës të Agjensionit Qendror të Prokurimit (AQP). Kufizimi dhe mosshpenzimi i këtij buxheti të IAP ka ndodhur për shkak të moszhvillimit të aktivitetit të prokurimit të centralizuar nga AQP, për furnizim me dy automjete të IAP. Përkundër përgjegjësi dhe obligimit ligjor të AQP, si autoritet publik përgjegjës për zhvillimin e aktiviteteve të centralizuara të prokurimit publik për të gjitha organizatat buxhetore të Republikës të Kosovës, ky agjension asnjëherë nuk e ka zhvilluar këtë aktivitet të centralizuar të prokurimit qendror për nevojat e IAP edhe përkundër të kërkesave të vazhdueshme të IAP, ose që AQP ta lejojë IAP që vet ta zhvillojë këtë aktivitet të prokurimit.

Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2017

Buxheti final i IAP për vitin buxhetor 2017 është realizuar në nivelin **80.66 %**. Në tabelën vijuese është praqitur gjendja e buxhetit final në raport me shpenzimet buxhetore për vitin 2017. Paraqitja tabelare e të dhënave buxhetore është sipas kategorive ekonomike dhe sipas shpenzimeve të shprehura në përqindje.

Tabela 2: Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2017

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti Final për 2017	Buxheti i shpenzuar	Mjete të lira	Realizimi në %
1.	Paga dhe mëditje	820.365.99 €	653.807.19 €	166.558.80 €	79.70 %
2.	Mallra dhe shërbime	289.853.00 €	235.219.34 €	54.633.66 €	81.15 %

3.	Shpenzime komunale	25.500.00 €	24.525.01 €	974.99 €	96.18 %
4.	Shpenzime kapitale	15.000.00 €	14.647.50 €	352.50 €	97.65 %
Gjithsej		1.150.718.99 €	928.199.04 €	222.519.95 €	80.66 %

Financimi i IAP-së nga donatorët

Gjatë vitit 2017, IAP-i ka pasur donacione të ndryshme nga ana e institucioneve ndërkombëtare të cilat veprojnë në Kosovë, e sidomos: Këshilli i Evropës, OSBE, UNDP, etj.

Në mënyrë të veçantë duhet dalluar dhe emërtuar projektin-donacionin e Këshillit të Evropës, i cili ka ndihmuar IAP me katër këshilltarë të jashtëm ligjor lidhur me hartimin e raporteve të veçanta (ex-officio) për vitin 2017. Njëherit, në kuadër të këtij projekti janë realizuar edhe shumë trajnime e seminare për punonjësitë e IAP lidhur me arritjen e njohurive të reja me standartet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe për praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kurse nga OSBE duhet veçuar mbështetjen kryesore në ridizajnimin e ueb faqes të IAP, sipas nevojave dhe praktikave më të avancuara të teknologjisë informative.

19. Statisitikat

19.1 Përmbledhja statistikore e ankesave dhe rasteve për vitin 2017

Nga 1 janari 2017 deri më 31 dhjetor 2017, në selinë e IAP-së në Prishtinë dhe në zyrat rajonale janë parashtruar 1863 ankesa apo/dhe kërkesa për këshillë, a ndihmë juridike, nga qytetarët e Kosovës.

Numri më i madh i rasteve të hetuara nga IAP, gjatë periudhës raportuese, kanë qenë kryesisht përkitazi me: të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, të drejtën për mjete juridike, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, mbrojtjen e pronës etj.

Në tabelat e mëposhtme, në mënyrë të hollësishme paraqitet numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura dhe rasteve të hetuara, rasteve të zgjidhura, raporteve dhe letër rekomandimeve për rastet e hetuara, rekomandimeve të nxjerra në raporte dhe në letër rekomandime etj.

Tabela 1: Ankesat e paraqitura nga qytetarët në IAP gjatë vitit 2017

	Numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në IAP	1863
	<i>Numri i personave të përfshirë në ankesat e paraqitura²⁸¹</i>	3246
<i>Përkatësia etnike e ankuesve</i>		
	Shqiptarë	1628
	Serb	101
	Boshnjak	26
	Turq	25
	Ashkali	25
	Egjiptas	24
	Rom	22
	Të tjerë	12
<i>Gjinia e ankuesve të paraqitur në IAP</i>		
	Meshkuj	1381
	Femra	482
<i>Autoritetet përgjegjëse ndaj të cilave janë drejtuar ankesat (një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)</i>		
	Gjykatat	521
	Ministritë	509

²⁸¹ Një ankesë mund të ketë disa ankues, të cilët pohojnë se u janë shkelur të drejtat nga autoritetet publike

	Komunat	320
	Person privat	88
	Policia	86
	Prokuroritë Shtetërore	66
	Kompanitë private	52
	Ndërmarrjet publike	48
	Agjencia Kosovare për Privatizim	40
	Autoritetet e huaja	27
	Të tjera	233

Tabela 2: Ankesat e shpallura të papranueshme gjatë vitit 2017

	Numri i ankesave të shpallura të papranueshme	992
<i>Baza ligjore e papranueshmërisë së ankesave bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit</i>		
	S'ka shkelje, keqadministrim - Neni 22, pika 1.1	292
	Mosshfrytëzim i mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.4	264
	Në shfrytëzim të mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.3	227
	Jashtë juridiksionit - Neni 21, pika 1.3.1	155
	Mosinteresim, dështim i palës - Neni 22, pika 1.2	49
	E parashtruar pas afatit ligjor - Neni 21, pika 1.3.2	5

Tabela 3: Rastet e hapura për hetim IAP gjatë vitit 2017

	Rastet e hapura për hetim nga ankesat e paraqitura të qytetarëve	871
	Rastet e hapura sipas detyrës zyrtare (Ex. Officio)	60
<i>Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hetuara</i>		
	Shqiptarë	733
	Serb	71
	Boshnjak	13
	Egjiptas	13
	Turq	12

	Rom	12
	Ashkali	10
	Të tjerë	7
<i>Gjinia e ankuesve bazuar në rastet e hetuara nga IAP</i>		
	Meshkuj	634
	Femra	237
<i>Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP (një rast mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)</i>		
	Gjykatat	298
	Ministritë	258
	Komunat	178
	Policia	39
	Prokuroritë Shtetërore	37
	Ndërmarrjet publike	21
	Kompanitë private	15
	Agjencia Kosovare për Privatizim	15
	Person Privat	8
	Autoritetet e huaja	3
	Të tjera	110

Tabela 4: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë (një rast mund të përfshijë më shumë se një shkelje të të drejtave të garantuara)

	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	261
	Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	159
	E drejta për mjete juridike	153
	E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	130
	Mbrojtja e pronës	108
	Të drejtat e të akuzuarit	56
	Të drejtat e fëmijës	37
	Barazia para ligjit	36

E drejta e qasjes në dokumente publike	25
E drejta për arsimin	17
Përgjegjësia për mjedisin jetësor	16
Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës	13
E drejta për jetën	11
E drejta e martesës dhe familjes	11
Dinjiteti i njeriut	8
Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	7
Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes	6
Liria e lëvizjes	4
E drejta e lirisë dhe sigurisë	4
Të tjera	11

Tabela 5: Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura nga IAP gjatë vitit 2017 (jo vetëm rastet e vitit 2017, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)

Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura	713
<i>Baza ligjore e mbylljes së rasteve bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit</i>	
I zgjidhur pozitivisht, në pajtim me kërkesën e ankuesit - Neni 21, pika 1.5.	329
I papranueshëm, s'ka shkelje, keqadministrim - Neni 22, pika 1.1	129
I papranueshëm, në shfrytëzim të mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.3	101
I papranueshëm, mos shfrytëzim i mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.4	59
I mbyllur me raport	52
I mbyllur për mosinteresim të ankuesit, dështim i palës - Neni 22, pika 1.2	29
I papranueshëm, jashtë juridiksionit - Neni 21, pika 1.3.1	14

Tabela 6: Raportet me rekomandime nga IAP

	Raporte për rastet e hetuara (nga ankesat e qytetarëve)	20
	Raporte për rastet e hetuara <i>ex officio</i>	9
	Raportet e MKPT-së	11
	Letra me rekomandime	14
	<i>Rekomandime në Raportet dhe letrat me rekomandime</i>	133
	Amicus Curiae	3
	Kërkesë për masë të përkohshme	3

Tabela 7: Implementimi i rekomandimeve të nxjerra në raporte dhe letër rekomandimet për rastet e hetuara nga IAP

Autoriteti përgjegjës	<i>Rekomandi me të implementuara</i>	<i>Rekomandi me të paimplementuara</i>	<i>Në pritje për implementim</i>
Ministria e Drejtësisë	3	7	17
Ministria e Shëndetësisë	7	4	5
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	0	3	3
Ministria e Punëve të Brendshme	0	5	0
Ministria e Arsimit	3	1	0
Ministria e Administratës Publike	1	2	0
Ministria e Financave	0	1	0
Qeveria e Kosovës	4	0	4
Kuvendi i Kosovës	0	0	2
Komuna e Ferizajt	4	2	1
Komuna e Prishtinës	4	2	0
Komuna e Shtimës	2	0	2
Komuna e Istogut	0	1	0
Komuna e Podujevës	0	1	0
Komuna e Shtërpçës	1	0	0

Komuna e Lipjanit	0	0	1
Komuna e Klinës	0	1	0
Gjykata e Apelit	1	0	8
Gjykata Themelore në Prishtinë	1	1	1
Gjykata Themelore në Ferizaj	1	1	0
Gjykata Themelore në Prizren	1	0	0
Gjykata Themelore në Mitrovicë	1	0	0
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	2	0	0
Gjykata Supreme e Kosovës	0	1	0
Prokuroria Themelore në Prishtinë	0	0	2
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	0	4	3
Këshilli Prokurorial i Kosovës	0	2	0
Zyra e Rregullatorit për Energji	1	0	1
Policia e Kosovës	0	0	1
Akademia e Drejtësisë	0	1	0
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	1	0	1
Universiteti “Kadri Zeka”Gjilan	1	0	0
Universiteti i Prishtinës	1	0	0
Banka Qendrore e Kosovës	1	0	0
Gjithsej	41	40	52

Paraqitja grafike e statistikave 1 janar 2017 - 31 dhjetor 2017




Figura 1: Shqyrtimi i ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2017




Figura 2: Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2017




Figura 3: Gjinia e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2017




Figura 4: Autoritetet përgjegjëse të ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2017




Figura 5: Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hapura për hetim gjatë vitit 2017




Figura 6: Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP




Figura 7: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë




Figura 8: Rastet e mbyllura nga IAP gjatë vitit 2017 (jo vetëm rastet e vitit 2017, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)




Figura 9: Implementimi i rekomandimeve të nxjerra në raportet për rastet e hetuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit